

FARUK MYRTAJ

Marrëveshje për të jetuar

trëgime
enovelë

4.3.1951
FARUK MYRTAJ



MARRËVESHJE PËR TË JETUAR

Tregime e novelë

46M7

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Letra për të dashurën e tjetrit

I

Për të dija vetëm se quhej Devi. Vetëm kaq. Çdo gjë tjetër që mund të thosha, kishte të bënte vetëm me pamjen e tij të jashtme. Sa herë dilja për ndonjë punë apo për të takuar dikë në qendër të qytetit, gjithnjë do të më kapte syri një djalosh të gjatë, brun, me flokët kokoridhka, të veshur dukshëm më bukur e më me shije se rioshët e tjerë të moshës së tij. Këmishët dhe bluzat, ashtu si edhe pantallona,

të qepura ngushtë pas trupit të tij të drejtë, të mbushur e harmonioz, ta têrhiqnin syrin menjëherë. Diku, në vende të dukshme të këmishëve apo bluzave, në xhepat e tyre dhe të pantallo nave të tij, gjithmonë shihje një lulkë të qën-disur apo një zburim të stampuar.

Deri atë ditë kur më kërkoi dhe më takoi, e kisha njatjetuar këtë njeri, Devin, vetëm e vetëm për hir të kësaj dukjeje të veçantë. Sa herë që përballeshim, tek shëtitnim, e vështronim për pak çaste njëri-tjetrin dhe përshëndeteshim me zë apo thjesht me gjeste, kur ishim më larg, si dy njerëz që mendojnë mirë dhe ia duan të mirën njëri-tjetrit. Dukeshim sikur të dy i ishim mirënjoës njëri-tjetrit, por për ç'arsye apo shkak as ai e as unë s'mund ta thonim.

Megjithatë, sapo më shprehu dëshirën për të ndenjur bashkë atë pasdite, dëgjova veten time që t'i përgjigjë se kjo ishte edhe kënaqësia ime.

Pas disa minutash të bisedës sonë po mendova se nuk ishte aq simpatik sa e kisha menduar më parë. Po kjo vinte ndoshta ngaqë kushedi përsë pata pritur që ai të fliste po aq bukur e këndshëm sa edhe vishej.. Në të vërtetë edhe ai vetë torturohej për ta zbutur këtë dobësi të tij.

— Si i keni punët?! — e pyeta më në fund, kur edhe heshtja s'po sillte dot gjë. Kishim folur për skuadrën e futbollit të qytetit sa për të dalë atje ku duhej të dilnim.

- Dua edhe unë një vajzë! — i tha ai.
— Po ajo ju do?
— Edhe ajo, por ... të mos e mundojmë njëri-tjetrin. Unë e di që ti, po të duash, mund të më ndihmosh që ajo të më dojë më shumë.
— E njojkam unë atë vajzë?!
— Jo, jo, — tha Devi me të shpejtë. — Ajo është nga qyteti. Po ti më shkruaj ca letra mua!

Më lindi dëshira të tallesha nga pak me këtë djalurçinë që kërkonte t'ia rregullonin dashurinë të tjerët me letra, por ai ishte tepër serioz, madje mua m'u duk se pikërisht ky shqetësim e kishte detyruar ta rriste zellin e të veshurit bukur.

— Ajo është nga qyteti, më kuption? — përsëriti ai. — U njohëm në një dasmë dhe kercyem shpesh bashkë ... se unë di të vallëzoj bukur. Ajo më do mua, por e ka të vështirë ta lërë qytetin e të vijë këtu. Më tha se lexon shumë libra, prandaj them se mund t'ia prish mendjen me letra të bucura, me vjersha... më kuption?! — Devi tani po fliste rrjedhshëm fare, po me një logjikë të tillë, që më bënte të mendaja se çdo gjë që do të më thoshte paskëtaj unë do ta besoja, pa dyshuar nëse kishte ndodhur apo jo. Nuk e dija se ç'do të ndodhët me këtë riosh pas pesë apo dhjetë vjetësh, por e shihja qartë se tani që po më kërkonte të shkruaja vjersha dhe letra dashurie për të dashurën e

tij, ai mund tē mbahej pranë si lodër e bukur zbavitëse.

I kërkova menjëherë tē vinte nē shtëpinë timë. Ai natyrisht nuk më kundërshtoi. I kërkova gjithashtu tē më fliste pér një orë rrësht pér qytetësen e tij: si e kishte emrin, mbiemrin, flokët (dendësinë e këtyre, ngjyrën, gjatësinë, butësinë apo ashpërsinë, si i krihte, a i rrëzonë balluke mbi ballë apo i lindhë mbrapa, bishtkali), cilat komplimente i pëlqenin, nē cilat poza e profile i pëlqente më tepër t'i bënte fotografitë, pëlqente më tepër një akullore dhjetëshe apo një pastë, një shëtitje apo një film, çfarë sysht kishte? Ngjyrë deti, tha menjëherë Devi. Po tē cilit det, e pyeta unë. Si tē cilit det?! ngriti supet ai. Tē detit Adriatik, shtoi duke buzëqeshur. Jo, jo, e kam fjalën tē detit nē dimër apo nē verë, tē detit nē mëngjes apo nē mesnatë! Më kuption, i thashë, po tē pyes pér tē gjitha këto se, ndryshe, as vjershat, as letrat nuk do tē na dalin gjë. Se pér dashurinë kanë rëndësi vjershat me detaje tē vërteta. Ç'rroba mban ajo, ç'lloj fustanesh ka e cilat pëlqen më tepër? Në ç'ngjyrë, nē ç'kohë jeni njohur, kur, si? Ç'nuk pëlqen ajo t'i përmendim, përse? Ha shumë? Ç'peshë kâ, a ka harmoni fizike? Sa e gjatë është? Ka ndonjë cen? Hundën ... Normale? Hajde, mos qesh, s'kemi kohë, i thashë prerë Devit. S'e kam vënë re saktë, pranoi dobësinë ai. As pér dhëmbët e dhëmballët e dukshme nuk dha dot përgjigje tē saktë. Në gjendje tē

turbullt tha me mëdyshje apo me një gjysmë sigurie se qytetësja e tij përdorte pak parfum.

Boll, i thashë, nuk ka nevojë më. Sa për letrat e para, mjaftojnë. Vetëm se tani do të dëgjosh kushtet e mia. I pari: Askush, më merr vesh, askush ... asnjeri ... as ajo vetë nuk duhet ta dijë se ty t'i shkruaj letrat unë! Qartë?

Kushti i dytë: Pasi t'i kopjosh, origjinalin e letrave do të ma kthesha mua!

Nesër eja merr letrën e parë, i thashë. Çohu, ik tani!

II

Letrat e para dukej që i bëra të sakta e të ndjera, se Devi ishte aq i mrekulluar prej tyre dhe prej përgjigjeve që merrte, sa vinte tek unë tërë gaz dhe, megjithëse përpinqesha që të mos e bënte këtë, më lexonte shumë pjesë prej përgjigjeve të saj. Ajo merrte letra jo më pak se dy herë në javë dhe kthente po aq përgjigje.

*Ti kot nuk më ke shkruar me kohë, qysh
në fillim, Devi dashur, i shkruante ajo, në letrat
ti zbërthen shpirtin dhe zemrën e një njeriu
100 herë më të bukur se të atij që duket në
sytë e mi.*

Nisa edhe unë t'i lexoja letrat që m'i kthen-
te Devi pasi i kopjonte, dhe mahnitesha në af-

tësinë time për të depërtuar aq thellë në botën shpirtërore të një njeriu që nuk e kisha takuar kurrë. Dashuria e Devit dhe e asaj vajze të panjohur pa e kuptuar kishte zbuluar tek unë mundësi që kurrë nuk i pata përfytyruar.

Devi nuk dinte si të ma shprehte mirënjojen. Ai dashuronte tanimë në një mënyrë disi tjetër. Përpara se të nisej për te qytetësja e tij, mbyllej e i mësonte përmendsh letrat që i kishte dërguar së fundi asaj; në asnje mënyrë nuk duhej të linte vend për dyshime.

Dalëngadalë ai i bëri të vetat shprehitë që përdoreshin dendur në letrat, filloj të përshtaste edhe vetë vargje, sipas atyre që i pata shkruar unë, për të dashurën e tij, filloj kështu të mos ndihej më si dikur inferioriteti i të folurit të tij ndaj dukjes dhe veshjes trupore. Ia shkova ndër mend se ai mund të provonte të niste vetë letra për vajzën që donte, po kjo sesi iu duk. Sikur u tremb, u hutua, nuk reagoi dot menjëherë, pastaj nisi të qeshte me zë të lartë. Jo! Nuk donte ta prishte punën tani në fund fare, kur ishte bërë njohja familjare dhe të dyja palët dukej se ishin të kënaqura që kjo dashuri nuk ishte bërë pa mend në kokë.

Në një nga këto ditë e pashë Devin në rru-
gë me një vajzë. Sipas të gjitha gjasave besova
se do të ishte e fejuara. Ajo?! e pyeta më
vonë, kur doli i vetëm. Jo, jo! Ishte një ku-
shërirë e saj. Ngjan shumë me atë.

Ndjeva lehtësim. Nuk do të më vinte hiç
mirë sikur të kishte qenë ajo, së cilës i kisha

shkruar dhjetëra letra dhe ai të mos më prezantonte më të, kuptohej, jo si autor i letrave, po thjesht si një shok i tij. Më dukej krejt e ligjshme kjo dëshirë.

— C'ne! — tha Devi. — Të ishte ajo dhe të mos e takojë ti? Budallallëqe! Ku të shkon mendja!

III

Natyrisht që më kishte gënjer. Pikërisht ajo pati qenë. E dashura, e fejuara dhe tanigruaja e tij. Por unë më vonë e mora vesh...

Ishë martuar në fund të korrikut. Me dasmë të bujshme, si për ta kurorëzuar atë dashuri po aq të veçantë. Ashtu siç e prita unë, nuk më ftoi në dasmë. Në të vërtetë unë e kisha pritur me kureshtje dhe dëshirë njohjen me atë vajzë që erdhi nuse në qytetin tonë të vogël. Nuk mund të fshihja dëshirën për të qenë, me gjithë zemër e them këtë, në dasmën e tyre. Sepsë i njihja aq mirë të dy dhe isha bërë shok, shoku më i afërt i të dyve në këtë dashuri.

Asaj nuk i hedh asnje faj, ndonëse dyshimi im është aq i madh, sa hija e tij nuk ka sesi të mos bjerë edhe mbi vellon e bardhë të nusërisë së saj. Ata më kishin treguar çdo gjë mua, më ishin hapur për gjënë më të shtrenjtë e më të bukur, për dashurinë, e cila (më vonë këtë doja ta theksoja e ta përsëritja), pa ndër-

mjetësinë time, mund të mos kishte fituar pjeturinë dhe kurorëzimin.

Dikujt do t'ia tregonin dashurinë, kjo dihej. Doemos do të ndodhët kjo. (Dikush madje e kishte shpalluar pas vdekjes së të dashurit.) Devi ma tregoi mua. Ndoshta m'u hap ca më tepër se duhej në fillimet ... atëherë kur ai ende s'e kishte plotësish dashuri dhe unë pranova t'ia shkruaja letrat për qytetësen thjesht për kureshtje... Po kjo nuk i doli keq; unë edhe pas martese e shoh që shëtit i qeshur dhe i kënatur me të!

Kalojnë pranë meje dhe hiç. Asnjë fjalë! Asnjë përshëndetje! Përse vallë?!

Më mirë të mos i kisha shkruar ato letra!

Devi më vinte re që larg, po, kur ndodheshim afër, ulte sytë ose vështronë përpara drejt.

Fytyra e tij kishte dy sy të plogësht dhe i mungonte ai mirëbesim i dikurshëm ndaj meje. Për mirën johje as që bëhet më fjalë, madje unë pres ditë të këqija në këto marrëdhënie. E kup-toj fare mirë që pikërisht ajo që dikur e bënte të ngrohtë, të qetë, të gëzuar e mirën johës ndaj meje, tani vepron në të kundërt. Letrat e dashurisë për të dashurën e tij, që tani e kishte grua, e bënin të ftohtë, e trazonin, e trishtonin, e bënin dyshues dhe i ngjallnin hamendje të liga.

Ah, zemërngushtë, i thosha pa zë, kur përballeshim në rrugë dhe ai bënte sikur nuk më shihte. Ti akoma nuk je i sigurt në dashurinë

e saj. Nuk e beson dot akëma se ajo të do ty
dhe vetëm ty!

* * *

Tamam si më parë, Devi vishet bukur dhe
me shije. Përsëri bie në sy, dallohet.

Po mua se përse më duket i zbehtë dhe ca
fatkeq. Rrobat me lulka dhe stampa më bëhet
sikur mundohen shumë për ta treguar të lir-
shëm e të qetë, siç janë të dashuruarit.

Me mua nuk përshëndetet më si dikur, kur
nuk e njihja, kur i dija vëtëm emrin dhe kur
nuk i ishim për asgjë mirënjoës njëri-tjetrit.

Dje u ndamë përfundimisht.

Erdhi më foli në shtëpi. Kishte veshur një
xhakavento të kaltër, një pulovër me ngjyra
dhe pantallona me kuti të spikatura që s'ia kisha
parë herë tjetër. Megjithatë mua m'u duk se
kishte nxituar. Rastësisht më shkuan sytë te li-
dhësat e këpucëve: Ah, jo! Të lidhura i kishte.

— Ja tek i ke! Të gjitha! Asnjë nga letrat nuk
të mungon! — i thashë kur u afrua pranë, bel-
bak si dikur.

— Po pate merak ti, i djegim bashkë! —
tha duke i shtrënguar fort me duar.

— Shko, shko! Kam besim se do t'i dje-
gësh vetë, — i thashë.

Dhe, më besoni, më erdhi keq për atë njeri.

Gruaja e Zimes

Pagat ndahen javën e parë dhe të tretë të muajit. Në këto dy ditë s'mungon asnjëri prej punëtorëve, prandaj Baçi i bashkimeve profesionale pikërisht atëherë gjente rast t'i mblidhët kuotat e organizatës.

Këto ditë në minierë nuk mungon as Razim Llapushi! Dhe kur është Zimja në punë, nuk ke pse bën apel për minatorët, aty i ke të gjithë.

Sapo lajmërohet me sinjal të veçantë ardhja e pagatorit, nga nëntoka fillojnë e dalin punëtorët e parë. Lënë veglat në depo, hyjnë me radhë në dushe dhe dalin të larë e të pastër

e me ça më shumë humor, që as vetë ata nuk e dinë nga u vjen. Shakatë ndjekin njëra-tjetërën duke qenë aq të mirëpritura e joshëse, sa midis tyre fare lehtë hyn e zë vend ndonjë llapje pa kandar apo ndonjë e sharë vendçë, nga ato për të cilat minatorët thonë se, ndonëse nuk janë të këndshme, i përmban vendi i punës.

Duket sikur askush prej gojëprishurve, që njihen e numërohen me gishta, nuk shkon ndër mend se aty përqark ka edhe gra. Nuk e mendon njeri aty të keqen e tyre. Gratë e minierës sikur nuk kanë veshë fare për të dëgjuar këto fjalë. Të sjellin ndër mend ata punëtorët e ble-tëve që pranë koshereve të hapura vazhdojnë shërbimet pa kurrfarë meraku prej zukamës apo rrezikut të tyre.

Po për disa kohë rresht midis grave që punonin aty u pa edhe një grua tjetër. Ajo vinte pikërisht në ditët e pagave dhe vetëm ato ditë.

Ajo rrinte mënjanë, me duart lidhur kryq mbi bark, me vështrimin ngulur atje, te gryka e galerisë, ku dilnin mihatorët.

* * *

Gruan e quajnë Verete. Nuk këmben fjalë me njeri. Gratë që punojnë në llambisteri e ftojnë të shkojë e të rrijë me to, por ajo bën jo me kokë. Era ia ngre te balli shaminë e

bardhë lidhur lehtë nën gushë, por ajo e rrëgullon prapë.

Pret të dalë dikush te gryka e galerisë, prandaj i qep sytë atje.

Ai që pritet, është Ramiz Llapushi. Veretja është gruaja e tij. Nuk ulet diku e ta presë ash-tu, sikur kërkon të lodhet ajo grua.

Koha kalon, po Zimja nuk po duket ende.

Të gjithë e dinë pse. Edhe Zimja vetë, edhe ajo Veretja, edhe të tjerët, e prapë ai vonohet.

— E ku çan kokë Zimja për pará! — thotë me zë dikush aty përballë.

— Pse, akoma nuk ka dalë, o Pako?!

— Si duket, vonohet për të dalë me përgjegjësit! — thotë ai që ka emrin Paskal 'dhe i flasin shkurt Pako.

Pakoja punon te gryka e galerisë. Veg të tjerash, ka për detyrë të numërojë sa njerëz hyjnë brenda, në galeri, në fillim të ndërrresës dhe sa dalin prej andej në fund të tetorëshit.

Po ti hajde, merri vetë lekët e Zimes, i thotë prapë pagatori Veretes. Lekët e tët shoqi i ke, s'i ke të botës! Por ajo nuk e pranon as këtë. Ja! Do të vijë vetë ai... Zëre se ka dalë... thotë ajo duke përshtpjëritur e pshërëtirë njëkohësisht.

— E, mirë, prit ti, prit — s'duron dot dikush aty. Ai flet si i zemëruar, sikur, po ta kishte aty përpara Razim Llapushin, do t'i përplaste turinjve të paktën ca pëllëmbë, aty, në sy të gruas së tij, që rri si e mpirë, në këmbë.

— Mos kushedi hap ndonjë galeri nga ana tjetër dhe ia mbath andej Zimja! — shton një zë tjetër. Duket sikur këta njerëz bëjnë ç'është e mundur që me anën e shakave t'ia shkurtojnë e t'ia lehtësojnë pritjen Veretes së pagojë. Dhe, krejt padashur, ajo e ka kapur veten duke buzëqeshur me shakatë e tyre. Sikur ato të mos kishin të bënin fare me burrin e saj.

Përse u martove prapë, moj qyqe?! Përse, i thoshte vetes. Të kishe gjetur ndonjë për të qenë, hajde de, po këtë...

Te gryka e galerisë dalin vagonët e fundit. Makina ngritëse pushon zhurmën. Në njërin nga vagonat e sapodalë diçka është shkruar me shkumës të bardhë. Ajo e lexon menjëherë: *A e mbaroi rakinë e klubit Zimja??*

Pakoja nxiton dhe e fshin fjalën e fundit, emrin e Zimes.

— Do më mbarojë mua njëherë, — thotë ajo me zë të ulët, me duf, për vete, — pastaj do mbarojë rakinë. Akoma nuk po del nga galeria. Mbase nuk del gjallë, — shton me po atë duf e trishtim, po një çast më vonë qorton veten që kishte menduar e ishte shprehur ashtu. — T'u thaftë gjuha gjer në rrëzë, dëgjove, — mallkon veten, — as hasmit nuk i thuhet ashtu.

Ishin martuar pak muaj më parë, vetëm pak javë pas vdekjes në lindje e sipër të gruas së parë të Zimes.

Veretja nuk lindte vetë, po nënë u bë me fëmijët e të shoqit. Syrin nuk e mbyllte pa rënë

në gjumë ata. Nuk vinte gjë në gojë përpara tyre. Zimja më shumë s'vente se vente në punë. Ndiente erën e gjakut kur therej ndonjë mish dhe nxitonte atje të merrte lëkurën me çmim të lirë. E conte në rrëth dhe pas një pazari fitonte diçka. Këto i linte klubeve.

E rrahu gruan kur i erdhi ditën e pagave në minierë, por ajo nuk bëri zë. Erdhi prapë ditën tjetër të pagave, por ai nuk e preku më.

Më në fund dilte nga miniera si oxhakfshirës.

Fshihte sytë nën vetullat e trasha e të zeza si krahë mëllenje dhe bënte për nga depot për veglat. Një grua tjetër edhe e gjej, i thoshte sa herë vetes, po pse t'i zemërohem kësaj fatzeze, pse? M'i do fëmijët si t'i ketë mbajtur vetë në bark. Ç'dua tjetër unë?

Po pse s'punon atëherë, more qen, i kthehej vetes, kur firmoste në bordero për gjysmën e parave që mernin të tjerët. Fëmijët po, ja edhe gruan e dashke, atëherë shtroje kurrizin. Apo do të bëhen dy-tre nga këta çikbirët e sektorit dhe të të shtrojnë në hu?!

Kot bëhesh merak më. Pse erdhe, i thoshte asaj.

Ai ecte dy-tre hapa përpara, ajo e ndiqte nga prapa. E urtë, e bindur.

Se ti bëhesh xurxull po pate para në xhep, i thoshte ajo me mend, por pa kthyer asgjë në fjalë.

Për tre muaj rresht e bëri këtë punë ajo grua. Zimja e duronte, por edhe pa raki nuk

rrinte dot. Merrte borxh derisa, duke mos i shlyer, nuk i jepnin dot më. Borxhet nuk ia kërkonte njeri, se u vinte keq për të. Vdekja e gruas së parë sikur ia kishte prishur të gjitha gjërat e mira që kishte pasur. Edhe si minator ai nuk kishte shkëlqyer kurrë. Vinte në minierë se diku duhej punuar.

Në këto kohë Zimen e kishin dëgjuar t'i kërkonte borxh një të deklasuari që punonte në minierë.

Edhe ata njerëz janë, si të gjithë, kishte gjykuar Zimja. Unë para i marr, para i jap. Ar-mik s'më bën dot ai mua, ápo jo??

Te Zimja vesi dhunonte njeriun, duke shpëllarë fytyrën e tij dhe duke e shndërruar pa e kuptuar.

Zimja i kërkoi borxh disa herë dhe, për çudi-në e tij, që «armiku» që nuk ia dha! Nuk mund, s'kam tepër! S'më, del... i tha ai. Zimja i kërkoi prapë, i sigurt se më në fund do t'i merrte, por prapë u gabua. Kur humbi shpresën, ta dëgjoje Zimen ç'i këpuste. Ç'i bën paratë, ti, ë? Ku i prish gjithë ata lekë që merr ti? E? Se ty njeri, miq a shokë, nuk të vijnë në shtëpi, ku i prish, xhanëm? Kush ta dhjet shtëpinë ty? Hale! Hua t'i doja, ditën e rrogës t'i jepja. Tani, edhe po të m'i japësh, nuk t'i dua. Mut!

Prej asaj dijtë nuk kërkoi hua asgjékundi. Dhe gruaja e tij nuk erdhi më ditën e pagave. U mor vesh se Zimja paskëtaj çoi në shtëpi edhe qindarkat. Madje thuhej se ajo grua i blin-

te raki që burri ta pinte në shtëpi të vet, por i jepte edhe lekë Zimes, që ditët e festave të mos ndahej me shokët e punës, të pinte një gotë me ta.

* * *

Jo vetëm gratë e minierës, por edhe shokët e pyesnin Zimen për gruan. Jo, jo, nuk e kam mirë, u tha një ditë ai, kokulur dhe ata vunë buzën në gaz. As që do t'u besohej pak kohë më vonë se kur Zimja të shtrohej e të bëhej njeri, ajo, Veretja, do t'i vdiste.

Razim Llapushi ia bëri të gjitha nderet Veretes. Sytë e tij, të zinj sterrë, të papërqendruar, vështronin si të përhumbur. Sikur u gërmuq brenda atyre ditëve. Nga puna mungoi ca si tepër dhe, kur dëgjuan se kishte filluar prapë të pinte alkool, në punë besuan se Verete tjetër nuk gjendej më.

Po Zimja erdhi në punë e kërkoi që mungesat t'ia llogaritnin si leje vjetore. Punoi që atëherë si i pagojë, nuk pyeti për asgjë, për ditë të tëra as nuk iu përgjigj njeriu. Rinte mënjanë, shkonte e punonte ku i thoshin, nuk ia vinte veshin sa i hidhnin për djersën që derdhët, s'e vriste mendjen për asgjë. Kështu thoshin shumica, por ai vagonisti që punonte me Zimen betohej se kishte dëgjuar ngashërimet dhe të qarën e tij nëpërmjet pusit.

Askush nuk i ra në qafë. E lanë siç donte, në punën e tij. Hynte nën tokë dhe s'dilte nga

galeria apo pusi derisa i bërtithin të nxirrte çekiçin, që ta hidhte në vagon, po të mos donte ta mbartte në krahë deri në sipërfaqe.

Kishte ndodhur edhe kjo e fundit: kur i kishin folur nga poshtë pusit vertikal, nuk ishte ndier, «ikni, se vij avash-avash», thoshte pasi ulte çekiçin. Dhe dilte vonë fare, kur në sipërfaqe s'gjente njeri nga ndërresa e tij. Si dikur, kur i vinte Veretja dhe merrnin bashkë lekët e nise-shin për në shtëpi.

Atë ditë kur shpërtheu gazi në llavën veriore, erdhën dhe e vunë përpëra Zimen. E nxorën jashtë, me të tjerët, duke pritur që të pastrohej ajri. U hoq prapë mënjanë, ndërsa punëtorët po grindeshin për ventilatorët e gjendur jashtë gatishmërisë nga avaria.

Befas, Pakoja alarmon se nuk ka dalë ende nga nëntoka Cef Karamani!

Të tronditura nga kjo e papritur, gratë e minierës nisën të këlthitnin. Askush nuk donte ta besonte këtë, por as të kundërtën nuk e provonte dot njeri. Dikush thoshte se Cef Karamani ishte lajmëruar, se ai duhej të ishte nisur, por ... në sipërfaqe s'ishte. Kjo ishte e vërteta.

— Gazi ka depërtuar kudo tan!... — tha di-kush.

— I gjori! Kalamaqtë! — shtoi një grua.

— Na lini dhe ju! Hajde, largohuni nga gryka e galerisë! — ngriti zërin përgjegjësi i ndërrresës.

Njerëzit u zhvendosën më tej, po kjo nuk

qetësonte asgjë. Ndienin sikur pas një çasti s'do të merrnin dot më frymë, sikur po u shteronte diçka në shpirt, zemra u punonte, por plogët, vetëm sa gjallonte.

— Po ne ç'do bëjmë, kështu do rrimë? — pyeti dikush. Nuk iu përgjigj njeri, prandaj dikushi doli prapë, por prapë nuk ia vari njeri.

— Dy-tre të tjerë e panë në sy sikur të kishte folur përralla. Pse, ne nuk duam të bëjmë diçka? thoshte vështrimi i tyre. Po ç'të bësh, or vëlla? Ti e di gazin e tepërt, hyn dot në të? Ne të gjithë njëlloj e kemi Cef Karamanin, po kush të lë të futesh në galeri tani. Kanë vënë njeri të ruajë hyrjen!

Në mes të heshtjes u dëgjua zëri i dikujt:

— Po Zimja, ej, Razim Llapushi ku është? Ej, Zimen, e ka parë njeri?

As Zimja s'na qenka?! Paska mbetur edhe ai brenda? O Paskal, doli apo nuk doli Zimja? Ti vetëm për Cef Karamanin na the!

Pakoja është mekur. Turbullira ia ka errur sytë, i ka marrë edhe gojën tani!

— Me këta sy e pashë që doli! Veç në paça lajthitur, a në më ka ardhur mua vdekja sonte!

Zërat që Zimja kishte dalë, ishin më të shumtët, por ata s'kishin provën: Zimja nuk ishte! Mosqenia vërtetonte të kundërtën. Njerëzit nuk e merrnin vesh njëri-tjetrin. Fjalët që thoshin nuk vlenin një lek dhe, kur kuptuan këtë, pushuan njëri pas tjetrit. Nuk flisnin fare. Kështu

secili qetësonte apo shqetësonte vetëm veten. Të vetmet punë që mund të bëheshin, vënia në punë e ventilatorëve dhe aspiratorëve për ajrim dhe lajmërimi i skuadrës së avaroshpëtimit të minierës, ishin bërë.

— Një! Një! Vetëm një njeri mbeti brenda! — u thotë me siguri Pakoja djemve të skuadrës së shpëtimit. Ata janë veshur me kundërgazet dhe zbresin nën tokë.

Pakoja vete e vjen. Ngre supet për Zimen, e shan, thotë se ai do t'ia ketë mbathur në shtëpi, por po vetë e largon këtë mendim... Po ku djallin është futur? pyet pastaj.

Fytyrat e njerëzve, të gjitha si eshkë atë natë, sikur morën zjarr kur nga galeria nxorën krahë e këmbë trupat e Cef Karamanit dhe të Zimes.

Zimja erdhi në vete më shpejt. Frymëmarrja e Cef Karamanit u ngjall me shumë mund, pikërisht kur njerëzit që po jepnin ndihmë, po e humbisnin shpresën për të.

Më vonë u morën vesh të gjitha. Zimja pati hyrë në galeri nga rrugëdalja e dytë: E kishte mbartur Cef Karamanin në shpinë gjersa ishte blokuar edhe vetë. Ashtu i gjetën ata të skuadrës së shpëtimit!

Cef Karamani thotë se ia ka Zimes borxh jetën, por askujt nuk i shkon mendja të thotë se në të vërtetë ai ia ka borxh Veretes, gruas së dytë të Zimes. Boshllëku dhe dhimbja për vdekjen e saj, ia lehtësoi Zimes të rrezikuarit e jetës së tij.

Nata e ditëlindjes

I

- Sonte i përgjova, — më tha Vilma.
— Cilët? — e pyeta duke parë se nuk po më vështronte drejt.
M'u duk se për pak çaste po vendoste: të më tregonte më tej apo jo. Ndoshta ngaqë unë isha gati ta lija në heshtje, se më bezdis për vete kur reshtja e të tjerëve, ajo vazhdoi të fliste:
— Atë pra... Ishte me atë bionden e kursit të dytë.
Aha, thashë me vete, me Mondin e paska!

— Nuk ke të drejtë t'i përgjosh, Vilma! — i thashë. Vetëm kështu mund të shpëtonte kjo budallaqe nga dobësia që e kishte pushtuar pas largimit prej tij.

— Si? Kështu thua ti, Sara?

— Po! Mendoj edhe që ti je pak torollake! — i thashë. — Të mbeti peng se u ndave prej tij! Tuhafe!

Vilma më vështronë me ca sy që sikur gjurmonin tek unë ndjenjën e keqardhjes. Sado e vogël, ajo do ta torturonte këtë vajzë, të cilën e njihja prej katër vjetësh.

— I ke përgjuar? Jo, këtë nuk ke të drejtë ta bësh! — ia preva rreptë. Doja t'i ngjallja asaj ndjenjën e zémërimit e, po të mundja, të urejtjes. Atëherë do ta kishte të lehtë të harronte jo më një njeri, por gjithë botën.

— As ai nuk ka të drejtë ta marrë nëpër gojë emrin tim dhe të thotë ç't'i vijë për mbarë për mua me vajzat që gjuan!

Vilma u kthye me shpinë nga unë duke kafshuar buzët që të mos shkrihej në vaj.

Mbuloi kokën me çarçaf dhe unë e lashë, nuk i fola më. M'u duk sikur sapo pranoi se edhe vetë kishte qenë gjah i Mondit.

Në fjetore kishte pak vajza të tjera. Pjesa më e madhe ishin përgatitur e kishin dalë përmbrëmjen e vallëzimit.

Duke dalë, më zuri syri një bionde me një fustan shumëngjyrësh, dhe u kujtova se këtë kishte përgjuar Vilma natën e shkuar.

M'u duk se më pa me vëmendje. Sikur e dinte se kishim folur për të. Unë e di, e di! Edhe me atë po tallet ai, më tha Vilma, po mua as që më shkonte ndër mend ta paralajmëroja këtë fyçkë, që po vonohej aq gjatë para pasqyrës.

Ah, Vilma, përse... përse? thashë me zë kur dola në sheshin e gjerë, ku rreshtoheshin brigadat e vullnetarëve...

II

Atë natë s'do ta harroj kurrë. Vilma u vonua tepër. Në dhomë rrinim me veshë ngritur. Ishim katër shoqe. Unë do të fle. Do ta shuajmë dritën tha Krista. Pak më vonë u çua dhe uli çelësin pa na pyetur ne dy të tjerat. Unë u ngrita dhe e hapa. Do lexojmë, s'na merr vesh, i thashë. Do prisni Vilmën, atë thuaj! Po prisni, prisni! Ka për të ardhur! Ajo bën qejf, ju.... Mbylle, Krista, i thashë.

Vilma me të vërtetë po e tepronte. Parandje-nja e së keqes po bëhej sunduese. Ajo më kishte thënë se Mondi kishte ditëlindjen. Aty, midis të tjerëve, kishte ftuar edhe Vilmën. Njiresh edhe me nënë edhe me motrën me këtë rast i kishte thënë ai. Po ti e paske prerë për po, apo jo, Vilma, i thashë. Po nuk e di sa më do ai se... m'u përgjigj turbull dhe mua m'u duk ca naive. Ti e di vetë ç'bën, i thashë. Vetëm mos u vono. Ne vajzat sepse kemi një lloj frike, a druajtjeje,

a dyshimi, ndiejmë një lloj pabesie apo pafuqie a kushedi çfarë natën! Vetëm mos u vono! Këtë më kujtohet mirë që ia thashë. Ndoshta kjo më torturonte, se ajo po vonohej, si për t'i dalë fjalë Kristës, që po flinte e qetë. E zuri gjumi edhe shoqen tjetër, u ngrita, shova dritën dhe rashë edhe vetë në shtrat, pa u zhveshur. Vilma, po ti duhet të vish, i fola duke përgjuar zhurmat e natës. Ngrita perden e dritares. Rruga që zbriste mes për mes qytetit «Studenti» shtrihej nën një dritë të zbehtë. Po ku të jetë Vilma në këtë orë, ku? Mos kanë mbaruar herët atje dhe ajo ka shkuar nga halla e saj? E, mirë, te halla e saj!

Dikur, duke pritur, m'u bë se po e goditnin me grushte dhe shqelma derën, madje sikur di-kush e kapte Vilmën për flokësh dhe ia përplaste kokën pas mureve të korridoreve. Kurse Vilma, çuditërisht, nuk qante, por qeshte. Po, po! Vilma qeshte si e marrë! Kërceva nga shtrati dhe u gjenda te dera. Ajo ishte e mbyliur. E hapa, askush pas saj. Korridoret të qeta

Kisha dremitur. Ah, moj Vilma, thashë. Mbylla derën, u zhvesha dhe rashë. Nuk kishte më kuptim të prisja. Mbulova kokën me çarçaf që të flija më shpejt, po m'u bë se më thërritnin nga mbrapa derës dhe trokitën lehtë. Na bëre me fiksime, Vilma, mendova duke qeshur me vete. Po prapë: «Sarita, Sara! Hapma derën» Fluturova atje.

Vilma ishte! Torollake, na çmende! Pse u vonove kaq? Rrinte e heshtur, m'i fshihte sytë. Ho-

qi pallton, këpucët, fustanin, më të bukurin që kishte veshur, mbathë pizhamet dhe prapë, pa më thënë asgjë, u shtri në krevat.

Mua, që e prita kaq orë, sikur të isha gur e jo njeri, s'më përfilli fare.

Pas pak minutash u çova edhe njëherë nga shtrati, se dëgjova dënesën e saj. Vilma, mos... mos, i pëshpërita. Nuk doja të merrte vesh gjë Krista. Mos, Vilma!

«Nuk kishte njeri në shtëpi. As ditëlindje nuk kishte Mondi. E mora vesh kur dera ishte mbyllur...»

Mos, Vilma! Mos fol më! Dhe ti qëndrove?! E besove edhe pas kësaj? Nuk e shqeve derën me thonj? Po ai më përsëriti se më donte dhe se do të dërgonte njerëz në shtëpinë time për të më kërkuar, por... ti e kuption, Vilma, më tha, unë dua të bindem përfundimisht se... vetëm mua, më kuption? Dhe prapë i besove, Vilma? Iu binde?! Po! E besova, se unë diçka ndijeja përtë. Dhe unë vajzë e mirë isha, Sara, përsë ta lija të dyshonte për këtë?

Budallallëqe, të gjitha budallallëqe, i thashë, po në vetvete isha e bindur se Vilma kishte përrpara saj jo pak ditë, në të cilat, të paktën në ato, do ta ndiente veten të mashtruar. Të nesërmend Mondi nuk do t'i binte fare në sy, do ta zbehte dalëngadalë shoqërinë me Vilmën, pastaj, nëse kjo do të kërkonte pse, ai mund t'i thoshte se «kollaj i dukej asaj të martohej në Tiranë, brenda?!» apo, me zë të ulët dhe si me keqar-

dhje, do t'i premtonte se për darkën e ditëlindjes së paqenë nuk do të bënte kurrë në jetën e tij fjalë me njeri.

Tani Mondi priste bionden dhe kushedi ç'i përralliste asaj për Vilmën. Rrinin gjatë mbrëmjeve bashkë; në fjetore biondja kthehej shend e verë. Në këto çaste vështroja Vilmën, që do të donte të ishte e verbër, po nuk dija si të veproja. Kërkova gjatë disa ditëve një lloj hakmarrjeje dhe më në fund e gjeta. Nuk kishte asgjë të përbashkët me hakmarrjet e vjetra. As nuk do të shkoja të ankohesha te komisari i aksionit dhe të bëja që Mondin ta përjashtonin. Jo! Do të ishte diçka fare e thjeshtë, fare femërore...

III

Bëra gjithçka që të bija në sy të Mondit. Lëviza si ai grepi flutur, në ujë të rrjedhshëm, që josh peshkun.

Bëra ti shkonin në vesh disa konsiderata të miat për të. Në muzg fërshëlleva dhe këndova nja dy këngë spanjolle tepër ritmike pak hapa më tej vendit ku ai priste bionden e vittit të dytë. Ndryshova disa herë formën e flokëve, gjë që s'e kisha vështirë ta bëja, se i kam të butë e të epshëm. U përpoqa të krijoja tek ai mendimin se nuk më pëlgente asnjë kënaqësi kolektive. Për nja dy pikturna të vëna në mensë thashë se

mjet më të mirë për të na prishur oreksin s'kishte.

Më në fund peshku nisi të ngacmonte karremin: Biondja u kthyë herët në dhomë dhe jo e qetë. Madje m'u kthyë mua: «Ç'ke me Mondin ti?» «Unë me Mondin?! Pse, ç'jam unë, nga ato teneqetë e rrugës, ku shkruhet *hidhni mbeturina?!*»

Të nesërmen ai më ndali. Mond Vila, m'u prezantua.

— Uh, — i thashë! — Si 100 vjet më parë! Ç'më duhet emri juaj?! Apo provove që s'je shurdhmemec?

— Që të jemi në rregull, — tha ai.

— Në rregull me kë? — ia prita unë. Jam deri në grykë e ngopur me simetrinë. Dhe nënshtrimin ndaj opinionit e quaj skllavëri. Mos je gjë kundër?

— Jo! Jam i kënaqur, — nxitoi të thoshte.

— Unë nuk fola për të të kënaqua ty, — e ndërpreva.

— Më fal, u keqkuptuam.

— Keqkuptimet çojnë në zhvillim, — thashë unë duke e detyruar të zgërdhihej me dhëmbët e bukur.

— Unë jam njeri i lirë, — shtova. — Bëj ç'dua. Jo vetëm në shtëpinë time. Në qytetin tim më shohin që ulem në bordurat e trotuareve, e dinë që pëlqej të lexoj librat që sulmon kritika, dy vjet më parë mësova motorin dhe çuditem

përse ne e shohim me konservatorizëm futbollin e femrave!

— Ah, po më befasoni, — gati sa nuk thi-rrai ai. — Gjithnjë kam menduar se ne femrat i kemi të vogla, shtëpiake. Qofshi shansi im!

— Po më zhgënjeni, më duket. Tjetër kam dëgjuar për ju! Kaq i cekët?! Kurrë!

Dhe ika. E lashë si shtyllë betoni përpara fjetores së vajzave. Brenda biondja turfullonte si mushkë e ngjacuar shkurt, kurse Vilma më shihte e trishtuar dhe e gjëzuar njëherësh.

Të nesërmen më priti prapë. U mundua të sqarohej, dhe unë, si ata gazetarët që shkojnë diku vetëm për të kapur dobësi, e lashë të grinte.

— Vetëm mos bëni siç bëjnë rëndom djemtë naivë, — i thashë. — Vetëm të propozojnë e kanë mendjen!

— Në rregull — pranoi ai.

— Si në rregull? Kaq shpejt i ndryshoheni mendimet tuaja ju?! — ia shkurtova kënaqësinë. Nuk dinte nga të mbante. Fluger do të bëhej në çast, po kjo era që fryja unë s'kishte as orientim as djall.

— Cilën ngjyrë pëlqeni? — e pyeta.

— Blunë, — tha ai, duke parë veshjen time.

— Unë pëlqej ngjyrën e zezë! Cilin poet preferoni të lexoni? — thashë.

— Për tanët pyesni apo për të huajt?

— Pse, paskemi poetë ne?! — ia prita duke e ngrënë të gjallë me nënqeshjen dhe sytë

e mi, që nuk e fshehin dot përcëmimin. Por ai vazhdoi të më buzëqeshte.

— Jam e shkathët, apo jo?! — i thashë. — Jam edhe e bukur, edhe simpatike. Kam ballë të mermertë, sy të mëdhenj, elegantë... T'i them këto se nuk dua t'i dëgjoj s'i komplimente. Prej tyre më vjen për të vjellë!

S'kaloi pak dhe Mondi, pa e kuptuar, më kishte lëshuar dy komplimente radhazi. Ia solla ndër mend këtë gjë. Duhet të bëhesh i denjë përmua, i thashë dhe e lashë prapë aty, pa i dhënë as dorën. As natën e mirë nuk i thashë.

Në fjetore shkëlqeqja nga lumturia dhe biondja s'gjente vend të futej. Në mëngjes më erdhi të shtrati dhe më tha:

— Ndoshëta ti je më e bukur, por... ta dish! E mjera ajo. Ishte gati të kthehej te Mondi, edhe sikur njëzet herë ta largonte ai.

Ishte e kotë të mendonte ta ingranajo edhe bionden në lojën e hakmarrjes. Le të vuante ca.

Të nesërmen natyrisht që do të më priste para fjetores, po le të priste, s'humbte gjë. Pas një gjysmë ore dola për pàk te dera, sa për t'i thënë të priste edhe më. E lashë të priste jo pak, por ai duhej të qetësohej vetë, se të dashuruarit pritjen e kanë të dashurën e parë.

Nuk munda t'ia mbushja mendjen Vilmës.

Vajzat e tjera, që ishin në fjetore, më ndoqën pas. Na prij, Sara, më thanë.

Unë përpara, ato dy-tre hapa pas meje.

— Ikim?! — i thashë Mondit sapo arrita tek ai.

— Ikim! — tha ai, po zëri sikur i humbi midis të qeshurës së tyre. Do vijmë edhe ne. Të gjitha do vijmë me ju! Do vijmë, thoshin gjestet e tyre.

Ky qenka i pasur me mospasje, vajzani, dome-thënë ka ato që nuk ka, thashë unë.

Ai na vështron te të tëra njëherësh me sy të trembur. Midis nesh nuk kishte asnje të gjinisë së tij dhe kjo e bënte frikën e tij të veçantë. U zbeh në pak çaste, si e meitit iu bë fytyra. Po mendonte se, po ta kishin ndër mend ato, ai nuk do të gjente dot fuqi për ta shhangur një hakmarrje poshteruese, efektin e së cilës po e ndiente ndërkohë. Aty, para fjetores së dhjetëra vajzave, rrethi i të cilave, tanimë, duke u rritur edhe me studentë, po bëhej mbytës, ai sikur u ndodh përpara një trupi gjykues.

Ato çaste Vilma na vështron te prej drifores.

— Ah, ç'bëtë, Sara, më turpëruat përgjithnjë,
— më tha ajo kur u ktheva në fjetore.

E pashë si një të qmendur, por ajo nuk fliste qmendurira. Ajo tha se, sidqoftë, edhe pse ata dhjetëra studentë nesër pasnesër, atje ku të jetojnë, do të tregojnë për një Edmond të poshtër e të poshteruar, prapë, qoftë edhe për të konkretizuar këtë poshtërsi, do të thonë edhe për mua, Sara! Ti harron që femër jam unë, ne... jo ai!

Për tri ditë radhazi ajo nuk doli në punë.

Ditën e tretë, kur u kthyem në qytetë, nuk e gjetëm. Kishte lënë një shënim nën jastëkun

tim. *Ika, Sara. Le t'ju vijë keq të gjithëve pér mua. Paçi fat tjetër! Vilma*

Më vonë unë pyeta pér të udhëtarë të rastit, në tren, nga qyteti i saj. «Po si s'ë njohim», më thanë duke çakërritur sytë. «Eshtë ajo që e përjashtuan nga universiteti pér moral, apo jo?!»

Përpara tyre u ndodha e pafuqishme, nuk i kundërshtova dot. Pa e kuptuar, po e bëja! prapë fajtore, edhe unë si ata, Vilmën, pér natën e ditë-lindjes. Po, mirë e thashë! Natën e ditë lindjes të zhgënjimit të saj!

Aime çizme të grisura

Edhe sikur për çdo ditë të heqë brisk, Liman Aliu prapë do të duket i parruar. Ka një qime të tillë që të bie në sy edhe kur është e sapoprerë.

E keni parë gruan e tij, na thotë Gazaliu kur bie fjala për mjekrën e Limanit. Vetëm duke vrapuar e sheh. Nga shtëpia, në lagjen e jashtme të qytetit, deri në mapo, nga mapoja, në shtëpi, vetëm duke vrapuar. Nxiton t'i çojë briskun të shoqit, shton Gazaliu. Sa e afron Limani briskun te mjekra, brisku thyhet dhe ... vrap gruaja për brisk tjetër. Limani po, kuptohet, atje. Pse më dhe këtë qime, o zot!

Kështu thotë Gazaliu, por ata që dinë ca

më shumë për Liman Aliun, thonë se rrallë e gjen atë në shtëpi, brenda. Po e zure, e gjen ose duke hyrë ose duke dalë nga porta. Nuk di Liman Aliu të ulet e të rrijë, të bëjë muhabet, të dëgjojë radio apo të shohë televizor, siç bëjnë të tjerët.

Me mjekrën e ka rregulluar ndryshe. Në fund të javës rruhet, e kjo nuk e bezdis fare. Se mos kam punë zyre unë dhe duhet të jem i rruar e i kruar! Nga shtëpia në minierë, nga miniera në shtëpi, kush do më shohë, thotë Liman.

Kur thotë këto fjalë, ashtu siç rri shtrirë në një nga stolat e drunjta të barakës, fytyra e tij e mbufatur, plot rrudha e zhobra merr një dritë hidhnake, bëhet ca finoke dhe sikur s'e fsheh dot ngazëllimin e të zotit.

Pas pak e lë edhe stolin, shtron një copë kompensatë përdhe, mbi hirin e derdhur të sobës dhe bëlldunget mbi të.

Ka një pelje të vjetër të zbardhur qysh tri vera të shkuara, por që e fsheh vjetrimin nga andrat e hedhura kohë pas kohe. Tek zhgërryhet aty, në hi, i mbledhur kutullac, ngjan si një buburrec. Aty ngre kokën e vështron punëtorët që e kapércejnë, aty mbyll sytë dhe fle. Po, po! Fle me të vërtetë!

Edhe pantallonat i ka tërë arna, tërë të qepura, por ato që të bien më tepër në sy janë çizmet: Vetëm qafat u mbahen. Fundet e çizmeve janë ngrënë me kohë, janë hapur nga të dy-

ja anët. Të duket budallallëk që Liman Aliu të hyjë me to nën tokë. Atje ka ujë, mund të njomesh edhe me çizme të reja, jo me këto zhargë.

— Me ato çizme nuk punohet, — thotë dikush, i ulur në stolat.

— E po ç'të bësh, duam të hamë, duan të hanë kalamajtë! — thotë Liman Aliu duke hapur për një çast sytë, të cilët i mbyll përsëri dhe menjëherë.

Pritet të vijë përgjegjësi i ndërresës së tretë. Ai do të ndajë punën. Minatorët rrinë në barakë e ngrohen. Soba, e sajuar prej një kapaku vagoni të vjetër, është përskuqur nga flakët.

— Tutje, se do digjesh! — ngre zërin dikush, po Liman Aliu s'luan vendit.

— S'e gjen gjë atë, ja, shikoje! Dilet në këtë dimër me ato çizme?! Të grisura çizmet, të grisura çorapet, hajde merre vesh ku vete me këtë mendje ky njeri!

— I bën lekët raki e birrë, prandaj, — tha një nga të rinjtë pranë Gazaliut.

— Ç'i bini në qafë kot, — gjen shkak Gazaliu. — Deri para katër ditësh, kur u bënë rrogat, Liman Aliu nuk e dinte çmimin e shishes së birrës. Në daçi besoni, në daçi mos më besoni, — u drejtohet të tjerëve. S'ta pamë hainrin një herë, s'na dhe një grykë birrë, i thashë ditën e rrogave, merr gjithë ato para e s'na the një herë gëzuar! Sa i thashë këto, kur shoh Li-

man Aliu tē mē nxjerrē me duart qē i dridhesin dy njézetepesélekéshe tē reja e mē thotē: «Na, merri! Pi dy birra, mē thotē, njē me dyqindepesédhjetéshen e parē, njē me tē dytēn». Po njézet e njézet bējnē dyzet, more kōçimare, dyzet tē vjetér, jo peséqind. «Pse, nga sa bējnē birrat?» — mē pyeti dhe ju e dini, o shokē, se Liman Aliu nuk bēn shaka me lekē.

Liman Aliu e dëgjon mirē Gazaliun, dëgjon edhe tē qeshurat e tē tjerëve, por nuk i hap sytē. Dremit, por veshét i ka pipëz. Nuk flet, se e di qē kot tē flasë. Kthehet nē anën tjetér.

— Po tē doni, besomëni, — thotē prapë Gazaliu. — Kaq ka pér detyrë njeriu i mençur, sa tē tregojë! Mē tej secili sipas rradakes sē vet. Sa i nxē kotruvja, aq, jo mē tepér.

— Ty tē paskan zgjedhur mē tē mençmin sonte?! — thotē Lazja, përgjegjësi i ndérresës qē sapo ka dalë nga nëntoka.

— Unë po them nga ne, njerëzit e thjeshtë, pa pushtet, unë jam mē i mençmi! Përgjegjësit janë tjetér!

Lazja qesh bashkë me tē tjerët. Lë kapelen e llambën mbi dollapin e hekurt dhe i afrohet sobës. Do tē thajë djersët dhe ujin qē i ka pikuar mbi rrobat nē galeri.

— Shtoni ca dru zjarrit se do na e gjejë gjë përgjegjësin, — thotē Gazaliu. — Del dot kokërr minerali pa tē?!

Liman Aliu ende rri symbyllur, por e di qē i ka këmbët pranë kurrizit tē përgjegjësit, qē

po e nGRE avullin si mjegull. Ia ka parë Lazja
çizmet e grisura? Kushedi!

— Nesër na duhet fronti i gjashtë, o Ndreo!
— dëgjohet t'i thotë përgjegjësi një armatori.
— E bëjmë dot?

— Po pati dru të trasha dhe dërrasa, pse të
mos e bëjmë? — përgjigjet Ndreo armatori.

— Por pikon edhe ca ujë atje! — shton për-
gjegjësi.

— Do dalim të thahemi me radhë, — thotë
Ndreojë.

— Sa veta të duhen? — vazhdon Lazja.

— Tre boll i kam. Me gjithë veten.

— Hallall! — thotë përgjegjësi duke parë
Ndreo armatorin që del përjashta. Me siguri
shkonte për të zgjedhur drutë te stivat. — Ha-
llall lekun që merr! — shton prapë pastaj.

— Ari është, ari! Punë do, — thotë një tje-
tër.

— Punë do, por edhe punën e do! — saktë-
son një tjetër. — S'ka normë për të. Punën e tij
e kërkon vetë. E, po tha ai s'bëhet, lëre. Po haj-
de më thuaj një rast kur ka thënë s'bëhet.

— Gjysmat e punëtorëve të kishim si ai e
nuk do të kishim nevojë për përgjegjës, — thotë
më në fund Gazaliu, që si shumë priti të vazh-
donte biseda pa të qeshura. Po kësaj radhe as-
kush nuk qeshi.

— Vallahi, ashtu është! — thotë Lazja, për-
gjegjësi. — Po gjysma bëhen shumë. Çereku i
punëtorëve të jenë si Ndreojë...

— Mirë e ke, se duhen edhe ca si unë, pa edhe ca si Liman Aliu duhen.

— Ti bëj llogarinë tënde. Halen tënde shiko ti, ç'të duhet me mua? — u shkund Liman Aliu përmes të qeshurave.

Ngrihet në këmbë sikur ka ndër mend të grindet, po natyrisht që nuk ka për të ndodhur gjë. Gazaliu nxjerr dhe i jep një cigare. Liman Aliu e merr dhe, sikur të mos i mjaftojnë tërë ai prush i sobës, shkon dhe e ndez te cigarja e përgjegjësit.

E thith dy — tri herë dhe ulet mu përpara tij, në të ndenjura. I heq një nga një të dyja çizmet. — Lagështira i ka zbardhur, dhe fishkur këmbët. Kërkon t'i thajë te soba.

Përgjegjës Lazja nuk bën zë fare. Ose nuk e ka mendjen aty.

Liman Aliu than këmbët e dobëta dhe se ç'emer mërmërit me vete. Thonë se në këto çaste ai rikuhton borxhet që i kanë të tjerët. Ka merak borxhet e vogla. Ato deri në një mijë lekë të vjetër, ato dua të mbledh unë, se mund të harrohen! Kurse borxhet e mëdha e di që i kam atje ku i kam dhënë e një ditë do të m'i japid. Dhe thonë se nuk ka pak në librezë Liman Aliu! Paçka se rri ashtu, si kripan, pa një dyshkë. Po t'ia japid një ditë tërë paranë që ka, ai nuk do të dijë ta numërojë, thotë Gazaliu për të.

Për disa vjet radhazi, si minator, kishtë marrë para me të dyja duart, Vetë e priste mine-

ralin, vetë e rrëzonte me lopatë, vetë armatos-te galerinë. Djersinte e kollej nëpër galeri, dilitte në sipërfaqe për të pirë cigare dhe kollej edhe më keq. Por, kur merrte çekiçin, i errësöheshin sytë. Kur priste mineralin, i dukej se priste parâ. Merrte dhe donte edhe më tepër. Ia ngrinin shpesh normat, por ai osh hiqeji, me këmbë e duar, dhe e tejkalonte prapë. Prandaj s'më duan, thoshte për të tjerët, se u ngre normat. Dhe i shtonte hiletë, nuk i fuste këmbët e armaturave në thellësinë e duhur, rrëzonte mineral në fronte të afërtë, të ndaluara nga ata të sigurimit teknik. Do t'i bësh ilaqe tejkalimet që merr, i thoshte Gazaliu duke bërë shaka. Puno, tejkalo, po me karar, kot nuk ka vënë normë shteti. Edhe puna të bëhet, edhe njerëzit të jenë mirë.

Liman Aliu nuk hante ku hanin të tjerët, në mensë. Mbështillte diçka që në shtëpi në një plastmasë dhe përtypej atje në front të punës, në galeri, krrëp — krrëp! Të tjerët dilnin në sipërfaqe, hanin gjellë me mish, me yndyrë dhe kalori. Shtonin edhe nga njëëmbëlsirë. Po hajde në mensë edhe ti, or qyq, ngjalle këtë faqe të rreshkur, se, kur të shoh me tët atë, ju ngatërroj me njëri-tjetrin, i thoshte Gazaliu duke i qeshur afër hundës. Hajde, se ta paguaj unëëmbëlsirën!

Po fëmijët, thoshte Liman Aliu. Fëmijët do të të pështyjnë mbi varr kur të marrin vesh se ke

pasur kaq para dhe po i rrit si njerk, ia priste tjetri duke e vështruar si me frikë.

Liman Aliu aq herë ishte bërë gati të bënte si të tjerët, po krimbi i lekut e gjerryente thellç. Ato ditë që punonte, fundin e nxirrte, ditët e tjera ndihej i sëmurë, gjithnjë e më rëndë, përditë të tëra merrte raport mjekësor, blinte ilaqe dhe mëzi gjallonte. Por e merrte prapë veten, ngjaljej nga pushimi, nga shtëpia dhe, kur kthehej në minierë, fillonte përsëri tejkalimet, gjersa prapë merrte raport.

Erdhi një ditë që mori rekomandim për punë të lehtë, përgjithnjë. Paga mbeti po ajo, e larta, e ditëve kur ishte minator.



Çizmet, megjithatë, i mban të çara dhe këmbët të zbardhura nga lagështia. Ja tek po i fut në çorape pasi i ka tharë në prushin e sobës.

— E po kështu nuk punohet, de! — ngre zërin pastaj. — Me këto çizme nuk shkoj dot deri të stacioni i pompave. Të mbyt uji!

Lazja, përgjegjësi, e vështron vetëm për një çast. Pastaj vazhdon të ndajë punën për të tjetrët. Liman Aliu ngrë prapë zërin. Përse të mos më jepni një palë çizme jashtë radhe, thotë. Më janë bërë copë, shikoji vetë! Punohet me këto? Ja, shikojini edhe ju të tjerët.

Lazja dikë dërgon të punojë të pompat. Li-

man Aliu e dëgjon mirë këtë. Po mua, mua ku do të më dërgojë, pyet veten i alarmuar. Unë kam raport për punë të lehtë, nuk të shkoj në vend tjetër, ta dish! Ç'do të bësh me mua?

Mos më ka harruar fare, shton me vete, duke i dalë përpara përgjegjësit. Por ai nuk i bën zë fare. Sikur Liman Aliu të jetë bërë i padukshëm.

Ata që merrnin punë, largoheshin një nga një. Pasi iku dhe Gazaliu, edhe përgjegjës Lazja bëri për nga dera, pa i thënë asgjë Liman Aliut.

— Për punë kam ardhur edhe unë, o përgjegjës, — thotë më tepër për ta kujtar, se për t'u ankuar që vendin te pompat e kishte zënë me një punëtor tjetër.

— Po ti s'ke çizme, o Liman. Me ato zharga do hysh nën tokë ti?

— E po duan të hanë fëmijët edhe sot, o Laz. Ashtu, njomur pa njomur, do vete të punoj, ç'do bëj!

Liman Aliu nuk po e ngrinte zërin si pak më parë. Sa më tepër e tirrte fjalën, aq më shumë e ulte dhe e zbuste; aq sa, kur nuk kishte ç'të thoshte më, kur kishte përsëritur disa herë se nga e keqja ishte grindur, kishte prishur kot gojën pak më parë, fjalët e fundit nuk arrinë t'i artikulonte dot. Vetëm sa tundte kokën dhe duart dhe murmuriste kushedi çfarë, duke prekur me dorë çizmet e hapura, që sikur tallashin edhe ato.

— Ik sonte, Liman, ik! Qenke edhe i pagju-

më, më duket. Pa shiko edhe një herë se kushe-
di i gjen edhe një palë çizme të reja!

— Ç'të ka hedhur me mua, o Laze! Unë nuk
ia kam futur; njeriu dorën në xhep, apo jo? Me
djersën e ballit i kam. Pse ju rënden juve para-
të e mia? S'e marr vesh!

— Ik, të thashë, Liman, ik! Dhe shikoje veten
një çikë, or shullap, more vesh? Mora thuaj!

Liman Aliu po çapitej dalëngadalë pas përgjegjësit të ndërresës, kokëvarur, në mëdyshje.
Ata i dinë të gjitha, si nuk i dinë, tha me vete.
E dinë edhe që çizmet e reja, që më jep miniera,
unë i shes dhe vazhdoj të mbath çizmet
e vjetra e qahem se afatet janë të gjata, se çizmet
grisen shpejt. E dinë që shes edhe rrrobat,
edhe peliqet që më jep shteti... Si nuk i dinë?!

— Por unë nuk të lutem! — foli paskëtaj.

— Unë kërkoj punë. Se puna nuk është jotja,
punën ma jep shteti mua, jo ti.

Kishte shpërthyer papritur. Vështronë me
sy të egër dhe dridhej pa pushim.

Përgjegjës Lazja dhe ata përqark kishin mbe-
tur pa gojë përpara këtij ndryshimi të beftë.
Ç'ti thoshe këtij njeriu? Si t'i silleshe? Ga-
zaliu ishte gati të luante prapë me të, po nuk
bëri gëk. Ai do dru, vendçë, pëshpëriti dikush,
po asnjeri nuk lëvizi.

Të gjithë vështronin të heshtur e të turbu-
lluar. U vinte keq për Liman Aliun, po nuk ia
hidhnin fajin punës së tepërt të tij. Bënin me
faj paranë, paranë që nuk prishej.

— Ik, ore djall me brirë, ik, — ia bëri më
në fund armator Ndreoja — ik dhe, po nuk
erdhe me çizme e rroba të reja, nuk të qasim
më në punë. Ik, ik tani, mos na lër pa punë ne
të tjerët.

Versioni i komoditës

ben mëd si — si qënd por lëshon. Ai
nët e qënd si — sëmundjetam. Ai që
mësuarët shen përsëri si qënd por lëshon.
An Shënq uqëd si torn me si qënd por lëshon

Versioni më komod

I

Sa herë i kishte thënë gruas se letërsia nuk mund të jetë asnjëherë vetëm autobiografike, ashtu siç edhe nuk mund të mos jetë asnjëherë pa asgjë autobiografike. Çdo herë ajo pati ngritur supet dhe, duke buzëqeshur lehtë, si e zënë në faj, i thoshte: «Si, si e the? Pa ma përsërit edhe një herë!»

Shkrimtari M. i përsëriste jo vetëm sentencën, dalëngadalë, por përpinqej edhe ta konkretizonte me diçka të njobur. Të kujtohet Flavia e tregi-

mit tim të librit të tretë? E pra, ajo studentja tiranase, që la shtëpinë dhe u regjistrua në konvikt për hir të dashurisë, që nuk mund t'ia pranonin prindërit. Ti e lexove në dorëshkrim dhe të botuar, e përsëri nuk arrite të vësh re se Flavian-personazh unë e kisha veshur me rrobat që vishje ti, gruaja ime, kur ishe studente. Gjithnjë shkrimtari fut diçka të vetën, të njerrëzve që njeh, por asnjëherë nuk mund të shkruajë vetëm për veten, apo vetëm për dikë tjetër. Personazhet janë njerëz, prandaj, si njerëz, nuk mund të jenë vetëm të vetes. Secili, pa e ditur, pa e kuptuar, ka homologët e vet. Të mos ishte kështu, letërsia do të ishte jo vetëm e kotë por edhe e pamundur.

— Do të t'i përsërit edhe një herë tjetër — — pyeste gruan e vet shkrimtari. — Apo më kuptove?!

— Të kuptova, si s'të kuptova! — thoshte ajo duke qeshur. Qeshnin të dy paskëtaj, të sigurt se s'kish pse të përsëritez më dhënia e këtyre leksioneve.

— Atëherë, merre, lexoje këtë tregim, — i tha pas një bisede të tillë ai. — Sa herë të kam thënë se nuk do të të jap kurrë të më lexosh dorëshkrime, por... Unë s'të marr në konsideratë si kritike letrare, kurse ti këtë e merr si mungesë respekti e harmonie familjare.

— Sa të lexoj unë tregimin tênd, të lutem, laji pjatat dhe lugët e drekës, — i tha gruaja.

— Natyrisht, s'ka asgjë pa kushte, — pranoi shkrimtari M.

Kështu edhe çlodhem, tha me vete, si përtu' zbavitur.

Në punët e shtëpisë çdo gjë duhet marrë si e natyrshme, thoshte ai, në të kundërt çdo gjë do të merret si e panatyrrshme. Qetësia, harmonia, fare lehtë, vetëm prej një keqkuptimi, mund të shndërrohen në zhurmë e kundërvënie. Të të çakërdiset mendja pastaj dhe në çdo çast të mallkosh veten: «Përse u martova? Përse u martova me ty?»

Eshtë njëqind herë më mirë, oh, shumë e shumë herë më këndshëm kjo, që unë laj pjatat, në kohën kur ajo lexon tregimin tim mendoi shkrimtari M. duke bërë humor përvete. Më mirë të laj një lugë, me luftë të brendshme shpirterore, sesa të dëgjoj një orë zhurmën e ankesës për sjelljen time fodulle.

Gruaja më në fund e mbaroi së lexuari tregimin. Erdhi dhe i qëndroi mu përpara syve, sikur kërkoi të prekte me dorë ato që mund të lexonte në sytë e tij.

— Ti nuk do ta botosh këtë tregim... Apo jo, i dashur?!

Të dy i kishin kaluar të dyzet vjetët dhe fjalët i, e dashur i përdornin tanit më tepër përtë kërkuar, me etiketë, nga njëri-tjetri miratim pa fjalë, pa ngurrim, pa kushte, sesa si terminologji të dashuruarish.

Shkrimtari e ndjeu veten pa dëshirë për të pohuar. Megjithatë priti. Ajo me siguri do, t'i jepte arsyе, shkaqe, hollësi të tjera, për të cilat tregimi s'duhej botuar.

— Se ky është tamam Grigori, prandaj! —
— tha ajo.

— Grigori? Cili na qenka ky Grigor?!

— Është i shoqi i Katjas, s'e di ti?

Katja ishte shoqe pune e gruas. Ajo i pas-kësh treguar për Grigorin pothuaj po ato gjëra, oh, çuditërisht, po ato gjëra... që ajo sapo i kishte lexuar në tregim, te personazhi kryesor.

— Vërtet është krejt e rastit?! — pyeti gru-aja me mosbesim.

— Jo, nuk është e rastit, — u përgjigj shkrimtari duke kuptuar se leksioni përsëri ishte harruar. — Është ligjësia, homologjia, a s'e kemi mësuar?!

— Po ato veprime, po ai karakter... të dy nën-punës ministrie në kryeqytet, si ka mundësi?

— Mundësia është kthyer në realitet, — tha shkrimtari duke u kënaqur nga përhumbja e gruas së tij.

— Grigori nuk ka faj që është i tillë, — tha ajo për burrin e shoqes. — Ai ka një shef që hakmerret si perënditë.

— Unë s'di asgjë për këtë Grigor që më tre-gon ti. As që di edhe se kush e ka fajin: ai vetë apo shefat e tij. Mbase ai vërtet nuk ka faj, por as unë nuk kam faj që ky Grigori i shoqes sa-te vete, e rron si personazhet e mia!

Shkrimtari M. po tallej nga pak. Nënqeshja te cepat e buzëve po e vingëriste pak nga pak qetësinë e gruas. Sytë iu errën menjëherë, si ato ujërat me shfaqjen e reve në qìell dhe u shformuan si të ndodheshin pas xhamave të syzeve të hipermetropëve.

— Ajo m'i ka treguar mua... në mirëbesim,
— tha për të shoqen e Grigorit.

— Ti s'e ke shkelur besën. E para kjo. E dyta: Unë nuk marr leje nga personazhet e mia dhe aq më pak prej grave të personazheve apo shoqeve të tyre! — tha shkrimtari duke ndier se po tallej. Kështu i ndodhët sa herë që prekej.

Buzët e së shoqes seç morën një përgjakje të bukur, u drodhën nga fërgëllimi i ndjenjës së tepërt, e cila, duke mos mundur të kthehej dot në fjalë, breshëroi në formë lotësh.

— Kam faj unë. Ti vetëm të qash di! — i ktheu shpinën shkrimtari. — Kujt vete e i jap të lexojë tregimet!

Hyri në dhomën ku shkruante, por doli shpejt. Ishte veshur. Mbathi këpucët dhe zbriti në rrugë. Do të na lësh të vetëm fare, dëgjoi zërin e gruas si përpjekje të fundit për t'u marrë vesh. Do të na ndash me të gjithë.

Si nuk vura mend edhe unë, po thoshte një orë më vonë, duke ngjitur përsëri shkallët e pallatit. Më mirë të kujdesem për oreksin dhe shëndetin, më mirë të shoh veten, sesa të tjerët. E përsë të bëhem lulëkuqe, siç u bëra te redak-

tori i tregimit? Unë vetë, si lexues, e pëlqeje, madje e pëlqeje shumë. Se ka ca gjëra të gjetura bukur aty. Po, pikërisht për këto gjëra unë nuk e botoj dot, më kuption?!... i kishte thënë redaktori. Si për t'i bërë edhe më të besueshme ato që thoshte, redaktori i dha një kafe shkrimtarit M. për kënaqësinë e fituar nga leximi i tregimit, të cilin megjithatë nuk do t'ia botonte. Ah, redaktori i çuditshëm! Sesi kishte ardhur në atë detyrë! Sesi përpiquej të mos e humbte atë karriqe!

Shkrimtari M. hyri në shtëpinë e vet duke menduar se njeriun kudo e kurdo, për veten, por edhe në marrëdhëniet me njerëzit e tjerë, të, afërt apo jo këta, e shoqëron një ndjenjë pakë-naqësie e fshehtë, e cila, edhe kur nuk shprehet mbetet e pakëndshme dhe e pamënjanueshme.

Gruaja ishte përmbyss mbi divan. Televizori, pa shikues vazhdonte të shfaqte një film. Hajde, gjumë televiziv, hajde, tha me zë të ulët kur kuptoi se ajo flinte. Vështroi fytyrën e saj të lodhur, të nxirë poshtë syve nga mërzia, mendoi për një çast ta linte të flinte aty, po prapë e largoi mendimin për ta kaluar në heshtje këtë mbrëmje.

— Ti kot fare shqetësohen, — i tha mu pranë veshit, të cilin ia zbuloi prej flokëve. — Kot pandeh se unë kam pasur model atë Grigorin e shoqes sate.

— Cdo njeri me grua dhe me fëmijë duhet t'i mendojë mirë ato që bën, — tha ajo pa lëvizur.

— Kurse unë nuk i mendokam?! Kështu thua ti?!

As që e përfytyronte dot veten indiferent në shtëpinë e tij. Duke e shoqëruar gruan për në dhomën e gjumit, tha me vete se vetëm një njeriu apatik, fluturak, mund t'i shkonte mos-kokëçarja për ta ruajtur këtë mirëqenie e ngrohtësi familjare. I hodhi një mbulesë së shoqes dhe iu duk se ajo në atë çast i hapi pak sylë përgjysmë, sikur priste që edhe ai të shtrihej aty, pranë saj.

Ah, gratë! Çdo gjë që bëjnë ndër mend, e arrijnë! Ose pëlcasin!

II

Ja që, ai është redaktor dhe jo një tjetër, tha shkrimtari kur hyri në dhomën ku punonte. Se cili i njeh dheri vlerëson gjërat në mënyrën e vet. Dhe ja gruaja ime, shtoi pastaj, është siç është, shqeqe me gruan e një Grigori, që do të prekej apo zemërohej sikur ai tregim të botehej.

Eh, si po bëhen këto punë, qeshi me vete. Unë natyrisht që do ta botoj atë tregim. Do të ndryshoj diçka, por asgjë thelbësore. Grigori nuk do ta shohë, por do ta ndiejë vete aty. Përse duhet ta vendosësh doëmos nëpunësin në institucionet e kryeqytetit, s'ë kuptoj, Mirë kishte thënë redaktori i tregimit.

Shkrimtari M. e largoi subjektin dhjetëra kilometra, madje ndryshoi edhe emrat e personazheve. Grigori u bë Avdi e Avdiu ishte thjesht një nëpunës dogane, larg, në një pikë kufitare. Asnjë shqetësim s'do të ngjallte.

Magazinieri i doganës do të kishte jo dy fëmijë, si ai nëpunësi i ministrisë, por pesë. Në qytetin e tij të vogël kufitar nuk dalin shëtitje, siç dilte personazhi Grigor në kryeqytet, dy hapa mbrapa shefit, ose me gruan dhe fëmijët, në mbrëmje. Avdiu e shprehte ndryshe dashurinë familjare: Gjente rast dhe e mbyllte magazinën, nxitonte për shtëpi. Fëmijët ishin në shkollë dhe ai hopa, e merrte gruan, në krahët e tij të fuqishëm, e rrötullonte derisa asaj i merrë fryma, duke e lutur ta lëshonte me nëma dhe kukurisje.

Avdiun e bëri si një binjak të Grigorit. Me rroba të ndryshme. Si binjakë kishin të njëjtë gjakun dhe eshtrat. Këtë gjë kërkoi ta realizonte me çdo mënyrë në versionin e dytë të tregimit.

Të dy ishin të plotë, të përbërë secili nga dy gjysma. Te çdonjëri gjysmat ishin të kundërtat e njëra-tjetrës, edhe pse gjysma të së tërës.

Grigori, pra edhe Avdiu, edhe pse i donin grata dhe fëmijët, në punët e tyre nuk i lejonin vetes asnjë lëshim për to. Gjysmën e vetes e ruanin të pastër, siç bën njeriu me njérën nga duart, kur të paktën njérën prej tyre duhet ta ketë të tillë. Ja, kjo është detyra jonë, sikur thoshin

ata. Detyra dhe virtyti. Ta ruajmë gjysmën të ndërgjegjshme, të vetëdijshme, të dlirtë. Unë, në-punësi i institucionit në kryeqytet, pra edhe unë nëpunësi i vogël i doganës larg, në provincën ku-fitare, asnjëherë nuk kemi pranuar për vete udhë të shtrembra, s'kemi përfituar asgjë. Fëmijët e mi mund t'i privilegjoja, p.sh. mund t'i nxirrja me ndonjë ekip jashtë shtetit; dhe unë, magazinier, do të kisha sajuar për fëmijët e mi golfe, bluza, pantallona, stema, orë-stilografë, radio, oh, po të doja, unë i siguroja secilit prej tyre aq shumë gjëra.

Po nuk e kemi bërë këtë për vete. Jo, i thamë vetes, përderisa ke mundësinë ta ruash këtë pjesë të ndërgjegjes, ruaje! Le të të qeshë ndokush në punë, apo në shtëpi, le të të mërziten fëmijët, do të të japid të drejtë më vonë...

Po kjo nuk ishte, e lehtë të arrihej, kur Grigori, pra edhe Avdiu, kishin shefa që ua vështirësonin këtë gjëndje. Ata sesi i formulonin mendimet e tyre, pak si të errëta, si të ngatërruara, me ca të qeshura të hidhëta e ca mos-kokëcarje, ohu... si ishin ata.

Njëherë Grigori pati vënë re në listën e një ekipi basketbolli, që do të nisej për një turne miqësore, emrin dhe mbiemrin e vajzës së njërit prej shefave. Me cilësitë fizike që kishte ajo, as pati luajtur as do të luante kurrë basket-boll. Po mbapse luan atje jashtë vendit, tha me vete, duke hedhur firmën në fund të listës. Kurrë nuk do ta bënte këtë për vajzën e vet.

Si Grigori, Avdiu e di mirë ç'u mungon ende fëmijëve të shefit të vet, të cilët të nesërmen venë dhe u krekojnë fëmijëve të magazinierit që nga ana e tyre, kur kthehen në shtëpi, i mbajnë mëri babait.

Njëra gjysmë, ajo e vetes, sillej urtë e butë me tjetrën, gjysmën e eprorëve. Duke u ndierë fatkeqe ndaj saj, ajo përpinqej ta justifikonte të tërën si për një të keqë që nuk kishte ç'ti bëje! Nervat e tyre, dikur të lodhur nga mëdyshja e vazhdueshme, tanimë ishin bërë elastikë, të gatshmë për të mos ndierë atë që nuk ishte mirë ta ndieje.

Ata ishin si dy sy, njëri prej të cilëve, duke ditur verbërinë e tjetrit, punonte edhe për të. Dhe trupi bën përpala edhe me një sy.

Njëra gjysmë shpërblehej me fletë nderi apo honorare të vogla nga shefat, gjysma tjetër shpërblehej nga grindje e shamata të pafundme në shtëpi.

Shkrimtari M., duke e përfunduar variantin e ri, i detyruar nga qëndrimet e redaktorit dhe të gruas, po provonte, sidoqoftë, një kënaqësi të vërtetë, Magazinieri Avdiu u bë prej nëpunësit të ministrisë pa shumë mund, ashtu siç nxirrte lehtë prej një palë rroba të gjëra veshja për një njeri të imët e hollak.

Duke qenë për gruan dhe redaktorin më komod dhe i pranueshëm, versioni i dytë, megjithatë, për një lexues të mençur, e kishte brenda versionin e parë. Çdonjëri prej tyre mund ta hiq-

te emrin Avdi e të vinë vend të tij një emër tjetër, p.sh. Grigor. Natyrisht, nëse kishte arsyë dhe dëshirë për ta bërë këtë.

Shënoi emrin në fund të tregimit, po duke qortuar veten se, sadopak, një lloj kompromisi e kishte bërë.

Por ja që... jemi njerëz dhe mes njerëzish rrojmë, tha më vete. Dhe, duke menduar së të gjithë njerëzit janë nga pak personazhë, shtoi si për të bërë lodër fjalësh: Njerëz jemi dhe mes personazhesh rrojmë.

III

Kështu po. Versioni është i pranueshëm. Edhe unë jam në rregull me të dy: me ty si krijues dhe me punën time.

Shkrimtari M. duke e dëgjuar, përfytyroi për një çast sikur t'i kujtonte redaktorit se edhe ai qenkej prej dy pjesësh.

Por asnjë arsyë nuk kishte ta bënte këtë. Mjaft që ai ta botojë tregimin, tha me vete, Megjithatë, kur doli nga redaksia, sepse po përfrente mendimin se ai vetë... Unë pra, shkrimtari M. ... a nuk ngjaj me redaktorin si gjysma të një së plotë, tha me vete duke qeshur me këto fjalë kote. Ndoshta të tëra këto hamendje vinin nga pagjumësia e natës së shkuar.

Më mirë të mos isha nxituar, të mos e kili shësuar kaq shpejt për botim, thoshte një javë më vonë, duke parë tregimin e botuar të

shoqëruar me një ilustrim. Gruaja e njoftoi se kishte folur në telefon me shoqen e saj, gruan e Grigorit. Ah, sa na ka pëlqyer, sa na ka pëlqyer! Sidomos ai Avdiu e la pa mend tim shoq. Jepini urimet tona për suksesin...

Pas kësaj telefonate shkrimtari M. u bind përfundimisht në dështimin. Përderisa Grigori ndihej i kënaqur, kjo do të thoshte se tregimi për të kishte shërbyer si një pije freskuese, çlodhëse tretëse...

Disa konsiderata të mira që i bënë shokë e miq të tij, pas kësaj, iu dukën si ngushëllime të vobekëta.

Gruaja quditej me mpirjen dhe hutimin e tij.

Madje për ta çlodhur, për ta nxjerrë prej kësaj gjendjeje, ajo i propozoi t'i bënин një vizitë në shtëpi Grigorit dhe shoqes së saj.

— Që t'i kérkoj edhe të falur, apo jo?! — sa nuk bërtiti shkrimtari M. — Po më doli në telefon, do t'i them se ai, Grigori, është Avdiu dhe askush tjetër.

Gruaja u përpoq ta kontrollonte ato ditë të qeshurën e saj dhe i hapi rrugë disa herë dëshirës së tij për t'u grindur, pasi rrinte për orë të tëra mbyllur në dhomë.

Ndoshta kot kam pritur sukses te ky variant, thoshtë me vete ai. Mbase magazinier Avdiu nuk e mbarti dot tërë jetën, tërë ngarkesën emocionale të nëpunës Grigorit. Mbase godina Avdi s'e kishte dot hapësirën për të gjitha mobiljet e orënditë që çova aty nga godina Grigor!... Ose!...

Thuaj që nuk jam këtu, po të më kërkojë njeri, porositi gruan, kur në fund të ditës së gjashtë, pas botimit të tregimit, po binte zilja. e derës.

E përse duhet të mbyllem, pyeti veten duke ndezur cigaren në dhomën e punës. Që të tjerët të gjykojnë në mungesën tënde? Apo që të thonë se edhe vetë e ndien dobësinë, kompromisin, komprom...

Njeriu që tërhiqet, që lodhet, që përgjunjet, asnjëherë nuk ka të drejtë, kujtoi një frazë të dëgjuar kushedi ku. Se, po të ketë të drejtë, ai nuk duhet të lodhet, as të përgjunjet. Dhe ai që nuk e pëson nga të vërtetat që s'duhen thënë, me siguri është dhelparak, hipokrit. Hipokrizia asnjëherë nuk ka shpëtuar njeri nga robëria, përkundrazi...

Po trókitnin në derën e dhomës. Dëgjoi zërin e gruas ta thërriste në emër.

— Të kërkojnë ty, — i tha ajo. — Ishte një burrë, po nuk pranoi të hynte brenda. Iku, po zbret shkallët.

— Po cili ishte? Ç'tha? Ç'emër kishte... si iku?!

— Nuk më tha asgjë tjeter. «Po deshi yt shoq të dalë, e pres atje poshtë», kaq më tha dhe më kthëu shpinën.

As gruaja nuk e fshihte dot çudinë.

— U! Sesi m'u duk, — tha ajo. — Po ti ç'ke që të ndritën sytë? Apo ke pritur njeri?

— Shkrimtari M. qeshi. Provonte kënaqësi të

veçantë kur ajo ia rrokte mendimet pa thënë
ai ende asnë fjalë.

— Mos është ndonjë nga ata, homologët?!
— tha me zë të ulët, me një gjëzim të beftë. Të-
rë këto ditë pati shpresuar se ky, dikush, iden-
tik me Avdiun (pra me Grigorin, me Grigorët
d.m.th.), do të lexonte tregimin me nëpunësin dy-
pjeshësh dhe, duke ndierë veten, aty, mbasë do të
besonte se ai vetë ka qenë modeli, ngacmuesi,
objekti fillestar. E kishte pritur një ardhje të
tillë. Në vend që të tronditej, ai po nxitonë ta
takonte sa më parë këtë njeri, kushdo që të ish-
te, me çfarëdo qëllimi, ankimi, justifikimi apo
kërcënimi të kishte ardhur.

— U, u! Për çfarë gjëzon ky! — ia bëri gru-
aja kur ai po vishte këpucët për të dalë. — Kuj-
des, mirë? Hapi udhë! — i foli nga pas. Pa e
parë i shoqi, ajo zbriti shkallët pas tij, derisa u
duk sheshi para pallatit.

I ardhuri qëndronte atje, kokulur, me këmbët
pak të larguara nga njëra-tjetra e duart të mble-
dhura në gjoks. Si ata boksierët e kalibrit, që
mezi presin daljen në ring të kundërshtarit për
ta përfunduar ndeshjen me raundin e parë, tha
me vete shkrimtari M. Në të vërtetë ata që
arrijnë të preken prej tregimeve të tillë nuk
hakmerren me grushta, shtoi pas pak.

— Ju e kishit bërë atë gazeten? — pyeti ai
që priste.

Pra nga homologët qenka! Nga ata, — tha me
vete, si i gjuar. Domethënë se s'paskam dësh-

tuar fare! E vëtmja gjë që nuk dukej se shkonte ishte veshja e të ardhurit. Homologët nuk i mendonte kurrë të veshur si ky.

Megjithatë nuk e përmbajti dot buzëqeshjen kur dëgjoi atë «Ju e kishit bërë gazetën?»!

— Po zbardhni edhe dhëmbët! — dëgjoi homologun e çuditshëm. I çuditshëm jo se prej tij nuk pritej zemërimi, ngritja e zërit, fyerja e grindja. Ai dukej i prekur, por me një prekje që provon njeriu nga një i panjohur, me të padrejtë, ose nga një i njohur të cilin deri në atë qast e ke adhuruar.

— Ç'të shtyu, xhanëm, ë?! Qenke dhe goxha burrë, me grua, me fëmijë!...

— Më falni, mos jeni ngatërruar kot! — arriti të fliste më në fund shkrimtari M. Kur vuri re se tjetri pothuajse vetëm sa pëshpériste.

— S'ke lënë gjë tjetër për të ngatërruar ti. I ke bërë lesh arapi në gazetë... Unë nuk i lexoj kurrë ato gjëra, por erdhi djali e ma futi flakën në shtëpi!

I ardhuri dukej tani si një prind që kërkonte të sqarohej për ndonjë gabim, papjekuri moshtë të birit gjimnazist. Aq butë po fliste.

— Të më falësh... po mua akoma nuk po më bini ndër mend... Ku qenkemi takuar bashkë?

— U përpoq të sqarohej shkrimtari M. Tjetri po e vështronë mosbesues, siç vështronë një njeri për të cilin je i bindur se është keqdashës, shpirzi, i poshtër, por ende kërkon të hiqet si mirëdashës.

— Cili jeni... ju lutem? — pyeti prapë me një këmbëngulje ndoshta të tepërt, por që iu duk aq e nevojshme.

— Jam magazinieri i doganës, — tha tjetri, me duf, sikur edhe ai të kishte qenë në gulç.

— Më ke futur grënjen në shtëpi, — shtoi pas pak.

Shkrimtari M. e kuptoi më në fund se ndodhej përballë Avdiut, që, pa të drejtë, pati menduar se e kishte krijuar me dorën, mendjen e ndjenjën e vet. E pra, në të vërtetë pothuaj as gjë nuk kishte sajuar. Çdo gjë, mbase edhe me po atë emër, me atë grua e mënyrë dashurie, me po ata fëmijë... Unë vetëm se, pa e kuptuar, me veprimin e pavetëdijshëm të krijimit, kam ndriçuar atë pjesë të jetës që në heshtje bënte ky njeri, tha me vete shkrimtari M.

Pa e ditur, e kishte ndëshkuar këtë njeri po nuk dinte si t'i shpjegohej. Natyrisht që do të ishte budallallék t'i thoshte se kurrë në jetën e vet nuk kishte njohur ndonjë magazinier dogane. Kur nuk thuhen në kohën e përshtatshme, edhe të vërtetat duken të gënjeshtra, mendoi.

Megjithatë ndiente si të domosdoshme nevojnë për ta qartësuar të ardhurin. Kur mendoi se edhe gruan ai e merrte hopa në krahë dhe e rrotullonte, gjersa... iu shua deri në fund shprelsa e të shpjeguarit.

— Po munde... dhe po deshe... Po munde, besomë, besomë! — i tha të ardhurit, duke i prekur lehtë krahun, — Eja të rrimë brenda, në shtëpi!

Ia tha këto se nuk dinte ç'ti thoshte tjetër. Çdo fakt, çdo provë, çdo fjalë mund të merrte në këtë rast ngjyrën tjetër, të dyshimit se diçka fshinte. Rastësia kishte luajtur siç di të luajë ajo, me të gjithë, edhe me versionin e fundit të tregimit.

Po heshtnin të dy. Magazinieri i ktheu shpinën dhe u largua pa ia varur fare. Sikur kërkoi ta bindte përfundimisht se nuk ishte personazh i tij. Ose që, edhe pse kishte diçka prej personazhit të tij; kjo s'do të thoshte kurrsesi se më të mund të bëje ç'të doje. Ai ishte ai që ishte. Edhe sikur të mos shkruhej ose edhe sikur të shkruhej ndryshe nga ç'ishin në të vërtetë ai dhe homologët e tij.

— Përse kishte ardhur? — e pyeti gruaja përsëri kur hynë në shtëpi.

— Për komoditet e dashur, — tha shkrimitari M. — Vetëm për komoditet.

lindarës së qytetit që e kishte përfunduar me dështim. Nëpunës i zyrës së vullës i po shiheshin që është një vlerë e madhe. Përfundimisht, që e ka qenë që gjithë qyteti i përfunduar. Nëpunës i zyrës së vullës i po shiheshin që është një vlerë e madhe. Nëpunës i zyrës së vullës i po shiheshin që është një vlerë e madhe.

Nëpunës i zyrës së vullës

— Kur ta lanë drekën e lamtumirës? — pyeti Vani Xhelili duke nënqeshur lehtë.
— Përse shprehesh kështu dhe ti... si ata... të tjerët? Unë nuk jam bërë akoma për të më lënë lamtumirën, më duket.

Syrja Dimri nuk përpinqej për ta fshehir, mërzinë që i krijonte kjo bisedë. E shoh se ju të gjithë jeni bashkuar kundër meje, thoshte vështrimi i tij, po q'doni të bëhet më tepër se kaq me mua?!

Për vite të tëra kishte hedhur vullat.

Si? Vetëm të hedh vullat?! Vetëm kaq? Vetëm për këtë do të rri gjithë ditën e ditës?! ki-

shte thënë dikur, kur filloi punën e vulëvënësit. «Vetëm për ta bërë mirë këtë,» iu patën përgjigjur çudisë së tij dhe, vite më vonë, sa herë që i kujtonte këto fjalë, u jepte ë drejtë. As që i pati shkuar ndër mend ndonjëherë se do të bëhej nëpunës, madje aq i rëndësishëm, siç ndodhi me të më vonë. Shumë eprorë e vartës erdhën dhe ikën nga zyrat përqark, ca për të mirë e ca për të keq, po Syrja Dimri mbeti ai që ishte. Një vulëvënës i thjeshtë, por që, edhe po të doje, s'e harroje dot. Madje kishte zëra që flisnin se për një pjesë të madhe të atyre që e pësonin ishte bërë shkak pikërisht Syrja Dimri, që nuk ua kishte dhënë vulën kur u ishte dashur.

Dalëngadalë tek ai vetë, por edhe te njerëzit që kishin të bënин me të, dhe këtu nuk besohej se përjashtohej kurrkush, u rrënjos bindja se pa të s'bëhej dot as e mira, as e keqja.

Filluan ta nderonin e ta donin të gjithë, se të gjithëve një ditë do t'u duhej të shkonin te sporteli i tij. Ata që deri atëherë e kishin vështruar ftohtë ose me qesëndi, që e patën quajtur «një copë vulaxhi», nisi t'i kishte merak vetë. I linte një copë herë të prisnin te sporteli, në të ftohtë apo në zheg, pastaj, pasi i dëgjonte mirë e mirë përse e si e qysh e kërkoni vulën, i përcillte pa u zgjidhur punë, por gjithnjë i qetë dhe i sjellshëm. «Një vulë kërkoni ju? Po vula... Eh, vula! Ajo vihet në fund! Pse, kollaj ju duket të shkojë puna deri te vula?!» Të shkretët!

Largoheshin tërë nerva e të dëshpëruar, po duke u përpjekur të dukeshin të bindur e të svaruar nga ato që u thoshte vulëvënësi. Se do të vinin prapë aty! Dhe që mbante mend gjithçka, kjo ishte provuar...

Vetë Syrja Dimri thoshte se i harronte menjëherë, sa po fytyra e tyre s'dukej më në sportel. Unë nuk kam kohë, as fuqi që të qaj e të qesh me hallet e të tjerëve, thoshte ai. Unë vë vula, nuk jam as i zyrës së funeraleve, ai i gjendjes civile. Unë jam si vula, i njëllojtë për të gjithë, s'di me aman e me të keqen unë, s'them për atë besë unë, po për atë shkresë. Veç kur ajo ka vulë në fund.

Ndodhë që të grindej gjithë ditën e ditës dhe të kthehej në shtëpi prapë i qeshur e me humor të mirë, të luante me fëmijët me aq qetësi, sa ata, duke dëgjuar ç'fliteshin në qytet për babanë e tyre, çuditeshin. Për ata jam vulëvënësi, për ju jam babai, sikur u thoshte qëndrimi i tij, pse çuditeni??

Numri i atyre që i luteshin, që përsëritnin hallet, që i luteshin prapë dhe ai nuk u jepte vulë, rritej me të shpejtë, dhe kjo po e kënaqte. Herë pas here, kur grumbulli i këtyre njërzve tej sportelit të mbyllur bëhej i madh, Syrja Dimri rrinte e përgjonte bisedat e pësh-pëshet e tyre. Pastaj hapte sportelin dhe, duke shkëlqyer i téri prej kënaqësisë, që vetëm ai dinte ta nxirrte nga mërzia e të tjerëve, fillonte nga punët.

«Jo, nuk ta hedh dot vulën», i thoshte njëriut, zëri i të cilit e kishte lëvduar pak më parë kur ai përgjonte. «Po pse? Si kështu? Nuk qen-kan të plota?» thoshte-i befasuar tjetri duke ngritur supet. «Se radhën e fundit ju sikur më thatë se duhej vetëm diçka... që ja tek e kam shtuar, dhe ishin gati për vulë! Apo s'ju kam marrë vesh mirë?... Ndoshfa!»

Largohej nga sporteli dhe bashkë me të merrte udhët fjala se Syrja Dimri ishte njëlloj përtë gjithë: dimër, siç kishte mbiemrin. Ai i ndëshkonte të gjithë, ata që e lëvdonin dhe ata që e shanin.

Duke qenë njëlloj përtë gjithë, e donin dhe e urrenin njëlloj të gjithë. Si vulën që kishte në dorë.

Më urrejnë njëlloj të gjithë... po nejse», tha me vete tërë ato ditë kur sekush nxitoi t'i sillte lajmin se do të dilte në pension së shpejti. Në pak kohë këtë lajm e morën vesh të gjithë, sikur të ishte fjala për vdekjen e tij. E mbylli përtë disa ditë rresht zyrën dhe trokiti atje ku duhej trokitur, foli zë ulët, siç pëlqente t'i flisnin ata që i vinin te sporteli, po pas pak, kur u detyrua të përmendte meritat e veta, të cilat megjithatë askush nuk ia mohonte, e ngriti zërin. Unë kam ende forca për të punuar, tha, përsë të më lini mënjanë? Nëse kam shkelur rregullat apo nëse i ka zbutur ato... më thoni prapë...

Përkundrazi, i tha ai që e dëgjonte, duke u

ngritur në këmbë. Pra duhej të dilte jashtë.
Dhe doli Syrja Dimri. Si të kundërshtonte?!

Tani po ia dorëzonte detyrën Vani Xhelilit.

U ngushëllua njëfarësoj kur kuptoi se po hakmerrej nga pak me të gjithë, duke e zgjatur kohën e dorëzimit. Dorëzimet, kudo të bezdisshme, Syrjai diti t'i kthente në të padurueshme. Vani Xhelili pothuajse nuk fliste fare. Vetëm dëgjonte paraardhësin, pohonte me kokë, ose nuk reagonte fare. Syrjai megjithatë vazhdonte të fliste pa pushim, për aq shumë gjëra, asnëra prej të cilave nuk kishte ndonjë lloj lidhjeje të dukshme me vulën apo vulëvënien.

U mërzite?! Ehe! Po do ta mësosh se pikërisht mërzia është kënaqësia e profesionit tonë!
Hajde! Dalim të pimë një kafe?

U lodhe?! Dalim e shëtitim ca i thoshte herë tjetër. S'na nxiton gjë!

Dhe ngrihej vetë i pari shpejt e shpejt dhe drejtohej nga dera, për ta bërë të pamundur kundërshtimin e tjetrit. Sikur donte ta zgjaste sa më tej kohën e qëndrimit në atë zyrë. Të mos kishte të drejtën e të vulosurit, po kjo ishte fundi... Ai.... pa vulë! Si?!

Binte zilja e telefonit. Herë e ngrinte Syrjai dhe herë Vani Xhelili.

— Alo? Po, nëpunësi i vulës jemi.

Tjetri, ai që nuk fliste, vetëm dëgjonte. Dhe heshtte. Zyra ngjante në këto raste me një shpellë që sillte si jehonë zërin e vet.

— Më kupton, Vani? Duhet të bindësh më parë veten, pastaj edhe të tjerët se vetë puna jonë... Kjo vulë të bën të pazëvendësueshëm.

— Megjithatë... edhe ti po zëvendësoshesh, — tha tjetri duke e ndier se s'mund të merrej vetëm si shaka kjo që po thoshte.

— Me të padrejtë, — foli Syrja duke ngri-tur duart.

E drejta s'është si gënjeshtra, që t'i takojë një njeriu të yetëm shtoi pa zë Vani Xhelili duke shkuar ndër mend ç'mendonin ata, «të tjerët», për largimin e Syrjait...

Ishë diku mes tyre kur u njoftua për dal-jen në pension të Syrja Dimrit. Ata, «të tjerët», siç i kishte quajtur ai, gëzonin për ikjen e vulëvënësit. Do të pinin atë ditë, kot fare, të lirshëm. Më në fund, do thoshin, jo se prej tij varej kushedijeta e tyre, po sepse ai pa e kuptuar as ata vetë sesi, u kishte hyrë deri në dë-shirën për të qenë më të shpenguar.

Duke marrë detyrën prej tij, Vani po shih-te qartë tërë mekanizmin e bezdisjes.

Zyra e vulës vazhdonte dypushtetin e vet. Kudo lëviznin së bashku: në rrugën për në zyrë, për kafe, për shëtitje, në oborr, në korridoret kur pinin cigare. Njëri ishte e shkuara, tjetri ishte e ardhmja; e tashmja ishte diçka e papërcaktuar, madje edhe atyre «të tjerëve» sikur nuk u interesonte ç'ishte kjo e sotme. E mirë apo e keqe, apo edhe e mirë edhe e keqe, kjo dukej fare e pa rëndësishme për njerëzit. Ata e kishin

lénë pér më vonë, pér ditët që do të vinin, marrjen e vulave që u duheshin.

Qysh në çastin kur e ngarkuan të merrte detyrën e vulëvënësit, Vani Xhelili pati menduar se duhej të bënte diçka krejt tjetër, diçka krejt të kundërt me atë që pati lénë paraardhësi i tij. Sa më shumë kalonte koha, aq më e domosdoshme i dukej kjo kërkësë.

Vulëvënësi i vjetër kërkonte të vononte.

Trokitën në derë. Nuk u ndie asnjeri. Trokitën prapë. Hyr, tha vulëvënësi i vjetër.

— Kush është këtu... me vulat? — pyeti i ardhuri, sikur të mos njihet asnjerin prej të dyve.

— Hajde njëherë. Ulu këtu! — Vani i tre-goi një karrige.

— S'na kanë mësuar kështu! — tha tjetri, pa druajtje, pa iu drejtuar askujt. — Vetëm nga sporteli merreshim vesh. Ose nuk merreshim vesh, kuptohet, — shtoi me humor.

Mbaroi punë dhe doli. Pas pak ra telefoni, por nuk e ngriti njeri.

— Edhe ne pothuajse mbaruam, apo jo?
Syrjai s'u ndie.

— Dalim. të pimë edhe një kafe?

Syrja Dimri pothuaj nuk po nxirrte më zë, sikur ta kishte dorëzuar bashkë me vulën.

Kishte shtetur dalëngadalë, duke gulçuar më vete.

Në korridore kishte plot lëvizje, po në oborr njerëzit ishin edhe më dendur. Dy herë më të-

për se numri i njerëzve, sy, që sikur kërkonin të verifikonin diçka me ngulm. Unë e di se çfarë, mendoi Vani duke parë nga tjetri. Edhe unë... ç'ti bësh, thoshte qëndrimi i tjetrit. Ndërkaq, pavarësisht prej tyre, vazhdonte krahasimi prej atyre, që prisnin në oborr. E, si të duket ky i ri? Jo, mor vëlla, është tjetër gjë ky! Po të ishte tjetër, s'ia linte njeri vulën në dorë! Të ishte ashtu, mbanin atë të parin!

Ne e kemi parë ca si vëngër Syrjanë, ti e di vetë pse, i kishte thënë Vanit dikush. Ata presin diçka tjetër nga unë, mendoi Vani Xhe-lili duke iu shhangur kureshtjes së njerëzve. Ai do të përpiqej të ndryshonte diçka. Tani ende nuk dinte mirë se çfarë, por kjo s'ishte aq e vështirë!... Një vulë dhe aq më...

Po ti ke aq ditë që rri me të. Përse kaq gjatë? pyesnin me shqetësim shtë e tyre. Për disa caste e ndjeu njëthës mendimin se, pa e kuptuar, nga bashkëqëndrimi, nga pritja e gjatë, nga moslëvizja, mund të shndërrohej edhe ai në paraardhësin e vet.

Dy-tre prej njerëzve që u ndodhën përballë, i përhëndetën, duke parë nga të dy, më tepër nga Vani, po ky, megjithatë, në indiferencën me të cilën po fillonte dënim i Syrjait, vuri re edhe ndonjë notë që qarravitej. Ndokush mund të jetë lodjur duke pritur tej sportelit, mendoi, dhe ndoshta, fillimisht, më tepër do trishtohet se do gëzohet për diçka që mund të ndryshojë. Kam pritur kaq kohë... mos duhet prapë të... presim, të mësohemi me këtë tjetrin?!

— Jemi që jemi, e bëjmë një fotografi bashkë? — dëgjoi zërin e Syrja Dimrit.

Aparati u shkrep shpejt, madje Vanit iu duk se ai buzëqeshi në atë çast duke hamendësuar për dëshirën e Syrjait që fotografia dyshe e sapobërë të shihej prej të gjithëve, si për inat të tyre! I ikuri ti, mjerani ti, tha me vete për vulëvënësin e vjetër. Si për ta përjetuar ndjenjën që provonin ata që prisnin në oborr, tha i vendosur me vete se fotografia do të ishte nga ato që «digjen» ose që, edhe kur lahen, futen menjëherë në fund të ndonjë bauleje, së cilës të vdekurit i marrin me vete çelësat.

Të paguarit e heshtjes

— Kam vendosur të mos i kundërshtoj më shefit, — tha me zë të ulët Noni. Unë qeshë me mënyrën si ma tha dhe ngaqë po rrinte kokulur.

Ditën e shkuar ai ishte grindur shumë ashpë~~r~~ me shefin, kjo dihej: dihej edhe që në mëngjes, kur në oficinë ishte dukur s~~hef~~ Nadiri, disa prej punëtorëve i kishin qëndruar ca si ftotë, të heshtur pak si të trishtuar, sikur grindja e një ditë më parë t'i kishte prekur edhe ata. «Si do të shkojë puna jatë, ë?» do të thoshte distanca vendosur aq shpejt midis tyre dhe Nonit.

— Ke vendosur tē grindesh me grushte kësh-
tu? — i thashë.

— Nuk do t'i kundërshtoj më vërtet... Kot
kam grirë deri tani.

Të paktën në grindjen e djeshme Noni kishte
pasur tē drejtë. Për këtë secili prej dëshmitarëve
ishte i bindur. Ai ishte fare i pafajshëm. Por
edhe në tē gjitha grindjet e ditëve tē tjera; në
tē gjitha seancat e mëparshme pra, shef Nadiri
kishte qenë i padrejti dhë i pamëshirshmi. Nëse
duhej pritur që dikush tē tërhiqej, se aštu du-
hej bërë, ky, për këdo, duhej tē ishte pa dyshim
Nadiri.

— E q'më duhet mua tē kundërshtoj?... — më
foli ai pas pak; sikur kishte vendosur me çdo
kusht tē më detyronte tē bëhesha kureshtar ose
tē qeshja më ato që po thoshte.

— Ne nuk kemi nënshkruar ndonjë marrë-
veshje që tē kundërshtojmë shefin, apo jo, —
i thashë. — S'të kë detyruar njeri për këtë.

Ai priti që tē thosha diçka më tepër, por unë
nuk e bëra një gjë tē tillë. Edhe nuk kisha ç'të
shtoja, por as nuk dëshiroja tē flisja më. Noni,
megjithatë, më erdhi prapa, duke mbetur gjith-
sesi serioz, tmerrësish serioz, për gjëra tē cilat
meritonin veçse një tē qeshur, siç kishim bërë
gjithnjë në raste, tē tillë.

— Duhet tē më japësh tē drejtë... Të pak-
tën ti duhet tē më japësh tē drejtë, — më tha
s'di përsë këmbëngulës. Kishte një fytyrë tē vra-
rë, si tē lodhur, sikur gjithë natën tē kishte mbe-

tur pa gjumë nga ndonjë e keqe. Po ç'të ketë bërë, pyeta veten, që mundon që kërkon mbësh-tetjen time? Serioziteti i tij as që shkonte në marrëdhëniet me një shok të afërm, siç më kishte mua.

— Pa mos më dërdëllit mua kështu ti, — iu ktheva pa e duruar dot më. — As që po të marr vesh fare ku e ke hallin. Ç'të drejtë kërkon të të jap unë, pse s'ma thua?

— Nuk i dilet dot gjithnjë me të drejtën, ja këtë dua të të them. Ç'ka këfu për të kuptuar. Ai më ka në dorë dhe pikë.

— Nadiri e ka në dorë jetën tënde kështu?

— Jetën jó, po ditën po... dhe ditët janë jeta, apo jo?

— E po pastaj?

— Pastaj dua të të them se nuk ia vlen ta shkosh jetën duke u ngrënë si qen.

Por sytë i shprehnin pavendosmëri. Përnjëherë më lindi mendimi se dikush, një i tretë, i ndërmjetëm, midis Nohit dhe shef Nadirit, përtërë natën kishtë ngritur urën e marrëveshjes së tyre, një marrëveshje që s'mund të ishte pastër.

Ai që lëshonte, pa dyshim, ishte Noni, kjo as që vihej në pikëpyetje. Po cili të jetë i treti, thashë më vete. Cili të jetë ai që, i nisur kushti nga g'interes, kishtë ndërmjetësuar? Ç'mjet kishtë përdorur për të arritur një sukses kaq të shpejtë e të sigurt? Kjo bëhej edhe më e beftë kur kujfoja se ishte kurrorëzuar me një njeri të

tillë, të prirur për të kundërshtuar këdo, veç vetes, siç ishte Noni. Si mund të pranonte ky, brenda një nate, të nënshkruante një marrëveshje të tillë, sipas së cilës ai duhej të bëhej i urtë, qengj e të deklaronte me kaq vendosmëri se paskëtaj do të kthehej në votë të përherershme «pro» ndaj të gjitha veprimeve të shef Nadirit? Sidomos pas grindjes së fundit një tërheqje, e tillë dukej krejt e pamundur.

Në të vërtetë jo pak herë e kisha qortuar për serialin e kontradiktës së gjatë joantagoniste Noni — Nadir, duke i veshur atij edhe ndonjë prej fajeve që kishte shefi. Grindjet, sidqoftë, grindje ishin dhe prej grindjeve askush nuk ka fituar veçse nerva apo edhe më keq akoma, dështim. Në rastet më të mira Noni arrinte të duronte pa u grindur me shefin jo më shumë se dy-tri ditë. Si dukej, të haheshe me Nadirin gjatë orarit të punës, ishte jo vetëm e natyrshme, por edhe një kënaqësi e vërtetë. Sapo shefi niste të fliste, Noni nxirrte dy copa pambuku' dhe i vendoste me kujdes në të dy veshët, që të mos e dëgjonte fare. Në të vërtetë Nadiri përdorte vetëm zërat e lartë kur fliste përpara punëtorëve të vet dhe çdonjéri prej tyre do ta shkonte ndër menç përdorimin e pambukut. Noni bëri qishte e mundur dy-tri herë të përgatiste një turmë të tillë, pa veshë, të fliste pastaj shefi sa të donte, gjër në ngjirje, le të bërtiste, le të urdhëronte ata që nuk mund të urdhëroheshin... Dhe për vete as që nuk kur-sehej.

Sapo ndante punën, shef Nadiri hynte në zyren e vet, dhe të gjithë e dinin radhën e tij të punës: Atje, si gjithnjë, e priste një vazo kosi, që ia përgatiste kovaç Nashoja. Thekte bukën, e bënte përshesh dhe këtë e shoqëronte më një kokë qepe ose preshi, pastaj shkonte nga bufeja e sektorit dhe, meqë nuk përdorte pijet me ngjyrë, pranonte ta qerasnin me byrekë, petulla ose biskota, qofshin këto edhe njëlekëshe, se i bënин mirë për stomakun, për të cilin ai harxhonte pothuaj pjesën më të madhe të jetës së vet. Kthehej përsëri në zyrë, i telefononte nëndrejtorit të ndërmarrjes, të cilit gjithnjë i kërkonte diçka për të cilën edhe ai vetë ishte tejet i bindur se nëndrejtori nuk do t'ia jepte, formonte një numër tjetër për të diskutuar përndeshjet e së dielës në futboll, që ai e quante «top me këmbë», Thërriste në zyrë zëvendësshefin vetëm e vetëm për të mos e lënë pa njeri telefonin (dhe pikërisht se shkonte ora 9), të gjithë e dinin... shef Nadiri nisej për në shtëpi.

«Ka orarin e fëmijës. Po i qan fëmija!» thoshte në këtë rast Noni, duke imituar aq qartë të qarën e fëmijës, sa e tërë oficina, madje edhe vetë zëvendësshefi, queshte me lot. E qara, kjo ishte provuar, arrinte gjer te shef Nadiri, që iekte: «Ej, ti, ç'më qesh ashtu? Për këtë të la zëvendës shefi ty?» i kthehej Noni këtij tjetrit.

E ja tani, ky Noni u bë i urtë si shqerrë dhe papritur betohet se nuk do të prishë kurrë fjale

me shëfin. Unë seç kisha një bindje se, që të squlleshe pas një sherri të atillë, duhej të kishe një arsyе të fortë. Dikush duhet ta ketë detyruar, ose i kanë premtuar diçka, ndryshe s'ka sesi, thashë me vete kur pashë se Noni u bë me të vërtetë i heshtur sa po shef Nadiri hyri në oficinë.

Pas një dite brutale,është gjë e ulët,është një padrejtësi, një brutalitet tjetër, këtë radhë i ushtruar ndaj vetes, të tregchesh i arsyeshëm, thashë më zë të ulët, por jo aq të ulët, sa të mos më dëgjonte Noni. Le të më zemërohej... As që më bëhej vonë fare. Madje m'u duk kënaqësi e vërtetë, çuditërisht, të lëshoje fjalë të tillë për një njeri të cilit pak më parë i ka thënë shok.

Shef Nadiri hyri, si gjithnjë, me duart të lidhura prapa shpinës, i shkurtër, i shëndoshë, me një entuziazëm që të detyronte buzëqeshjen. Thoshin se ai fliste me veten kur ecte rrugës. Të folurën e shoqëronte edhe me gjeste, me lëvizje të duarve, duke i ngritur ato lart herë pas here, sikur të thoshte ashtu: «Ju kam thënë, sektori i oficinës duhet të shkojë vetëm përpara! Përpara, pra!»

Kishte kohë që për të thuhej se për tre muaj dilte në pension, se do të transferohej për diku tjetër, ku duhej një tip i tillë, ose, po të mos ndodhë asnjëra prej të parave do të ndodhë e treta: Do të mbetej shef aty ku ishte.

Gjithnjë energjik, qëndroi para punëtorëve.
— Secili në vendin e djeshëm, — tha prerë.

Priti të bënin hapat e parë të tjerët dhe iu kthye Nonit:

— Si thua... do të punosh? — e pyeti shkurt, pa e parë në sy.

— Njeriu për punë vjen këtu, — iu përgjigj Noni, kokulur edhe ai, po gjithsesi më i druajtur. Madje mua m'u duk edhe ca i skuqur në fytyrë, sikur të ishte duke u lutur për diçka që s'i takonte.

— Ai që vjen për punë, s'ka kohë për llafe, or djale!

Shef Nadiri as që po e zbûste tonin e së folurës. Nuk dallova dot tek e folura e tij goftë edhe shenjën më të vogël të një kompromisi të mundshëm.

I caktoi Nonit njërin nga frontet më të vësh-tira të punës, i vendosur, pa shkuar ndër mend ta zbûste goftë edhe formalisht, qëndrimin. Tjetri pranoj po aq i bindur, madje me një qetësi aq të pàzakontë sa atyre që po e ndiqnin këtë skenë e qeshura është tanimë pikërisht prej kësaj harmonie. Ngritën supet, duke parë njëri-tjetrin ende me shpresën se, sidoqoftë, sado urtë që të rrinte, Noni diku do të shfaqej, diku s'do të duronte më.

Por s'ndodhi asnjëra prej tyre, hamendjet mbetën veç hamendje. Isha gati të jepja gjithçka për të marrë vesh mekanizmin e padukshëm që vepronë në mënyrë kaq të fshehtë.

Gjithë ditën Noni nuk u bë i gjallë. Dikush tregoi se kishte punuar si kalë, pa ngritur kokë,

pa u çlodhur, pa u ankuar, sikur të ishte fare i ndërgjegjshëm se pikërisht atë meritonte, jo më mirë.

— Më fsheh gjë mua? — e pyeta kur po ik-nim nga oficina, pas pune — Që po të pyes, besoj se kam të drejtë, aq sa ke edhe ti që të mos më përgjigjesh, apo jo...

— Ti je budalla! Budalla dhe asgjë më te-për! — më tha duke buzëqeshur më në fund, pas kësaj dite tërë ngatërresa.

— Ashtu qoftë, — thashë i lehtësuar njëfa-rësoj. Ai qeshi prapë dhe unë përsërita: — Ashtu qoftë! Siç thua ti...

«Do të shkoj në shtëpi, një banjë të fortë, do të ha mirë e mirë, televizori ka një film të mirë, por unë do të bie të fle, menjëherë. Vetëm të ha e të fle dua. Po sa do të fle, thua ti? Dhjetë — dyimbëdhjetë-katërmëdhjetë orë pa pushim do të fle. Deri nesër, kur më duhet të vij në punë. Ndryshe nuk do të jem në gjendje të shkoj pikërisht atje ku të më urdhërojë shefi ynë i dashur dhe të kryej detyrën!»

«Po cila të jetë marrëveshja, cila?» pyesja veten duke parë dritën e syve të shokut, vepri-met e të cilit nuk po mundja t'i zbërtheja. Apo ato, duke mos pasur asnë kod, bëheshin të errëta vetëm e vetëm nga këmbëngulja e pa-shkak? «Noni, mbasë pa asnë shkak tjetër veç dëshirës për të mos u grindur kot me Nadirin dhe me këdo tjetër, do t'i shtrohej tërësisht punës, dhe vetëm asaj, do të linte mënjanë të gjitha

gjérat e vogla, siç lémë tē gjithë një ditë lodrat e fëmijërisë, thashë më vete. Por... cili prej fëmijëve i ka lénë lodrat pikërisht atëherë kur ia kanë kërkuar këtë? Kur ia kanë detyruar largimin prej tyre? Askush.»

* * *

Të tëra ditët e javës më pas ishin njëlloj, pa asnje ndryshim, pa asnje tē re.

Marrëdhëniet Noni — Nadir, pasi morën atë formën e mprehtë, sikur s'kishin më ndër mend tē lëviznin. Shefi, i prerë, i rreptë, madje ca si tendencioz në qëndrimin ndaj Nonit, kurse ky, i qetë, sado si i ndëshkuar, i ngjante një fëmije tē bindur ndaj prindit tē tij tē ashpër, që kërkon t'i ushtrojë tē birit durimin dhe vullnetin. Mës është fejuar ky, tha njëri prej punëtorëve më në fund, se më duket është bërë djalë për shtëpi! E ç'bëni kot llogaritë e tjeturit, tha një nga punëtorët e vjetër, lëreni tē punojë, se puna gjithnjë mirë tē bën.

— Po ç'djallin ka ndodhur me ty kështu, ë?!
— ia plasa një ditë, kur dëgjova se shefi prapë e kishte tepruar me tē dhe prapë Noni i pati hapur udhë.

— E, si dukesh — i kishte thënë shefi, duke i

nënqeshur, tek e shihle Nonin, të djersitur, të pluhurosur; por edhe të prirur për të mbajtur mbi shpinë edhe fyereje të reja të shefit. — Më mirë, apo jo? Apo ke ndonjë vërejtje për të bërë, ë?

Noni as që bëri gëk, e besoni, na tha më vonë shoku i tij i punës. Sa folët ju, që s'ishit atje, aq u dëgjua edhe zëri i tij. Ù detyrova unë të futja hundët e të grindeshë me shëfin, që nuk po nginjej me robin e vet. Po, po, mirë e thashë, robin e vet. Se si rob po i rrinte. Pa kur m'u kthye pastaj edhe mua, që i dola avokat mbrojtës, atëherë ta shihnit Nonin! «Secili bën mirë të shohë punën e vet», më tha duke më lënë pa mend. Edhe vetë Nadiri u hutua nga ato që i dëgjuan veshët.

— Po ty mirë të të bëhet, — i thashë më në fund, — kokën të hani me njëri-tjetrin, q'më duhet, vërtet, mua.

— Nuk paskam të drejtë as të luaj me veten?

— m'u përgjigj Noni.

— Ti mund të bëhesh aktör shumë i mirë, — i thashë, — madje duke interpretuar veten.

— Unë nuk shtirem, këtë duhet të ma bessosh! Vetëm se eksperimentoj nga pak me veten.. Vetëm kaq! Dhe kjo nuk besoj se i prish punë njeriu.

— Nëse nuk shtiresh tani, do të thotë se je shtirë më parë. Je qarë kot, i ke dramatizuar kot situatat, je shfaqur ai që s'je, pra....

— Unë veproj me ndërgjegjë të plotë, për

këtë të jesh i sigurt, unë jam i qetë gjer në detaje.

— Ke garant pér këtë qetësi? — e pycta më në fund.

— E përse të bëj ndryshe, a s'më thua? Ç'të mirë pata që u bëra grindaq i zakonshëm? Edhe ti vetë më ke qortuar, jo një herë, që ta kyçja gojën, apo jo?

— Ik, ik! Sonte nuk dua të të dëgjoj më, — i thashë. — Ti po flet si përfaqësues i brezit të hëmbur. Ta paska futur lepurin në bark shef Nadiri. Nesër të pres në shtëpi, dëgjove? Se mos bën gabim dhe nuk vjen! «E vërteta kurrë nuk komprometon njeri, thashë me vete. Dhe ky, po të mos jetë komprometuar, s'ka si të mos më thotë të vërtetën.»

Të nesërmën e prita gjatë, por nuk erdhi. Mbështetje i kishte dalë ndonjë telash, mbështetje... Por se përse doja të besoja atë tjetrën, që te ky djalosh se çfarë pati ndodhur. S'mund t'ia hidhje të gjithë fajin pér këtë shëf Nadirit, jo... Ai kishte pjesën e vet, por jo të tërën. Mbështetje, me që ishte e diel; kushedi q'vizita ka pasur pér të bërë dhe nuk mundi të vinte, kërkova ta justifikojë. Ose rri shtrirë në shtëpi dhe çlodhet, se gjithë javën e lodhi Nadiri, në frontet më të vështira e degdisi.

Të hënën në mëngjes erdhi vetë, duke më thirrur që atje tej, më njoftoi se shefi e kishte caktuar në një punë të mirë. Si tip përgjegjësi,

më tha. Noni, nuk e di se ku, ende s'më ka thirrur vetë në zyrë.

«Ja pra, pa asnje fjalë tënden, unë që në filim e mora vesh se një marrëveshje ishte në këtë mes! E kam marrë vesh me kohë, Noni, ë...»

— Nuk e beson? — më pyeti me zë, pa ditur gjë se ç'po mendoja në ato çaste për të. — Ja që qenka e mundur të merresh vesh edhe me shefin tonë të bezdissëhm e të padurueshëm, apo jo?

— Urimë, urime! — i thashë, pa e fshehur atë që ndieja. Ai që të ka pasur, më të afërt, më të dashur, e paska më të lehtë për të të urryer, po mendoja në ato çaste. Se ai t'i di të gjitha, të di edhe shkaqet, por edhe mundësinë për të mos u bërë për t'u urryer, prandaj...

— M'u desh edhe mua ta aktualizoja ndërgjegjen më në fund. Nuk mund të vazhdoja dot ndryshe, — tha.

— Një javë heshtje, ky ishte çmimi i marrëveshjes, Noni?

— Unë do të duroja edhe më tepër, për ta fituar me anën e heshtjes atë që ndoshta e kam merituar qysh më parë.

— Cili ishte ndërmjetësi, ai që hartoï kontratën?

— Asnjë marrëveshje nuk ka pasur, të betohem! Vetëm se unë, pa folur as me ty, as me njeri tjetër, vendoşa të heshtja. Dhe ti nuk e quan të mjaftueshme një javë heshtje, për të fituar besimin e një njeriu si shef Nadiri? Aq më tepër kur është fjala për një njeri aq llafazan, siç isha unë para një jave!

— Ah, sa mirë, njëqind herë më mirë do të ishte sikur të kishte pasur midis tyre një të tretë, një

ndërmjetës... sesa kështu, sesa një parëmendim si ky, po mendoja.

Ca gjëra, që më parë kishin qenë të padukshme, po shfaqeshin tani të kthjellëta fare, të tejdukshme, prandaj edhe tronditëse, madje edhe ca të dhimbshme. Përmes heshtjes, vetëm duke u parë sy më sy, nga fare afër, po i largoheshim njëri-tjetrit, sikur po udhëtonim në drejtime të kundërtta, me shpejtësi të mëdha, marramendëse, trullosose.

Noni, s'është gjë e këqe të sillesh mirë me këdo, edhe më ata që nuk e meritojnë këtë sjellje, por.. ta dish ose më mirë të mos e harrosh, as bindja as urtësia s'kanë asgjë të përbashkët me humbjen e dinjitetit, të cilin njeriut nuk i ndodh shpesh ta rivendosë. Dhe, dihet, kur ke vendsur të mos e kesh më atë, dinjitetin, pra, mund të arrish të fitosh gjithçka, se ai që bëhet me gjithë shpirt skllav, më lehtë se kushdo mund të shndërrohet edhe në zotëri.

Nuk po fliste asnjeri. E ç'të thoshim? Mua ende nuk ma ha mendja që Noni të bëjë palo punë të tillë, sado që po e shoh dhe po e ndiej me të gjitha shqisat se ai i ka bërë këto palo punë e ndoshta ca më tepër se kaq

— Në të vërtetë tërë puna është të mos të vijë turp nga vetja, — i thashë më në fund. Vetëm kaq. Do t'i thosha edhe të tjera, por e thirrën nga zyrat, me zë të lartë, si duke qeshur, si duke bërë shaka.

— Nonin ej! Nonin, kontrollorin e ri të cilësisë, e kërkon në zyrën e tij shef Nadiri.

Reizi pa mbiemër

Nxori nga sirtari i këmodinës fotografinë që ruante aty, dhe, ashtu siç ishte, shtrirë në shtratin e vet, e vështroi gjatë.

«Të butë i ke flokët...» i tha djaloshit që e vështronte buzëqeshur nga fotografia. «Të butë e të bukur», shtoi pastaj si për ta zgjatur edhe më kuvendimin më të. Ia përkëdheli kaçurrelat e rrëzuara mbi ballë. «Secili ka gëzimet dhe festat e tij, tha me vete, unë këtë gëzim kam, të rri e të çmallem me këtë fotografi!»

Ishët fotografia e një njeriu të cilin e njihte aq mirë, gjer në skutat; ia dinte të gjitha 'çmund

t'i dihen njeriut, gjer edhe ato që i fshiheshin tej syve të ëmbël, me një ngjyrë kafe të zënë e tej ballit të pastër, rinor, të ngushtuar prej kaçurrelave të njëzetetë-vjeçarit.

— Ah, edhe unë me këtë jetë... — tha me zë ankues, por edhe të zbutur kushëdi pse.

E kishte fotografinë e vet. Më atë bisedonte sa herë që ishte vetëm, si kësaj së shtune.

Ishte i vetëm në dhomën nr. 114 të pallatit të punëtorëve. Pandi, shoku i dhomës, si në çdo fund jave, kishte ikur për në shtëpi të vet, në fshat, te fëmijët dhe te gruaja.

Kurse ti as grua ke, as... asgjë nuk ke! Nuk ke ku shkon, nuk të pret njeri, i tha vetes.

E kishte pushtuar, papritur, një ndjenjë e thellë trishtimi. Vëtmia i kishte behur tronditëse, marramendëse dhe ai ndjeu t'i njomeshin sytë. Në pasqyrën e dollapit ishin fotografitë e fëmijëve të Pandit. Të qeshurat e tyre, krejt të pafajshme, kësaj nate po i bëheshin aq të ngrohta, aq tunduese, sa ai u ngrit dhe i vështroi më nga afër. Dy djem dhe një vajzë, të tre të bukur e të shëndetshëm. Reizi u dinte edhe emrat, madje, ngaqë e pyeste çdo herë Pandin, kur ai kthehej nga fshati, u dinte edhe përkëdhelitë që përdornin me njëri-tjetrin.

«Pandi me siguri tani ka arritur atje te ju», tha duke iu drejtar fëmijëve. «Ju ka puthur me radhë, ju ka marrë të tre njëherësh hopa, në krahët e tij si të ariut, duke jua mbushur duart me shëqerllëke! Merrini edhe këto tri

çokollata, ju ka thënë, i keni nga xhaxhi Reizi, që ju ka xhan. Deri në dhjetë e gjysmë vëtëm do të jem, tha me vete. Në orën nëntë do të zbres të ha darkën, me një teke raki, do të kthehem pak nga televizori mös ka ndonjë film të bukur ose ndonjë teatër, pastaj do të vij në dhomë për tu veshur e do të dal për në punë, te rruga e minicrës.»

Kishte disa vjet që punonte në ndërresën e tretë. Ishte mësuar të mos e bënte gjumin e natës. Flintë paradise, nga dy apo tri orë, po kaq pasdite, pas buke dhe mjaft e kishte. Gjithë ditën e kishte të lirë. Shkonte në sallën e leximit për gazetat, merrte pjesë edhe ai; si shumë të tjerë në këtë qytet, në grumbullin e njerëzve që prisnin ardhjen e autobusit nga qyteti, shikonte cili vinte e cili ikte, si ishte veshur e kush e priste; pastaj bënte një dy shëtitje në rrugën e asfaltuar të qytetit, derisa vinte koha e drekës. Hani të drekë, duke llogaritur që gjithnjë t'i ngelej një tridhjetë qindarkëshë te për Lonjës, kamerierës së re, që i shërbente aq mirë, sa klientët e tjerë kerkonin të gjenin arsyë të kota për t'i shpjeguar.

Pastaj vinte në dhomë e shtrihej përsëri në shtrat duke lexuar ndonjë roman ose thjesht sa për të qëndruar i qetë. Kujtonte një nga një bisedat që bëheshin në sëktor dhe shpesh bisendonte me Pandin. Duke shkuar ndër mend të gjitha këto, pyeste ndonjëherë vëten se, në fund të fundit, ç'ishte jefa për të. Sikur të mos ishin as këto biseda, as kjo jehonë e jetës së të tjerëve, ai

mendonte se nuk do të dinte t'i përgjigjej kësaj pyetjeje. Në këto raste ulej në gjunjë, aty ku ishte, dhe ndiente një këputje të përgjithshme.

I dukej vetja si një llambë e lënë mënjanë, që digjet pa dritë, pa zhurmë, që nuk i shërbën askujt, Por nisej për punë, hipte në makinën e minierës, dhe në mes të zhurmës së minatorëve sikur përshkënditej, niste të thoshte ndonjë fjalë, të bënte ndonjë shaka dhe si pa kuptuar e ndiente vëten në hullinë e jetës së vërtetë. Atëherë gjallërohëj edhe më, nuk linte bisedë pa ndërhyrë, shakatë e tij ndiqnin njëra-tjetrën dhe ai bëhej episondra e së qeshurës.

Vetë... eh... Vetë qeshte nga pak fare, sikur të thoshte ashtu, «Unë i kam të gjitha të njeriut... përjashtuar gëzimet e tij!»

Ja edhe këtë mbrëmje. I vetëm fare, në një dhomë me dy shtretër të pallatit të punëtorëve. Në këtë pallat flinin punëtorët nga fshati, ata që nuk mund të shkonin dot çdo mbrëmje në shtëpitë e tyre. Për këtë e thërritnin «Pallati i beqarëve». Dikush e kishte krahasuar me një shkrepëse; mjaft që ta prekësh pak në faqet e fosforta, pati thënë ai, dhe kjo do të marrë zjarr në çast. Ah, zjarri im! Ka marrë ujë me vakt e jo tanis, tha me vete Reizi duke dalë në dritare të dhomës, duke u çuditur edhe vetë me këtë trishtim që e kishte pushtuar këtë mbrëmje.

Njerëzia shëtitnin megjithatë. Nga dritarja dukej e tére rruga që të nxirrte për në qendrën

e qytetit. Kohët e fundit e kishin bërë zakon të dilnin në shëtitore edhe të dashuruarit, që më parë përgojoheshin, dhe kjo sikur ia kishte bërë edhe atij më të këndshme tjetër e mbrëmjeve. Ata sikur i jepnin një aromë tjetër shëtitores. Njerëzit, tanimë, në prani të seksit tjetër, nuk flisnin vetëm për punën dhe për futbollin, por edhe për shumë gjëra të tjera...» të cilat mua më kanë munguar «e do të më mungojnë...» tha për vëten Reizi, mbështetur te dritarja. Atë kamërieren e mensës së pallatit të tyre, le të flisnin të tjerët sa e si të donin, pavarësisht prej fjalëve, para 10-15 vjetve edhe mund ta shkonte ndër mend, po jo tan... tan kurë! Tani e kishte si vajzën e vet.

Dikur pati ëndërruar edhe ai të gjente një njeri për të shkuar jetën. Jetim, siç ishte, ditët i kishin fluturuar pa e kuptuar. Ai kërkon te një njeri që të mos trembej nga fati i tij, një femër që t'ia shuanë etjen për njerëz, donte një grua me gjak të ngrohtë, që t'i ngrohte edhe të tjin, por kjo i vonoi si shumë...

Një ditë i sollën fotografinë e një vajze, mosha e së cilës iu tregua disa herë e ndryshme, por ai nuk u thyë nga kjo; madje iu duk e bukur, më e bukur seç pati pritur ai vëtë të ishte. Pranoi të takohej me të, ia sollën, u pëlqyen dhe pas një muaji ai e mori grua. Por ajo nuk dëgjoi të flinte me të. Ai i bleu fustane, këpucë, këmishë të reja dhe çorape, të gjitha sa i duhen një gruaje dhe e përçolli për në fshatin e saj përgjithnjë, bashkë

me shpresën e vet për të pasur ndonjë ditë shtëpinë e tij. Më vonë e pati qortuar veten që ishte treguar aq i butë. «Ta kisha mbërthyer një herë në krahët e mi, ta kisha shtrënguar fort, t'ia kisha zbuluar ftyrën më të puthura, t'ia kisha provuar se e doja, se do ta doja gjithë jetën dhe se edhe ajo mund të më donte, se jetime kam jetën, jo zemrën,» i thoshte vetes ndonjëherë, po në të shumtën e ditëve mendonte se kishte bërë mirë që e kishte lënë të shkonte atë vajzë. «Dhia s'bëhet dele kurrë», u thoshte atyre që e pyesnin për këtë gjë.

Pas kësaj sikur u tha e u fishk shpejt. U mbylli në vete si ai molusku që e shqetësojnë të gjitha lëvizjet përgark tij. Më të tjërët rrinte kur i bë-heshin shokë në raki, kurse në punë kërkoi ta kthenin rojë në sektorin e vjetër, nga ku po tërhimeshin. Nata e fuste rojën në gjirin e saj, sikur ai i kishte kërkuar ta fshihet prej njerëzve. Miniera i jepte para qhe ai i pinte të gjitha. Pinte me këdo, po më tepër, me ata që nuk e pyesnin për atë që i dhimbte. Me këta nuk vinte re sa paguante. Vetëm sepse nuk e lëndonin. Pinte, po nuk bënte zhurmë fare, paguante deri në një dhe kthehej, në dhomë e flinte si qen i rrahur...

E la dritaren dhe u shtri prapë.

«Kjo fotografi më turbulloj», tha dhe e futi atë në mesin e librit që po lexonte. «Pastaj edhe ky gjumi i pasdites të trazon jo më pak.» Lu afroa pasqyrës për të vëzhguar me nge veten, të tanishmin, pasi ishte cmallur me të shkuarin nëpërmjet fotografisë. Shkoi pëllëmbën faqeve,

mjekrës, gjér poshtë në gushën e rënduar nga rrudhat, vuri re, si për herë të parë, se prej kurrelave kishte mbetur vetëm imazhi i të dikurshmeve dhe kushedi për të setën herë tha me zë se ishtë plakur.

«E po edhe me vjet je plakur, de,» sikur i bërtiti vetes, si për ta kujtuar se pas një javë do të dilte në pension. Do të luante domino tërë ditën me pleqtë e-tjerë, do të pinte kafe me të tjerë njerëz... dhe prej këtij mendimi sesi i erdhë. Jo se për pleqtë mendonte keq apo se dyshonte mos me ata dō ta shkonte më keq se me këta, në minierë, jo. Po në minierë kishte, një jetë të tërë. E ç'kam pasur më të afërt se ata?! Kur nisej për në sektor, ai gjëzonte sic gjzonin të tjerët kur shkonin për nën shtëpitë e tyre. Sapo hipte në makinën e ndërrsesës! Reizi besonte gjithnjë e më tepër se bota e kishte edhe atë.

Disa ditë më parë ishin ndarë pakot e Vitit të Ri. Merrnin pakoyetëm ata që ishin familjarë, që kishin fëmijë nën shtatë vjec. Reizi ishte hequr mënjanë dhe dëgjonte zërin e kryetarit të bashkimeve profesionale që lexonte emrat. Të gjithë ishin në sallë, flisnin, bënin shaka, qeshnin, ngacmonin njëri-tjetrin. Eja, e di ti që vitin tjetër fëmija të mbush shtatë vjeçët? Prandaj mendo për ndonjë tjetër, me të vogël! Po deshe që të marrësh pako... për këtë ta them, jo përgjë tjetër, po thoshte njëri:

«Të kisha pasur edhe unë një herë një fëmijë, pa le të më kishte vdekur pastaj», po thoshte kur dëgjoi të thërritnin emrin e tij.

— Reizi, ej, Reizi, të vijë të têrheqë numrin e pakos së tij, — po tnoshin, — ku shkoi Reizi?

«Bën shaka ndonjë nga djemtë», tha me vete duke qeshur. Vetë i kishte mësuar të bënин shaka me të. Vetë i kishte nxitur dhe i ndizte shakatë pér beqarinë e tij të pafundme. Më shumë se kushdo ai vetë bënte hoka pér të. Dilte nga galeria dhe fillonte të këndonte:

*Ditë pér ditë po rritesht, moj,
dhe unë po të pres...*

Vetëm këto dy vargje këndonte. Refren pér nusen e tij që s'po rritej, sado që ai po e priste që prej afro një gjysmë shekulli. Vajzat e llambisterisë e dëgjonin dhe qeshnin, por shpesh e vështronin të menduara, si të përhumbura, sikur ai t'u paralajmëronte ndonjë gjë të keqë.

E gjetën aty ku rrinte dhe e quan në sallën ku ndaheshin pakot e Vtitit të Ri.

— Të kanë bërë edhe ty një pak, — i thanë, — e ke vitin e fundit këtë, do të na ikësh, prandaj...

Ç'ta dua pakon unë i shkreti... — tha me zë të ulët, duke shkuar pér atje ku i thanë. Kur hapi pakon dhe panë se i kishte rënë një kukull, qeshi një i vetëm, por ai ishtë një punëtor i ri, pak ditë kishte në minierë. Do t'ia fut fshehurazi në çantë Pandit, t'ua çojë fëmijëve, mendoi në çast Reizi pér kukullën. Pse

nuk e mbajte për nuse?! Ose ta kishim shitur e ta pinim raki, do t'i thoshte ndonjë nga pijanikët e pallatit të beqarëve. Po Reizi kishte kohë që ishte larguar prej tyre. Me Pandin ulej ndonjëherë, ose me ndonjë nga shokët e tjerë të punës. Me ata që kam qejf, më ata rri, u përgjigjej atyre. Ditët e festave, atëherë po! Vinte i pirë në dhomë, e sillnin shokët, e mbulonin dhe ai flinte si qengj...

«Do dal», tha, po vuri re se ishte i parruar, «Kam mjekër filozofësh», tha me vete duke qeshur. Kërkoi në gardërobë një këmishë të pastër, veshi trikon e leshtë e mbi to xhaketën dhe u kreh, gjithnjë duke qeshur nga pak me veten. Pastërtinë e kishte merak të madh; përditë rruhej, rrrobat i conte në pastërti. Mjekrën e hiqte përditë, në rrojtore. Ia linte kokën në dorë berber Vasos si një fëmijë i urtë dhe vetëm buzëqeshte duke dëgjuar ngacmimet e tij. Berber Vasoja e pyeste gjithnjë se kur e kishte lënë ditën e dasmës. Të dielën, i përgjigjej Reizi. Që e diel do të jetë ajo ditë, kjo dihet, thoshte Vaso berberi, po cila e diel, e cilit vit?

— Dhëndër të bëra sot, — i tha, si gjithnjë, edhe këtë të shtunë berberi, — se mos e ke lënë sot dasmën e ma fsheh mua, or mik?!

U drejtua për tek arka e kursimeve. Kishte pará me vete më shumë seç i duheshin. «Do bëj mirë t'i vë ca atje», tha. Pjellë nuk kishte, as të afërm, që t'ua linte, po çdo njeriu i janë vënë në pjesë ca ditë të vështira, thoshte shpesh kur e

pyesnin përse mendonte për kursime. «Të paktën për të ikur, për t'u nisur atje ku janë të shumtët, për te varret, pra, duhen ca parâ, të cilat nuk është mirë të t'i paguajnë të tjerët, kushdo qofshin' ata.»

Prej aty hyri në shtëpinë e kulturës, shfletoi gazetat e ditës, bëri dy lojë shah, të cilat i fitoi të dyja, po nuk pati dëshirë të vazhdonte më. Nxori orën e xhepit, një orë të madhe e të vjetër, për të cilën nuk kishte pranuar asnjë lloj çmimi dhe llogariti se i kishin mbetur edhe pothuaj dy orë e gjysmë gjersa të vinte koha për punë.

Kafoi dalengadalë përmes qendrës së qytetit, ku ndizeshin e shuheshin llambat neon dhe te koçeku vuri re Kalo Monen që nxitonte me një fëmijë në krahë. Gruaja i vente prapa, e shkurtër, pothuaj duke vrapiuar pas hapave të gjatë të tij.

— Mirë je, Reiz? — e pyeti Kaloja i pari.

— C'pyet për mua edhe ti. Paske fëmijën sëmurë?

— E po fëmijë janë. Po nuk ërthu dot sonte, thuaju andej nga puna, mirë?!

— Hic mos ki merak! Shiko fëmijën, atë bëjt... të tjerat i rregulloj unë.

I ndoqi më sy gjë atje tej Kalo Monen më të shoqen dhe vështroi përsëri orën si për të verifikuar edhe më mirë nëse kishte kohë të mjaftë përtakryer porosinë e tjeterit. «Ishin bërë një grusht përfëmijën, tha me vete... por edhe kështu, qyq, si unë; c'e do qetësinë fare.»

Te bufeja, prapa së cilës luanin domino pensionistët, bleu një paketë cigare me filtër.

— Hajde, do na japësh ndonjë dopio, se do të myken paratë... apo do t'i marrësh me vete?! — — dëgjoi t'i thoshte njëri nga beqarët e tjere të pallatit.

— Ti po deshe, pije, unë jam për në punë, — iu përgjigj duke ia lënë në bufe paratë për dopion e rakisë.

Në mensë hëngri si me pahir. Tek po dilte, i tha kamerieres se do të shkonte të pinte çaj në dhomë.

Dëgjoi se kishte teatër në televizor, por ndihej aq i lodhur, sa mendoi se bënte mirë të shkonte e të shtrihej ca në dhomë më parë. Atje ndjeu përsëri këputje të gjymtyrëve dhe vendosi të mos shkonte për televizor. Megjithatë u ngrit, gjer te dhoma tjetër, sa për të lajmëruar se Kalo Monia nuk do të shkonte sonte në punë, po të mos i qëtësohej fëmija. Pastaj u shtri përsëri, u rehatua. Ndoshta me të vërtetë çaji i bëri mirë dhe sikur i erdhi gjumë. U mundua të kujtonte diçka nga ato që i kishin ndodhur gjatë ditës, për të marrë vesh njëfarësoj shkakun e kësaj gjendjeje, por nuk mundi. E shkuara dhe e përditshmja e tij ishin aq të ngatërruara më njëra-tjetrën, saqë në të vërtetë ato pothuaj nuk i dallonte gjë. E gjithë jeta e tij ishte njëlloj, një përsëritie ditësh me fytyrë të njëjtë.

«Pandi nuk ka asnje faj, në qoftë se unë vete e vdes sonte, si njeri pa njeri», tha me vete, i

guditur nga mendimet që i vetëtinin këtë mbrëmje. Mori librin që kishte nën jastëk, por s'mundi të lexonte.

«Si do ta shtyj këtë natë, ë?» pyeti pastaj, duke vendosur fare papritur që të mos shkonte kësaj së shtune në punë. «Për Koli Monen lajmërova. Nesër duhet të shkoj të dorëzoj dy librat në bibliotekë dhe të çoj ca rroba për të larë.» U ngrit dhe nxori ato që duheshin pastruar. Në të vërtetë ato mund t'i linte edhe ca ditë në gardërobë, por s'i duronte dot jakat e ndotura sadopok. Kishte boll këmishë, kanotiera, ndërresa të ndryshme, shami dore, tri kostume, njëri prej të cilëve fare i ri, po kaq kapele me ngjyra përkatëse dhe në çdo rast afo ia gjeje të pastra, të hekurosura, në varëset e shumta në dollapin e madh.

Në korridoret u dëgjua zhurma e atyre që dilnin nga salla e televizorit. Zërat u fshehën ca nga ca nëpër dhomat dhe më në fund sundoi qëtësia, por edhe kjo nuk ia largoi do t'atë mugullirën që po e shoqëronte gjithë kësaj dite.

Kur po shkonte 22 e 30, tek dëgjoi hapat e atyre që nxitonin të dilnin për në ndërresën e tretë, seç i shkrepi dhe u ngrit vërtik në këmbë, veshi rrobat e punës; çizmet dhe pothuaj duke vraptuar i kapérceu shkallët si njëzetvjeçar; la çelësin e dhomës te sporteli, por, kur doli para pallatit, makinat e minierës nuk mund të arriheshin më. Qeshi me vete, duke u kthyer në dhomë.

— U plaka, s'e arrità dot turnin, u vonçva,
— i tha sportelistit. «Por më mirë që nuk e

arrita, tha pastaj. Rri e çlodhu, s'e shikon vreten si je sonte? Rri, dëgjon? Se s'të ngelën fëmijët pa bukë ty», i tha vetes.

Dhoma sikur iu duk më tjetër, më e gjerë, drita më e rreptë. Gjer edhe vetja në pasqyrë iu duk më e ëmbël. Fëmijët e Pandit në fotografi i qeshnin aq ngrohtë, sa Reizi u afrua pranë pasqyrës dhe i kërcënoi me lëvizje të gishtit, miqësisht. Shkoi te komodina, mori nga brenda librit fotografinë e kaçurrelësit 23-vjeçar dhe e vendosi atë poshtë asaj të fëmijëve të Pandit.

— Dhe të më falësh, i tha vetes së dikurshëm, të më falësh që s'munda të të gëzoj dot! Të kam munduar ca... jo pak! S'e lashë askund rininë, as gjakun tënd! Ty, i tha vetes së tanishëm, të mjaf-ton aq sa kam unë sot, se mes njerëzve je, dhe kaq i mjafton njeriut në këtë moshë. E, do të më falësh apo jo? iu kthyet të dikurshmit. Le që vëtëm vdekja, ajo është njësoj si falja», kujtoi një thënie, s'mbante mend se ku të lexuar.

U shtri me një ndjenjë gjithsesi më të rregulluar humori dhe, duke vështruar nga fotografia e vetes 23-vjeçar, e mori gjumi...

kishte shkuar në punë, ata të dhomës tjetër e gjetën të vdëkur. Me sytë andej, nga fotografia e rinisë, sikur të donte të mbetej përgjithnjë duke i kërkuar të falur asaj.

— Sikur ta kishte ndjer se do të vdiste, — tha dikush, — që nuk shkoi në punë!

— Po të kishte shkuar në punë, kushedi... mund që kjo të mos kishte ndodhur fare... ku i dihëj! — iu përgjigj një prej atyre që kishin filuar nga përgatitjet e përcjelljes së fundit të Reizit pa mbiemër.

Nesër, më dhjetë e gjysmë...

Pleqtë vazhdonin të luanin domino atje, nën ullinjtë, në brinjë të ëmbëltores. Kishin të gjithë nga një stol druri të vogël dhe nga një shilte që e vinin mbi të për të ndenjur butë.

Latoja është njëlloj edhe kur fiton edhe kur humbet. Gjithnjë qesh e këput hoka. Hoka do të bëjë edhe Xhezoja, po nuk i kanë lezet fare. U plake dhe nuk di t'i bësh dy fjalë bashkë! e ngacmon Latoja. Hë, de, do luash apo... ku e ke mendjen? Apo do të ikësh edhe ti me Reizin?

Reizi, njeri pa njeri, i ardhur në qytet kushtëdi nga, përpëra nja njëzet e pesë vjetve, ki-

shte vdekur natën e shkuar në dhomën e tij, në pallatin e punetoreve, qe quhej eahe pallat i beqareve. Kishte dhënë frysme nja gjysme ore përpara se të niseshin makinat e nderresës së tretë të minierës, ku punonte. Tani që po e rregullohin në dhomën e tij, para pallatit po mblidheshin shokë pune, të njohur e njerëz të tjerë, që s'kishin punë tjeter atë kohë.

Donte edhe dy orë të bëhej varrimi dhe pleqtë, përpara se të shkonin atje, thanë të bënин një dorë domino. Reizi nuk kishte njeri të tij, të gjakut, ku duhej të shkonin për të ngushëlluar.

— Domino! Fillojmë tjetrën! — tha Xhezo Kërpica. I kishte vdekur dy vjet më parë gruaja dhe që atëherë e thërritin Xhezo Beqari.

— Ike, më duket, edhe ti, o Xhezo, — iu kthyë atij Lato Brahoja. — Ka filluar vdekja të të marrë me të mirë. Të lë të fitosh dy-tri lojë domino me mua, dhe fap, të mbërthen!

— Hajde, luaj ti, atë bëj, s'dihet kush shkon më parë atje lart, të Lebua. Po tu bë për mbarëty, mos harro, merri një palë domino me vete!

Leboja kishte «ikur» tre vjet më parë, pa u ankuar fare për shëndetin. Kur dëgjuan për vdekjen e tij, pleqtë e tjérë sesi u ndien. Nuk e fshihnin tronditjen. Atëherë Latoja e kishte prekur me dorë fytyrën e verdhë të meitit dhe kishte pëshpëritur pa fuqi: «Ike, vëlla?» Me pëshpërimë lëtët ia veshën sytë si të zbardhur nga dhimbja. «Na iku edhe Lebua, ë!»

Pleqtë qanin rrallë, po për njëri-tjetrin sepse rrëmbusheshin e lotonin fshehurazi.

— Po ja, shkuan tre vjet dhe ne jemi këtu akoma. S'ka radhë kjo jetë.

Lato Brahoja po dredh cigaret e pestë. I përgatit ato që t'i ketë për rrugës, kur ta çojnë Reizin atje, në varreza.

— Ore, po ty t'u dridhkan duart. — gjen rast të flasë Xhezoja.

— E po dimër është dhe dimri pleqtë e zogjtë i ka qejf. Por unë nuk vdes në dimër, jua kam thënë.

— Me kë e ke rregulluar, me ata të varreza?! Apo do të dërgosh plakën në këmbë tënde. Ta gjesh gati konakun kur të vesh.

— Jo, more, jo, po kam dëhendrin gjahtar. Mos bën gabim e vdes në sezon të gjahut, më thotë, se as unë nuk të vij e as tët bijë nuk ta dërgoj të të qajë.

Pothuaj të gjithë kanë dalë në pension si minatorë dhe kanë pensione të mira. Rrinë me kostume gri, të holla në verë dhe të trasha në dimër. Cakoja, që ka qenë zyrtar, mban akoma kollaren. Latoja e këshillon se ende duhet t'i ruhet kollares, mos e shtrëngon ca më tepër ndonjë ditë dhe...

Xhezoja qahet se, që kur «iku» plaka, nuset e mërzitin duke ia ndërruar këmishët një herë në dy ditë. Hakiu nuk ulet të luajë me moshatarët e vet veçse të hënave, kur dyqanet, ku ai zë radhë për gjashtë fëmijët e vet, janë të mbyllura.

Tre prej pleqve kanë orë të vjetra xhepi, të cilat dy orë pasi i vinin njëlloj fillonin e tregonin

kohë të ndryshme. Hakuut, që te dominotë e gjen vetëm në këmbë, sa për të parë, fëmijët i kanë blerë orë. Dikur, duke ndarë pagat e minatorëve, e kishin mërzitur aq shumë, sa Hakuu, duke bërtitur. «Na, ja tek i keni, merrini paratë, merrini», i kishte hedhur ato në ajër, mbi kryet e punëtorëve. Por ishte njeri aq i drejtë, sa, kur ishin mbledhur lekët e shpërndarë fije-fije, nuk mungonte asnje! Edhe në radhët e dyqaneve Hakuu ruante rregullin e nuk i lëshonte askujt pe.

— Po për atje, do zësh radhën, o Kike?!

— Aha! Vetëm për atje s'nxiton njeri! Do s'do ti, vjeri vetë ajo e të gjen, në shtëpi a duke lozur domino, ku të jesh!

Duket sikur i kanë mendjen vetëm te loja, por e njohin mire njëri-tjetrin dhe merren vesh edhe kur flasin me zë të ulët, kur lëshojnë ndonjë thumb të pafajshëm.

Qeshin mbyturazi, kollen nga pak, i bëjnë ndonjë shenjë shoshokut duke përgjuar shenjat e atij në krah, shohin herë pas here nga pallati i punëtorëve mos po del arkivoli i Reizit, pa harruar cilë prej kundërshtarëve ka dopjo gjashtën e rëndë, që t'ia lënë në dorë. Pa kujtohet dikush të hapë muhabetin e djemve dhe po ta dëgjosh, një ditë del se ata janë të hairit, për shtëpinë e për shoqerinë, kurse ditën tjetër as për njérën as për tjetrën. Or po, po nuk punuan sot, që janë të rinj, kur do punojnë ata! T'i shohësh në aksione, të dielave, një punon, pesë janë komandantë!

E, ore shokëni, e! U bëmë më në fund të men-

çëm dhe... tani na ardhka radha të vdesim! —
thotë Latoja si pér t'u dhënë udhë të gjitha fjalëve.

Po nxirrnin arkivolin e Reizit. Makina e komunales u afroa pér te hyrja e pallatit të punëtorëve. Grumbulli i njerëzve atje ishte rritur shpejt. Pleqtë u ngritën e pas pak iu shtuan turmës së mbledhur pér përcjelljen e Reizit, që ikte pa lënë asgjë të tijën në këtë jetë. Shumica ishin shokë të punës, minatorë, por, kur dolën në rrugën kryesore, u shtuan aq shumë njerëz, një pjesë e mirë e të cilëve mbasë s'e njihnin fare Reizin, saqë numri i shokëve të punës ishte pas kësaj, fare i papërfillshëm në krahasim me të tjerët. Askush nuk do të besonte po t'i thoshe se tërë ajo masë e madhe njerëzish, ai kortezh i gjatë, me fëmijë, gra, burra e pleq, përcillte një njeri pa njéri.

Procesioni zhvendosej ngadalë, si me hapin e pleqve.

Pleqtë dinin si ecej në këto raste.

— Unë kam çuar djem të rinj atje, dhe prapë, kaq rëndë, si sot... — i tha njërit prej tyre Lato Brahoja.

— Vdekja, sidoqoftë, vdekje është! — tha tjetri, pa ditur ç'pillte mendja e Latos në ato çaste.

— Mirë, o, mirë, po Reizi do të na e falte ndonjë budallallék, po ta bënim! — pëshpëriti dhe, ashtu kokulur, siç ecte, e nxitoi pak hapin, nxori pak majën e këpucës dhe pengoi Xhezo Beqarin, që as i shkonte ndër mend të ruhej nga një rre-

zik i tillë. Ai u dha përpara, po vetë Latoja e mbajti, duke i folur te veshi.

— Ti sikur do nisesh që sot për andej, — i tha me zë të ulët, duke i qeshur fare afër, me ata sytë e tij tërë shprehje, — por unë të them prit njëherë. Prit njëherë të të kthejë xhevap Reizi nga plaka jote.

— Po rri, mor bela, rri. S'm'u ndave as këtu?

— Këtu, në rrugën e varrezave, dalin më mirë analizat. Pa të provojmë edhe Shaqon njëherë, — dhe bëri për më tej.

Shaqoja i kishte lënë të tetëdhjetat, po nuk e kishin dëgjuar të kollej një hërë. Tërë jetën kishtë bredhur si çoban me mushkat e minierës dhe durimin e forcën e mushkës kishte. Këmba e Latos dredhoi midis të tijave dhe një pëshpërimë e lehtë e qeshure përshkoi njerëzit përqark pleqve kur panë që, po të mos ishte mbajtur te Shaqoja, Lato Brahoja do të ishte rrëzuar për vete.

— Të kanë lënë edhe sytë, o Lato?! — tha Shaqoja pa e ditur qëllimin e mbrapshtë të tjerrit.

Këta pleq, që luanin kaq pa të keq, në këtë funeral dukeshin nga pak si fëmijë të pafajshëm. Vetë pjesëmarrja e tyre në përcjelljen e të vdekurit, (e tyre dhe e dhjetëra të tjerëve që u buzëqeshnin dhe i falnin duke i parë tek pengonin miqësish njéri-tjetrin), jo vetëm shprehte qartë respektin për të, po për më tepër me këtë shaka

të vogël që provokonin me njëri-tjetrin sikur i jepnin kuptim, e shpjegonin këtë pjesëmarrje. Të gjithë këta njërez vinin pas arkivolit jo thjesht për të përcjellë kufomën e të vdekurit, këtë mund ta bënin fare mirë qoftë edhe dy-tre nga shokët e tij të punës. Po tërë ky grumbull njerëzish vinte aty për të respektuar, në fund të fundit, jetën, atë jetë së cilës Reizi i kishte mbetur dashur pa dashur ca borxhe. Duke ikur ngajeta, e këtij qyteti, ashtu siç erdhi, i vetëm, ai u jepte, pa e kuptuar, të drejtën këtyre pleqve që pikërisht në ditën e vdekjes së tij t'i lihej vend edhe jetës, gëzimit, së gjallës, që tani merrte formën e shakave.

Në të vërtetë funerali po çonte te vdekja vdekjen, jo jetën. Edhe këta pleq, më afër se kushdo tjetër me të, ja tek po luanin! Përmendja dendur apo nënkuptimi i vdekjes, në bisedat e tyre, i ngjante armatosjes për t'u siguruar nga rreziku i luftës.

— Më duket se do na mbledhësh vetë, së shpejti, o Lato!

— Po të duhet një i vetëm, po rri unë, që sot, o Shaqo, por... po të duhet edhe ndonjë tjetër... ë? Si do t'ia bëjmë?! A ikim bashkë??!

— Vij, or, vij! Po s'bëhen dot katershë këta që mbeten për domino!

Zbritën arkivolin nga makina. Për njëzet a tri-dhjetë metra e mbartin mbi supe njerëzit. Vijnë vënë duart edhe Latoja e pleqtë e tjerë. Aty dhe

pak më vonë, pasi nga qendra e punës u lexua lamtumira dhe u ul arkivoli në gropën e hapur nga punëtorët e komunales, pleqtë sikur pëshpëritnin diçka. Si nëpër dhëmbë e si nëpër dhëmbje, njëkohësisht: «Ne ta bëmë hallall gjithçka, Reiz. Na e bëj edhe ti neve», sikur kërkojnë ndjesë për shakatë e Lato Brahos.

Poshtë, në qytet, duke u ndarë nga njëri-tjetri, Latoja i ndal përsëri pleqtë dhe me po ata sy djallushë u thotë:

— Ore! Si e lamë ne atë punën? Kush e ka radhën nga ne...?!

— Ik, mor djall me brirë, ik!

— Nesër më dhjetë e gjysmë të vazhdojmë lojën që lamë në mes, dëgjuat? Te pasticeria, nesër në dhjetë e gjysmë!

— Me duhet se do t'ua shqipëzi —

— Po si shqiptar i është i veshur —
... e shpërdorë por... që do t'ua shqiptar... —

— A! Këtë përpjekje! —
All tu nivill po s'përfull dot këtij lloji kështu —

— Tu më doli po qëndroni —
S'përfull s'përfull vepër më pak. HSH n'dëshet vepër më pak. Vëlfje
shqiptare s'përfull vepër më pak. Vëlfje
shqiptare s'përfull vepër më pak. Vëlfje

poj e qëndrueshëm i cili është një vëllazëri i cili është
që është një vëllazëri i cili është një vëllazëri i cili është një
vëllazëri i cili është një vëllazëri i cili është një vëllazëri i cili

poj e qëndrueshëm i cili është një vëllazëri i cili është një vëllazëri
i cili është një vëllazëri i cili është një vëllazëri i cili është një vëllazëri i cili
është një vëllazëri i cili është një vëllazëri i cili është një vëllazëri i cili
është një vëllazëri i cili është një vëllazëri i cili është një vëllazëri i cili

poj e qëndrueshëm i cili është një vëllazëri i cili është një vëllazëri
i cili është një vëllazëri i cili është një vëllazëri i cili është një vëllazëri i cili
është një vëllazëri i cili është një vëllazëri i cili është një vëllazëri i cili
është një vëllazëri i cili është një vëllazëri i cili është një vëllazëri i cili

Thonjtë e maceve që më përkatë heleshin

Ndonjëherë e shkuara të turbullon, kur ta
kujton dikush tjeter. Të duket se ka qenë edhe
s'ka qenë siç thotë ai, po nuk mund të shtosh
hollësi të tjera për të pranuar ose kundërshtuar
variantin tjeter. Duket sikur ai zbulon, në të
shkuarën tënde, diçka që, edhe kur s'të trondit,
arrin, sidoqoftë, ta ndezë nga pak zjarrin e vo-

I

Ndonjëherë e shkuara të turbullon, kur ta
kujton dikush tjeter. Të duket se ka qenë edhe
s'ka qenë siç thotë ai, po nuk mund të shtosh
hollësi të tjera për të pranuar ose kundërshtuar
variantin tjeter. Duket sikur ai zbulon, në të
shkuarën tënde, diçka që, edhe kur s'të trondit,
arrin, sidoqoftë, ta ndezë nga pak zjarrin e vo-

gël të mohimit të atyre orëve e ditëve të jetës, që çdokush i ka dhe kërkon t'i zhdukë përgjithnjë.

Po jo rrallë njeriu sikur mezi e pret nxjerrjen nga letargjia të pjesëve të tilla të së shkuarës. Atëherë ai jo vetëm turbullon veten e të tjerët, po ngjall në ndjenjën e arsyen e qetësuar ca zemërim e ca vrazhdësi, ca urrejtje e ca dëshirë të marrë pér t'i çuar gjërat në vendin e vet.

Mentori nuk dalloi dot asnjë lloj mërie apo rezerve në sjelljen e Minervës. Ajo i foli kur ai po kalonte pa e vënë re fare, i qëndroi përballë, madje i zgjati dhe dorën, ndonëse pak nga larg. Kjo shprehte më tepër druatjje nëse ai do t'ë vepron te siç po bënte ajo, sësa jehonën e asaj së shkuare, në marrëdhëniet e tyre. Në të vërtetë askush nuk mund të thoshte se kishte një shkak, një arsyë të madhe apo të dukshme, që Mentor i ishte larguar prej Filove dhe vajzës së tyre, Minervës. Ai, herën e fundit, ishte ndarë prej tyre si çdo herë tjetër, i mirëpritur kurdo që të vinte, kishte thënë «mirupafshim», si gjithë herët e tjera. E vëtmja shenjë që mund të merrej më vonë si paralajmërim se nuk do t'ë vinte më, ishte se ai kishte thënë «nxitoj» dhe nuk kishte pritur ta shqéronte Minerva, deri te shkallët e pallatit apo pak metra më tej, dëri te stacioni urban. — Mirë... Nga shtëpia mirë? — pyeti Men-

tori, pa e shkuar ndër mend se mund t'i interesonte vërtet shëndeti i tyre. Madje as nuk e dëgjoi përgjigjen e Minerva Filos, nëse pati të tillë.

Ajo nuk po pyeste. Aq më mirë. Të mira dëgjofshim, tha ai duke buzëqeshur për mirësjellje. Minerva nuk e vonoi dorën, s'bëri as më të voglën përpjekje për të shpjeguar ndonjë gjë, por, duke u kthyer të ecte, tha lehtë «mirupafshim, këtu do të jemi».

Ai e dëgjoi mirë këtë, po nuk diti si ta merrte.

Minerva Filo në këtë qytet province?!

II

Përpara njëzet vjetësh ka rënë borë e tillë, thoshin njerëzit. Si për t'i çuditur edhe më, ajo vazhdonte të binte e dendur, në të tërë horizontin, madje në emisionet e lajmeve njoftohej për përmasa të habitshme të frontit të ftohtë. E zbritur nga Veriu i Evropës, bora kishte arritur detet e ngrohtë, Adriatikun e më poshtë akoma, Spanjën e olivareve, Jugun e Italisë, madje vetë Algjeri ishte veshur, si banorët e tij, me të bardha. Më shumë se gjysmat e lajmeve në gazetat bënин fjalë për borën. Me borë e ke shkrimin? pyesnin redaktorët në telefon. Po e pate me borë, na e dërgo menjëherë. I kemi të bardha borë faqet e gazetës!

Vazhdonin ndihmat për Veriun, kurse në rrugët e kryeqytetit dhe sidomos në udhët e qytetit «Studenti» vazhdonte ndjekja me topa bore e vajzave të bukura.

Nga Rruga e Elbasanit Mentor i formoi numrin 8765.

Një grua, nëpunëse e njohur në TV, papritur e kishte ftuar në shtëpi. Dhe ai po i shkonte.

Ajo kishte kërkuar vetë ta takonte. Më le pa mend me ato pikurat, i kishte thënë kur ky kishte hyrë në zyrën e saj. Ah, si luan ti me të gjelbrën, si mjeshtër!

— Kam qenë bujk, në fshat jam rritur, prandaj, — kishte thënë ai. — Gjelbërimi përfshatarin...

— Mos thuaj ashtu, — kishte nxituar nëpunësja e Televizionit. — Ti ke talentin, ke shpirtin...

— Alo! Po 87-65 jemi. Cilin doni?

Pyeste një zë femre. Ç't'i thoshte asaj? Ajo mund të mos dinte gjë fare që rronte njeri me emrin e tij.

Nxitoi të thoshte emrin e nëpunëses së TV-së. Duke shqiptuar, pa kuptuar, «Shoqen... kërkova. Nuk qenka aty!?!» «Prisni pak», tha zëri nga ana tjeter. Ajo e la telefonin hapur.

— Ah, ti, Mentor, je?! Ç'ne me «shoqja»... ti?!

Ato dukej se po qeshnin së bashku. Pastaj, gjithnjë duke u ndier ngushtë, Mentor i tha

se për atje ishte nisur. Por, sipas porosisë së saj, ja tek po lajméronte më parë.

— Eja, eja sa më parë! Këtu kam edhe vajzën, dëgjon, Mentor? Me vajzën time fole pak më parë. Hajde, të presim të dyja! Mirë ardhsh!

— Mirë ju gjetsha, — pëshpëriti ai kur telefonin nga ana tjetër ishte mbyllur. Përse më presin me kaq ngrohtësi? mendoi. Të jenë aq të veçanta pikturat e mia?

Doli nga posta qendrore pak i turbulluar, madje mendoi se duhej të ulej diku.

Te Banka e Shtetit po xhironin një film. Vazhdonte ende rënia e borës dhe aktorët po luanin me ombrella, me pallto të mëdha, njëlloj si qytetarët që ishin ndodhur aty e vështronin xhirimin.

Po pse ma përmendi edhe vajzën? T'i ketë pëlqyer edhe ajo vizatimet e mia?

Urbani ndalonte fare pranë pallatit të tyre, të cilin Mentor e kishte kërkuar një mbrëmje tjetër për të mos u ngatërruar e vonuar pasi të telefononte.

Shtypi butonin e ziles dhe priti. U vonua përgjigjja dhe ai nuk kishte ndër mend ta shtypte përsëri. Do të iki, tha me vete. Kushe di kush u ka shkuar. I shoqi i nëpunëses së TV-së ishte mjaft i njobur. Te ne vijmë shumë vizitorë, i kishte thënë ajo ditën që e kishte ftuar në shtëpi. Prandaj, përpara se të vish, na telefono... Mirë?!

Dera u hap kur ai vendosi të zbriste për të ikur. Një vajzë e gjatë, me flokë të shtrirë, të butë, si vështrimi i saj, veshur me pantallona bluxhins të ngushta, e ftoi brenda.

— Shoku Mentor?! — tha ajo duke e vazhduar humorin e bisedës telefonike.

— Po. Ju, vajza e shoqes...

— Po! Minerva! — tha ajo. — Kemi qeshur kaq shumë pak më parë me mamin! Ne nuk i përdorim në shtëpi ato fjalët: shok, shoqe, a ç'janë ca të tjera...

Ajo queshte vazhdimisht. Me një lehtësi të dukshme dinte të kthente në humor edhe bisedën më të vështirë, dinte ta lehtësonte dhe madje ta treste fare mjegullën e druajtjes, që ia mpinte Mentorit fjalën dhe e bënte të lëvizte si i ngrirë.

— Të kemi pritur... kaq ditë. Që kur tha mami se do të na vizitojë një piktor i ri, i talentuar dhe... i këndshëm, kështu u shpreh ajo për ju, dhe; me sa duket...

Qeshi prapë. I kishte dhëmbët të rregullt, të lëmuar e krejt të bardhë.

Minerva foli gjatë, pa pushim dhe Mentorit po i pëlqente që ajo të fliste. Ndërsa e dëgjonte, shihte të gjitha imtësitë e dhomës dhe iu duk se në plot hamendje të tij ishte gabuar. Se përse i kishte përfytyruar ndryshe shtëpitë e këtyre njerëzve, të cilëve ua dinte emrat: qysh në vogeli.

Minerva heshti dikur. Ù hap i dera ëdhe hyri nëpunësja e TV-së.

— Po bisedoni? Sa mirë! Sa mirë më vjen!

— Duke mos mundur të them ndonjë gjë të re, unë po rri më mirë i heshtur. Kështu shhang edhe ndonjë budallallëk që mund të them, — tha Mentor.

— Shiko sa bukur e tha! Sa e mençurështë kjo fjalë ë, Minevra? Sonte mua po më duket edhe më simpatik!

Nëpunësja e TV-së po e kundronte sikur pas pak do të fillonte xhirimin.

— Për mua po thoni kështu?! — tha Mentor pa e menduar se kënaqësia e tyre do të rrjetë edhe më prej këtyre fjalëve.

— Shiko sa i mirë po më duket! — tha prapë nëpunësja e TV-së dhe i la vetëm.

Minerva mbylli derën dhe u ul në kolltukun fare pranë. I zgjati një cigare, po Mentorit iu duk e pavolitshme ta pinte.

— Nuk e pi, — tha.
— Po ti nuk fshehe gishtat më parë! — qeshi ajo, duke i afruar edhe shkrepësen e ndezur.

Ndezi edhe përvete cigare, pastaj nxori dy gota, hodhi verë në to, tha prapë «mirë se erdhe dhe gëzuar, shoku Mentor!»

Kishte një të folur me të cilën Mentor nuk do të mërzitej edhe sikur ajo të vazhdonte gjithë atë natë. Duke e tjerrur fjalën me një shkujdesje të habitshme, e linte profilin e vet të vë-

zhgohej nga i ftuari për disa minuta dhe pëpritmas kthehej me po atë qetësi dhe qeshte lehtë.

— Nëna ime do të vihej në merak, — tha Mentor i duke qeshur. — Më iku djali nga duart, do të thoshte, po të më shih te duke pirë i vetëm me një vajzë në kryeqytet.

— Eh, provinca! Kështu është ajo. — Minerva i mbushi gotat prapë.

— Nëna ime ka punuar në bujqësi. Ka larë presh në ngricat e dimrit.

— Ron më nëna? — e pyeti ajo si përpara një së papriture që s'duhej të vazhdonte më.

— Është në pension prej tetë vjetësh, — qeshi Mentor.

— E shkreta ajo! — tha Minerva duke i afuar paketën e cigareve.

— Jo. Do të dal. U bë vonë, — bëri të çohet ai.

Si të duash.

Ajo kishte hapur derën, por Mentor nuk po luante.

— A do të ndahem me «shoqen» mama?! — tha ai.

— Kushedi ç'bën në dhomën e saj. As unë nuk hyj pa trokitur atje. Herë tjetër je i ftuar vetëm nga unë. Mirë?

Ata sy Mentorit nuk iu ndanë jo vetëm në rrugë, por as në dhomën e tij, te qyteti «Studenti».

Ditën tjetër ajo u duk më e shtruar. Ai nuk

u befasua më që në korridor s'doli njeri tjetër për ta pritur.

— Të kam gjetur dy kalendarë vjetorë murri të dy shteteve të ndryshme, — tha ajo. Nuk kanë fotografi me grurë, si kalendarët tanë. Në njérën anë kanë piktura të klasikëve evropianë, në tjetrën të modernistëve bashkëkohës.

Mentori u përhumb në ta, po megjithatë ia zuri veshi një si gërvishtje thonjsh te dera. Minerva u çua, e hapi pak dhe e mbylli prapë. Ai ndjeu prekjen e diçkaje te këmbët dhe i tërhoqi shpejt ato.

Minerva qeshi kur ai ngritti kokën.

— Ah! Nuk të kishim prezantuar me të gjithë pjesëtarët e shtëpisë! — tha ajo, — Këto janë fituesit e festivalit të bukurisë për vitin e shkuar!

— Televizori i godinës sonë kap vetëm Tiranën! — bëri shaka Mentorin duke përkëdhelur njérën nga macet, e cila menjëherë i kërceu në prehër.

— I dashke macet. Ah, sa mirë!

— Po, — tha ai, — gjyshi im, përparsi se të ulej të hante vetë, ngrihej dhe u hidhte ushqim gjësë së gjallë, kafshëve, qenve, maceve.

— Kur do vijë në Tiranë gjyshi yt? — pyeti ajo.

— Ai ka vdekur, s'vjen dot, — tha Mentorin duke i ardhur për të qeshur.

— Kaq shpejt?! — shprehu keqardhjen ajo.

— Njëqind e dhjetë vjeç rrojti.

Qeshën të dy fort, pastaj Minerva tha se macet i kujtonin gjithnjë një tregim të Hemin-guejt, «Plaku te Ura». Mentor i nuk e pa të udhës të thoshte atë që mendonte.

Minerva kërkoi të dinte cilën prej maceve pëlqente më tepër, dhe ai kot fare, preku mace-n e bardhë, me qime të shkëlqyeshme e pilla të kafenjta.

— Ah, sa mirë, moj mami! — përsëriti Minerva kur ajo u duk te dera. — Sa mirë që edhe Mentor i do macet!

Eëma shfaqi një buzëqeshje që kishte në vete qetësi, kënaqësi dhe mirën-johje.

— Po gëzoni?! Si lum ju! — tha ajo dhe e tërroqi derën pas vetes me nxitim. I shoqi po fliste me dikë në telefon.

— Nuk do vijnë të rrinë? — pyeti përti ta Mentor.

— E përse duhet të rrinë me ne? — u përgjigj me pyetje ajo.

Njëra nga macet nuk po i afrohej. Mentor i kujtoi ç'i kishte punuar një maceje në lagje. Ajo kishte filluar të jetonte me vezët e lagjes dhe zogjtë e vegjël. Pinte edhe qumësht. Mentor i e zuri me lak dhe e vari në një gorricë. Derisa i dolën të shtatë shpirtrat, donte t'i thoshte Minervës, por e mbajti veten.

— Gjithnjë i kam dashur macet, — tha me zë.

— Kemi pasur edhe një tjetër, por na vdiq vjet. Shkuam të dyja motrat dhe mami e va-

rrosëm. Babi nuk vinte dot. Se... ç't'i bëjë detyrës që ka...

Mentori pati dëshirë të qeshte, po nuk po gjente asnjë shkak për ta bërë këtë.

— Po dal tani, — tha ai, — kam merak mos më digjet edhe lata e mensës.

Pas kësaj, ai i siguroi vetes të drejtën për të qeshur aty dhe gjithë rrugës.

Ajri kishte filluar të lagështohej nga nata, por atij iu duk i thatë, mbytës. Një i dehur ankohej për vonesën e urbanit të linjës për sanatorium. Mentor i dalloj se i dehuri ishte Xani, njeri pa njeri.

— E, s'doli gjë as për ty sonte? — pyeti ai Mentorin, i cili ndonjëherë i jepte nga një cigare.

Ah, ta dish ti, tha pa zë Mentor, ta dish!

Do të dal edhe unë sonte, i kishte thënë një natë Minerva. Do të më çosh deri te një shoqe?

Natyrisht që do ta shoqëronte. Ajo nuk i tha askujt në shtëpi ku do të shkonte. Në shkallë kishte prekur lehtë krahun e Mentorit, kurse në rrugë i qëndroi në krah të dëjathtë.

Mentori u përpoq t'i shmangonte ato prekjet e lehta të krahevë.

Më tutje, kur hynë në mes të një grumbulli pallatesh dhe ndriçimi ishte i dobët, ajo i tha se kishte frikë natën, pastaj, sikur të kishin

lidhje me njëra-tjetrën, i tha diçka për dashurinë.

— Ajo është privilegji rrugëve pak të ndriçuara, — tha ajo.

— Ashtu është, — tha Mentor.

Kishte dorë të ngrohtë dhe ai nuk mund të mos i besonte asaj ngrohtësie.

Ishin aq pranë, aq afër, sa u çudit të nesërmen kur askush nga shokët e kursit nuk i tha se e kishin parë edhe duke u puthur me një tiranase.

Tek po ngjitnin shkallët e katit të tretë, ndoshta pikërisht pse edhe aty ishte errët, Minerva ia kapi përsëri dorën, madje ai i ndjeu flokët e saj pranë faqes.

— Eja brenda! Lata të është djegur me sigruri. Rregullojmë këtu diçka për të ngrënë. Ti je i shtëpisë tani, — i pëshpëriti ajo.

Ai i zgjati dorën dhe pas pak po zbriste shkallët duke folur me vete: «Pu-pu-pu! Ç'janë këta, ç'janë! Pu-pu!» Nëna e kishte ftuar për të bijën, e linin vetëm në dhomë me atë dhe... «tani ti je i shtëpisë!» Shkoi ndër mend kronikën në TV, shkrimet në gazetat për pikaturat e tij dhe ndjeu gjymtyrët të këputura. Ç'janë këta, ç'janë! tha prapë për ta. «Po ti, ç'je për ta?» pyeti veten duke u ndier fare bosh. Asnjë përgjigje nuk mundi të jepte. Nuk do të shkoj më atje, vendosi, por pas dy ditësh u gjend para derës së tyre. Shtypi butonin e ziles dhe dera u hap. Përballe iu ndodhi ai,

babai i Minervës. Mentor i njihte qysh i vogël. I kishte dëgjuar edhe zérin duke folur në radio, në një përvjetor brigade. Ai nuk iu përgjigj as përshëndetjes. Madje i hodhi një vështrim dyshues.

— A të kanë thënë se më parë duhet të telefonosh, — e pyeti. Menjëherë e futi në dhomën e Minervës. Mentor i kishte vënë re mirë përpjekjen e të zotit të shtëpisë për të mbyllur në kohë derën e dhomës ku rrinte ai.

— Nuk na ka ardhur njeri deri tani pa lajmëruar njëherë në telefon, — tha ajo nervoze.

— Po unë jam i shtëpisë, — tha ai.

— Ti je i keq, — u skërmít ajo, pa mundur të qeshte.

— Macet i kam dashur gjithnjë, — tha ai duke kujtuar prapë macen e varur.

— Eja ulu më pranë! — e ftoi ajo si e sapoda-shruar. Ai nuk lëvizi. — Dera. —

— Nuk hyn njeri në dhomën time, — tha ajo. — Çdo njeri te ne ka dhomën e vet. Vëtëm macet hyjnë në të gjitha.

Minerva e puthi dy herë radhazi. Mentorit iu dukën si të plakave. Madje e mori njëlloj frike prej tyre. Sikur ta kishte kafshuar.

Megjithatë e puthi edhe ai, që të mos vonohej më aty.

— Rri sonte këtu! Ka vend, — i propozoi ajo si fajtore.

— Jo. Nuk mund. Sonte jo, — tha ai.

— Kur do vish prapë?

— Mirupafshim! Nxitoj.

Mentori ishte larguar me të shpejtë. Nuk i la kohë Minervës ta përcillte deri poshtë, te shkallët e errëta apo deri te stacioni urban. Albumin ua kishte sjellë, s'u kishte borxh tjetër. Allah, allah! Mirë që ika! Po sikur?...

Po ç'i shtyn të më vardisen mua? pyeste veten. Nuk ka Tirana një tjetër? Mos edhe talentin tim ata e frynë vetëm që të justifikonin veprimin e vet? Dhe të përligjin, njëfarësoj... Çfarë kërkonin t'i fshihnin? «Më parë se të vish, doemos të na lajmërosh në telefon, mirë?»

Në mbrëmje, në dhomë, përsëriti dy-tri herë se dashuria ishte gënjeshta më e madhe.

— Po ti pak ditë më parë e quajte kohën e dashurisë ditët e vetme kur njeriu jeton, — e ngacmoi njëri prej studentëve.

— Pikërisht prandaj është edhe gënjeshta më e madhe, — nguli këmbë Mentorin, që nuk përqëndrohej dot në bisedat e të tjerëve.

Gjumi e zuri shumë vonë, kur në udhën që shkonte për nga Varrezat e Dëshmorëve nuk lëviznin më makina. Menjëherë e pushtuan ëndrrat. Sikur e puthnin papushim 32 dhëmbë e dhëmballë të bardha borë. Vetëm buzët dukeshin prej njeriu. Mentorin bënte të largohej, por nuk mundte; nga prapa e kërcënonin dhëmbë të tjerë, jo njerëzish këta, por macesh. Pse ke thënë se na ke dashur, pse? Sikur skërmiteshin ato. Dhe thonjtë...

Pas dy ditësh kishin prova. Përgatiteshin për festivalin e pranverës.

Nëpunësja e TV-së hyri duke u përshëndetur prej të gjithëve. Anoi pak kokën dhe priti duke buzëqeshur që Mentor i të shprehte kënaqësinë e tij për interesimin e saj.

— Po shkoni për vizita te Filot? — i kishte thënë kameramani me flokë të kuq e të shkurter.

— Po, pse?! — kishte thënë pa e kontrolluar veten Mentorit.

— Sepse atje, ata që kanë shkuar, ose kanë fituar, ose kanë humbur, — kishte thënë kuqoja me një shkëlqim lemeritës të syve, duke qeshur si vjedhës. Pak më vonë Mentorit e dëgjoi të fliste për nëpunësen me superlativa në një grup njerëzish ku dikush, kushedi përsë, u parathoshte perspektiva kasandras. Rrënim.

Kur po dilnin, e thirrën te nëpunësi i shërbimit. Kishte një shënim për të. Dy gisht letër,

Të vish sonte! Doemos!

Nënshkruar Minerva, por ishte e qartë se shënimi, madje e gjitha, edhe shkrimi i letrës ishte i së emës së vendosur e praktike.

Unë nuk dua të fitoj, tha me vete Mentorit. Jam gati të kthehem në fshat, t'i humbas të gjitha. Vetëm kështu jo! E qeshura dhe fjalët e kuqos, kameramanit të TV-së, nuk i shqiteshin nga sytë.

Kurrë, tha prapë kur doli tek Rruga e Elbasanit.

in qarqetisq aq qas qet qet. Minerven
Mentori e pa përséri në mbrëmje Minervën.
Me nënënqet vet në krah, duke rënduar edhe
më mbi supet e sajstë rëna. Skishin vëç dy
ditë që kishin lardhur aty. Familjarisht. «Me
qarkullim të plotë!» i kishin thënë Mentorit.
«Babanë ia kanë arrestuar.»

«Ah! Më në fund... më në fund!» pati thë-
në ai duke ndier të merrte frymë thellë. Sa
mirë që ndihet njeriu; i kishte thënë atij që
i dha skëtë lajm, kur sheh se ndryshojnë ca
gjëra që me kohë nuk shkonin më. Se njeriu
mund të dojë vetëm ato gjëra që duhen, apo
jo?

Ndiente dëshirë përtë mësuar hollësi për
ata, «të qarkulluarit». Të dinte, për shembull,
ç'kishin bërë me macet!

Me qarqetisq aq qas qet qet. Minerven
Mentori e pa përséri në mbrëmje Minervën.
Me nënënqet vet në krah, duke rënduar edhe
më mbi supet e sajstë rëna. Skishin vëç dy
ditë që kishin lardhur aty. Familjarisht. «Me
qarkullim të plotë!» i kishin thënë Mentorit.
«Babanë ia kanë arrestuar.»

«Ah! Më në fund... më në fund!» pati thë-
në ai duke ndier të merrte frymë thellë. Sa
mirë që ndihet njeriu; i kishte thënë atij që
i dha skëtë lajm, kur sheh se ndryshojnë ca
gjëra që me kohë nuk shkonin më. Se njeriu
mund të dojë vetëm ato gjëra që duhen, apo
jo?

Ndiente dëshirë përtë mësuar hollësi për
ata, «të qarkulluarit». Të dinte, për shembull,
ç'kishin bërë me macet!

Përpjekje për të rregulluar humorin

E rendësishme është që unë shpëtova prej saj.

Shpëtova?! Po unë ende dridhem kur e shkojnë ndër mend. Se nuk ka vëçse tri ditë që një rrezit po më shohin si të shëruar nga ajo dobësi, apo qëndro metë, apo sëmundje, a q'djall qe. Dridhem, se ku ta di që nuk do të më kthehet përsëri dhe unë do t'i zhgënjej përsëri dashamirët e mi. Më thonë se shpëtovët prej asaj

gjendjeje, por, ashtu siç më la, ajo mund të më kthehet përsëri, se askush nuk m'i tregoi e as m'i tregon dot shkaqet e shfaqjes së saj.

Vijnë këto ditë ca njerëz tek unë, në shtëpi, sikur të kem dalë nga spitali. Nuk sjellin komposto apo ndonjë vazo reçel, ja, vetëm kjo e largon dyshimin e spitalit tim. Vijnë thjesht për vizitë, këmbejnë vështrime të heshtura me gruan dhe, me sa kuptoj unë, janë të kënaqur me gjendjen time. Ashtu më duket edhe mua, sikur thotë gruaja, me fytyrën tejet të kënaqur, duke qerasur të ardhurjt.

Ajo kalon për pak nga kuzhina dhe ndonjëri prej tyre gjen rast të më pyesë, në intimitet, si me kureshtje, si me keqardhje, apo nga meraku së mos ka edhe më vonë ndonjë përsëritje, se si ndihesha më parë, në ditët e asaj dobësisë a sëmundjes, a ç'djall ishte, se çfarë ndieja, si ndodhë që nuk arrija të kontrolloja dot veten...

Por unë nuk di se çfarë t'u them. Më saktë se çfarë kërkojnë t'u them. Fare lehtë mund t'u sajoi një lloj përgjigjëje, që, sadopak, do t'i qetësonte, po nuk dua të bëj ato që nuk i mendoj vetë. Nesër-pasnesër mund t'i kapllojë ata vetë marrëzia, ime e dikurshme, dhe do të mendojnë se pikërisht unë i moranë qafë. Më mirë po hesht: Po u flas vetëm përgjëra fare të qeta, po u them, për shembull, se fëmijët i kanë shumë mirë me shëndet, dhe për këtë gjë ata pa dyshim që do të binden, se ja tek i kanë fëmijët, i shohin me sytë e

tyre. Ose do t'u them, pér shembull, se me gruan shkojmë fare mirë, tē lumtur e nē mirëqenie dhe ata do ta besojnë me këtë rast edhe një provë tjetër tē shërimit tim tē plotë. Ose, nē fund tē fundit, kam pér tē heshtur. Le ta marrin si tē duan heshtjen time, domethënë le tē jetojnë si tē duan, domethënë akoma, le ta pësojnë ose ta gëzojnë si tē duan. Se secili prej tyre ka nga dy sy, nga dy veshë e nga një grusht tru dhe, po nuk i përdori pér këto gjëra, pér çfarë t'i dojë tjetër? Në fund tē fundit, tē bësh jetën tënde, do tē thotë tē fitosh ose tē humbasësh pér meritat apo dobësitë e tua.

Ata largohen dhe, pasi i përcjellim, gruaja më vjen pranë e më përkëdhelet. Unë ende e dua aq, sa tē më pëlqejnë përkëdheljet e saj dhe nuk ia prish kënaqësinë e rastit.

— Ah, sa mirë që jemi tani, — pëshpërit ajo e kënaqur.

— Ne asnjëherë nuk kemi qenë keq, — shtoj unë.

— Ashtu është, po ti se ç'kishe ca kohë, po shyqyr që ikën...

Heshtim pér pak tē dy. Unë pér tē mos e trishtuar atë, ajo pér tē mos më shqetësuar mua.

Ajo mendon se unë nuk di asgjë pér «sëmundjen» që kam pasur, po kërkon tē më thotë diçka pér tē, sikur do tē krijojë tek unë

një lloj paraprite mbrojtëse. Unë shtoj një përkëdhelje nga ana ime dhe pas kësaj ajo e ndien dritën jeshile të ndezur.

— Ti seç kishe një mani të çuditshme, — më thotë ajo. — Si një keqdashje, si një dyshim të pérhershëm, të të gjithë. Mezi rrripe pa i thënë ca gjëra që, allah, allah, ku i gjejel Ato që nuk duheshin thënë, ato veje e thoshe! Dhe të gjitha gjeje rast t'i thoshe atje ku nuk duheshin thënë! Si për të na prishur punë të gjithëve!

Ajor thoshtë të vërtetën, po nuk kishte të drejtë.

Unë ato kohë (domethënë para tri ditësh e më parë) e kam pasur atë dobësi: Harroja me cilin flisja. Vetëm kaq. Harroja se përpara meje ishte shefi i mësimi, se përqark ishin shokët e mësimi të njohurit, harroja pra me cilin flisja dhe i thosha të gjitha ato që mendoja.

Më kujtohet mirë, për shembull, kur bëhem shish pesë-gjashtë shokë dhe hynim në turizëm për të gjerbër nga një kafe. Ishim shokë, domethënë të një moshe afërsisht, po ato shaka e atë humor duhej të bënim, po ato shqetësime kishim dhe, meqë ishim shokë, edhe pagat aty-saty i kishim! «Kush do të paguajë?» pyesja unë sëpshë ulëshim në tryezer. Jo vetëm për të bëre shaka, kuptohet, por as që edhe dikush prej nesh të rrudhete buzët. Pothuaj të barabartë, askush nga ne nuk kishte të paguante qoftë edhe dy herë radhazi kafet e pesë-gjashtëve në tu-

rizëm. E përse të mos paguanim si të barabartë? Përse dikush të harronte pa paguar gati gjithnjë? Këto gjëra mbase i mendonin edhe të tjerët (për këtë isha i sigurt), po vetëm mua nuk më durohej dhe ato që mendoja i bëja të zëshme, domethënë të mërzitshme për ndokënd.

Por aq më bënte. Ç'shoqëri do të ishte ajo e tij, kur nuk respektonte dot çdonjérin prej nesh as në orët e lira? Fakti që edhe të tjerë mendonin po kështu, më qetësonte, po pikërisht kjo gjë edhe më torturonte. Më bënte nervoz dhe e vinte në dyshim e në një provë të vështirë kënaqësinë time për të ndenjurën me ta. Të paktën të mos varnin turiçkat kur unë thosha po ato gjëra që nuk guxonë t'i thoshte asnjeri prej tyre.

Rrinim gjatë atje, te lulishtja, përballë turizmit. Unë vija re ndonjë grup, sidomos një grup, dhe i thosha RADMIRIT:

— Radi, shiko ata që hyjnë. I shikon?

— E çfarë pastaj?

Midis atyre ishte edhe babai i tij. Kjo është arsyaja që RADMIRI më përgjigjet ca si ftohtë. Por mua kjo nuk më bezdis aspak. Mjaft që ai kishte sy e veshë.

— E di se cili prej atij grupi do të hyjë i fundit në turizëm?

— E nga ta di?

— Ajo që ndodh gjithnjë s'ka si të mos dihet.

— E cila ndodh gjithnjë?

— Që Nuredini bën qështë e mundur derisa i fut të gjithë para vetes në çdo derë që hyn, pastaj hyn edhe vetë. Dhe gjithnjë, kur del, po ai i fundit. Për të, të gjithë janë shefa.

Radmiri s'bën zë. Pra nuk bashkohet me humorin tim. Po mua sepse më pëlqen angazhimi i tij, qoftë edhe duke shprehur bezdinë, prandaj shtoj edhe një hollësi tjetër: I them se pa dyshim i pari do të hyjë babai i tij.

Dhe ia arrij qëllimit. «U bëre i bezdissħem me këto huqet e tua.» Mérzinë e tij ua shpreh edhe të tjerëve dhe, sikur unë të kem shpifur e jo të kem thënë të vërtetën, edhe ata më hedhin ca vështrime sikur të kisha sëmundje ngjittëse. Dhe nënë të vërtetë ajo nuk po më shqitej. Pas pak rri e vështroj ngultazi rrobat e Radmit. Ne të tjerët jo se jemi veshur keq, por ai ka diçka që jo kushdo prej nesh mund ta sigurojë: Nëna e tij, gruaja e atij që hyn gjithnjë i pari në turizëm pra, ka kohë që gëzon të drejtë për t'i zgjedhur copat e bukura qysh në magazina, përpara se të furnizohen mapot.

— Ka ardhur ndonjë furnizim i ri? — e pyes Radin. Ne jemi shokë, pra mund t'i themi të gjitha me njëri-tjetrin, por ai më kthen shpinën e nis të më largohet. Pas pak zënë e largohen edhe të tjerët, pothuajse të gjithë, domethënë mbetem vetëm unë. Se unë nuk kam përsë t'i zemërohem vetes e të marr anën e Radit, sado që edhe unë e di emrin që gëzon babai i tij

në qytet. Më vjen mirë, për shembull, që ndokush prej atyre që më lënë kthehet përsëri aty ku mbetem unë dhe përpinqet të më shpjegohet.

— Ti sepse ngul këmbëqë tē shpjegohen tē gjitha, tē thuhen tē gjitha gjérat, — më thotë, me dashamirësi, merret qesh, po kjo mua më torturon edhe më.

Rrija dhe i dëgjoja kokulur, por kjo s'do tē thoshte se u jepja tē drejtë. Tē dëgjosh, s'do tē thotë tē premtosh.

Se edhe ata si unë mendojnë për shokun Thanas. Pothuaj me tē gjithë kam rastisur tē flas veças: Nëse ka ndonjë njeri që nuk meriton atë «shoku», ky duhet tē jetë Thanasi, ky është medimi i tē gjithëve dhe për këtë që them unë jam gati tē përgjigjem kudo: Tē vërtetën e vetëm tē vërtetën po them!

Por ja tek bëhemë më shumë se tre veta bashkë dhe... me çfarë t'i mbyll veshët? Pjesa më e madhe e atyre që flasin nisin e radhitin meritat dhe virtytet e shokut Thanas. Secili sikur përpinqet tē shtojë diçka në thesarin e tyre dhe kjo më lë mua pa mend, por jo pa gojë. Edhe unë e di se tē gjitha ato që thuhen aty i shkojnë veshit tē shokut Thanas, por, thjesht për variacionin, nuk them nga ato gjëra që do t'i sillnin atij kënaqësi. Them se shoferin e tij tē mëparshëm ai e ndërroi se i shkaktonte alergji së shoqes.

Them këtë dhe jam i qetë, domethënë e besoj se ende vuaj nga ajo sëmundje që, si duket, do ma brejë shpirtin. Pas kësaj të gjithë shokët janë të detyruar të më lënë shëndenë dhe s'di pse mendoj se prej kësaj dite do më përshëndetin vetëm me gjeste që së largu.

Kjo ndodhi përpara dy-tri ditësh. Në mbrëmje më vizitoi njëri nga këta shokë.

— Ty çdo gjë të duket e paplotë, e rrëgjuar, e gatshme për t'u kthyer në objekt humori, — më tha ai, i shqetësuar për qënien time shoqërore, të ngatërruar, sipas tij.

Unë po i buzëqeshja.

— Apo jo? — tha ai.

— Jo tërësish ashtu, — i thashë. (Nuk ia thashë të plotë as atë që mendoja, pa llogaritur këtu pamundësinë e fjalës për të përcjellë mendimin.)

— Unë s'të kam më borxh, — tha ai më në fund, kur po ngrihej për të ikur. U largua kokulur. Më kishte pllakosur një fatkeqësi prej së cilës nuk besonte se do të shpëtoja dot më. Unë nuk ia zgjata se, vec shok, e kisha edhe nga njerëzit e gruas; le të merrte hollësi të tjera nga ajo.

Kjo më ndihmoi jo pak për rregullimin e humorit dhe, kuptohet, në kurriz të humorit të gruas, sime. Ta shihnit, të shkretën, se si iu venit çehrja kur unë fillova t'i thosha se problemet familjare, midis të cilave hynte si-

gurisht edhe respekti i saj për personalitetin tim dhe harmoninë familjare, nuk kishte pse t'i bënte objekte diskutimesh në fisin e saj.

Trokitën te dera dhe kur ajo u kthyesh bëshkë me një grua, të cilën e njihja mirë, unë vazhdova ligjëratën time.

— Ti duhet të bindesh më në fund, i thashë asaj, se harmonia familjare nuk mund të arrihet duke e diskutuar në mbledhjet e organizatës së gruas në lagje.

Nuk e kisha parë gruan time më të përmbarbajtur se këtë herë; e përcollë shoqen e saj dhe atëherë m'u kthyesh mua:

— Po si s'durove të ikte njëherë Katerina, si?! Apo nuk e dije se ajo është qryetarja e gruas në lagje?

— Si nuk' e dija, e dija që ç'ke me të. Por edhe ajo duhet ta marrë vesh se nuk duhet të merret vetëm me mbledhjen e kuotave.

— Ti duhet të vizitohesh, mor burrë, — më tha me zë të shuar, krejt e pafuqishme.

— Po unë nuk ndiej asnjë dhimbje, — i thashë, pa mundur ta qetësoja ndryshe. E ftovë të dilnim shëtitje në mbrëmje, por ajo nuk pranoi. Si duket edhe ajo e kishte të padëshirueshme ta shihnin me mua.

— Do t'ua them fëmijëve çfarë mendon ti për mua, — i thashë i vendosur.

— Për hir të vjetëve që kemi shkuar bëshkë, mos e bëj këtë!

— Për hir të vjetëve që do të shkojmë bashkë, do ta bëj! — i thashë.

Me këto fjalë e detyrova të qeshte, dome-thënë se sëmundja ime nuk ishte ndonjë gjë serioze.

— Hajde të bëjmë një çikë muhabet, — iu luta.

— Ne jemi bërë si të huaj, — tha ajo, duke m'u ulur fare afër.

— Po pse, ty nuk të vjen fare inat që grua ja e shokut Thanas shkon e hyn magazinave dhe i zgjedh ajo, e jo ti copat më të mira? — i thashë i sigurt se nuk do t'i binte hilesë sime.

— Ta shihja me sy, pa ta shikonte ajo, po të mos ia përplasja fytyrës, në sy të të gjithë njerëzve! — tha ajo rreptë.

— Qenka ngjitëse kjo sëmundja ime, — i thashë kur ajo pushoi së shfryri kundër gruas së shokut Thanas.

Ata thonë vetëm të vërteta
Burgjekë, Në gjetje, nuk është përfshirë, tregt
Pensionistin qëndronin e llojshëm, që
nuk është që dëgj dy që i kishte qëndruar
qëllmesit e tij, që dëgj dy që i kishte qëndruar
në një gjykatë e përgjithshme
Ai nuk po e strati se ja bënë
një mësim i ri i një komunitetit që
nuk ka qëndruar

Ata thonë vetëm të vërteta

Katër ditë rresht që nuk kishin vrarë gjë.

Të pestën më morën edhe mua me vete.
Më i vjetri ishte një pensionist, Muhedin e quanin.
Ai bënte muhabet më shumë. Ai kishte
edhe qentë. Tjetri, i dyti, ishte mjeku. Këtij
nuk po i ecte me qentë. I humbnin përpara se
t'i blinte.

E përpjeta na kishte vënë në radhë. Pensionisti
në krye, se punë gjahu ishte. Ai mba-
nte gjallë edhe fjalën.

— Ka 200 çifte qyteti dhe pyjet janë pri-

shur, gjahu është larguar. Pa venë edhe barinjtë dhe i presin lisat vetëm për të kullotur dy metra vend. Ku të rrijë gjahu pastaj? E shikon atë gropën atje ti? Atje uleshin e rrinin përpara tre-katër vjetësh nga 2000-3000 guhakë. Një kokërr nuk e gjen tani.

Pensionisti qëndronte hera-herës dhe trembte një qen që na ishte vënë mbrapa sapo dolëm nga qyteti. Kishim tre qen me vete, pa llogaritur atë tjetrin, që ndiqte erën e bushtrës sonë. Ai na rrinte aq larg, sa të mos na humbte nga sytë, domethënë sa të mos i humbte nga syri bushtra.

— Ja ka qejfi edhe kësaj, pa vjen ai i botës! — tha Muhedini duke e tërhequr fort litarin e saj. Kur ndaleshim ne, ndalte edhe qeni që na ishte vënë pas. E goditëm të tërë me radhë, me gurë. Një herë u fsheha pas një gëmushe, të vinte më afër e ta goditja keq, por nuk bëri çap më tej, Domethënë na kishte numëruar.

Kur u larguam nga qyteti sa të mos dëgjohej gjë, Muhedini zuri një të përpjetë ku qeni do të shfaqej më afër dhe ngriti çiften. Do ta godiste me saçme. Jo për ta vrarë, sa për ta trembur, që të kthehej.

Qeni angulliu dhe u kthye.

— E godita... — tha Muhedini.

— E vrave, më duket, e vrave dhe ti e di që unë tregoj, — tha mjeku.

Unë e kisha herën e parë që shkoja për

gjah dhe nuk merrja vesh kur bënin shaka,
kur thoshin të vërtetën e kur talleshin me mua.

— Jo, nuk e vrava. E goditë sa për ta trembur. Se na lë qentë pa punë, prandaj. Kërkon të hiqet.

— E vrave dhe s'e ke herën e parë që vret qen, — ngulmoi mjeku.

— Unë nuk e godita dot fare, ti thua e vrave. Po ta kisha goditur, do kishte lënguar gjatë.

— Ja, të shohësh po nuk e gjetëm të ngordhur kur të kthehem!

Në të vërtetë qeni nuk na ra më në qafë. Bushtra hiqej sikur të mos kishte ndodhur asgjë.

— Ah, ti, ah, ti! — ia bëri Muhedini duke iu kërcënuar, por nuk e goditi.

— Po si nuk i gjete një armë këtij?! — tha Muhedini për mua. — Vihet për gjah pa armë?! Apo vetëm për t'u lodhur?! Të më kishe thënë mua, edhe mbrëmë vonë të më kishe thënë, do t'ia kisha gjetur një.

— E kush e lë armën bosh këto ditë, o Dine? Apo do të na largosh mendjen nga qeni i botës që vrave ti?

— Na, merre këtë timen ti, — më tha mua Muhedini, — merre e shkrehe një herë, godit atë shtyllën atje! Pa të të shohim njëherë si e ke synë!

Godita pikërisht atje ku tregoi ai, por ata as që e kishin mendjen tek unë.

— Bashkë ishim radhën e parë ne? Jo, jo, kam qenë me Ziken, më duket, dhe na iku një skile, kot fare, ah, edhe tani po më vjen keq për të. Dhelpra na hyri në një tunelth të vogël. Aty e pritëm një orë e ca. Zikja sat largua për të mbledhur ca dru të thata, do bënim zjarr dhe tymi do ta nxirrte hileqaren. Unë po pushkën ngrehur, në shenjë. Prita sa prita, hiç! Ta heq këtë çantën njéherë, se ma mori frymën, thashë, me vete. E ula vetëm për një çast pushkën, sa të hiqja çantën nga shpina... Por ky çast i mjaftoi skiles të ikte, nëpër duart e nëpër sytë e mi! Iku, fluturoi! 150 lekë e merrte grumbullimi atë qene. 150 lekë i bënte lëkura.

— Po mishi?... — pyeta unë, pa e ditur sesi.

— Mishin s'ia ha as qeni dhelprës.

— Nga dinakëritë që bën?

— Janë një familje, prandaj, — tha gjah-tari i vjetër.

— Siç është, për shembull, lepuri i egër me lepurin e butë, — ndërhyri në bisedë mje-ku, duke trazuar në sytë e tij një të qeshur, që Muhedinit ia ngriti kacabunjtë. Po kjo nuk e bëri mjekun të tërhiqte atë që vendosi të tregonte. Vetëm mos shto gjë, vetëm ... u lut paraprakisht Muhedini.

— Që ishte lepur i butë, do ta them, apo jo? — ia nisi tjetri.

— Po, i butë ishte, — pranoi pensionisti duke tundur kokën si të thoshte: «Ç't'i bësh,

kur e bëj veten unë, pse të mos tallesh ti...»

— Që ishte lepuri i tjetrit, edhe këtë do ta themi, apo jo?

— I tjetrit ishte, s'e bëj dot hasha, — pranoi përsëri Muhedini.

— Po do themi edhe që ti e vrave dhe ia solle sat shoqje për lepur të egër, do ta themi, apo s'do ta themi? — e çoi deri në fund mjeku.

— E po ç'të bëja tjeter, pa më thuaj ti, ë? Ja, kemi kaq ditë që nuk po vrasim gjë ne të dy, me ç'sy e faqe do të kthehem i në shtëpi?

E qeshura e tij ishte krejt shfajësuese.

— Gjahu tani nuk ka më lezet, — tha prapë Muhedini. — Ose duhet të ikësh nga shtëpia me ditë të tëra, të largohesh nga era e njériut që të biesh në të gjahut. O kështu, o hidhe çiften tutje!

Qentë po lehnin tutje nga e majta, te një rrëpirë që binte në përrua. Ata të dy ngriten veshët për të dëgjuar më mirë. Angullima e qenve u rrokullis përgjatë brigjeve të përroit, duke u bërë gjithnjë e më e largët.

— Le ta ndjekin, po të duan. Mbase e nxjerrin nga faqja jonë, — tha Muhedini. — Skemi gjunjë për t'i ndjekur prapa.

— Fol për vete, ç'ke me të tjerët, — iu përgjigj mjeku. — Se je plakur ti, nuk do të thotë që janë pleq edhe të tjerët.

— E po ndiqe qenin pastaj, mos e lër të njiret kot!

— Qeni le të lehë atje ku dua unë, jo ku do ai, — shtoi mjeku. Sikur ishte i pakënaqur me qentë e tjetrit. — Qeni i mirë e sjell gjahun në shteg.

Muhedini dëgjoi edhe pak angullimën dhe gulçin e qenve të vet, u ul në gjunjë dhe zuri veshët me duar. Që të mos i dëgjonte.

— Shihe tani kur të ngrihet. Do ta shes çiften, do thotë, — tha mjeku për Muhedinin.

Tjetri nuk po lëvizte më. Si një gjysh që nuk dëgjon të qarat e nipërve të ndëshkuar nga etërit e tyre, ashtu dukej.

— Do ta shes çiften. Do ta shes, sa herë kam thënë, po kësaj radhe do ta shes se s'bën, — foli më në fund.

Unë qesha. I vetëm, se mjeku nuk qeshi. Unë kisha pritur që të qeshnim së bashku. Muhedini po më vështron te i bezdisur, sikur të ishte penduar që më kishin marrë për gjuesti.

Nga përroi nuk po vinte asnje zë. Sikur kishte rënë një heshtje fill pas së qeshurës si me. Një çast më vonë m'u bë sikur kuitja e qenve ngrihej fare afër, po çastin tjetër ajo u largua edhe më tej seç ishte ndier më parë. Ata të dy thoshin se qentë tani ishin duke e ndjekur gjahun (dhelpër thoshin ata), kushe di pse, në faqen tjetër të përroit. Gjithnjë së pas tyre, as që duhej shpresuar që gjahu të kthehej më nga ana jonë, të paktën për ndonja pesë-gjashtë orë.

— Do ta nisim këtë djalin të na i ndjellë qentë andej, — i tha mjekut. Unë i dëgjova fare mirë fjalët e tij. Pashë edhe fytyrën e Muhedinit, që u ngërdhesh lehtazi, por as që më shkoi ndër mend se mjeku mund të fillonte përsëri lojën e Sokratit.

— Jo, jo, — ia bëri pensionisti. As që nxirrja dot ndonjë arsy që ai të më kursente mua për diçka që nuk kishte dashur ta bënte me baxhanakun tim, Sokratin, që për më tepër punonte në Komitet. E kishin futur, të gjorin Sokrat, shkurreve dhe ferrave të pafundme e të parruga, për të rrethuar gjahun gjoja. Ishte i detyruar të bërtiste, të trembte gjahun, të ecte barkazi e rrëshqanthi, i çjerrë e i gjakosur nga gjemba. Mezi kishte dalë që andej, i ziu baxhanak.

Nuk pranoi ta bënин me mua.

— E ka mendjen te qentë tani. S'i hyn në sy gjë tjetër, prandaj, pa ta shihje ti, — tha mjeku.

Muhedini i kishte hequr duart nga veshët, por edhe kuitja e qenve ishte qetësuar.

— Mbase e kanë futur gjahun në ndonjë strofkë dhe e mbajnë aty, — tha mjeku.

Ishte ulur në gjunjë dhe në atë çast vështroi orën.

— Erdhi koha e gjumit, ë?! — ngacmoi Muhedini.

Mjeku flinte çdo pasdite, në të njëjtën orë, pa asnje përjashtim, në të gjitha ditët. Edhe

kur dilte për gjah. Aty, në pritë, me armën në gjunjë, mbyllte sytë sa herë. Edhe duke pritur derrin kishte dremitur, vetëm për të mos e prishur rregullin!

— E po edhe do flemë kur të vijë sahati. Se nuk jemi plakur, që të na lërë gjumi që në dy të natës.

— Pa ngrihu ti, ngrihu, atë bëj! Lëri fjalët! Gjahtari duhet të hapë sytë e të mbyllë gojën, po do të jetë gjahtar. Ngrihu, të thashë, e qepju asaj brinjës atje! Më bëhet se nja pesë guhekë po na e bëjnë me sy që atje tej.

Mjeku u ngrit.

— Eja edhe ti,— më tha mua, — se do mërzitesh me Muhedinin. S'di të bëjë muhabet ky, se ndryshe nuk e dërgonte për gjah plaka e shtëpisë.

— I marrsh të keqen plakës sime ti! Ajo është më e re se ti.

E ndoqa pas mjekun. Por nuk dija mos e merrte për keq ikjen time Muhedini.

— Merre, merre, se nuk do ngresh dot gjahun kur të vish, — tha ai.

Guhekët ishin atje, te një pemë e vetme. Që nga larg dukeshin si zogj të vegjël, fluturakë ferrash. Do të binim në përrua, pastaj do të ngjiteshim rrëpirës, për të dalë te mezhdha, nga mund të goditeshin mirë.

— Unë po i ndjek me sy, — na foli Muhedini. — Po qe se lëvizin, do t'ju bëj zë e

të ktheheni. Pse të shkoni kot deri atje lart.

— Tani po, the fjalë me mend, — foli mjeku. — Por përpiku ta mbash. Se çoku harron ti.

Kur zbritëm në përrua, mjeku më tha të prisja aty. Ç'të lodhesha kot deri sipër. Aq më keq se mund të shkaktoja edhe ndonjë zhurmë që do t'u kujtonte zogjve fluturimin. Nuk i kundërshtova. Zura një fund rrapi dhe u ula.

Ai nisi të ngjitej avash-avash. Sikur të hynte në sallën e të shtruuarve. I qetë, i sigurt në veprimet e veta. Nuk kishte shëndet të tepërt, por as bëhej merak për këtë. Me oreksin gjithnjë ndihej mirë. Edhe fëmijët e tij i detyronte të hanin radhë. Dhe pothuaj nuk i përdorte fare ilaçet. Këtë të fundit e dinim vetëm ne, të afërmit e tij, kuptohet. Në sallën e vizitave ai thoshte ndryshe.

Rrëpira ku po ngjitej, nuk kishte drurë. Nga ndonjë shkarje i kishte humbur. Atje lart fillonin lisat. Ca lisa të shkurtër, po të gufusur nga degët e gjethet. Lisi ku duhej të rrinin ende, pesë-gjashtë guhekët, nuk dukej që nga unë.

Lisi me guhekët dukej vetëm që atje ku rrinte Muhedini. Meqë nuk po dëgjohej gjë prej andej, do të thoshte se zogjtë ishin atje. Prisnin doktorin. Mbase edhe ata kishin orar gjumi si ai. Ose mbase në këtë orë e dinin mjekun në gjumë dhe s'e prisnin kurrë aty,

me çifte, duke nxituar e duke shënjuar në drejtim të trupave të tyre.

Ai vazhdonte ngjitjen me këmbëngulje. S'ish-te ndonjë Xhomolungmë, po, aq sa ishte, duhej ngjitur brenda kohës që zogjtë ishin atje. Me Everestin ishte më thjeshtë, se ai nuk lëvizte. Kurse tani, sikur ta dija unë, mjeku priste nga çasti në çast të dëgjonte zërin apo fishkëlli-mën e Muhedinit, që do ta lajmëronte se gu-hekët i kishin lënë shëndenë.

Të dy duhej të vritnin diçka, me doemos. Kishin kaq ditë që ktheheshin duarbosh. Kur dilnin nga shtëpitë, i mbushnin çantat plot me bukë dhe ushqime, shkonin në mäl, i hanin ato të gjitha, i boshatisnin dhe ktheheshin të lehtësuar në shtëpi. Pas çdo dite, seç kishin një lloj bindjeje se e nesërmja u kishte rezervuar një shans më të mirë dhe... çdo gjë niste nga e para.

Edhe një guhak të vetëm po të vritnin, do të ma dhuronin mua, që vija për herë të parë për gjah, po ja që kjo po vonohej aq shumë!

Mjeku e arriti mezhdën, unë e pashë mirë që ngriti çiften dhe instinktivisht isha ngritur në këmbë.

Por nuk u dëgjua as krismë, as gjë. Vetëm se mjeku nisi të nomatiste si hoxhët. Me siguri që e kishte me Muhedinin, po nuk me-

rrej vesh përse. Ah, jo, mor vëlla, jo, s'ke faj ti... Faj kemi ne...

Guhekët nuk i kishte parë në pemë, kurse ai shushamenoja, kështu tha mjeku për Muhe-dinin, kushedi nga kulloste. Po në të vërtetë faj s'kishte ai, se kot nuk i kishte vënë shteti pensionet.

Muhedini atje po na priste. As që kishte lëvizur nga vendi, por po na shihte vërtet si shushamen. Qentë nuk ndiheshin më, kushedi ku gjurmonin, po tani ai nuk kishte hall me ta.

— Ti, po deshe, besomë, o doktor, por unë do të flas, se ashtu më ndodhi vërtet. Të ndo-qa me sy, derisa fillove t'i ngjiteshe rrëpirës, jo më tutje. Më kishte marrë gjumi, beson? Kur u zgjova unë, ti po zbritje tëposhtë. Do ta shes çiften, sot e vendosa e s'e luan as pë-rëndia vetë.

Mjeku nuk nxori asnjë fjalë. Mua më vinte për të qeshur me fjalët që po përsëriste Dinea, po në të njëjtën kohë i besoja dhimbjes së vërtetë të tij,

— Unë do të iki. Një minutë nuk do ta zgjat më këtë punë.

— Ku do të shkosh, o Dine?!

— Nga sytë këmbët do vete, ku tjetër...

Në kthim, fare pranë qytetit, i shkrehën nga një herë të dy çiftet dhe i vranë tre gu-hekë.

Muhedini vrau edhe një lepur të egër, kur

po dilte i ushqyer nga lakrat e fermës. Guhekun e parë ma dhuruan mua, që nuk po dija si ndryshoi kaq befas kjo ditë gjahu.

Ato që ma shtonin edhe më të qeshurën si prej budallai, (se dy të tjerët s'kishin ndër mend as të vinin buzën në gaz), ishin fjalët e që Muhedini po ia thoshte për të njëqindtë herë vetes:

«Ik, ore vëlla, e rri urtë, atje në shtëpi, te oxhaku! Dremit sa të duash e kur të duash! Ç'të duhen më ty këto punë, ë...?»

Mjeku dukej sikur nuk dëgjonte asnjëren prej këtyre.

— Po ata qentë, nuk i pritëm ne?... — i thashë unë me zë të ulët.

— Vijnë vetë, ç'ke me ta! Se mos është hera e parë që na ndodh kjo punë.

Doktori fliste me zë të lartë kur nuk ishte në orarin e vizitave.

Marrëveshje për të jetuar

— Dreqi ta marrë shpresën time!

I tha këto fjalë duke e vështruar veten në pasqyrë. Fytyra iu duk si e shformuar, sikur po i avullonte. Sa herë që nervozohej, kështu i bëhej: Hunda i rrëshqiste ca më poshtë, njëri nga sytë i rrëgjohej...

Mirë që kafkën e kam njerëzore, shtoi pastaj me atë aftësinë e vjetër për ta rregulluar humorin me fjalë. U ngrit nga shtrati për ta kundruar veten edhe më nga afër në pasqyrë. Kujtoi grafikën e Gojës «Gjumi me ëndrra sjell

përbindësha» dhe nënqeshi përsëri, duke thënë se ai më kot priste t'i silltë vetëm... transferimin.

Priste telefonin e katërt nga sektorët e minierës. Tri të tjerët e kishin kënaqur, po të pranonim se kënaqësitë për të, prej kaq kohe, ishin të lidhura me shpresën për t'u kthyer në shtëpi.

Dreqi ta marrë shpresën time, tha përsëri, duke i shkuar nëpër mend që ishte i detyruar të flinte larg fëmijëve dhe gruas, në një krevat marinari, dyqind kilometra larg shtratit dopio të shtëpisë së tij... Ç'ta duam... Ç'të sakrifikojmë kaq shumë për të ardhmen, kur po i haxhojmë të gjitha, nervat dhe energjitet, e të gjitha për të sotmen e vështirë?

Ngriti menjëherë receptorin e telefonit që po binte pa pushim dhe priti zërin e inxhinierit të sektorit. Përfytyroi lëvizjet e atij tjetrit: nxjerrjen e bllokut të shënimeve, shfletimin e tij dhe...

— Hë, mo inxhinier... Ç'pate që t'u pre fryma?

— Keq fare... shoku drejtör.

— S'të marr dot vesh unë ty...

— Nga llavë lindore asnjë kókërr qymyr. Nandodhi në fillim të punës një aksident i vogël dhe s'pranoi të shkonte më tijeri të punonteratje.

— Gjallë je vetë... të paktën?

— Përderisa po flas me ju...

— Ti, djalë, nuk je fare pa tru, po aq duhet të ta priste mendja, sa të dërgoje në atë llan-

vë një nga ata minatorët e vjetër që... (që e njo-
hin nëntokën më mirë seç njohin trupin e gra-
ve të tyre, shtoi vetëm për veten.)

— I pari që nuk pranoi të punojë atje ishte
një minator i cili pas dy muajsh del në pension...
shoku drejtor, — iu përgjigj inxhinieri, pa e
fshehur kënaqësinë e sigurisë së fjalëve të veta.

— Po ç'i paska shkrepur, djallit?!... — u
pre befas drejtori. — Edhe dy muaj të dalë në
pension dhe të trembet nga miniera?! Vetëm
po t'i ketë bërtitur vdekja te rrëza e veshit.
E prapë, mua më duhet të realizohet plani, —
tha pastaj, — përpara kësaj asgjë tjetër nuk më
hyn në sy... — Receptorin e kishte flakur mbl
tryezën e mbajtur pastër edhe pse e dinte se
inxhinieri ende priste në anën tjetër të fijes.

— Dëgjon ti... o inxhinier? Vetë aty të
mbish, ditë e natë... Kurse atë trimoshin, merr
vesh, të ma dërgosh këtu menjëherë!

E mbylli menjëherë edhe telefonin. Ende nuk
po i mësonte dot të gjithë se ai nuk kishte ar-
dhur për së dyti nga kryeqyteti për t'u kundër-
shtuar.

Në Konidë kishte qenë jo shumë kohë më
parë. Sapo kishte mbaruar shkollën e lartë atë-
herë. Hoqi dorë me radhë nga shumë gjëra, të
cilit pikërisht pas kësaj ndjeu t'i donte edhe

më shumë, më me dhimbje. Do të mësohem edhe me këtë jetë, tha me vete, pas ditës së parë të punës. Fillimet të gjitha kështu janë: Edhe dashuria, që dashuri është ... ditët e para ka të vështira. Sa të bëhet marrëveshja... Tërëjeta një marrëveshje është, vetëm se nuk duhet nxituar ta firmosësh këtë marëveshje. Kjo është e tëra. Vetëm të mos nxitohesh. Se një herë të jepet kjo e drejtë, ta marrë djalli, kjo është e keqja.

Unë e bëra me këta marrëveshjen, thoshte i vetëm në zyrën e tij, në sektor, duke treguar nga fotografia që kishte bërë me minatorët dhe specialistët aty. Me ta do të merrej, ata me të do të merreshin. Me njëri-tjetrin do të duheshin, do të këmbenin fjalë të mira e të këqija, do të grindeshin e prapë do të vazhdonin të punonin bashkë. Kjo është marrëveshja. Fare e thjeshtë, siç ishin të gjitha gjërat konkrete të kësaj bote. Pothuaj gjithë ditën vetëm për punën mendonte, vetëm për punën fliste, edhe kur shëtiste në rrugën e vetme të qytetit. Kështu i kishte ndodhur edhe në universitet: Zgjidhët detyrat e kursit të shokëve të vet, të cilët nuk linin asnjë teatër të ri a ndeshje futbolli pa parë. Po për asnjëren nga këto nuk ishte bërë pishman. Pas tre vjetve në minierë e caktuan kryeinixhnier dhe pikërisht kur priste të largohej (flitej ta merrte universiteti), e bënë drejtor të minierës. Pas kësaj e largoi përfundimisht dëshirën dhe ndonjë përpjekje modeste për të vizatuar

ndonjë gjë të vogël. Pasioni për pikturen iu bë, pas çdo dite, më i largët, sado që për të i dhimbte sa më shumë kalonte koha. Një mbrëmje i ndodhi të pinte me dy mësues dhe një ekonomist, që prisin edhe ata transferimin. Ekonomisti dikur kishte pasur një të dashur, e kishin bërë fjalë edhe në shtëpitë e veta, por, kur ai kishte marrë emërimin, e dashura i ishte larguar, dalëngadalë... Për të mos i shkaktuar dhimbje këtij, shokut tonë, thoshte për ekonomistin njëri nga mësuesit, sikur nuk e priste dot. Ekonomisti nuk i mbante aspak mëri biondes së tij të viteve të rinisë studentore. Të më priste, thotë ky... Po kush mund të më thotë nga ju, edhe sa vjet të më priste? Kush e di nga ne se sa vjet do ta zbuluojmë klubin e kësaj qyteze!... Ekonomisti priste edhe pak, mos i përgjigjej njëri, i sigurt se një gjë e tillë nuk mund të ndodhte, dhe ngrinte gotën: Ta pimë për ata që na kanë harruar! Dhe e kthente me fund gotën. Dy mësuesit e shoqëronin për solidaritet në këtë veprim. Pije edhe ti, Leonard Bisha, pije, këtu nuk je drejtor. Këtu je si ne: Njeri që pret transferimin. Dikur do të na vijë, kjo dihet. Kush na e vonon, kjo nuk dihet...

Edhe me këta e gjente një mënyrë për të shkuar mirë, si me të tjerët. Njeriu ka nevojë për njerëz po aq sa për veten, kjo ishte fare e qartë. Rastet kur njeriu zhgënjet nga njerëzit e tjerë provon pikërisht këtë e jo të kundërtën.

Më në fund Leonard Bisha kishte vajtur. Trokiti atje ku duhej. Nuk të kemi harruar, i tha ai njeriu i kuadrit, i zeshkët, fjalëpak.

— Më mirë më thoni diçka tjetër... ju lutem! — iu përgjigj Leonardi fjalëve të nëpunësit përtë cilin thuhej se kishte më shumë se pesëmbëdhjetë vjet aty. Do të donte t'ia thoshte më në fund se shkollën e lartë e kishte mbaruar shkëlqyeshëm, se atje ku ishte emëruar po punonte jo keq dhe ... përse të mos më thoni diçka të quartë, dregi ta marrë! Diçka që të më bindë, të më qetësojë e të iki, të shoh punën.

— Nuk të kemi harruar, jo, më kupton se ç'dua të të them ... — qeshi nëpunësi me mishrat e mbufatura nga shëndeti i tepërt.

— Tani, edhe po të dua, nuk mund të të harroj... Po, po! — Pikërisht me këto fjalë iu përgjigj ai, Leonard Bisha, fjalëve të Çoban Çilit, ditën që i solli në zyrë fotografinë e tij si drejtor, më minatorët më të vjetër të minierës.

— Mos fol ashtu, o Leo Bisha, i tha Çoban Çili, intim dhe fjalëthekur. — Mos fol ashtu se, po të duash, po të të leverdisë, ti na harron edhe po të na mbash; siç jemi, të gjallë, brenda në zyrë, e jo në fotografi, në një copë letër...

Me dyshimin e pafajshëm të njeriut të mirë, me dyshimin përveten, Leonard Bisha e vendosi edhe nën xhamin e tryezës së tij në ministri, tre vjet më vonë këtë fotografi. Një ditë dikush i telefonoi nga Konida dhe e njoftoi përvarrimin e Çoban Çilit, të aksidentuar në mi-

nierë. Kërkoi makinë e shkoi atje. U kthye dhe e rrithoi me të kuqe kokën e Çoban Çilit në fotografinë mbi tryezë. Ike ... Ike, po si kështu... ë?! Po si të të harroj, pas kësaj... ë?!

Mbrëmjen e asaj dite u tregoi gruas dhe vajzës së madhe për ata të Konidës. Gruaja e vështronë e heshtur. Pak muaj më vonë, kur Leoja erdhi dhe i tha se e kishin thirrur të njëri nga zëvendësministrat dhe i kishin kërkuar mendim se përse Konida, pas ikjes së tij, kishte bërë vetëm poshtë, ajo i tha se tanë mund t'i plotësohej dëshira për t'u gjendur edhe një herë në mes atyre njerëzve. Madje t'i duhet të ngrihesh e të nisesh vullnetarisht për atje, të mos presësh të të dërgojnë ata, me urdhër... Ata s'mund të shkojnë kurrë vetë... Se ti je i ri në ministri, akoma ngatërron derën e zyrës sate.

Si gjithnjë, ajo ia kishte thënë gjërat më të rëndësishme duke sajuar humore të vogla, të cilat ai, Leo Bisha, dinte t'i zhvishtë nga e qeshura dhe t'i shndërronte në veprime të menjura. Disa ditë më vonë ai u nis vullnetarisht për në minierën e Konidës. «Sa për të shëndoshur gjendjen, mirë bën të shkosh, i thanë shefat e tij me këtë rast, familjen s'ka përse ta lëvizësh fare...!»

Bën mirë t'i marrësh të dyja fotografitë me vete, i tha gruaja ditën që do të nisej. Gjithnjë duke qeshur, siç dinte vetëm ajo. E kishte fjalëën për foton me minatorët dhe atë me shokët e kolegët e tij të rinj, në ministri.

Leo Bisha qeshi edhe ai, po këtë radhë nuk ia vuri veshin porosisë së të shoqes.

Në të vërtetë ai, «minatori i trembur nga miniera», po vonohej ca. Leonard Bisha vendosi të rruhej ndërkokë. E shkumoi mirë e mirë ftyrën dhe ndërroi briskun e makinës. Po e ndiente gjithnjë e më të vështirë jetën e beqarit. Mërzitej, edhe pse përpinqej të punonte deri në atë masë, sa, kur të binte në mbrëmje, ta rrëmbente menjëherë gjumi. Gjithandej lëvizte vetëm. Kudo, në çdo kohë, gjer edhe në mensë vetëm.

Qysh në ditën e parë kishte lënë të kuptohej se, sado që ai ishte Leoja i vjetër, prapë nuk kishte ardhur aty për t'u çmallur me ata vjet e me miqtë e dikurshëm. Të parin kishte shmanqur kryeinxhinierin e dikurshëm, të cilin ai vetë, kur u nis për Tiranë, e propozoi për drejtor. E bëri inxhinier të thjeshtë sektori. Madje e qortoi hapur, duke u kujdesur që askush të mos mendonte se e kishte bërë një gjë të tillë se pikërisht ai kishte bërë që të linte përsëri shtëpinë e punën në ministri e të kthehej në Konidë. Pazotësia është pazotësi, pavarësisht se kujt i kushton, tha ai në mbledhjen e parë të personelit inxhiniero-teknik. Bëri të ditur rregulla të reja, të forta, për zbatimin e të cilave përgjigjeshin të gjithë, dhe për këtë çdo ditë, në mes-

natë, pasi të dilte ndërresa e tretë, do të vinin e do t'i raportonin atij, në drejtori, ku vendosi edhe shtratin e fjetjes. I shkeli vetë të gjitha punimet minerare, vuri detyra më afate, mori masat e para disiplinore ndaj drejtuesve të mefshtë, të cilët, sipas fjalëve të tij, mund të mos ishin të tillë, të mefshtë pra, si punëtorë. Vuri gjobat e para, dikujt ia premtoi lejen e zakonshme në dhjetor, që të bënte banja të ngrohta pranë sobës së ndezur dhe mezi ndjeu një lloj qetësie kur pa se miniera filloi ta merrte ca veten.

Atë natë, kur e morën në telefon nga shtëpia, u tregua me shumë humor, i tha së shoqëse aty, në Konidë, i kishte të gjitha gjërat, fëmijëve u premtoi se me siguri do t'u shkonte në shtëpi brenda muajit (kur muaji sapo kishte nisur) ... hajde, ma mbyllni telefonin, u kërkoi pastaj, se po më presin këta urithët e nëntokës mua! Apo nuk po u hapet edhe goja për gjumë!

— Ku e kishim fjalën? — iu drejtua befas atyre që e ndiqnin me vështrime të druajtura.

— E ku ta kemi tjetër, te qomyri, — tha njëri nga inxhinierët.

— Aty ta kemi e të mos jemi hiç pishman, — tha rreptë Leonard Bisha. — Të gjithë njëlloj po lodhemi, apo jo?!

Dhe kush mund të thoshte se nuk ishte pikërisht ashtu. Të gjithë e dinë se unë shkoj në shtëpi vetëm një herë në një muaj e gjysmë, tha

me zë, duke filluar të hijte mjekrën e regjur. Sikur të jem dashnori e jo burri i sime shoqejë! Kurse ky birboja që gjithë jetën në minierë e ka shtyrë, thotë u tremba dhe ... Bëj ç'të duasti, drejtor, realizoje ti planin, po deshe! Paska vrasë një punëtor i ri gishtin dhe ... ia mbathën të gjithë ... Mirë të tjerët, po ky me ç'sy e faqe ikën, xhanëm? Si do t'u thotë njerëzve që e njohin, ë? U tremba do t'u thotë?

Duhet trembur ca këtu, në zyrë ky, që të mos trembet në minierë, tha pastaj me vete Leo Bisha. Po vallë do ta tremb dot? pyeti veten. Pamjen e kam të ëmbël, më kanë dashur femrat, qeshi prapë, duke sjellë ndër mend një grafikë tjetër; «Nëna mbron fëmijët» të Kollvicit, ku heroina, përballë rrezikut të fëmijëve, shfaqte një fytyrë të trazuar, të shprishur, si të një kafshe të sulmuar.

Për fëmijët njeriu i bën të gjitha, tha pastaj, duke pasur parasysh veten. Pasioni i vjetër i pikturesh ia zbuste shpesh shpirtin, ia qullte vëndosmërinë, fjalët, veprimet.

E po nëntoka nuk është kënd lojérash, de, gati sa nuk thirri pastaj, kur u kujtua se lënia bosh e llavës lindore i kushtonte jo pak planit. Në minierë vijnë të gjithë, por rrinë vetëm ata që kanë b...

Dëgjoi të trokitnin te dera. Tha hyr, por vazhdoi të pastronte fytyrën.

— Më kishit kërkuar... shoku drejtor.. Erdha.

Leonard Bisha vuri re te dera Shero Binakun. Q'donte Shero Binaku aty?! Q'e kishte sjellië në këtë çast, kur priste një tjetër, një frikacak miniere?!

— Jo, s'të kem kërkuar, — i tha Leo Bisha. Sa për t'i lënë të kuptonte se, edhe po të kishte ndonjë gjë për të, le të dukej më vonë. Apo mos është vetë ky ... i tremburi, shkoi në mend. Shero Binaku, të trembej ky njeri nga miniera! Po njerëz si ky, nën tokë ndihen më lirshëm se në shtëpinë e tyre. Shero Binaku, më duket.. Tremberëz më tej Çoban Çilit në atë fotografinë që s'e kishte marrë me vete. Vetëm këtë nuk mund ta shkonte dot ndër mend. Dhe ja, të vjen Shero Binaku e të thotë, pa e çarë kokën, erdha unë.. Më kishe kërkuar gjë... inxhinier Gjergji më tha...

Të dy nuk po bënin zë për ato që mendonin. Leoja u fshi, hodhi krahëve xhaketën dhe ndezi një cigare. Tjetri, pasi priti edhe pak, u afrua edhe më, vetë, pa i thënë njeri, mori një cigare nga paketa e drejtorit dhe po me shkrepen e tij e ndezi.

— Dihet që për ne nuk çan kokë njeri, o shoku drejtor. Edhe ndonjë që mbështetet na ka ngenë. Secilit i ka mbetur të merret me hallet dhe gëzimet e veta tanë... U pa puna jonë.

Leonard Bisha po e zotëronte çuditërisht qetësinë e vet. Vazhdonin të pinin cigare, si dy aktorë në një monolog, fundi i të cilit natyrisht që mund të mbyllej kështu.

— Po si ke fytyrë e më vjen këtu, këtë nuk po e marr dot vesh, — tha më në fund Leonard Bisha.

— Dikush duhej të vinte, — u përgjigj tjetri. — Po të ishte gjallë Çoban Çili ... ai do të vinte.

Fytyra e minatorit, é etur pér diell, e vështronë sikur asaj t'i mungonte diçka më shumë se drita e tij, diçka më e domosdoshme pér njëriun.

— Nëse të tjerët kanë borxhe ndaj teje, në s'të kemi borxhe, apo jo? Dhe ti s'kishe të drejtë të na harrojë... Leo.

— Ne po vrishnim mëndjen pér të organizuar drékën e lamtumirës sate, ... kurse zotrote... S'do ta besoja kurrë se do të vinte një ditë e do të trembeshe në minierë! Më mirë do të ishte të të binte një plis i madh e të të zinte atje brenدا, se të më vije këtu...

Leonard Bisha e ndiente se nuk mund të thoshtë më gjë pas këtyrë fjalëve. Po i shfaqej qartë tërë skenari i kësaj komedie që përbënë njëkohësisht dramën e tij: As Shero Binaku e as ndonjë minator tjetër nuk ishte trembur në minierë.

— Ti mbasë mirë bën që kërkon të kthehet sa më shpejt në shtëpinë tënde, ... mbasë Tirana të takon ... po ç'faj të kemi në ty? Ne kemi punën tonë, atje, nën tokë... Ti bëj ç'të duash me punët e tua, por, që të na përdorësh ne pér të rregulluar ato... këtë nuk ta lejojmë

dot! Se njerëz jemi edhe ne. Dhe në shtëpitë tona kemi ca njerëz të tjerë, që na presin edhe ata, siç të presin ty... Ata na duan të jemi mirë, por, siç po e hamë minierën ne, si qentë, një ditë do të na kërkojë kurbanin ajo... Sot kerkoi gishtin e atij punëtorit të ri, nesër do të dojë kokë njeriu! Po ne për ato koka hyjmë tetëqind metra nën dhé de...

Leo Bishës iu kujtua, fare kthjellët, dhe një herë, grafika e Kollvicit «Nëna mbron fëmijët». Fytyra e Shero Binakut ishtë ashpërsuar e turbulluar tek po fliste.

— Mjaft, dëgjon? Pusho, të them!

— Ti do të ikësh një ditë, po ne këtë minierë e kemi për tërë jetën, ne dhe fëmijët tanë. Dhe duam të hamë përditë nga një çikë.

Minatori po gulçonte sikur tani sapo të ishte ngjitur më këmbë nga galeritë e pjerrëta në sipërfaqe.

— Dil jashtë! Jashtë!

— S'është ndonjë hall i madh kjo... — ia bëri minatori. Derën e tërhoqi lehtë, por u përpoq ta mbyllte mirë.

Mirë bëri që doli, tha me vete Leo Bisha, mirë bëri. Seç kishte një bindje të plotë se minatori do ta merrte vesh se në fund të fundit atë e kishte nxjerrë nga zyra jo Leo Bisha, por drejtori i minierës. Dhe nëse Shero Binaku do të nisej qysh tani për në minierë, këtë do ta bënte jo për drejtorin, as për Leo Bishën e fotografisë së dikurshme, po se s'mund të bëhej ndryshe.

Duke lëvizur i turbulluar nëpër dhomë, kokulur, dalloi në dysheme plasaritje të saj. Mbësë galeritë e tyre janë edhe nën këtë ngrehinë timë, tha me vete.

Jeton njeriu... sidoqoftë

I

Nuk ka njeri tjetër që e njeh qytetin tonë si ai. Të gjithëve u flet me mbiemra, gjer edhe fëmijëve të sapongritur në këmbë, që i shfaqen përpara në rrugë dhe i kërkojnë gazetën. Ai e di që fëmijët me flokë të ashpër e të zinj janë të Dhylëve, ata qimekashtët janë të Cefëve, madje të degës së tretë të këtyre, dhe kanë ngjyrë ca më të errët. Xha Rapi i postës njeh eshtrën e të gjitha fiseve, kafkën e tyre. Me

anë të kësaj dallon lehtë edhe ndonjë krushqi. Fëmijët i shfaqen në rrugë, i zgjatin dorën dhe ai u vë atje gazetën në të cilën është pajtuar prindi i tyre. Qyteti po i kapërcen të 7 mijë banorët, dhe xha Rrapi asnjëherë nuk i ngatërron pajtimtarët. E di mirë cili pajtohet vetëm te «Sporti» e cili prej tyre nuk e ndan dot «Rininë». Për «Zërin...» nuk e vret mendjen kurri. Vetëm se, po ta ketë marrë më parë një tjetër nga djemtë e shumtë të Cefëve, Xha Rrapi s'të lë gazetë në dorë. Një kafkë të fillë e kam parë... tek angjencia, kujtohet në çast ai. Mos u përpinq ta kujtosh se harroi të të japë gazeten. Ai zhvendoset nëpër rrugë si një copë kujtesë. Vetëm kujtesë është. Qyteti rritet ditë pas dite dhe ai po lodhet ta përballojë i vetëm.

I kanë dhënë një ndihmës këto kohë. Ky ndihmës do ta zëvendësojë një ditë. Madje ai po të donte xha Rrapi, duhej të kishte fillouar me kohë. Po xha Rapi ka dëshirë t'i lërë diçka prej vetes këtij punëtori të ri të postës. Vjen në postë dhe pasditeve dhe rri me të riun. Ka një mënyrë tepër origjinale për të ndikuar të zëvendësi i tij i ardhshëm: Vetë rri me shpinë të kthyer nga sheshi i qendrës së qytetit. Madje, për ta bërë më të plotë mungesën e vështrimit për andej, e ul gjer mbi sy kapelen ngjyrë hiri. Ti do të më përgjigjesh mua, i thotë ndihmësit. Mirë, pranon tjetri duke buzëqeshur i téri.

— Eshtë Papa?

— Po, — përgjigjet ndihmësi.

— Me Xhaferrin eshtë?...

— Po. Tjetër... me kë?

— Atë do të ta them tashti. Me Kalemin.

— Po, po... Lëri këta tani. Te grupi tjetër.

— Më thuaj pra njërin prej tyre, — thotë xha Rapi.

— Koçi.

— Boll më. Eshtë me të edhe Shija? Edhe Ilia, edhe Driza?

— Po, po!... — i mbetet vetëm të thotë «po» ndihmësit të tij.

— Jo, prit të të them se ata të grupit të parë po grinden për ndeshjet e futbollit, kurse të dytët po flasin për edukimin e fëmijëve të tyre dhe të qytetit. Shko një vrap, po deshe, deri tek ata dhe, po nuk qe e vërtetë kjo... po e lë punën që sot unë...

— Eshtë e kotë, thotë ndihmësi i tij. Eshtë e kotë. Po megjithatë diçka shoh në sheshin e qytetit dhe nuk e lë xha Rrapin të kthehet mbarë.

— Eshtë edhe një njeri tjetër, këtë po mundë të gjesh.

— Se mos e ke fjalën për ndonjë nga ata të deklasuarit ti...

— Jo, jo...

— Se për ata eshtë fare e thjeshtë përgjigjja: Vetëm me veten rrinë ata.

— Jo, jo, s'është nga ata. Është Sako Ceci, ai fshatari...

— Lëre, mos e zgjat! Ai fshatari që i dhanë shtëpi në katin e tretë dhe e ndërroi me dikë tjetër, te shtëpitë përdhese të Lagjes së vjetër, pér të mos u ndarë nga toka.

— Lëri fjalët tani, xha Rrapi, e më thuaj, me cilin është ai në shëtitje? Këtë më thuaj ti. Hajde, fol!.... Të kapa keq, ë?

Postieri i vjetër ndjeu nevojën pér të larguar ca mënjanë kapelen, deri tani të ulur mbi sy. Po me këtë nuk ndryshoi dot gjë. Me cilin të jetë ky djall... Me cilin të ketë zënë shoqëri? S'kishte shumë kohë në qytet i ardhur dhe ... me cilin të dilte të shëtiste?...

— Mos nuk është fare pér shëtitje dhe unë rrji e vrash mendjen kot?

— Është në shëtitje që ç'ke me të. Po ta pranosh veten të mundur, ktheje kokën e ta shohësh me cilin është.

Po si ta pranonte këtë postieri i vjetër? Kishte menduar se vetëm pér këtë gjë nuk mund të zihej kurrë gafil, por ja që mbeti vuv... me këtë fshatarin e çuditshëm, që djalli e di se me kë kishte dalë të shëtiste këtë mbrëmje. Por ai kurrë, në fërë këto ditë a javë që kishte ardhur në qytet, nuk kishte shëtitur... Ç'e nxori këtë mbrëmje?

— Mos ias ka prishur mendjen gruaja, matufit, — tha pastaj me një ndjenjë të pastër

zemërimi. Hajde se u bëmë qytetarë, i ka thënë të shoqit, dhe do dalim shëtitje.

— Je i mundur, xha Rrapi? Pranon se...

— Ah, fshatar, ç'më bëre! Më turpërove në pleqëri.

U kthye me vrull nga sheshi dhe e pa Sako Cecin. Aty ishte. E njohu atë tjetrin që ishte me të. E njohu dhe e shau. Me zë. Çimkë, i thirri, Çimkë e keqe. Ku vajte dhe njohe atë të parin, o fshatar... shtoi pastaj. Ku e gjete!

II

Postieri i vjetër doli në shesh i vetëm. Ishte mësuar që gjithnjë vetëm t'i shkelte rrugët. Me të gjithë qytetarët e tij kishte afërsi e njohje por pothuaj me asnjërin nuk kishte shëtitur. Ku kishte ngë ai të shëtiste. Këtë e dinin të gjithë: Xha Rrapi merrte gazetat, telegramet e lajmthirrjet në dorë dhe merrte rrugët. Të gjithë e përshëndetnin, por ishin mësuar me një lloj përhumbjeje të tij! Edhe po të mos ua kthente ai përshëndetjen, ata nuk ia merrnin përters. Kushedi ç'haber i conte ndokujt dhe... Vetëm kur dorëzonte ndonjë telegram vdekjeje, zgjatej ca xha Rrapi. Duhan nuk pinte, por e mbante një paketë për këto raste. E nxirrte një cigare atje ku shkonte për këto telegrame, i pëshpëriste «Të rroni vetë... T'i rrojnë një-

rëzit!», e thithëtë disa herë cigaren bashkë me tjetrin, pastaj ndahej e largohej me hap të ngadalshëm. Plot njerëz thoshin se e kishin parë shpesh, pas këtyre rasteve, të përlotur, por pamja dhe një lloj indiference e çuditshme e këtij njeriu sikur nuk të bënин ta besoje këtë gjë.

— Tungjatjeta, fshatar! — iu drejtua Sako Cecit.

— Tungjatjeta, vëlla! — ia ktheu tjetri. E njihte, si s'e njihte postierin ai. Edhe një herë të vetme të vije në qytet, do të dëgjoje për xha Rrapin e postës.

— Rrimë ca bashkë? — e pyeti postieri duke i hedhur një vështrim ku e qeshura babaxhane tretej në një lloj ftese për t'u afruar.

— Qyteti ka njerëz shumë; po me mua nuk rri njeri!... Kushedi përsë... — tha Sako Ceci. Dhe mbeti një copë herë kokulur.

— Avash-avash, o Sako! Do të të njohim e do të na njoħeš dhe do bësh imiq e shokë plot! Pastaj... Ku ke filluar punë ti, ke shokët e punës të parët.

— Po għshok ka puna ime, or vëlla! Vetëm të vdekurit të bën shokë ajo.

— Si the, si?!

— Punoj më varreza, mirëmbajtës, — tha Sako Ceni.

— Po pse, për të hapur varre në qytet erdhe nga fshati ti, o fshatar?! — qeshi me téré shpirt postieri i vjetër.

— E po do të rrojë njeriu. Ti u çon tele-

gramin në shtëpi, unë ndërkohe u përgatit vendin atje...

— Ashtu është vërtet, mirë e the, o fshatar. Jeton njeriu, sidoqoftë! Po më bënë sytë mua apo të pashë me njeri tjetër ca më parë?!

— Hidrauliku ishte. I thashë të vinte andej nga shtëpia e të shihet... Se dua të fut ujin brenda në shtëpi unë, prandaj.

— Vemi e pimë një kafe, po deshe, — tha postieri.

— Jo, jo! Nuk kam kohë. Ty të falemnderit, por unë pres një mik këtu. Do pres edhe pak e do iki në shtëpi.

— Si të të bëhet më mirë, o Sako Ceci. Po mos thuaj se nuk rri njeri me ty.

Postieri i vjetër u kthye prapë në zyrën e postës. Ai që do ta zëvendësonë më vonë po e priste. Duke qeshur.

— E, Sako Ceci ishte?! — i tha xha Rrapit.

— Ai djall ishte, ai.

Dhe nuk ia ndante sytë ende që aty ku ishte, nga dritarja e postës. Sikur ende nuk e besonte që fshatar i kishte dalë për shëtitje! Apo nuk besonte se pak më parë kishte qenë me hidraulikun e qytetit?

«Pa ta shohim edhe këtë mikun tënd?» po thoshte me vete postieri i vjetër, pa ia ndarë sytë fshatarit, si i fyj përsë tjetri kishte kundërshtuar t'i pinte kafen. Numëroheshin me gishta ditët kur kishte hyrë postieri i vjetër për

të pirë kafe në bufetë e klubet e qytetit, kurse Sako Cecit nuk i dilte koha...

· · · Pas pak e pa qartë atë që nuk donte të ndodhë: Sako Ceci kishte pritur hidraulikun! Të dy morën rrugën e bufesë. Do të pinin!, Dihej, po përse të më gënjeje, ë?! Përse të më gënjeje, o fshatar? Nuk kishe përse, apo jo?! Unë nuk të detyrova për gjë. Kot që e përdore gënjeshtëren për një njeri si unë.

Priti edhe ca, sa u duhej atyre të dyve të uleshin në tryeza dhe të porositnin, dhe i foli postierit të ri, atij që do ta zëvendësonte.

— Hajde vemi të ta jap atë gotën e bastit. S'e gjeta dot me cilin ishte fshatari. Hajde shkojmë!

— Pse, shkoke në bufe, ti, xha Rrapi, shkoke edhe ti? — e pyeti dy-tri herë postieri i ri, duke ecur për atje.

— Shkoj, si, ore, nuk shkoj?! Pse, nuk jam njeri unë?!

Si t'i them tjetër, thoshte me vete. T'i them që dua të shkoj atje sa të më shohë Sako Ceci... Të më shohë e ta marrë vesh se...

— Shkoj, or bir, si nuk shkoj?! — i tha prapë postierit të ri.

III

Fshati i tyre ishte përmbytur nga liqeni i krijuar për hidrocentralin. Sako Ceci kishte ar-

dhur në qytet punëtor te varrezat.. Fshatarët e tjerë ishin rregulluar edhe ata, dikush në fshatin e ri, dikush në qytet. Për varret u kishin lënë të bënин si të donin. T'i merrnin me vete, atje ku të shkonin, ose t'i ngrinin më lart, kodrës ku i kishin. Për transportin e për të gjitha harxhimet e tjera, kështu u thanë, përgjigjet shteti. Sako Ceci i mori me vete varret e pleqve. Aty i kishte ujdisur më dorën e vet. Varret ngriheshin në një kodër me dhë të bardhë që e kullaonte ujin. Në kodrën tjetër, ngjitur, ishin depot e ujit.

Përqark depove hidrauliku i qytetit mbillte domate e bostan. Ai ishte një gjatoburrë, me sytë aq pranë njëri-tjetrit, sa dukej si të kishte vetëm një sy. Këtë mendim e përforconte ajo fjala e përhapur në qytet në adresë të tij. Vërtet uji është i perëndisë, kishte thënë ai, po në këtë qytet ujin e kam unë në dorë dhe jo perëndia! Dikush e kishte quajtur, jo vetëm për humor, Polifem të ujit, dhe vetë hidrauliku queshte me këtë.

I hidhte ndonjë kokërr domate Sako Cecit që vinte nga varret aty pranë dhe rrinte te depot e ujit. Hajde dhe na i bëj varret të thella kur të vdesim, ë?! Sipas normave, queshte mbyturazi Sako Ceci, si ti që e ke ujin me bollëk, si unë që s'kam fare në shtëpi. Varret njëlloj! Kaq e lehtë të duket ty të bëhesh me ujë me të ardhur nga fshati?! Hidrauliku thoshte këto e queshte. Ishte i trashë si një lëkurë e fryrë, e

cila ishte çarë me brisk të lehtë në shtatë-tetë vende, për të dalë sytë, veshët dhe organet e tjera. Marrim ndonjë ditë ca domate nga këto të miat dhe pimë ndonjë gotë, ë, fshatar, i kishte thënë. Një herë pinë, po Polifemi i ujit don-te të pinin prapë. Dhe gruas i duhej uji në shtëpi. Detyrohej ta merrte në krahë, dyqind metra larg.

IV

Postierit i ishte vjedhur pasi i kishte ardhur në bufe, atë ditë... Edhe në rrugë nuk i dilte përballë. Kot e gënjeva, kot farc, thoshte me vete, po gënjeshta ka vetinë të mos kthehet rrëmbrapa. Po si të bëja edhe unë, si? Hidrauliku, vetëm ai mund të ma sjellë ujin në shtëpi! E po çfarë, pastaj, thoshte, ç'lidhje ka kjø më gënjeshtren që i bëre postierit?! Ai nuk dinte e ti s'i the gjë se me kë ishe dhe kë prisje.

C'e vret mendjen për gjëra që nuk ta vrassin xhepin fare, as tani e as kurrë ndonjëherë, i tha më në fund vetes. E ç'u bë se nuk e rregullon muhabetin me një postier?! Po më erdhi letra apo telegrami, ai të tërën do të ma sjellë, nuk do të më sjellë gjysmën.

Por, për çudinë e tij, postieri e ftoi përsëri për kafe. Nuk ia bëri për fjalë ditën që e kishte gjetur duke pirë me hidraulikun. Págoi dhe, duke u ndarë, i përsëriti atë që i kishte

thënë edhe më parë dhe që Sako Cecit i kujtohej mirë: Do të të njohim e do të na njohësh dhe...

Dhe kur të mërzitesh, na bëj zë e rrimë nga ca bashkë, dëgjove, i tha më në fund. Sikur të mos donte ta fshihte në këtë mënyrë atë mera-kun e tij se Sako Ceci edhe pas kësaj do t'i fshi-hej, ose së paku nuk do të kishte dëshirë të rrinte me të.

Shtatë ditë më vonë Sako Ceci e kërkoi në punë postierin. E priti aty për një gjysmë orë dhe pas një ore tjetër u kthye aty përsëri. Xha Rrapi është kthyer, i tha postieri i ri, duke e parë me dy sy të vëmendshëm, sikur të dinte përse ai, Sako Ceci kërkonte ta takonte postierin tjetër.

Rrapi doli dhe eci përkrah tij. Pa folur, pa e përshëndetur. Vetëm eci përkrah tij. Ti që më ke thirrur, ti duhet të flasësh; se kof nuk më ke thirrur, thoshte heshtja e tij. Unë, merret vesh që unë do të të thëm për se të doja, por sidoqoftë edhe ti mund të thuash diçka, sa përtë nisur, se..., po thoshte me vete Sako Ceci.

— Do ta pimë një kafe nga unë?

— Do ta pimë një kafe, thuaj, o fshatar! Se kush do paguajë, është tjetër gjë e, kur s'është punë interesit, pak rëndësi ka.

Sako Ceci nuk bëri zë, por pas pak u dë-gjua të thoshte:

— Nuk qenka për mua qyteti, jo...

— Kur t'u mërzit kaq shpejt, o njeri?!

— Mbase nuk jam unë për qytetin, mbase...!
— shtoi pastaj, i lodhur.

Postieri e vështroi me sy pyetës, pa e ditur se ç'do të dëgjonte pas pak prej tij.

— Mbrëmë më ka ardhur turp që jam njëri i ndershëm, më beson?

Sako Ceci i nxori me dhimbje këto fjalë.
Pas tyre u gëlltit.

V

Kishin hyrë në klub vetëm ata të dy: Sako Ceci dhe ai, hidrauliku. Në fillim vetëm ne të dy ishim, tha Sako Ceci, pastaj erdhën të tjerrët. Pa u ulur mirë në tavolinë ne, na kishin ardhur porositë. Mezet dhe rakia, dopio. Na ruaj edhe racionet e të tjerve, i kishte thënë hidrauliku kamarierit. Ne nuk e kishim lënë me njeri tjetër, i tregoi Sakoja postierit. Gëzuar, o fshatar! e kishte ngritur gotën i pari hidrauliku. Gëzuar e mos na turpëro sonte se, përderisa ti bëre ndërmend të vije në qytet, i ke marrë parasysh ca gjëra, apo jo? I ka qyteti këto gjëra. Nuk jetohet vetëm këtu. Bashkë i kemi të gjitha, të mirat e të këqijat.

Vetëm të rregulloj atë ujin në shtëpi, hë, vëlla, kishte ulur zërin Sakoja. Hidrauliku kishte qeshur me druatjen e tjetrit.

— O do ta sjell ujin unë ty, o e thaj qytetin fare! Dhe që vij e pi raki, këtë e bëj se

kam respekt për ty e jo se kam ngelur të pi rakinë e një varfanjaku si ti. Hajde gëzuar!...

— Gëzuar dhe ju bëftë mirë — u dëgjua nga pas shpinës së Sakos.

— E mira ju gjettë edhe ju e mirë se na urdhëruat! Hajdeni, se me Sakon jam, me Sako fshatarin.... — tha hidrauliku, sikur ta kishte Sako Cecin mik a shok prej më shumë se njëzet vjetësh.

Të dy u ulën pa e bërë dysh dëshirën e hidraulikut. Njëri ishte përgjegjës i elektrikut dhe tjetri anëtar i këshillit të qytetit. Ku ta dija unë se ata e paskëshin zakon këtë gjë! Nga ti po e dëgjoj, po i thoshte Sakoja postierit. U erdhën gotat e pjatat dhe i përplasën. Në fillim me perëndinë e ujit, thanë për hidraulikun, uji ështëjeta! Festa e ujit është edhe festa e dritës, tha elektricisti. Festa e ujit, festa e gotës, thirri hidrauliku, që kishte ardhur në qejf. Tani do të fillojmë të pimë, tha ai. Dhe të mos më kursemi, shtoi pastaj. Hajdeni, t'i përplasim gotat me perëndinë e vdekjes, tha pastaj për Sako Cecin, M'u duk se atëherë sytë e tij ishin bërë me të vërtetë një, tregonte shtatë ditë më vonë Sakoja, endë i tronditur. Për mua ishte vonë, nuk mund të ndryshoja gjë. Vetë i kisha katranosur punët! Ata ishin me të vërtetë të kënaqur, aq të kënaqur, sa pothuaj po më harronin fare mua. Nisën t'i përplasnin gotat me njëri-tjetrin e rrallë kujtoheshin ta ciknin me gotën time, po këtë gjë e bënин aq kot e aq pa dëshirë, sa edhe mua

m'u bë e mundimshme ngritja e gotës drejt gotave të tyre. Edhe duke i përplasur gotat, dihet, unë, do të paguaja më në fund. Ata porositën prapë dhe unë... Ç'të bëja unë... Pikërisht atëherë erdhi edhe një tjetër dhe Sako Ceci as që ndjeu dëshirë për të marrë vesh cili ishte ai e ç'detyrë kishte. Cilido të ishte ai, unë do paguaja, tha Sako Ceci. Nuk u ngrita fare nga vendi, as për t'i uruar mirëseardhjen (se nuk e kisha ftuar, si ta uroja!), po tjetri me gjithatë nuk e ndjeu veten të fyter. Pranoi të pinte dhe të hante në atë gjëzim të tijin. «Sa keq», vetëm kaq tha i porsaardhuri kur e prezantuan Sakon si banor të fshatit të mbytur. Vetëm kaq dhe filloj menjëherë të pinte, sikur në atë mënyrë do të ulte nivelin e ujit të fshatit të mbytur.

Sako Ceci tërroqi pak mbrapa karrigen për të liruar ca vend për të porsaardhurin. Dalëngadalë u shkëput fare prej tyre, po kështu e ndiente veten ca më të shpenguar: të paktën ata nuk merreshin me të. Hajde gjëzuar, të pimë për njëri-tjetrin, thoshin ata, dhe askush nuk shkonte ndër mend të prekte gotën time. Sikur të mos isha fare aty. Sikur në tavolinë nuk ishin pesë, por vetëm katër veta. Nuk do të ishte e çuditshme sikur të më thoshin: Sako, ti e shikon që këtu u bëmë ca si ngushtë. Përse nuk shkon deri në tavolinën tjetër?! Sikur të mos kishte një orë, e cila vinte, e atëherë duhej të paguante dikush, ata do ta bënin një gjë të tillë... Më kishin lënë prapa shpinës së tyre, si të isha

një fëmijë 3-4-vjeçar që lëpinte një karamelë. Ose si një të dehur nga dhimbja e kokës prej mendimit se do të paguajà aq shumë.

Më nё fund nisën të flisnin pёr mua, të tallashin, të bënин humore të holla, sikur unë të kisha humbur edhe të drejtën e të dëgjuarit.

— E ka pёr herë të parë. Është qytetar i ri,
— tha njëri prej tyre.

— Pas ujit do t'i lindë dëshira pёr të riparuar mjetet e ndriçimit, — tha elektricisti. — Do mblidhëmi edhe një herë, siç jemi këtu.

Më vonë ishin ngritur e kishin ikur një nga një. Nuk më thanë as natën e mirë, më beson?! As vdeksh sonte nuk më thanë, po i tregonte postierit Sako Ceci. Ç'të bëja, pagova dhe dola. Ato çaste nuk më peshonte jeta fare... Nuk thashë kот që më erdhi rëndë nga vetja që isha njëri i ndershëm.

— Njeriu e bën veten si të dojë! — tha postieri.

— E ku kam gjë nё dorë unë?! Unë vetëm varre hap, por ohu... derisa të bëhen pёr tek unë ata... Pastaj dihet, mua m'i sjellin të vdekur...

— Njëriu ka nё dorë veten e tij, pёr këtë e kisha fjalën, — tha postieri nervoz. — Rasti apo, kushedi, mbasse edhe vetja ta solli pёr fat njohjen e qytetit me një njeri të lig. Se qyteti, si njeriu, ka edhe pjesën e vet të ligë, të cilën mezi e heq, të mallkuarën.

Sako Ceci rrinte e dëgjonte. I heshtur, si i

rrahur në të errët. I verdhë, i pagjumë, mezi e zinte vendi.

— Dua të bëj një letër. Ma dërgon dot ti atje ku duhet dërguar?

— Letra letër është, — tha postieri i vjetër si i mërzitur nga tepria e letrave që kishte shpërndarë gjatë jetës së tij.

Po ecnin nëpër sheshin e qytetit.

— Po ti këmbë ke, edhe gojë po ke... — tha më në fund postieri. — Këto gjëra që më the mua, thuaji aty kù duhen thënë. Po t'i thuash të gjitha, pa... As veten mos e kurse, se vetë shkove me atë Polifemin e ujit.

Postieri paskëtaj nuk u bë më i gjallë. Do të donte t'i thoshte tjetrit se duhej ikur për këtë natë. Nesër llafosemi prapë, do t'i thoshte, por e ndiente se ato fjalë nuk mund të ndryshonin gjë të madhe.

— Po deshe... rrimë edhe pak. Po deshe... — pothuaj u lut Sako Ceci. — Rrimë, kot... Ne s'i kemi interes njëri-tjetrit...

Rrugës, në të Kundërt

Novelë

Vetë ai sillej sikur e shkuara e tij të ishte e dikujt tjetër. Mbase kjo vinte se njerëzit përqark, kur përmendin fjalën biografi, nënkuptionin në çast të shkuarën e të tjerëve (gjyshërve, prindërve etj.) dhe pak qëndronin tejeta e vetë të interesuarit, mendonte ai.

Në të vërtetë kjo lloj biografie ia lehtësonë të shkruarën, sa herë që ia kërkonin, ose të dëgjuarën, sa herë ia lexonin diku. Rinte kok-

ulur, duke u përpjekur të merrte me mend bezdinë që shkaktonte te të tjerët përsëritja e saj kushedi për të satën herë. Edhe po të mbyll sytë, unë mund të ndjek me mend fragmente të tëra të biografisë sime, pra të biografisë së të tjerëve që kanë mbiemrin tim, thoshte duke qeshur lehtë.

Hektor Veshi, lindur në... një familje shumë të varfër fshatare. Babai i tij, Zeqir Veshi, ka vuajtur për bukën e gojës... ka hequr të zitë e ullirit në regjimet antipopullore. Prej viti 193... ka punuar në minierën e qymyrit në kushte çnjerëzore... Disa vjet rresht kalonte lumin në vah për të ardhur në punë çdo ditë, dimër e verë. Kur pronarët e shoqërisë së huaj aksionare ngritet stalla të reja për kuajt e minierës, në njérën nga stallat e vjetra strehoi familjen dhe fëmijët e vet Zeqir Veshi, babai i Hektorit...

Ajo që lexohej, që ai e dëgjonte edhe pse vëtë e kishte shkruar fillimisht, i dukej e ftohtë fare. Ashtu e pati shkruar, se ashtu ia' kishin kërkuar. Dhe pse të bënte ndryshe?!

Asgjë prej të shkruarave nuk ishte e gënjeshtërt, po shumë prej tyre nuk ishin të plota. I ati, Zeqir Veshi, dinte vetëm të punonte. Mbi dhë e nën dhë, ai të gjitha punët i quante të mira kur i sillnin aq para, sa të shtynte ca ditë me bukë fëmijët dhe të kthehej i dehur, me duar e me këmbë, në stallën e kuajve, pra në shtëpinë e vet.

Lufta ngjitej e zbriste në malet përqark minierës, por ai s'kishte nge të merrej me të. Ajo le të bëjë të sajën, unë do të bëj timen. Ajo do koka njerëzish, po s'ka punë me timen, thoshte ai. Mua më presin shtatë gojë në shtëpi! Ato po, ato do më hanë ndonjë ditë mua! Eh, lufta, ç'punë ka ajo me mua, apo unë me të? Çfarëdo që të ndodhë, unë prapë nën dhë do hyj e qymyr do nxjerr. Gjithnjë është dashur qymyr; pas qđo lufte!

Të gjitha këto nuk i shkruheshin në biografi. Vetë Hektori i pati dëgjuar nga të tjetrët. Ashtu siç kishte dëgjuar edhe për vdekjen e të atit. Kishte mbetur nën tokë pas një shpërthimi gazi. Bashkë me katër të tjërë. Pa katandi e pa shtëpi kishte qenë, papo mbeti edhe pa varr, thoshin pleqtë për Zeqir Veshin. Shoqëria aksionare u kishte falur një shumë të hollash, po paraja në duart e fukarait humbet vlerën. Aq më tepër se ndodhi edhe në kohë lufte.

Askujt prej vetrarëve, nuk u pati shkuar ndërmend të shtronin pyetjen që bëhej rëndom: përsë Zeqir Veshi nuk kishte ndihmuar luften? Dukej sikur varfëria e Veshëve, shtëpia e huajtur prej kuajve, e sidomos fundi i jetës së tij, me përvëlim deri në hi dhe mbetje pa varr, ishin të mjaftueshme që edhe të birin, Hektorin, ta quanin njeri me biografi të mirë, pra, siç thoshin për humor nëpër bisedat, njeri pa mbeturina nga Lufta e Dytë Botërore.

Në fund të biografisë së shkruar thuhej (më në fund), diçka edhe për të. Prej kësaj mësoje se në shkollë s'kishte shkëlqyer si nxënës, por si veprimtar rinie dhe se zhvillonte kritikën e autokritikën pa ndërprerje, në mënyrë revolucionare. Për tre vjetët e shërbimit ushtarak ishte shkruar edhe më shkurt: Të gjithë komponentët shumë mirë.

Hektori, kur filloi punën në minierë, kishte pyetur: «Mos duhen shënuar edhe të tjera gjëra? Aty ku e tha, e pritën me të qeshura. Ik, djalo, ik! Ka kush merret me ato punë. Ti puno, atë bëj! ..

— Por është biografia ime, se! — pati thënë diku duke bërë shaka.

— Jotja po, por e shkruajnë të tjerët! Po ç'do shtoje tjetër për jetën tënde ti. pyeti veten paskëtaj, ë?! Çfarë?

Është e kuptueshme që do shtoja, iu përgjigj vetes, si një tjetri. S'ka njeri që të mos ketë ngjarje, ditë e data të veçanta në jetën e vet, sado vakët që të jetojë ai, shtoi, i druarjatur nga qortimi që i bënte heshturazi vêtes për këtë gjë. Asnjë vajzë të dashruar, pëshpëriti atë ditë kur hynte për herë të parë në minierë. Dhe se përsë shkoi ndër mend se për biografinë kjo ishte diçka pozitive. Të mos shënohej gjë për moralin në biografi, do të thoshte ta kishe ruajtur atë të pastër. Dreqi e mori, po unë nuk do ta mbyll jetën si murg, i thirri vetes. Tridhjetë metra nga depoja e

mekanikës ishte baraka e llambisterisë. Në çdo ndërresë aty punonin nga dy bateristë. Qeshi me vete duke menduar se ndonjëra prej bateristeve do të përpinqej, mbase, t'ia njolloshte biografinë dikur!

Në shkollën e mesme, duke u kthyer prej një ekskursioni, pati vrapuar pas një vajze, E kishte arritur, ajo kishte ulur kokën, kush e di pse, dhe ai i puthi vetëm flokët pak si të kuqërremtë... Vetëm kaq! Pastaj më vonë, pas mbrëmjes së fundit të vallëzimit, ia kishte ngulur aq rreptë vështrimin një vajze, sa ajo kërkoi ndihmën e një shoku: «Më duket se Hektori është i dehur! Kam frikë!...» kishte thënë ajo. Vetëm kaq! Ah, jo! Ajo me flokët si të kuqërremtë e pati kërcënuar se do ta bënte problem. «Je edhe sekretar rinie!» i pati thënë për ta kthjelluar përfundimisht dhe ashtu kishte ndodhur vërtet.

Nga ai gjimnazisti i dikurshëm kishte mbetur po ajo gjallëri, e folura qartë e prerë, e qeshura me zë të lartë (veti e njerëzve të çilltër, thoshin për këtë) dhe, qishte më e veçanta, barceletat e pafundme. Për të tëra këto e morën pas vetes, qysh ditët e para, mekanikët e sektorit e, sado që ai vetë asnjë punë nuk dukej se do ta çonte ndonjëherë deri në fund, vendosën ta mbanin përgjithnjë. I dhanë çelësat e depos së mekanikës dhe ai nuk përtonte të vinte nga shtëpia, jashtë ndërresës, deri në sektor e të hapte depon për të nxjerrë veglat e

punës. Rinte aty deri në zhdukjen e avarive dhe vetëm atëherë kthehej për në shtëpi. Të nesërmen nuk bënte zë fare për këtë.

— S'ma merrte mendja të bëhej edhe ky punëtor! — tha dikush mes punëtorëve.

— Pse, im atë ç'ka qenë? — kishte pyetur i egërsuar Hektor Veshi, por një çast më vonë as që ua vari përpjekjeve të tjegrit për t'u sqa ruar. Ja që u dashka edhe biografia e të tjerëve, tha me vete.

II

Si gjithë të tjerët edhe Hektori vinte te sporteli e kërkonte llambën e vet. Gjer atë ditë kur më foli Roberta, për mua ishte si gjithë të tjerët.

Në minierë gratë janë të pakta, por unë kur rrë nuk jam e një mendjeje me Robertën, që këtë e quan shkak të lakmimit prej burrave. Madje edhe për vetë sjelljen e saj unë kam rezerva. paçka se jam e detyruar ta bëj rrugën me të. Ajo sesi sillet! Thonë që burri i beson si leshko. Robertës i ndodh të grindet shpesh dhe punëtorët s'lënë pa ia hedhur ndonjë fjalë për sjelljen e saj.

Hektorin edhe më vonë s'e njoha për keq, po nuk ndihesha mirë kur për të më fliste, mirë Roberta.

Përpinqesha që atij të mos i dilja vetë në sportel.

Detyrohej t'ia nxirrte llambën Roberta. Ai rrinte edhe pak, pastaj largohej.

Ti je budallaqe, Mirjana, më thoshte Roberta. Nuk të pëlqen Hektori?! Kush e shau? Përse nuk i përgjigjesh, atëherë? Si t'i përgjigjem? Unë nuk e njoh fare atë! S'më beson mua ti?!

Me punëtorët, çdo komunikim e bënim në-përmjet sportelit të llambisterisë. Mes tyre gjendeshim vetëm kur zhvilloheshin mbledhjet. Në to nuk kisha diskutuar kurrë, madje as kur kishte ndonjë vërejtje për ndriçimin e llambave. Vetëm rrija e dëgjoja, shpesh e hutuar përgjysmë nga serioziteti, zhurma dhe bisedat me zë të lartë të burrave.

Ai, Hektori, fliste shpesh. Njerëzit sesi heshtnin, urtoheshin kur diskutonte ai dhe dalëngadalë edhe unë po filloja të ndieja një lloj mpirjeje përpara tij.

Duhej të mendonin kështu edhe të tjerët, përderisa, sa herë që duhej thënë një fjalë e saktë, e pjekur, kthenin kokat nga Hektor Veshi, me ca sy që prisnin prej tij, plot besim e siguri.

Erdhën pastaj ditë që vija me qejf, në punë; prisja gjëra të këndshme dhë vetëm e vetëm prej atij. Si do të më ndalte, ç'do më thoshte? Sikur ta bënte me qëllim, ai po tregohej fare i pavëmendshëm ndaj pritjes sime. Ndoshta s'kishte biseduar fare me Robertën! Ku i dihej kësaj femme shkallaqe; ndoshta ia kishte dhënë truri i

vogël kot së koti. Aq më mirë nëse ajo s'ka folur me të, thashë.

Dëgjoja bisedat e tij, aty, pranë llambisterisë, qeshja pa zë me të qeshurën e tij dhe ia nxirrja llambën pa e kërkuar ai ende. As që pyesja për prani në e Robertës! E g'të keqe kishte se sille-sha ashtu me një njeri që edhe te të tjerët kish-te përshtypje të mirë?

Sikur t'i dinte të gjithë këto që mendoja e përfytyroja. Hektori filloi papritur ta kërkonte llambën vetëm nga dora ime!

Dhe ja që mua tanë më vinte mirë për këtë. Paskëtaj, edhe kur Roberta më thoshte ndonjë fjalë të mirë ose të keqe për atë, më dukej se e bënte nga zilia.

Herë-herë ai më dukej i mirë pikërisht sepse unë doja ta shihja të mirë, por pas këtyre hamendjeve qeshja me vete. Atë ditë kur e zgjodhën nënkyryetar të bashkimeve profesionale të sektorit, sesi m'u duk. Erdhi vetë te sporteli dhe ma dha këtë lajm. Sikur kushedi. ç'lidhje kishte kjo me njohjen tonë!

III

Në minierë erdhën njëherësh disa elektrovozë, arganello dhe pompa të reja, ndaj u bë e domos-doshme rritja e skuadrës mekanike. Nga katër numri i mekanikëve shkoi në shtatë dhe ishte i natyrshëm propozimi për të ngarkuar njërin prej tyre me detyrën e përgjegjësit.

Drejtuesit e sektorit e panë të udhës që të caktonin në këtë vend Hektor Veshin. Ai po humbte kohë gjithnjë e më të madhe mbledhjeve, ku po merrte pjesë dendur. Pra, meqë ai punon më pak se të tjerët, meqë i prish më pak punë punës, e bëjmë përgjegjës! Pak a shumë kështu menduan shokët e sektorit kur e thirrën dhe i njoftuan përgjegjësinë Hektor Veshit. Me këtë zgjidhje mënjanonin edhe ndonjë kritikë të mundshme nga ana e tij në mbledhjet e ardhme.

Aq më tepër që arsyeva formale ishte: Hektori kishte shkollën e mesme dhe, së fundi, ishte zgjedhur edhe nënkyretar i bashkimeve profesionale të minierës; kryerja e kësaj detyre e kërkonte, sidoqoftë, njëfarë kohe.

Dhe me të vërtetë, edhe pse filloi të hynte rrallë e më rrallë nën tokë, madje edhe pse në sektor s'dukej aq shpesh, detyrën e re po e kryente më së miri. Kërkoi rregull e disiplinë prej vartësve, gatishmëri të përhershme të mjetave e teknikës por edhe vetë shkonte e grindej në magazinat e ndërmarrjes, hahej si qen përfurnizimet. Në analizat e punës i pyeste një përnjë minatorët për kërkeshat e tyre, u sillte susta, pistonë, doreza për çekiçët rrëzues, madje u siguronte edhe ndonjë rezervë, e askush nuk kishte pse ngrinte supet më për caktimin e befasi- shëm të tij si përgjegjës.

Harruan dalëngadalë Hektor Veshin e mëparshëm, që ruhej mos ndotë me vajra (e ç'djall mekanik do bëhesh ti atëherë, pati thënë dikush

një ditë) dhe u mësuan me përgjegjësin e mekanikës, sikur i tillë të kishte qenë gjithmonë.

— Jo, mor vëlla, s'ishte për atë punë ai, e thosha unë, s'bëhej dot mekanik ai! Përgjegjës po!

Hektor Veshi nuk do t'i mërzitej kujt përkëto fjalë, edhe po t'ia thoshin në sy.

Ja që kështu jam, ç'të bëj sikur thoshte me heshtjen e vet.

Rinte e dëgjonte bisedat e punëtorëve me vëmendje, ngrinte sytë e gjallë, ku gjëzimi s'rreshqte kurrë, dhe ndiqte me vështrime të mprehta lojën e ndjenjave në fytyrat e mniatorëve, kur ata zemëroheshin, qeshnin, flisnin, jepnin e merrnin me njëri-tjetrin.

Thoshin që ai mbante shënime për gjëra si këto në një bllok, të cilin e ruante në dollapin e vet, tek depoja e mekanikës; shënon, thoshin, fjalë të Markos, Velos... or po edhe nga Nebi Areni zgjedh diçka dhe shkruan.

E ç'të keqe kishte kjo, kur dihej se Hektori i përdorte në diskutimet e veta, në mbledhjet e shumta, ku e thërritnin e ai nuk mungonte kurë?! Madje njërzve filloi t'u vinte mirë që fjalët e tyre, të zbukuruara e ujdisura edhe më, thuheshin edhe diku tjetër. Vetëm Nebiu druhej nga kjo e kishte filluar të rezervohej kur kishte Hektor Veshin pranë.

Të qenurit e tij mes punëtorëve bënte punën e vet dhe shpesh ata dëgjonin nga goja e Hektorit ato që mendonin e ndienin vetë, por që, nga mospërdorimi i mirë i fjalëve, nuk arrin

dot t'i shprehnin. Dalëngadalë ai u bë nevojë e tyre, dëshironin ta kishin sa më shpesh afër e t'ia tregonin të gjitha. Të kërkonin mendimin e tij. Po ndodhte si me ata ulokët, që rrinë arbitra në lojërat e fëmijëve, ngaqë vetë nuk luajnë dot. S'bënte dot si mekanik, por po tre gohej drejtues i rrallë. Se nuk është i prerë për të gjitha njeriu. Dëgjoje Hektorin kur flet dhe fol pastaj për të.

Në presidiumet e mbledhjeve, gjithnjë e më tepër po tërhiqte vëmendjen me diskutimet e tij. «E dëgjuat atë minatorin, sa bukur ë, si i tha ca gjëra, ë?! Bukur, bukur! Si e quanin, si? Hektor Veshi? Po i kujt është ky? Si s'e keni vënë re më parë...»

«Si, more, i biri i Zeqir Veshit qenke ti? O, sa m'u bë qejfi kur po flisje. Zeqiri i shkretë! Po ti vazhdo, vazhdo... s'të shkon kot kjo punë, Mirë?!!» i pati thënë pas një mbledhjeje të tillë një shok nga rrathi.

Në qytet filluan ta mbanin më afër, madje në shëtitjen e mbrëmjes e kishin parë të bisedonte me kuadrot kryesorë.

Pas kësaj ishte e natyrshme t'i zbutë ca diskutimet, u bë më i shtruar dhe, ata që e ndiqnin me vëmendje ndryshimin e tij, po bindeshim përsëri se Hektor Veshi ishte jo vetëm njeri i fjalës, por edhe i zgjuar.

— Prapë minj sot! Eh, djajtë e zinj! Po ç'i sjell te çanta ime, xhanëm? — tha pa u ulur mirë Tomi Margariti. — Të shkojnë te Vasua, hajde de!

Pas Tomit ankohet edhe një tjetër e më pas edhe Vasoja.

— Mish ke Vaso?! — ngacmon Tomi Margiti, që s'lë rast pa sharë ata të tregtisë. Vëllai i Vasos punon banakier te pista.

— Të paktën mos flakni gjë! M'i lini mua, se i dua për qentë! — Tomi sikur lutet për t'i ngrënë vetë, aq butë i lëshon fjalët.

— Po unë ç'do ha, ë?

— Ku nuk hyjnë ata dreqër! — thotë për minjtë Tomi Margiti, duke e bindur përfundimisht tjetrin se ushqimi s'hahet më.

Ç'të bëjë tjetër Vaso Ligori? I afron çantën e vet. Tomi merr mishin, vezët e ziera, bukën, pastaj i jep Vasos djathë e domate nga të vëtat.

— Merr edhe një të prerë byrek nga unë, se mirë të bën! — i thotë Vasos Velo Mersini.

Tjetri e merr. Ka gjithë atë trup, që duhet ushqyer për të lëvizur për punë, po ç't'u bësh minjve!

— Hajde, hajde, se minjtë janë mbarësi kur u rrinë nëpër këmbë njerëzve, — qesh Tomi Margiti, — Minjtë, janë kudo në sipërfaqë, nën tokë, në anije, avion.

— S'na e bënë që s'na e bënë mensën këtu në sektor, — qahet ende Vasoja, pasi ka pirë edhe një litër ujë nga bidoni.

— Na e dha fjalën Hektor Veshi, — tha Tomi, po zëri këtë radhë s'pati asnje ngjyrë.

— Fjalën na e kanë dhënë edhe të tjerët, po, sapo hyjmë nën tokë, na harrojnë! Si e si të kënaqin veten, për këtë mendojnë dhe çuditën pastaj kur i rrëzon karrigia.

— Për Hektorin the ashtu, o Vaso?

Tjetri nuk bëri zë. Sikur kërkoi që të tjerët të mos ia merrnin ashtu siç i dëgjuan ato fjalët pak më parë.

Mbarojnë së ngrëni e ngrihen një nga një. Vasoja ecën gjithnjë i përkulur, se është shumë i gjatë. Ty duhet të të paguhet edhe vështirësi për gjatësinë, e ngacmojnë, por ai nuk bën zë, madje as atëherë kur e pyesin nëse do ta bëjë arkivolin të gjatë, aq sa është, apo do të vendoset në dy arkivolë. I shëndetshëm siç është, as që i shkon ndër mend vdekja. Ç'punë ka ajo me të? Po i çahet hunda për cigare, po përton të ngjitet deri në sipërfaqe. Për të larguar mendjen, fillon punën. Muajin tjetër do të shkojë në det, me një fletë kampi të dhënë falas, si punëtor i pararojës. Bashkë me Tomi Margitin. Siç kishte dëgjuar Vasoja, do vinte me ta edhe Hektor Veshi.

— Hektori në kamp?! — pyeti Tomi. — Apo do bëjë muajin e mjaltit atje?!

— E ç'ka këtu për të qeshur, — tha Vasoja.

— Ti e di që unë qesh me vete pa qenë budalla! — sqaroi tjetri.

Në shtëpinë e pushimit të punëtorëve Tomi Margiti do të nxirrte të vërtetën, e minjve që gjoja ngacmuan çantat e bukës. Minj s'kishte pasur kurrë! Ai, Tomi, pati çukitur atë ditë çantat më të majme dhe pastaj kishte dhënë alarmin: «Minjtë, ej! Minjtë na kanë brejtur çantat, Ushqimet mos i flakni... i dua për qentë e gjahut!»

V

— Kishin përplasur këmbët në zyrën e kryeinixhinerit. Kur arrita unë, atje po shkruhej pyetja e trembëdhjetë, për të cilat ata të ekipit kërkonin përgjigje. E pashë se kryeinixhineri e kishte humbur fare. I erdhi çehrja kur hyra unë, po ku pyesnin ata të ekipit!

Hektor Veshi, që para pak kohe ishte ngarkuar me detyrën e kryetarit të bashkimeve profesionale, po u tregonte një grupi njerëzish, përrpara drejtorisë së minierës, se ç'u pati ndodhur me ata të ekipit.

— Sidomos njëri prej tyre po bëhej i padurueshëm. Pyeste me zë të lartë, me një nënqeshje, që e mbante në anët e buzëve, si cigare të ndezur. Mezi i linte kohë kryeinixhinerit të shënonte. Kërkonte të dukej përrpara kolegëve të vet dhe neve të tjerëve. Ju kapa, apo jo, ju

mbërtheva që në fillim, donte të thoshte ashtu.

Unë s'po bëja zë, sado që kryeinxhinieri një a dy herë u gëlltit duke parë në drejtimin tim. Po tamam kur ai më zevzeku i ekipit tha se edhe vetëm katër pyetje do të shtonte dhe përfundonte, ndërhyra, u prezantova cili isha dhe me zë të fortë e të prerë thashë se një pjese të pyetjeve mund t'u përgjigjeshim atje, te Velo Mersini.

Ata të ekipit nuk e kishin dëgjuar kurrë emrin e Velos, as e dinin që ishte minator te lla-va lindore, Kthyen kokën nga kryeinxhinieri. Këtij as që i shkoi mendja se ç'do bëja unë, por, meqë vetë s'do gjente rrugëdalje për njëqind vjet, e la timonin këjt në duart e mia.

Ti përgjigju pyetjeve që mund t'u përgjigjesh, i thashë, kur mora vesh se ai zevzeku i tyre pati mbaruar për bujqësi e jo për miniera. «Për përgjigjet e tjera shkojmë te Velo Mersini!»

Duke dashur t'i qetësoja shokët e ekipit, thashë se jo çdo përgjigje mund të merrret e saktë, e plotë, në zyrën e kryeinxhinierit. Duke mos i bërë të gjitha punët e ndërmarrjes vëtëm, ai s'ka se si të përgjigjet vetë për të gjitha hollësitë. Një zyrë, vetëm një zyrë mbetet, i thashë duke qeshur atij cinxrit që nuk pushonte.

Paskëtaj nuk bëri më zë. Kushedi ç'e mendoi Velo Mersinin. Ndjonjë sekretar a kryetar a... ai vetë e di!

Nga rruga kryesore i nxora prapa kinema-

së. Kur pa ku po i çoja, kryeinxinierit njëra fytyrë i vinte pa i ikur tjetra. Ç'na solle këtu, prapë në zyrë na fute? Po ne në zyrë ishim atje! Hajde bëj hall me ta tani, mendonte me siguri. Po nuk foli fare me zë. Ishte bërë meit kur hapa derën e zyrës së kryetarit të bashkimeve profesionale dhe hymë brenda.

Nuk erdhëm për t'u ulur, u thashë i vendosur. Prisni një minutë!

Hapa dollapin e madh e prej andej nxora aq komplete rrobash nëntoke, sa ishin ata të ekipit. Çizme, kominoshe, kapele. Llambat do të na i jatin atje, në minierë, thashë duke parë nga ai cinxuri, që tani kishte pushuar. Prit, prit se e ka mbrapa zjarrin ky tym, mendova tek e pashë të bëhej kruspull.

U vesha edhe vetë, shpejt e shpejt e dola në korridor.

Dy prej tyre s'e fshehën që kishin kureshtje për minierën, kurse cinxoja nisi të djer sinte. Po mbrapa s'kthehej dot më.

Kryeinxinieri edhe qeshte edhe dridhej. Po kur ta marrin vesh cili është Velo Mersini, vazhdonte avazin e vet.

Rri, ore gallof! Ore llupo! Rri, ore, urtë, i thosha. Rri e shiko ç'do vejë!

Në sektor morëm llamba të gjithë, vura përgjegjësin e sektorit përpara dhe... Te Vella, i thashë. Te Velo Mersini duan të shkojnë këta shokët.

Pas shokëve të ekipit unë e pas, meje vin-

te kryeinixhinieri; zbritën nga rrugëdalja. Jo me ashensor. Ashensori është në punë në këtë orë, u thamë. Do zbresim me këmbë.

Galeria kishte pak ujë, sa për t'u bërë e rrëshqitshmë, por ata e kuptuan mirë porosinë tonë që të mbaheshin fort në parmakët e vendosur anash.

Boll deri këtu t'i kthjemë, më tha kryeinixhinieri kur zbritëm në fund të nivitet të parë, por unë u kisha dhënë fjalën t'i çoja te Velo Mersini.

Shokët e ekipit ecnin nën tokë të urtë, si delet. Duke nxituar pas përgjegjësit të sektorit, i përplasnin herë pas here kokat tek armatura e galerivë. Një herë njëri prej tyre u përplas aq fort e papritur, sa ra menjëherë në të ndenjura.

Kaluam nëpër një galeri ajimi që shërbente për rrugëdalje të dytë dhe ecën nja pësëmbëdhjetë metra gjunjazi e nja dhjetë metra pothuaj barkazi.

Ja, kështu na duhet të ecim neve punëtorëve dhe kuadrove në minierë, i thashë atij zevzekut, që rrinte në errësirën e galerisë, të ndriçuar jo aq mirë nga llambat, si një fëmijë që del për herë të parë në një natë me hënë e yje të largëta. Bile ndonjëherë marrim edhe ndonjë shtyllë druri duke e têrhequr zvarrë, i thashë.

Aty ku pritëm të bëheshin minat, armatura e thyer në meset e drurëve na trembte ne

që e dimë nëntokën e jo ata! T'i shikoje si rrinin, si pula të trembura e të lagura.

Keni ndonjë pyetje tjetër, doja t'u thosha. Po ç't'u bije më, në qafë. Isha i sigurt se, po të bërtitje ose të klithje papritur, aty afër, ndokujt prej tyre mund t'i binte të fikët. Njëri prej tyre nuk ishte aspak shtirak. S'e fshih-te drujtjen, ndjenjën e lehtë të frikës, madje bënte vetë shaka për këto. Kishte krahë të gjatë, duart i varesin gjer poshtë gjunjëve, dhe gishtat e gjatë e të bukur kishin marrë ca bal-të e pluhur duke u mbajtur. Tjetri, më i hesh-turi, pati punuar vetëm dy muaj, vite më parë, në një minierë sipërfaqësore, po me një ndërhyrje, të cilën ai e quante «proces njojje», ishte transferuar në kryeqytet. I treti, ai që kishte mbaruar për bujqësi e s'dimë pse e kishin sjellë në këtë ekip, nën tokë ishte çuditërisht më i sjellshmi, më i binduri tanë. Do ecim edhe më? më pyeti mua. Edhe ca, i thashë, po ti mos ki merak, s'ka rrezik she-mbjeje këtu! Jo!... Mirë, mirë! tha pa kuptim ai.

Plasën minat, pritëm edhe pak, sa të binte pluhuri i qomyrit, dhe hymë në llavë.

Ja tek e keni Velë Mersinin u thashë. Vëlos i bëra shenjë që të bënte ndonjë nga ato qyfyret që di të bëjë ai, por, sapo mori vesh që ishin ekip kontrolli e ndihme, ai u soll sikur t'i kishin ardhur në shtëpinë e tij. U foli për punën, për vështirësitë, ... për detyrën.,

kurrë nuk jemi turpëruar, u tha. Por unë e shihja që vetëm njëri prej tyre po e dëgjon-te. I dyti herë pas here hidhte sytë nga tavani i llavës, ku vazhdonin të binin copëra qomyri, kurse i treti, zevzeku i zyrës, kishte mbetur pa gojë, pa veshë, pa... mend. As u shkoi ndër mend ta pyesnin për gjë Velo Mersinin.

Zbritëm nga llava duke rrëshqitur mbi qymyrin e rrëzuar nga minat. Mbi fytyrat e rrobat e të gjithëve kishte rënë goxha pluhur.

Atje poshtë na prisnin vagonistët. Shokët e ekipit u dhanë dorën të gjithëve. Një prej tyre pyeti mos kishin lënë ndonjë punëtor pa i dhënë dorën. Nga ky merak, tërë pluhur, siç ishin, duke mos e njojur dot shoku-shokun, i dhanë dorën edhe njëri-tjetrit.

Kur ua tregova këtë, filluan të qeshin me vete, po u thoshte Hektor Veshi grupit të njerëzve që po e dëgjonin aty, përpara drejtorisë së minierës.

Ky Hektori është djall, djalli vetë është, si me dorë i rregullon fjalët, thoshte dikush nga njerëzit që kishin dëgjuar Hektor Veshin.

Sa për fjalët, po!... shtoi dikush me zë të ulët. Ishte Vili Haruni.

E po si i thonë asaj fjalës, po s'qe i zoti të vjelësh mollët, zbrit poshtë e mbart koshat! Hektori s'i vjel keq pemët. Si përgjegjës i mekanikës s'ka punuar keq.

E, e! Sikur s'e di Vilin ti! Për mua, po pati

hyrë nën tokë njeriu, punëtor është që ç'ke me të. I kishe veshët në vend, ti, Vili, apo jo? Një orë hynë në minierë ata të ekipit dhe s'e hapën më gojën.

VI

Një ditë marsi, pas disa netve pa gjumë, gjatë të cilave ajo e shante dhe e mburrte Hektorin, kërkonte të mirat dhe dobësitë e tij, thoshte «po» ose «jo», «unë s'bëhem dot gruaja e tij», një ditë marsi, pra, kur ishte çuar nga shtrati, i cili tani kishte filluar t'i dukej tmerësisht i madh e mundues, me vetminë e tij të pafund, pati shkuar ashtu, me veshjen e gjumit, përpara pasqyrës, i ishte afruar aq shumë homologes së vet të qelqtë, sa fryma e kishte mjegulluar tjetrën. Pasi e pastroi xhamin, i nxori gjuhën Mirjanës tjetër, disa hehë, si një fëmijë i përkëdhelur dhe i foli sikur kërkonte të tallej me të: Mos e zgjat, Mirjana! Kupton, mos e zgjat!

Më duhet të blej një këmishë tjetër, tha me vëte, duke parë ronitjen e asaj që kishte vëshur. Eci me sy mbyllur nga para pasqyrës deri në shtrat duke dashur të mos e prishte imazhin që i mbeti nga vëzhgimi i trupit të vet. Budallaçkë, i tha vetes duke kujtar, përtë nëntëdhjetenëntë herë se në orën njëmbëdhjetë të mbrëmjes, kur të dilte nga llabisteria, do ta priste Hektori.

Në të vërtetë, atë ditë marsi të ngrohtë Hektori pati ardhur një çerek ore më shpejt.

Mirjanës iu duk e quditshme, madje sepse iu qesh kur e pa të veshur me rrobat më të mira.

Pse erdhe kështu?! pati pyetur ajo.

Si kështu, kishte qeshur ai lehtë, si me druajtje, se mos ajo zemërohej edhe e largonte.

Mirë, pra... hesht! Më prit ca më tej!

Hektori ishte bindur si fëmijë. Ishte languard ca më tej duke dëgjuar të qeshurën e Robertës në llambisteri. Kushedi ç'thonë për mua!

Kur filluan të ecnin, ajo e pyeti përsëri përse pati ardhur me rroba të reja.

Vij nga mbledhja, i kishte thënë Hektori, më bënë kryetar!

Kryetar të grave?! kishte pyetur ajo, e pakënaqur nga nxitimi i tij për t'i dhënë lajmin.

Jo, kryetar të punëtorëve, kishte bërë humor edhe ai, me një zë që Mirjanës iu duk i butë, i kujdeshëm, madje ca i ëmbël.

Ti qorton kot, i tha vetes. Në vend që të gëzohesh që je ti që lajmërohesh e para... Qeshi përsëri kur mendoi se ai kishte ardhur me rroba të reja.

Në të vërtetë ajo mbeti edhe si dita e fejesës sonë, i thanë tre muaj më vonë njëri-tjetrit. Meqë njerëzit e Mirjanës kishin qenë kategorikisht kundër kësaj lidhjeje me djalin e Zeqir Veshit, s'ishte bërë asnë ceremoni rasti.

Atë natë ti u tregove i sjellshëm, e ngacmonte ajo më vonë.

Përse të nxitohesha? S'kaluan as dhjetë minuta dhe ti m'u afrove vetë.

Ah! Po kalonim pranë kishës dhe mua më erdhi frikë atëherë.

Pothuaj gjithë pranverën e bënë të vëtëm këtë rrugë. Punëtorët lëviznin me makinat e minierës.

Në qershor, kur u martuan, shkuan fajtorë, kokulur, si fëmijë, në shtratin e martesës, se s'u kishte mbetur më asnjë hir i panjohur i saj.

Mirjana u shtri e para dhe pas pak ndjeu pas trupit gjymtyrët e tij. I kundërshtoi çdo përkëdhelje aty dhe as Hektori nuk këmbënguli. Një lloj ndëshkimi dhe faljeje që i dhuaronin njëri-tjetrit, të penduar për një veprim që edhe tani nuk kishin përsë të mos e quanin të bukur, paçka se me po aq të drejtë, s'mund të mos e vlerësonin, heshturazi, si të qortueshëm.

Pas pak ai nisi të luante me flokët e saj të gështenjtë, të gjatë gjer pranë mesit, të butë si kadife; vazhdoi gjatë me këtë lodër e kur u kujtua se kjo nuk shkonte si lodër përditën e dasmës (eh, ç'dasmë, pa!), hodhi dorën drejt fytyrës së Mirjanës, që nuk po ndihet fare. Ndoshëta e pati marrë gjumi. Kur gishtat e dorës po arrinin te faqet e saj, ndien lagien...

— Po qaka kjo! Mira! Mirjana! — e ngriti zérin ai, duke e ngritur përgjysmë, gati si i trembur, si pas një èndrrë të frikshme. E quajti llaçkë, tòrollake, fëmijë, e ç'i erdhi tjetër në gojë, ca sharje-përkëdhelje e ca përkëdhelje-sharje, e ktheu me forcë me ftyrë nga vetja e, mes të puthurave, të njomura edhe këto nga lotët, e pyeti përsë qantë.

— I lashë të gjithë! Vetëm ty të kam tani, — dëgjoi fjalët e saj të pasuara nga gulçe të tjera lotësh..

— Më ke mua! Dhe unë, ti e di, vetëm ty të kam, dëgjon, Mira? As që na duhet njeri tjetër, as nga të tutë, as nga të mitë!

Vazhdoi ta puthte me vrull, pak si rreptë, pak si ashpër, si për ta bindur përfundimisht se e donte, se do ta donte, ja kështu, si i marrë, si tani, si këtë pranverë.

— Mjaft, Hektor, mjaft! Nuk kam forca më të kundërshtoj. Ma more frymën!

Mirjana i la në duart e tij krahët, gjoksi le të pushonte nga vërtitjet e tij prej pafajësisë së dashurisë, dhe ai le të bënte ç'të donte me trupin e saj, që sikur vetëtinte nën këmishën e bardhë qumësht.

VII

Po të ndeshni në rrugët, në parqet, në plazhet apo... kudo, po të ndesheni me tre njerëz hokatarë të pashoqë, as fare mos dy-

shoni që të paktën njëri prej tyre është minator. Vetëm ata gjëzojnë privilegjin dhe mundësinë të tallen miqësisht, nga pak, me gjithçka.

— Ne hyjmë e dalim përditë në dhë... e si të mos tallemi, si të mos bëjmë shaka? — thotë duke qeshur Tomi Margiti, «brejtësi» i çantave të bukës (gjerfa u bë mensa e sektoirit). Vështirësitë, rreziqet, u shtojnë edhe humorin minatorëve, bashkë me një lloj monotonie në përballimin pa bujë të tyre.

Qysh ditën e parë, në shtëpinë e pushimit, Vaso Ligori u pagëzuat me një nofkë tjeter. Ai djall Tomi Margiti, me atë shpirtin e pangnjur për shaka, s'e quante dot jetë jetën e vet, po të mos bluante diçka në atë kokën e tij, që i ishte rrjepur, rrëgjuar e rrudhur qysh në moshës njëzetepesëvjeçare, s'e shijonte dot pushimin pa bërë të tjerët të shkriheshin në lot përreth tij. Dukej se ai provonte kënaqësinë e vet më të madhe kur mes këtyre tallazeve të së qeshurës rrinte si murg; jo vetëm nuk queshte vetë, por, përkundrazi, vrenjet e edhe më si i pakënaqur, si ata shkëmbinjtë e zinj në mes të detit.

Sekujt i pati thënë se Vason e quanin Monument. Priti që tjetri ta pyeste: «Me të vërtetë e quajnë Monument?!» dhe, me atë pamjen e vet, që shpërndante seriozitet për ata që nuk e njihnin, i tha se nuk ishte kala ma që të lëshonte fjalë kot.

Ditën tjetër, një pjesë e mirë e pushuesve e vështronin Vaso Ligorin siç vështrohet nga gratë një model i ri dhomës së gjumit.

Përballë tryezës së rezervuar për minatorët, midis të tjerëve hante edhe një çift të sapomartuarish. Djali ishte mësues, kurse e shoqja edukatore fëmijësh. Nuk kishin mundur të siguronin dhomë dyshe. Flinin në kabina të ndryshme.

Gjynah! As plazhi nuk u hyn në sy, as gjezojnë dot. Pa dalin edhe ca malukatë e s'i lënë rehat, thoshte me vete Tomi Margiti. Në rërë, duke qëndruar shtrirë e symbyllur, kishte dëgjuar rastësisht dy djelmosha që flisnin për mësuesin dhe edukatoren. Sapo ngriheshin, në mëngjes herët, pas netve të kaluara në dhoma të ndryshme, vraponin diku larg kabinave, në një vend me shkurre. Aty futeshin, putheshin pa pushim për njëzet minuta a më tepër dhe pastaj, duke dihatur rëndë, me leshra të shprishura, thoshin djelmoshat që i përgjoni, pastaj...

Tomi Margiti nuk kishte duruar dot më, ishte ngritur dhe, ashtu siç dinte të shante ai, i kishte paralajmëruar se, po të provonin më të përgjonin të tjerët, do t'i ngordhët në dru, do t'i rrihte sa të mbushnin të brendshmet e të...

Pastaj kishte tërhequr mënjanë mësuesin dhe, duke i rënë larg e larg, për të mos e lë-

nduar, por edhe pér ta qortuar, pér ta bérë më tē kujdeshém, por edhe pér ta pérmbajtur ndjenjén e lëshuar tē tij, sikur përgjimi i djemve ishte i mundshém pér tē ndodhur dhe jo tē kishte ndodhur, e mbylli bisedën edhe me tē.

Nga ajo ditë tē sapomartuarit përshëndetnin jo vetëm Tomin, por edhe Vason e madje edhe Hektor Veshin, që rrallë rrinte me ta.

VIII

Tomi Margiti, duke u përpjekur tē mos ndesheshtë në vështrimin e tyre, hëngri pothuaj kokulur disa ditë rresht.

Një drekë, në mensë, ndjeu prekjen e krahut tē Vasos.

— Ç'ka ajo edukatorja që s'po na i ndan sytë? — pyeti Vasoja.

— Ka rënë në sevda me surratin tënd!

— Thuaj jo, po deshe!

Pas pak Tomi pa se ajo vështronte me tē vërtetë në atë drejtim. Madje sikur i pësh-përiti diçka tē shoqit, që sepse e kundërshton-te pa pushim.

Ej, dreq! Mos ka ngatërruar gjë ky djall», tha me vete Tomi Margiti duke menduar Vason.

— Shiko, u ngrit, — tha Vasoja, duke i prekur përsëri bërrylin Tomit, — e la lugën!

— Mos ke ngrënë mut gjë me gojë ti?

— Po vjen drejt tryezës sonë, — tha prapë Vaso Ligori. — U ngrit nga buka.

E kishte ngritur kokën edhe Tomi Margiti. Tri tryeza më tej ndërpreu të ngrënën edhe Hektor Veshi, kurse Mirjana po gjerbte kokulur.

Gruaja e mësuesit qëndroi përpara Tomi Margitit, tha «më falni» dhe zëulët shtoi:

— Dua t'ju pyes për diçka! — Ajo priti reagimin pozitiv të Tomit dhe pyeti:

— Me të vërtetë atë shokun tuaj (ajo bëri me kokë nga Vasoja) e quajnë Monument?

Tomi i tha me vete «mushkonjë budallaqe», «mjerë ata fëmijë që edukohen nga ti, «qenka hero ai që të mbaka për grua ty», kurse me zë i tha se jo vetëm ajo që kishte dëgjuar ishte e vërtetë, pra që Vasoja quhej Monument, por ai sapo ishte propozuar për t'u dekoruar me titullin e lartë të Heroit të Punës Socialiste.

Kur po kthehej te mësuesi, i cili ishte bërë i kuq në fytyrë, Tomi tha me zë të ulët se kishte të drejtë që ushqente antipati për njerëzit e bukur, me kokë të vogël.

Pas pak minutash ata bënë sikur e mbaruan të ngrënën dhe dolën të dy jashtë men-sës. Mësuesi dy-tre hapa përpara.

Tami Margiti i ndoqi pas, edhe pse e dinte se Hektor Veshi do të shqetësohej edhe më prej këtij veprimi. E po ne nuk jemi në kopsht fëmijësh me drekë, tha për të qetësuar veten.

Mësuesi, duke e têrhequr gruan e vet lehtë pér krahu, por si në një shëtitje të shpejtë, e kaloi pas një ndërtese. Kushdo që do t'i shihte, edhe pa ditur aq sa dinte Tomi, do të kuptonte se nuk po vidheshin pér dashuri.

Ajo që priste Tomi ndodhi. U dëgjua përplasja e një pëllëmbe. Në faqen e edukatores, mendoi. Po mirë t'i bëhet, e kishte hak.

Në mbrëmje ata dukeshin të qetë fare.

Tomi i përshëndeti i pari. U tregoi se s'quhej Monument, por Vaso Ligori, se ndoshta nuk do të dekorohet kurrë, edhe pse si njeri s'ishte i keq.

Vonë, pas mbrëmjes, u erdhi në dhomë Hektor Veshi, turivarur, dhe është që nuk do ta shihnin me sy këtë shtëpi pushimi herë tjetër. Mos e prish gojën kot, o kryetar, iu përgjigj Tomi serioz.

— Të paktën sa të jem unë, jo, — përsëriti Hektor Veshi.

— Ty të paçim sa malet, po në kamp ne do vijmë prapë! — tha shtruar-shtruar Tomi Margiti.

Hektori doli pa thënë as natën e mirë.

— I têrheqin veshin atij po ndodhi gjë, — tha Tomi Margiti kur dera e dhomës ende nuk ishte myllur pas të ikurit.

— The gjë? — pyeti duke u kthyer kryetari i bashkimeve profesionale. Natyrisht që i pati dëgjuar fjalët e Tomit.

— Thashë. Thashë që ne nuk kemi ardhur

në kopsht me drekë këtu. Ja, kaq gjë thashë,
— u përgjigj ky.

— Të kam ditur burrë me mend.

— I ri jam! Kam kohë të piqem! — qeshi
Tomi Margiti dyzetekatërvjeçar.

IX

Fitim Gomushka, me ca flokë kokoridhka, të gështenjtë, me dy sy pa ngjyrë, pa lëng, që s'merrej vesh si dukeshin të shndritshëm, me një kokë të vogël që ndoshta torturohe; shumë për të mbajtur prapësirat që mendoante i zoti, ky njeri, pra, që për ditë të tëra kishte bërë ç'ishte e mundur të ndodhej i vetëm me Gani Elezin e sapoardhur në minierë, e kishte gjetur këtë çast nën tokë, në gjysmerrësirë.

Me një fryshtësuarje të shpejtë, por që diku pengohej, e kishte pyetur:

— O Gano, më qafsh, a nuk më thua, pse nuk e gëzove dot deri në fund zyrën që kishe?

Gani Elezi apo kishte humbur zyrën ato kohë. Ende besonte se kot ishin mbrehur me të. Ç'punë kisha unë me burokratët, donte t'i thoshte dikujt. Por, apo të shfrente me njërin, natyrisht do ta merrnin vesh të gjithë.

Më mori lapsi për poshtë dhe ja ku më keni, por... ç'punë kam unë me burokracinë? Ja, kaq donte t'u thoshte, por... Fitim Gomushka nuk ia mbushte synë për këtë qëllim,

Ca i parruar, siç rrinte gjithnjë, me leshra të dala përbimi xhup, me llambën e kapur me një dorë tërë damarë e baltë, Fitim Gomushka e trembi me pamjen e tij.

Solli ndër mend fjalët që pati dëgjuar se Fitimi merrej me shitjen e blerjen e kafshëve të dorës dhe të kafshëve për mish, pa dy sytë e tij të vegjël të rrëgjuar edhe më dhe vendosi që të mos i thoshte asgjë, nga ato që mendonte në të vërtetë e që dikujt do të donte t'ia thoshte.

Pas Fitimit e kishin pyetur edhe të tjerë. midis tyre nuk mungonin kureshtarët, po prijen për ta afruar e kishin njerëzit me klekë, me hije, ata që kishin nevojë urgjente derdhjen e ndjesive të grumbulluara me te-pri në vete dhe njerëz të tjerë, të pakënaqur të përkohshëm, sezonalë, madje ditorë. Në këta të fundit kishte njerëz që ishin grindur me shefat apo që u ishte bërë hile nga komisioni për ndarjen e pallatave të banimit. E dimë, or vëlla, e dimë, kështu e kanë këto punë, e hidhnin urën e afrimit në bisedë ata, po, duke mos i njohur, në fillim, Gani u bëri zë, duke i lënë të habitur.

Fitim Gomushka e kapi përsëri pas disa kohësh, pikërisht atëherë kur Gani Elezi, si padashur, po ndiente rolin mpirës të harresës për atë që kishte ndodhur.

— Nuk ma the, o Gani, kush ta hëngri kokën atje ku ishe?

«Ç'ka ky me mua, pyeti veten Gani Elezi. Apo kot, meqë nuk iu përgjigja dikur? Apo se e keqja e kërkon të keqen, se e vetme nuk bën dot në jetë?»

Në gjithë këto kohë pati dëgjuar jo pak për Fitimin, dhe pas kësaj i ishte tretur edhe pikë më e fundit e dëshirës për t'u qarë përpara këtyre njerëzve si ai, që ia provokonin këtë gjendje.

— Sa e bleve mëshqerrën që bëre mish?
— e pyeti Ganiu, sikur ta pranonte kompromisin e ofruar. Kjo do të thoshte se, për t'i treguar Fitimit diçka (kush ia hëngri kokën në zyrat!), duhej më parë që Fitimi të tregonte diçka, një dobësi të vetën, diçka që do të ishte e barazvlefshme me ato që do të dëgjonte nga Ganiu.

— Asnjë lek! Për be, asnjë lek! E zhvata në një fshat, e ushqeva dy muaj nën dhë, në një haur poshtë kasolles sime, pastaj e solla këtu në minierë. Mish për aleatët e fshatarëve.

Në dritën e llambës, që herë pas here, nga lëvizjet e dorës së tij, i binte në fytyrë sytë i kuqëlonin si të qenve.

— Po domatet e freskëta që na sjell?...
— Edhe ato, edhe dardhat, edhe fiqtë, nga prona e përbashkët i kam marrë. Po pa më thuaj ti, o Gano, kush ta bëri varrin ty, që erdhe këtu tek unë? Apo ndonjë nga këta që

duan tē bëjnë përpjetë, si puna e Hektor Veshit, ë?

X

Nga ajo kohë edhe vjetët ishin bërë tē shumtë, po dita e parë mbahej mend si e djeshmja.

Ganiu pati ardhur me xhaketë, triko, këmishë, se dimër ishte. Nën tokë e hoqi xhaketen por, kur filloi punë, ndjeu vapë, hoqi edhe trikon dhe pas një gjysmë ore edhe këmishën.

— Hiqe edhe atë! — i tha Velo Mersini për kanotierën e pastër, tē sapoblerë, por ai nuk e hoqi. Ajo u nxi dalëngadalë nga pluhuri i qymyrit që binte. Pastaj filloi tē fshintë edhe vetë djersët te fundi i kanotierës.

Pas dy orësh punë me lopatë i ishin skurq duart, te mollëzat e te shputat, dhe prapë ai nuk kishte bërë zë.

Flluskat kishin filluar tē pëlcitnin dhe nuk mund tē mbante dot më bishtin e lopatës.

— Rri atje, ulu! — e kishte urdhëruar Velo Mersini, duke i treguar një qoshkë. Nuk e kishte lënë tē punonte më atë ditë.

Më vonë Ganiu punoi si kalë; në fillim se ashtu duhej tē bënte, se nuk donte kurrë që ta merrnin me sy tē keq aty, ku do tē kalonte gjithë pjesën e mbetur tē jetës.

Pasi arriti ta fitonte këtë mendim të mirë të tyre, si punëtor, as që shkoi ndër mend ta ulte vrullin e t'i shmangej punës, se ajo i ishte bërë tani nevojë.

Megjithëqë nuk e ndiente më vëmendjen e njerëzve ndaj tij, si më parë, prapë mendonte se, po të mos kishte punuar ashtu si punoi, edhe ata nuk do të kishin mbajtur këtë qëndrim.

Prandaj u çudit kur një ditë, pas disa vjetve punë, Hektor Veshi i bashkimeve profesionale, përpara dy ndërresave, në një analizë pune u përmendi për punën e palodhur që bënte.

«Ç'ngatërrohesh kot me emrin tim, donte t'i thoshte Hektorit, apo do t'i hapësh telashe vetes?!»

Gjatë gjithë mbledhjes ai nuk mendoi tjetër gjë rrëth kësaj ndodhje. Ç'do të thoshte kjo? Ishte e vërtetë se në punë mund të lavdëroheshin të gjithë, por jo unë, unë jam tjetër, thoshte ai me vete.

Me cep të syrit, ose duke kthyer kokën si padashur, rastësisht, anash e mbrapa, u përpoq të vinte re reagimin e të tjerëve. Do të pranonin ata që ai, i shkarkuari në fushatën e madhe kundër burokracisë, të lavdërohej si punëtor i palodhur?

Kur po ngriheshin në këmbë e po dilnin nga salla e mbledhjes, ai u tall me merakun e vet të kotë. «Qyqari ti, i tha vetes, sikur të dekoruan! Për punë krahu të lëvduan, jo pér surratin tënd të bukur!»

Në makinën e ndërresës, kur shkonin në shtëpi, Mezan Nazemi, që i ishte ulur njitur, i pati afruar gojën te veshi dhe i pati pëshpëritur duke i shkelur syrin në mënyrë intime: «Mirë, ë?!» dhe pati qeshur me ata dhëmbët si kokrra orizi poshtë mustaqeve të kultivara në formën e një trapezi dybrinjënjëshëm. Pastaj ai u afrua përsëri te po ai vesh dhe me po atë buzëqeshje orizore i tha: «E shikon se po punove s'ta ha njeri hakun, kushdo qofsh ti!»

Mezani e kishte goditur lehtë me pëllëmbën e tij të vogël e të trashë te gjunjët, si ta përkëdhelte, po Gani Elezi ndihej sikur ta kishte goditur dikush në kokë.

Më mirë të mos ia kishin zënë emrin në gojë fare. Do të kishte qenë rehat ashtu. Ishte mësuar me jetën e qetë që po bënte, me marrëdhëni e vendosura me njerëzit dhe ja ku kjo qetësi ishte prishur nga një fjalë e thënë aq thjesht, si pa të keq, madje pér të mirë.

Por erdhën ditë të tjera që dyshimi, mos e mira padashur shndërrohej në të keqe nga e shkuara e tij, të binte dalëngadalë, të precipitonte në fund të enës së turbulluar nga Mezan Nazemi.

E lavdëruan edhe në analiza të tjera, ia shkruan emrin midis të dalluarve në tabelën e emulacionit dhe ai u ndie edhe më ngushtë kur e dëgjoi, në orët e mbrëmjes, kur shëtitorja ishte plot, emrin e vet nga qendra e zërit e shtëpisë së kulturës.

Mezani i sillej gjithnjë njëlloj dhe kjo mbeti torturuese për Gani Elezin deri një ditë, kur kjo ndjenjë nisi të shndërrohej në një humor të veçantë, që ishte përzierje e së qeshurës me habinë se përse ky njeri i shkaktonte bezdi, dhimbje, shqetësimë kot fare, pa interes, si për sport.

Atë ditë ishin diskutuar në kolektiv se cila nga dy kandidaturat e mundshme do të pranohej për të ndjekur një kurs kualifikimi profesional.

Ishte ngritur Mezan Nazemi dhe, duke mbetur brenda natyrës së vet, pati kërkuar të peshoheshin si në balancën e farmacisë biografitë e të dy kandidatëve, edhe pse qysh në fillim të diskutimit ishte thënë se të dy kandidatët ishin komunistë.

— Ju nuk keni të drejtë të mos e merrni parasysh propozimin tim, — tha Mezan Nazemi në mes të të qeshurave të rastit, po në s'duhet të harrojmë se, si çdo gjë, edhe biografitë e njerëzve lëvizin, ndryshojnë, pasurohen ose varfërohen dhe këto në çdo rast duhen verifikuar, ndryshe...

Pas kësaj Gani Elezi nuk i druhej më.

Atëherë forcoi mendimin, s'di se ku të dëgjuar, se njeriu, për të siguruar qetësinë e vet, s'e ka të domosdoshëm mirëkuptimin me çdonjërin prej njerëzve që e rrrethojnë; kryesorja është njohja e vetes dhe njohja e tyre e vërtetë.

XII

Pas shtatë orësh Vaso Ligorit iu qetësuau dhimbjet. Pothuaj, të gjithë ishin bindur, të detyruar, se krahu i tij nuk mund të shpëtohej.

Dy shkëmbinj, me përmasa të mëdha, të palëvizshëm, të pamënjanueshëm e shtrëngonin dorën e tij si dy dara që nuk mund të hapen përsëri. Vasoja nuk ndihej më. Ç'kishte për të thënë, e tha:

«E kam vetë fajin. S'ma ka njeri. U bëra tamahqar. Vajta e ngacmova në vend me irrezik, ja këtu, mes dy shkëmbinjve. E kam vëtë...»

Këtë e përsëriti disa herë. Kur erdhën e gjetën minatorët e tjerë, kur erdhë inxhinieri i sektorit, pastaj prapë kur erdhën nga drejtoria, dhe më në fund, me zë të lodhur, gati në të ngjirur, kur erdhë Hektor Veshi, kryetari i bashkimeve profesionale të minierës.

Pas një heshtjeje të zgjatur kërkoi ta linin pak minuta vetëm. Mjekët nuk e pranuan këtë

kërkësë. Me ata u bashkuan edhe shumë të tjerrë. Dikush tha që të mos e linin vetëm, por t'i fshiheshin syrit të tij, t'i qëndronin diku pranë, pa e ditur ai. Po të kishte ndër mend ndonjë veprim ndaj vetes (mjekët nuk e përjashtonin një gjë të tillë), ta ndalonin.

— Ikn! Të gjithë! Do të rri unë! — tha prerë Velo Mersini kokulur.

— Do të rrimë të dy! — shtoi Hektor Veshi.

— Edhe ti do të ikësh, o kryetar! E di unë pse duhet të rrrijë vetëm Vaso Ligori. — Vetëm unë, thoshte heshtja e Velos.

U larguan të gjithë. Hektor Veshi s'po lëvizte. Velo Mersini iu afrua pranë, këtë e vunë re të gjithë; pastaj panë që, pas dy-tri fjalëve me zë të ulët të Velos, Hektor Veshi u çapit pas të tjerëve.

I ngjanin një turmë të lodhurish që iknin prej një vendi ku do të ndodhët diçka e pa-përfytyrueshme, me përmasa të panjohura, e cila s'duhej të ndodhët në prani të tyre.

Pas linin një njeri të lidhur në mënyrë të çuditshme, të pashkëputshme, i cili pak nga pak ishte ngjitur nga fjalët që i thoshte e ato që nuk arrinte t'i nxirrte dot, nga lagështira që i vinte prej krahut të kapur.

Të gjithë, edhe ai vetë, ishin bindur me kohë që atë nuk mund ta ndihmonin dot. Asnjëri prej atyre që po iknin pak metra më tej. As Velo Mersini, që nuk iu largua. Të ikurit më tej pri-

tën gjersa u dëgjua zëri i Velo Mersinit. Ai tha vetëm «hajdeni!». Vetëm një herë.

Atëherë Hektor Veshi tregoi se ç'i kishte thënë në vesh Veloja pak minuta më parë, që edhe ai pati pranuar të largohej.

— Ai do të qajë, më kupton? Do të shfrejë, i vetëm fare. Ja, po rri edhe unë... por askush tjetër, ik, Hektor! S'bën të rrish këtu ti!

U kthyen të gjithë dhe, sado që përpjekjet e Vaso Ligorit për të fshehur lotët ishin pothuaj të frytshme, nuk kishin mundur të qenë të tilla ato të Velo Mersinit.

— Priteni krahun! — foli Vaso Ligori prapë. Për krahun e vet thoshte. Dhe e dëgjuan të gjithë. — Ju them unë ta prisni! — tha prapë ai, sikur ta dinte se midis tyre ishte folur për këtë gjë dhe ata nuk vendosnin dot pa fjalën e tij.

— Kush na siguron se s'do të ketë shembje të mëtejshme? Duhet shpëtuar jeta apo krahun?

— Sikur vetëm një centimetër të hapet boshillëk midis shkëmbinjve, dora del e plotë. Po hë, de, kush i largon këta shkëmbinj një centimetër nga njëri-tjetri?

Në sytë e Vaso Ligorit shfaqej dëshira e pamjaftueshme për të ikur. Një ikje. Vetëm ikje. Tani që të ikurit e vërtetë, të ikurit e plotë, me të gjitha gjymtyrët, ishte e pamundur...

«Vetë e ke fajin, i thosh vetes, u bëre makut sot për kokrrën e lekut. T'u vesh syri, as rrezikun që të kërkonte kokën nuk e pe. Mirë të gjeti! Vete e ngatërron dynjanë, pale!»

Paskëtaj ishte më i qetë. Trupi dhe koka po i bindeshin krahut të zënë peng, po mpitheshin pak nga pak si ai. Buzët, të kafshuara, skuqnin.

— Pse s'e prisni? Prejeni dhe shpëtojmë!

«Jo, jo!» ia bën më shumë me vete dikush që e dëgjon Vason duke thënë kështu.

— Po, po, do ta presim! — tha Hektor Veshi.

— Jo, jo, — bëri prapë Tomi Margiti.

— Duhet! Ai është i fortë, — tha prapë Hektori.

— Po është djalë, akoma i ri, se — ngriti zërin Velo Mersini për Tomi Margitin.

— Ne të mbajmë për burrë të fortë ty! Ti qenke grua!

— Atëherë, unë po iki!

— Udhë mbarë të qoftë! — sa nuk bërtiti Hektor Veshi.

Vasoja i sheh dhe i dëgjon të gjitha. Tani rri ulur. I kanë sajuar një stol druri e qëndron rehat në të. Po g'rehat, se!

— Pritja pa bërë asgjë është torturuese, por edhe të presësh krah njeriu...

— Prejeni! Filloni! Le ta mbajë mali krahun e këtij trimi, — tha i vendosur Hektor Veshi.

— Mua sesi m'u duk kur dëgjova që fliste ashtu, — tregonte Tomi Margiti më vonë, pasi e kishin nxjerrë Vason nga galeria. — M'u bë sikur bënte fjalë për një degë peme, të cilën e krasit dhe rritet prapë...

Mjekët filluan nga përgatitjet.

Filluan të largonin njerëzit që u ulën më tej, anës galerisë. Atje pritnin.

— Tani duhet duruar pak, — u dëgjua mjeku.

Pas pak minutash dëgjohet zëri i Vasos që shpërthen befas:

— Nxiton, dua të dal!

Zëri i tij përshkoi gjysmerrësirën e galerisë si shpend i plagosur që kërkon edhe ai të ikë prej kësaj hapësire rrëgjake.

Njerëzit bënim shyqyr që ishte aq terr, sa nuk i shihnin dot fytyrat e trazuara të njëri-tjetrit. U dukej se, po të fillonte të ngashërente qoftë edhe njëri midis tyre, në çast do të ngjallej një kor i tërë ngashërimesh, një kor i tërë vaji.

— Ia hodhe ti, Vaso. Ia hodhe minierës. Të gjejmë një vend pune, vend pëllumbash dhe... ku ka si ti. Ku të kam parë, i thua minierës.

Hektor Veshi ishte i vetmi që dëgjohej. Përpiquej të largonte vëmendjen, po Vasoja nuk e dëgjonte fare.

Tomi Margiti, që rri në errësirë, në gjunjë, ngrihet dhe hepohet pa drejtim, ulet, vetëm për një çast, se ngrihet përsëri. S'e mban vendi.

Hektori vetë flet e vetë përgjigjet për ato që i thotë Azemit.

— Unë s'e duroj dot më! — thotë Tomi duke marrë për nga dalja e galerisë.

— Po vij edhe unë. E paska zemrën kallkan. Si nuk u ligështoka?! — tha dikush për Hektorin prapë.

— I ati në minierë është djegur.

— Përralla! Atëherë Hektori ka qenë bebe.
Me të treguar e ka atë kohë.

XIII

Sado dritë që të dërgohet nën tokë, prapë atje do të ketë qoshe të errëta. Nëntoka është një natë e përhershme, përgjithësisht e ngrohtë, ku drita, duke dashur të zbardhë gjithçka, shfaq detyrimisht hije të objekteve që ndriçon. Madje, sa më e fortë të jetë drita, aq më të errëta duken këto hije.

XIV

Mirjana ndiente lodhje të përgjithshme, sado që në detyrën e re të përgjegjëses së llambisterisë pothuajse ishte e lirë. Kishte lodhje në mes, oreks të paktë, parandiente të vjella ose i provokonte këto, por nuk villte dot.

I thoshte Hektorit «më duket se jam shtatzënë», kishin shkuar në fillim së bashku, pastaj vetëm ajo, te mjeku, por ai nuk provonte dot gjë të vërtetë.

«Nuk keni gjë, po mos vini merak, kështu ndodh me gratë që kërkojnë të mbeten. U duket sikur janë shtatzëna, madje sikur ndiejnë lëvizjen e fëmijës. Po mos vini merak, çdo gjë vjen natyrshëm!»

Hektori nuk e besonte më pas kësaj, s'donte të dëgjonte asnje fjalë reth këtyre punëve. U kthyte një natë i dehur, pa asnje shkak e shau, e ndëshkoi për fajin që s'kishte bërë duke e qëlluar papritur me pëllëmbë dhe e la të mbytur në lot.

Vonë, pas mesnate, ai kishte qarë i penduar, me kokën mbështetur në trupin e sajtë zhveshur e të ngrohtë dhe Mirjana e kishte falur, madje e kishte quajtur fare të pafajshëm.

Pothuaj një muaj më vonë, pas disa ngurrimesh, ajo i tha prapë se kishte mbetur shtatzënë. Ti je bërë me fiksime, i tha ai me një ndjenjë humori të lehtë. Ja, po deshe dëgjoje vetë! Ajo ia mori kokën dhe ia mbështeti veshin te barku i saj. Më duket se ndjeva lëvizje, tha ai pa e fshehur gëzimin. Ajo e puthi në ballë, luajtën të dy si fëmijë, pastaj, ai gjithnjë, i kënaqur i tha: Ah, Mira, sikur të kishim me të vërtetë një fëmijë. Sa do të të doja!

— Pse, kështu nuk më do? — e pyeti e befasuar ajo.

Hektori nuk iu përgjigj dot; ia mori shpejt kokën në gjoksin e vet, sikur nuk deshi që ajo të lexonte më gjatë fytyrën e tij.

Gruaja, ditë më vonë, kur u bind se edhe kësaj here nuk do të bëhej dot nësë, shkoi vëtëm te mjeku, mori të njëjtën përgjigje, si herët e tjera, dhe u kthyte fare bosh në shtëpi.

— «Ndoshta ty do të të duhet një grua tjetër! — i tha Hektorit.

Ai e vështroi gjatë, më sy hetues, që zbritën gjer poshtë, te barku i saj i sheshtë, të cilin ai nuk donte ta quante të pafat dhe, sikur të fliste për diçka tjetër, pér diçka që s'kishte të bënte fare me shqetësimin e saj, tha:

— Të presim, Mira, të presim.

XV

Dy ditë më parë ishte njofuar pér një mbledhje të veçantë. U përsëritë se nuk duhej të mungonte asnjëri prej komunistëve e kuadrove të sektorit.

Në orën 14 e 30 minuta kishin dalë gjithë punëtorët e ndërresës së parë dhe pothuaj kishin ardhur ata të ndërresës së dytë. Nuk mungonte asnjëri nga komunistët e të tria ndërresave.

— Or, po nuk morëm vesh pér se do mblidhemi? — pyeti pa adresë dikush.

— Pér planin, pér çfarë tjetër? — tha një tjetër.

Arritën shefi i kuadrit të minierës, zëvendëssekretari i organizatës së partisë e pas tyre drejtues e kuadro të tjerë. Shoku i ardhur nga rrethi qëndroi gjatë duke i shtrënguar përzemërisht dorën Hektor Veshit.

Njerëzit, duke parë humorin e mirë të të ardhurve, (kjo dukej sheshit, se ata po tregoheshin të zellshëm në bisedat e shakatë me njëri-tjetrin dhe me punëtorët), u bindën se mbledhja

pa dyshim që nuk kishte asgjë shqetësuese, pras bëhej për planin.

Po atëherë çfarë?... Përse të kërkohej me ngulm tërë kjo pjesëmarrje?

— Gazeta nuk kishte gjë sot, — po thoshtë një minator, — por unë dëgjova edhe lajmet e mesditës në radio, se kushedi ç'ka ndodhur mendova, kushedi për çfarë do të na lajmërojnë.

Tomi Margiti filloi të qeshte duke dëgjuar këto biseda. Sikur ai të dinte diçka më tepër.

— E po, fillojmi, o shokë, meqë paskemi ardhur të gjithë? — tha sekretari i partisë. Filluan, dhe plot pas njëzet minutash çdo gjë kishte përfunduar. Brenda kësaj kohe kishin folur katër veta, tre nga të cilët ishin prej të ardhurve. Më entuziasti prej tyre, duke u ulur, përqafoi Hektor Veshin sikur t'i quante të pamjaftueshme tërë ato fjalë të mira që tha përtë.

Meqë i katërti tha se ishte i sigurt që mendimin e tij të mirë për Hektorin e kishin të gjithë punonjësit e sektorit, u ngrit një i pestë, prej të ardhurve, shoku Mitro e thërritnin, tha se, ashtu si gjithë të pranishmit edhe ai ishte i mendimit se ishin thënë të gjitha; të gjitha të mirat që karakterizonin formimin, qëndrimin dhe punën e shokut Hektor Veshi dhe shtoi se propozonte ta mbyllnin këtë mbledhje.

— Ç'të zgjatemi kot, mendoj edhe unë! — tha ai duke qeshur me një përzemërsi të veçantë.

— Atëherë, s'na mbetet gjë tjetër veçse t'i

urojmë shokut Hektor udhë të mbarë! Dhe të mbetet punëtor, i palodhur, siç ka qenë edhe ketu në minierë! — tha shefi i kuadrit duke u ngritur në këmbë.

— Pse, për ku po niset Hektori? Apo më bënë veshët mua që m'u duk se i thanë udhë të mbarë? — pyeti Tomi Margitën xha Sotka, që përdorte bastun dhe mezi dëgjonte.

Xha Sotka ishte vonuar, ndoshta i vetmi i vonuar i mbledhjes, dhe ende nuk kishte arritur të zinte vend në sallë, kur i thanë se kot që ulej. Mbledhdja kishte mbaruar.

— Ah! Unë i mjeri, me këta veshë! — po qahej me zë, duke dalë xha Sotka. — As nuk dëgjoj ç'thonë të tjerët, as më dëgjojnë! Një copë trung jam. Kot që rroj!

— Se mos vetëm ti! Ne të tjerët kemi nga dy veshë, e prapë s'morëm vesh ç'u bë! — i tha Tomi Margiti fare pranë.

Njerëzit sesi ndiheshin; me ca fytyra jo të hidhëruara, por të trishtuara pak, të përhumbura, si të fëmijëve kur vihen përballë gjérave të pakapshme prej dëlirësisë së tyre.

— Po ç'u tha për Hektorin?

— Do të ikë prej nesh, xha Sotkë!

— Ai i ikur ka qenë! Po për ku?

— Do ngjitet, do bëjë lart Hektori!

— Aha! Lart! E mbarë i qoftë!

Kishte zbritur edhe ajo gjer poshtë, për të përcjellë vizitorët. Mezi priti t'i jepnin dorën, nuk ishte e sigurt nëse ua ktheu kur ata i thanë «mirupafshim», por as për këtë nuk do ta qortonte veten; le të bënин edhe pa atë «mirupafshim» të saj.

Nuk besoi se do të arrinte dot deri në katin e pestë. Kur po ngjiste shkallët e të tretit, sikur iu mor fryma, mend thirri, por ndjeu hapa që zbritnin dhe «hë, edhe pak Mos u jep!» i tha vetes.

Pasi hyri, mbylli derën dhe u mbështet pas saj, me trup e kokë.

Ndihej e shkatërruar me trup e nerva. Si e marrë pëshpëriti: «O zot! Po si nuk më tha asgjë? «Si?!»

Vetëm pak orë më parë Hektori i pati treguar se mund të ftonte për vizitë në shtëpi një shok të rrethit dhe ata që do ta shoqëronin në harmin e karakteristikës.

«Të karakteristikës së kujt?»

«Të karakteristikës së Hektor Veshit, kishte thënë ai. A s'të kam thënë, Mira, se jam njeri me fat?!»

«Po unë, përse nuk po gjëzoj dot? pyeti veten ajo. Ç'jam unë për të?»

Nuk mundi të gjëzonte dukshëm, por bëri të

pamundurën që të mos shfaqte ato që po mendonte ato çaste.

«Përse të mos më thoshte diçka më parë? A nuk jam unë gruaja e tij? Cilin ka më të afërt se mua Hektori?»

Po nuk i tha asnijërën prej këtyre. E pastroi shtëpinë si një shërbëtore e bindur, edhe pse e trajtuar keq, vuri mbulesat më të mira, gjeti madje kohë t'u hidhte ujë luleve dhe të hiqte atë sadopak pluhur që kishte rënë mbi fotografinë e zmadhuar, me ngjyra, të bërë ditët e para të martesës.

Duke mos mundur ta gëzonte me ndonjë fëmijë, dalëngadalë Mirjana po mësohej që të ishte gjithnjë e kënaqur prej sjelljes, qëndrimit të Hektorit ndaj saj dhe të mos ia vinte veshin asnijë detyrimi që kishte ai si burrë.

Ajo nuk merrte përmospërfillje ose fyerve edhe rastet kur ai rrinte ditë të tëra pa i folur, ndërsa ajo, gjatë këtyre ditëve, rropatej që atij të mos i mungonte asgjë.

— Por jo deri këtu! Deri këtu jo, — tha me zë, e mbështetur prapa derës. — Kjo i kapërceu të gjitha. Pas kësaj unë s'mund të...

Në mënyrë të pavullnetshme, por pa keqardhje, goditi me këmbë një mbajtëse lulesh dhe vazoja u rrëzua e u thye duke e përhapur dheun e njomur mbi rrugicat e dyshemës.

— M'u morrën mendtë. Jam e lodhur. Dua të qetësohem, — i dha përgjigje çudisë së tij.

Gjithçka e kishte si nëpër mjegull.

— Të befasova, Mira? — po i thoshte ai përsëri. — Të më falësh, por... ti duhet të gëzohesh që çdo gjë eci mrekullisht!

— Më kupton? Dua të qetësohem! — i tha e vendosur.

— Të shkoj në dhomën' tjetër unë? — pyeti Hektori. Aasaj iu duk se ende tallej, por këto tallje ishin të papërfillshme.

— Do bësh mirë! — iu përgjigj ajo.

Ai doli pa bërë tjetër fjalë.

Mirjana u shtri me rrobat që kishte pritur vizitorët. Solli ndër mend se kështu, e veshur, ishte shtrirë në shtrat një ditë tjetër. Atëherë kur kishin bërë veprimet e celebri- mit në gjendjen civile dhe ajo kishte dëgjuar ta thirrnin me mbiemrin Veshi.

Atë ditë Hektori ia kishte zhveshur vetë rrobat; një nga një, me radhë, kurse këtë natë...

Vonë, kur u zgjua nga një gjumë çuditërisht i lehtë dhe vuri re se ai nuk e kishte parë të udhës të vinte ta qetësonte, ta sqa- ronte, ose të paktën të bënte qoftë edhe një përpjekje për këtë, ose më pak akoma, të vin- te t'i hidhte një rrobë, një mbulesë, aty ku ishte, e shtrirë, atëherë e ndjeu pothuaj mate- riale ftohjen.

«Ai nuk më do më! Ka kohë që nuk më do», tha me vete duke shijuar lotët e nxeh- të mes buzëve.

«Asgjë nuk e lidh me mua! Asgjë,» shtoi pastaj duke provuar vetë atë që një shoqe e saj, maturante, e zhgënjer prej një dashurie të hershme, i pati thënë dikur:

«Nuk ka më të hidhur se lotët e pangu-shëlluar.»

XVII

Nëntoka nuk është tekanjoze aq sa e bëjnë ndonjëherë. Kjo ndodh se, si për plot gjëra në këtë botë, edhe për minierën flasin e japin mendime më tepër pikërisht ata që nuk e njohin.

Nga kjo, gjërat marrin forma që s'i kanë. Themi për minatorët gjëra që edhe për ata vetë janë të bezdissħme dhe lëmë në heshtje ato që do t'i ngrinin të plotë pérpara syve të njerëzve.

Ndërkaq, pavarësisht prej indiferencës apo vëmendjes së atyre sipër, ata nën tokë nxitojnë pas vagonëve, të cilët edhe ata, dinë të ecin vetëm mbi shinat përgjithnjë paralele.

Midis nëntokës dhe sipërfaqes dihet, ka një shtresë jo të cekët sterilë, por shumica e njerëzve, të sipërfaqes e të nëntokës, së bashku mendojnë se jo kjo shtresë është shkaku i atyre ndryshimeve, dallimeve midis tyre. Ka diçka tjetër, një si shtresë izoluese zifti e katramaje, që krijohet pa e dashur, pa e kuptuar,

por edhe pa e luftuar, midis atyre që punojnë atje dhe atyre që këta të fundit i kanë pranuar si ndërmjetës e rregulatorë.

«Zift e katrama kam qenë unë ca kohë,» thotë Gani Elezi pa e fshehur edhe ai vetë frikën e mpirjen, pafuqinë dhe memecillëkun që të detyron heshturazi ajo shtresë zifti e parafine, që në të folurën e njerëzve quhet burokraci. Kush do të kërkonte të shtonte edhe më mbi shtresën sterile midis nëntokës e sipërfaqes?

Mosnjohja me minatorët s'do ta justifikonte kurrë.

Të saponjohur gjej gjithandej. Flasin, tre-gojnë, për vete, për të tjerët, nëpërmjet vetes, për botën e tyre si e kuptojnë ata, të kënaqur pak apo shumë, siç mundin...

Kur më duhet të gjykoj në i saponjohuri është apo jo njeri i mirë, vetvetiu më shkon mendja atje, në minierë.

Atje kam etalonin. Me të e krahasoj.

XVIII

Vili Haruni lëvizte mes njerëzve të ndarë në grupe pa vendosur të ndalej askund. Afro-hej diku, dëgjonte bisedë për futbollin, në një grup tjetër flisnin për Panamanë, që kërkonte administrimin e istmit (kishin përzënë ambasadoren amerikan), kurse te një i tretë dikush

shprehte shqetësimin e vet që anketat e fundit muzikore kishin shumë këngë dashurie, madje vetëm dashurie!

Askush nuk shkonte ndër mend të thoshte qoftë edhe një fjalë të vetme për mënyrën se si ishte vepruar për miratimin e karakteristikës së Hektor Veshit.

Ata dukeshin të qetë, pa shqetësime, pa asnjë shqetësim (jo më për Hektorin!), të kënaqur që vinin do ditë në punë, që dilnin shëndoshë e mirë nga miniera dhe që po ashtu i gjenin në shtëpi fëmijët, gratë e njerëzit e tyre.

«Vetëm kaq duan këta», po thoshte me vete Vili Haruni. Po kjo nuk ia shuanë kureshtjen e fuqishme për të marrë vesh ç'mendonin ata për Hektor Veshin. A ishin zbatuar, sipas tyre, rregullat, normat, parimet? A e meritonte ai këtë besim? Mos...

Donte t'i pyeste për këto, por nuk guxonente. Ata ishin të çuditshëm në qëndrimin e tyre. Kur heshtnin, ktheheteshin papritur në misterë të vërteta. «Këtë nuk e quan dot indiferencë, tha ai me vete. Më tepër është pasojë e një indiference. Kështu do të vepronin në çdo rast të tillë», shtoi pa zë, duke e quajtur vëten pa fat, pa shans, pa një dorë që të zgjatej nga sipër e të kërkonte dorën e tij për ta tërhequr lart.

Sic kishte ndodhur me Hektor Veshin.

XIX

— Shokun Hektor Veshi dua të takoj, i tha nëpunësit të shërbimit. I tha emrin dhe që ishte student...

— C'hall keni? — pyeti nëpunësi i shërbimit me zë të ulët, duke e parë të ardhurin në komitet me vëmendje.

— Asnjë hall!

— Si, asnjë hall?! Po ti nuk e kërkon kot shokun Hektor!

Studenti buzëqeshi, duke mos ditur si të sqarohej.

— Apo të pret shoku Hektor vetë? — pyeti ai duke kuptuar gjendjen e tjetrit.

— Jo, jo. Nuk më pret, por... kemi punuar bashkë në minierë, më parë.

— E po kështu më thuaj, de — qeshi nëpunësi i shërbimit duke formuar numrin. — Tani po zbret, — tha për Hektorin.

Nëpunësi i shërbimit vazhdonte të buzëqeshte.

— Jua morëm shokun Hektor! — tha pastaj.

— Nuk na e morët, jua dhamë vetë. Po të donim, mund të mos jua jepnim, — tha tjetri.

— Ashtu është. E kemi së bashku, — pranoi i kënaqur nëpunësi i shërbimit.

— Ja, po zbret, — tha duke dëgjuar hapat në shkallë.

— E, po i bën shoqëri minatorit? — i tha

nëpunësit të shërbimit Hektori duke i hedhur krahun të ardhurit. — Do pranosh një kafe nga unë? — pyeti duke qeshur.

Hynë te bufeja, poshtë.

— Minator. E kam pasur shok pune, — e prezantonte Hektori.

Këtë e bëri me disa njerëz që gjetën apo që erdhën aty.

Hektori fliste me zë të lartë, fare lirshëm, siç flet njeriu në shtëpinë e vet, kur çdo gjë i ecën mbarë.

— Minator. Shok miniere, sado që tjetri u përpoq t'i kujtonte se tani ishte student i kursit të tretë. Kushedi, dilte ndonjë që e njihte dhe vinte në dyshim përpara kolegëve fjalën e Hektorit. «Ky minator?! Po a nuk të kam parë në fakultetin»...

— Si e pi kafen? Apo të mesme me shumë?! — vazhdonte të fliste Hektori. — Edhe konjak, për minatorin!

— Për studentin tani, — i pëshpëriti pak mënjanë tjetri.

— Hajde, gjëzuar, o shoku minator! — trokiti gotat ai, sikur të mos e dëgjonte ç'i thoshte studenti, të cilit, nën vështrimet e qeshura të njerëzve aty, i dukej vetja si ariu në fshat në mes të fëmijëve.

— E dëgjon, shoku Mitro? — iu drejtua dikujt Hektori. — E dëgjon si thonë në minierë?

— Jo, s'e dëgjova, — tha ai që quhej Mitro, duke parë nga djaloshi. Me siguri men-

donte se atë që do të tregonte shoku Hektor
sapo e kishte dëgjuar prej të ardhurit.

— Thonë se Ansambli i Këngëve dhe i Valleve kërcen aq lehtë e aq bukur, se jemi ne minatorët nën tokë! E fortë, ë, shoku Mitro?

Shoku Mitro me dy të tjerët erdhën të tryeza dhe i dhanë dorën të ardhurit.

Po bënин g'ishte e mundur të kënaqnin ish-shokun e punës të shokut Hektor.

Gjithë këto fjalë, këto pyetje, kjo pritje e papritur, e bënë edhe më të druajtur studentin.

— Në të yërtetë unë nuk i përdor fare pijet me ngjyrë, — tha ai përfundë shëmangur porositë që mund të vijonin.

— Po mirë atëherë, bëja raki minatorit!

— Dhe mos hyr në merak kot! Këta të zyra, edhe në pëllëmbë të dorës të na mbajnë, e dinë se nuk e shlyejnë dot borxhin me ne të minierës! — tha Hektori.

Studenti uli kokën. Hektori tregoi dy-tri gjëra që iu kujtuan nga vitet e minierës; përmendi emrin e Nebi Arenit, pastaj shoku Mitro kërkoi leje për t'u larguar.

— Njatjeta e të fala shumë shokëve minatorë! — tha duke i shtrënguar dorën studentit.

Njatjetohen edhe dy të tjerët që ishin me shokun Mitro dhe, sapo ata largohen, Hektori pyet:

— Po hë, ç'thonë studimet? Në q'vit je?

Kur tē kesh provimet, na thuaj, se i kemi nja dy shokë edhe andej.

Ka sy tē mëdhenj dhe, i shëndetshëm, siç është, tani duket edhe i bukur.

— Edhe kur tē vijë puna e emërimit, na kujto. Apo do tē ktheshesh prapë atje ku ishe?

— qeshi lehtë Hektori.

Studenti nuk po thoshte dot asgjë.

Po ç'të thosha, kujton ai duke dalë nga ndërtesa e komitetit.

Kujtoi kohën kur Hektori kishte qenë atje poshtë dhe kishte zbritur ekipin te Velo Mersini, dhe kjo e pështjelloi edhe më shumë.

Po përse më prezantoi si minator, përse? pyeste veten studenti duke dalë në udhë tē gjerë. Përse duhej ta bënte këtë përpara shokëve tē zyrave?

«Duku prapë ndonjë ditë», pati thënë Hektori, pa e ditur se te studenti po lindte druajtja.

— E, po ikën? — dëgjoi t'i flisnin në tro-tuar. Ishte njëri prej njerëzve që shoqëronte shokun Mitro pak më parë.

— E ke pasur minator shokun Hektor? — pyeti ai duke i ecur në krah studentit.

— Jo. Punonim në një sektor, por as ai, as unë nuk kemi punuar minatorë. Shoku Hektor ka qenë mekanik në minierë, — tha studenti duke mos dashur që tē trashej edhe më ajo përshtypje nga njohja që iu bë në bufe.

— Si? — Tjetri nuk e fshehu habinë e vet. — Nuk ka punuar minator shoku...?

— E përse duhet të punojë doemos minator? — U përpoq studenti ta qetësonte zhgënjimin e tjetrit, që, pas pak, kur ai të arrinte të zyrat, do të shtrihej, do të bëhej i më shumë njerëzve. — Edhe pa punuar nën tokë njëriu mund të bëhet e të mbetet po aq i drejtë e i devotshëm.

— Nuk thashë të kundërtën. Por unë... Sikur kështu kam dëgjuar për shokun Hektor.

Ecën edhe pak, në të njëjtin trotuar, po tanimë të dy ishin të sigurt se, po të vazhdonin të flisnin, do të thoshin veçse gjëra që nuk i mendonin, ose do të heshtnin.

As njëra, as tjetra nuk mund të quhej e këndshme për dy të saponjohurit.

Në një çast, në të njëjtën kohë, panë se i kishin zgjatur dorën njëri-tjetrit për tu ndarë.

XX

Me makinën e tij erdhi deri në minierë, madje deri në sektorin ku kishte punuar dikur.

U fol, pastaj doli e vërtetë, se Hektori nuk ishte kthyer as në shtëpinë e vet.

— Atje, në minierë! — i kishte thënë shoperit. Zbriti dhe nuk e fshehu se po vinte që të shihnin njëri-tjetrin, të çmalleshin, se, dihet, njeriu për njerëzit e merr malli. Vinte edhe për ta parë ata, se ai i kishte punët në rregull,

përderisa gjente kohë e qetësi të vinte deri aty.

— Dua t'i takoj të gjithë me radhë, — tha ai duke vetëtitur i téri nga kënaqësia. — Dhe ju, mos më shikoni ashtu, se po më hani me sy, — tha përtat ngrohur edhe më gjendjen. — Hektor Veshi jam e askush tjetër. Ç'më silleni rrotull, sikur po më bëni pazarin! Ku e kam Nebiun?

— Ja tek e keni, po nuk e lënë këta djemtë të vijë e të të takojë se nuk është higjienik, kështu i thonë!

— Hajde ta ndezim një evropiane, o Nebo!

— i foli që atje tej, mes të qeshurave.

— Më mirë ndezim një allaturka, nga shubeku im, o shoku Hektor!

Duhanin e Nebiut s'e vinte njeri në buzë. Ai s'është duhan, por helm, thoshin përtë Prandaj kam vdekur unë, qeshte mbytur Nebiu. Përtë vdekur jo, po shtylla kryesore të është kthyer si qafë pate!

Shtyllë kryesore ai i thoshte shtyllës kurri-zore.

Para ca kohe Nebiu kishte ndarë gruan, dhe, sa më shumë ditë e javë kalonin, aq më e qartë dukej mungesa e gruas te jaka e kominosheve njyrëkafe.

— Po pse e ndave gruan, o Nebo?

Këtë pyetje ia bënин çdo ditë nga shtatë a tetë herë e më tepër. Sa herë që dikujt i dilte koha të bënte një dorë shaka.

— E, Nebo, na e thuaj, pse...

— Se nuk më vinte pas trupit, prandaj.

Sado që njerëzit përpinqeshin të mbeteshin seriozë pas kësaj përgjigjeje, vështirë se rezistonte njeri, edhe pse ajo pritej.

Por atij nuk i binte në sy kjo gjë.

Nxirrte shubekun dhe, kur nuk gjente dot letër cigareje, përdorte letër gazete të hollë.

Kur dikush e tēpéronte në fjalë me të, ai prapë nuk zemërohej. Vetëm ngrinte pak mbi ballë kapelen kafe, si kominoshe, dhe i thoshte, sikur i lutej: «Rri, ore! Ore kopaçe e djegur, rri!»

— Mensa na ka zgjidhur hall, por akoma s'po përdoren dushet, — tha pas pak dikush.

— Ngrijeni zërin, deri lart! — tha Hektor Veshi.

— Lart?! Po ja, ti je lart! — tha Tomi Margiti duke e parë në sy.

Hektor Veshi mbeti serioz.

— Po ti qesh, se s'ta kanë ngrënë bukën minjtë e mi! — e ngacmoi edhe më tej Tomi.

Tjetri qeshi. Pastaj, duke dashur të tregonte se nuk ishte lënduar, tha:

— Ma besoni kur them se këtu kam qenë më rehat se atje?

— Ti e di më mirë në thua të vërtetën apo jo, — ia dha përgjigjen Tomi.

— Hajde merre vesh Tomi Margitin!

E vërteta është se, tek rrinin ulur mbi shtyllat e druve, Hektori u trondit pak. Duke besuar në atë se asgjë nuk ndodh kot, rastësisht,

ai u kujtua se jo vetëm deri tani që nuk kishin folur shtruar, seriozisht, për ndonjë gjë, por, nëse dikush do ta bënte një përpjekje të tillë, mund të shprishej përnjëherë kjo situatë gazzmore.

Pas ngacmimit të lehtë të Tomi Margitit, ai tha me vete se, megjithëse këta njerëz gëzohe-shin tërësisht, për mënyrën se si po rridhtejeta e tij, prapë, qoftë edhe padashur, ata nuk i harronin dot të gjitha.

Kur nuk i kam harruar as unë vetë, tha me vete, si t'i harrojnë ata?

Do të donte t'u thoshte diçka këtyre njerëzve, t'u shpjegohej për disa gjëra, t'u thoshte për shembull se sigurisht, në të mirë të tij kishin qënë prania dhe nisja prej tyre. Unë ndoshta nuk dallohesha dot si punëtor, në mes tuaj, donte t'u thoshte, po kjo s'do të thotë se jam ngri-tur me të padrejtë. Ajo që më rrallë kam ardhur këtu... Janë ca gjëra që s'ka sesi të mos ndryshojnë. Në fund të fundit, ju duhet të gëzoheni që njëri nga ju, shoku, i dëshiruari juaj, u ngrit në shkallët e jetës. Madje, po të isha unë në vendin tuaj, donte t'u thoshte atyre, do të ndihesha edhe krenar.

Megjithatë natyra secilin e ka pajisur me kokën e vet, dhe njëra nga bukuritë e jetës është se secila prej tyre dëgjon në çdo rast veten e vet së pari.

— Kështu, pra, o Nebi, — tha pastaj me një buzëqeshje të lehtë për ta kuptuar të tje-

rët. — Ke ndonjë ankesë për këta shokët?

Nebiu ktheu kokën nga përgjegjësi dhe, si një fëmijë që përgatitet të ankohet te prindi për padrejtësinë e vëllait më të madh, tha buzagaz:

— T'ia them, ë?

— Thuaja, por mos turpërohesh, — ia dha përgjigjen përgjegjësi.

— Dje nuk ma plotësoi ditën e punës ky, — tha Nebiu dhe të qeshurat shpërthyen me qëndrimin që mori ai: Tregonte me gisht përgjegjësin.

Hektori, ashtu siç e priste edhe vetë, mësoi se një ditë më parë Nebiu kishte marrë pesëdhjetë qindarka më pak se dita e punës; për këtë ankohej dhe, po të kishte guxim (gjë që s'e kishte kurrë të mjaftueshëm), do të ankohej kudo ku mund të ankohej.

— Pse, more vëlla, të mos ma hedhë të plotë ditën e punës?! — çuditej ai dhe nuk qetësohej as kur i kujtonin se dy ditë më parë po ai përgjegjës i pati hedhur jo pesëdhjetë, por dyqind e pesëdhjetë qindarka më shumë se dita e punës.

— As nuk ia dua ato të tepërtat, të mos m'i hidhte! Unë ankohem përse s'ma dha ditën e punës, ja, për këtë ankohem unë.

Dita e punës për të ishte tabu. Për të marrë atë e vetëm atë vinte në punë, për atë lodhej e djersinte. Kur i thoshin ik, Nebi, e more ditën e punës, ai ulte kokën i kënaqur dhe dukej se vetëm pas kësaj nuk u kishte borxh shtetit dhe fë-

mijëve. Ai mund të duronte çdo gjë, çdo shaka, edhe kur ajo, pa e kuptuar, shndërrohej në fyerje për të. Vetëm po të mos i hidhje ditën e punës... aha! Këtë s'e duronte dot Nebi Areni.

— Nuk e di shoku Hektor që ti e ke sharë, po ne do t'ia themi!

— Unë të shaj njeri?! E di gjithë kazaja që Nebi Areni nuk shan! S'na the gjë!

— Mos i moho fjalët e tua, Nebo! Harrove ç'më the mua?! Ja, ta dëgjojë edhe shoku Hektor vetë. Vjen një ditë në zyrë e më pyet «O shoku sekretar, a s'më thua dot ç'eshtë ky eksporti, a importi, a, si u thonë të dyve bashkë?» «Me cikël të ulët je ti, Nebo? e pyeta unë. «Jam pa cikël fare», më përgjigjet. «Po ja, i them, eksporti eshtë kur u shesim atyre, importi, kur u marrim.» «Ti mirë e ke, o shoku sekretar, po ai Hektori më duket se e ka marrë angllëç këtë që the ti. Të rritim atë të parin, thotë ai kopaçja, e të ulim të dytin. Po pak na kanë marrë ata të jashtmit neve, që dashkemi t'u japim akoma? T'u marrim ne, o shoku sekretar, po atij Hektorit, kopaçes, ç'i thotë mendja ashtu?»

— Edhe këtë e ke bërë?

— Jo, o shoku Hektor, jo! Sesi i zbukurojnë gjërat këta djemtë e sotëm. Jo, jo!

Nuk kishte rënë ende vala e së qeshurës, kur përmes disa gogësimave u dëgjuat zëri i Sabri Volës:

— Të ka lezet fjala e konaku, o Hektor Veshi! S'ta mbajti dot këtu në minierë dhe the *ë

ngjiteshe lart njëherë, se ku i dihet! Mirë bën që lëviz, ngjiyu, po munde, po dëgjoja një fjalë Sabriut, po deshe! Po të zuri, karrigia është më keq se kjo rakia që pi unë. Ka një huq të keq ajo shejtane. Zor se të ëdel vetë ajo dreq, duhet të vijnë e të ta nxjerrin të tjerët! More vesh?! Vetëm kaq dëgjoja Sabriut, po deshe!

Sabri Vola iku me hapa të shprishur, si epileptikët, duke lënë mbrapa heshtjen.

— S'e futa në punë sot. Ka ardhur thumb fare. Ik qetësohu në shtëpi, i thashë, po mirë që, kur pi, nuk bën zhurmë, nuk grindet.

— S'është shenjë e mirë për asnjeri kur të vërtetat i thonë të dehurit, — tha me zë të ulët Tomi Margiti.

— Hektori s'është nga ata, — tha njëri që e dëgjoi të fliste kështu.

— As Sabriu s'e kishte për Hektorin, — shtoi si me vete tjetri.

XXI

Për një kohë të gjatë Mirjana priti që ai të vinte në shtëpi. Hektori i shkruante, madje jo rrallë. «O zot, thoshte ajo me vete, ku e gjen gjithë këtë kohë që më shkruan tërë këto letra mua?!» Detyrohej të shkruante edhe ajo, por, kur ai e vonoi ardhjen, iu zbeh edhe dëshira e fundit për këtë. Madje iu duk fyese po ta vazhdonte këtë formalitet bezdisës, të paktën për të.

Në fund të gjashtëmujorit të parë ai e kishte paralajmëruar se së shpejti do të merrnin hyrje, dhe Mirjana filloi, dalëngadalë, të mbyllte, të paketonte apo të përgatiste një pjesë të plaçkave për transport.

Por kaloi edhe gjashtëmujori i dytë dhe ai prapë nuk po bëhej i gjallë.

I hapi përsëri pakot, plaçkat e mbyllura e të parapërgatitura për rrugë. Iu dukën si plaçka të të vdekurve. Shkoi ndër mend djegien apo zhdukjen e tyre, po pastaj e largoi këtë mendim si ata pleqtë e sémurë rëndë që nuk duan ta zënë në gojë vdekjen.

Në të vërtetë ajo ndiente se diçka po vdiste.

E kishte lodhur kjo pritje e pafund. Po kaq stërmunduese, e ndoshta ca më tepër, i ishte bërë përpjekja për t'u shfaqur e qetë, e pa andrallë në sy të të tjerëve. Edhe pse ajo dinte të dallonte lehtë kureshtarët nga dashakeqësit, e bezdiste qëndrimi i Robertës dhe i Vili Harunit.

«Kur do na lësh, moj motër, e pyeste ajo herë pas here. Si lum ti! Apo ç'e keni menduar mirë që s'po bëni fëmijë! Rregullohuni vetë, pa të tjerat...»

Mirjana herë-herë i përgjigjej me zell e tërë vrull, me gaz të shtirë e i fliste për plane që gjoja hartonte ajo me Hektorin për të ardhmen, dhe duke parë fytyrën e Robertës besonte se ash-tu bëhej e besueshme, por pak orë më vonë, ose ditën tjetër, qysh në mëngjes, Roberta e

pyeste përsëri: «Akoma veç ju, Mira! E po martesë është kjo juaja? As burrë, as fëmijë, as shtëpi! Korba ti, mos i ka vënë syrin ndonjë tjetre ai, moj?!»

Tjetri, Vili Haruni, ai që i kishte sjellë rakinë ditën e vizitës për miratimin e karakteristikës, ishte jo vetëm i çuditshëm në sjellje, po Mirjana ngrinte supet për ato që donte të dinte ai.

«Na harroi fare ne shokët, shoku Hektor, tha një ditë. Të lutem, po munde, në çdo letër që t'i shkruani, shton: «Mos harroni Vilin». «Të ka premtuar gjë Hektori?» «Jo, jo! E di vetë ai për se është fjala!»

«Ishte mbrëmë», i tha dikur Mirjana. «Tha gjë për mua?» «Jo!?» «Pse s'më lajmërove, unë të pata thënë? Ç'ke bërë! Po dëgjo: He ë tjetër, të lutem, kije parasysh. Menjëherë sapo të vijë!....»

«Nëse do të vijë», tha ajo me vete. Ishte e bindur që ardhja tjetër do të vonohej edhe më tepër. S'di përse, më shumë se kushdo ajo besonte se këtë radhë ai erdhi për ta parë të tjerët, në minierë, dhe, meqë erdhi, ta shihte edhe gruaja e tij.

Po ai erdhi, këtë herë shumë shpejt. Ajo qortoi heshturazi veten për mendimet që pati, e priti si një motër që mendon se nuk e ka kënaqur aq sa duhet herën e fundit vëllanë e vet. Po dhuratat ia kishte sjellë Hektori! Një bluzë, një copë për fund, një palë çorape, të gjitha

prodhime të importit. Kushedi, mendoi ajo, vonesa e bëri më të dhimbshëm, e pse jo, i ka ngjallur përsëri dashurinë pér mua.

— Do bësh një banjë, apo do të dalësh në qytet? — e pyeti me ëmbëlsi duke i prekur supin.

Ai rrinte ulur mbi qilimin e shtruar në dysheme, pér fresk.

— Jo, nuk dal! E di si më duket kur mendoj pér këtë qytet? Sikur m'i kapin fijet e nervave dhe m'i shkulin një nga një!

— Ç'ke kështu, Hektor, — thirri Mirjana duke e prekur lehtë në sup. — Ty të kanë ndihmuar e të kanë dashur këtu.

Ai përpinqej të dukej i qeshur, por efekti ishte i kundërt.

— Ata më pyesin shpesh. Vili Haruni, pér shembull, sa herë që më sheh...

— Vili është më ndyraku, më egoisti! Po léri këto, grua e dashur. Vish bluzën, çorapet, se dua të t'i shoh si të rrinë! Hajde, shpejt!

Në sytë e tij gjëzimi e djallëzia luanin symbylltas.

— Hajde, vishi, pra!

Mirjana nuk donte ta zbehte këtë fillim të ngrohtë mbrëmjeje. Veshi bluzën, por erdhi me druajtje në dhomë.

— Mos më vjen ca e ngushtë në gjoks, më duket se më shtrëngon shumë.

Hektori s'ia ndante sytë kraharorit të saj ende vajzëror.

— Jo! Ta mbash me shëndet! — i tha duke qeshur me vete.

Po qeshte dho ajo, duke e parë si asnjehe-
rë tjetër të shoqin.

— Ti je shiranak, je hileqar! — i tha atij.

— Me ty jo!

— Me të gjithë njëlloj je!

— Ndoshta, — ia bëri ai qejf pa prishur.

Pas banjës ai ishte më në humor. E thirri
atje ku u shtri për t'u qetësuár, e tërhoqi dalë-
ngadalë nën mbulesën e lehtë verore dhe, pa i
folur, vetëm duke e përkëdhelur çdo çast e më
ashpër, sikur ende të grindej për diçka, sikur t'i
mbante mëri kushedi përse, u përpoq t'i krijonte
pas kaq kohe ndjenjën që buron nga afërsia e
burrit.

Më vonë, kur arsyefa e kishte larguar pa u
ngutur ndjenjën, ai e puthi pothuaj pa vëmendje.

— Nuk po rregullojmë dot gjë, Mira. As shtë-
pi, as punë për ty, as... Të kam premtuar aq shu-
më, po më duket se qenkam edhe unë ca dështak!

Qeshi befas, sikur provoi një kënaqësi të me-
njëherershme. Ajo po e vështronte qetë shndërrim
e ftyrës së tij.

— ... edhe ti dështak? — tha ajo, — pse,
kush tjetër është dështak? Unë që nuk bëj fë-
mijë? Apo jo!

Fytyra e tij, në sytë e saj, mori një pamje
prej harbuti, kurse e qeshura i dilte si hungë-
rimë.

Ajo e largoi me vrull, e pa me llahtari, por

u ndie e pafuqishme, e çarmatosur përballë paturpësisë dhe fyterjes. I ktheu shpinën duke u struktur në cepin tjetër të shtratit.

Të nesërmen cai iku herët dhe nuk tha se kur mund të vinte përsëri. As ajo nuk e pyeti:

Ndoshta janë të vërteta dyshimet e Robertës, mendoi ajo. Ndoshëta ai shkon me ndonjë feniër tjetër!

Po nuk e ndjeu ikjen e tij, madje nuk po provonte as fijen më të hollë të xhelozi. Po

Ndoshta ngaqë s'e dua as unë më, vërejti e lehtësuar.

Pas disa javësh, kur ai nuk u bë i gjallë, Mirjana mendoi se do të ishte më e arsyeshme të shkonte vetë në zyrën e gjendjes civile dhe të kërkonte ndarjen.

E po pastaj, pyeti vëteri, kjo s'ndryshon asgjë! Të paktën për jetën e saj, jo. E zvarriti për disa ditë dhe pas kësaj pothuaj e harroi fare.

Ai edhe kështu nuk është im shoq, tha duke i mbushur sytë me lot, por pas pak, duke sjellë ndër miend fjalët e tij, tha së më mirë që kishte ndodhur siç ndodhi. Në fund të fundit edhe kështu mund të jetohëj. Ditët, mund të mbushe-shin me punë e gëzime të tjera, të vogla, por që, kur janë të shumta e të vazhdueshme, s'të lënë të të mërzitet jeta.

Mjafton të kalojnë dymbëdhjetë muaj, të tillë dhe ka kaluar një vit, filozofoi me vete, si gjithnjë kur donte të ndikonte mbi humorin e saj.

Ra zilja e telefonit. Nuk e ngriti receptorin. U përpoq të kujtonte mos priste ndonjë telefona-të të veçantë, po nuk solli dot gjë ndër mend.

Zilja ra përsëri. E afroi receptorin te veshi. Zëri që tha «Alo! Shoku Hektor jeni?», nuk iu duk i njojur, prandaj nuk iu përgjigj.

Sa më pak zhurmë, tha me vete duke qe-shur i kënaqur. Duhen kursyer energjitet, duri-mi, nervat.

Ato punë që duheshin bërë mirë, i dinte ai. Të tjerat le t'i bënин të tjerët, ata që ishin të interesuar.

Unë nuk jam më i interesuar, shtoi duke qe-shur, atë që kam ëndërruar, e kam arritur! Se-cili ka epokën e vet, rolin e vet! Jo të gjithë arrijnë ta bëjnë atë që arrita unë!

Pastaj, atje poshtë ka edhe të tjerë Hek-torë e Vili Harunë që ëndërrojnë! Ç'bëjnë ata, pse nuk lëvizin? Punojnë? Mirë bëjnë, po kjo nuk mjafton! Punën e bëjnë të gjithë. Duhet shka-thtësi, iniciativë...

Përfytyronte, duke qëndruar në presidiume, se si ia bënин këta Vili Harunë të mbetur atje poshtë, në bazë. Unë do ta kisha të pamundur më tej, thoshte me vete.

Midis tyre kishte plot diskutime pasionante që i ndillnin Hektor Veshit nënqeshjen, të cilën ai kishte mësuar me kohë ta kthente në të qe-shur të pastër.

Ato shishet e verës e të rakisë që kam zbrazur unë për t'u ngjitur deri këtu, kuqtohet që do t'i mbushni ju tanë, u drejtohej atyre pa zë. Unë do t'i pi me ngadalë, i qetë, deri në gjallënjëkën e fundit!

Së sotmes e së ardhmes do t'i kërkoj haraç për të shkuarën, mendonte, ndërsa zilja e telefonit po binte përsëri e ai nuk e ngrinte.

Diskutimet e tij rridhnin në shtrat të qetë. Ai e dinte se një numër jo i vogël njerëzish nuk e ndiqnin më më interes, ose nuk e dëgjonin fare dhe kishte kohë që po e mësonte veten të kënaqej prej kësaj indiference. Ai do të vinte buzën në gaz nëse ata pëshpëritnin «aha, shteroi ky!» Si nga një peizazh natyror, prej fjalorit të tij dikur tërë ngjyrë, u laguan me radhë, si zogjtë, miniera, minatorët, nervi i tyre.

Zëri iu bë më i shtruar, në telefon përdorte sidomos fjalët «do të bëhet» ose «do t'i bëjmë...» Në përgjithësi heshtte. Të tjerët le të bënин ç'të donin.

I kam mirë punët, thoshte me vete në fund të ditëve, kur nuk i trokiste njeri në zyrë ose kur s'i telefononte njeri tjetër. E kalova mirë sot.

Rinte orë të tëra në zyrë duke mos bërë asnjë lloj pune, ose duke lexuar diçka në kalendarët e tryezave për apatinë e zvarranikëve në diillin e zbehtë dimëror.

Pas rënies me ngulm disa herë të telefonit, i trokitën bezdiss'hëm te dera, madje dikush e hapi paksa atë dhe po buzëqeshte...

Hektori nuk pranoi ta priste.

— Të lutem, të lutem shumë, — i tha, — kemi punë! Pa ka edhe rregulla! Ku është parë kjo, të hysh e të trokasësh drejtpërdrejt, pa u shoqëruar nga dezhurni, te zyra e... të lutem shumë!

Tjetri mbylli derën me ngadalë nga jashtë dhe Hektori ngriti telefonin.

— Do të bëni mirë po të na lini të punojmë, — i foli nëpunësit të shërbimit.

Në të vërtetë ai që kishte trokitur, edhe pse ishte befasuar, ishte larguar pa thënë asnje fjalë. As Hektori nuk kishte pasur as kureshtjen më të vogël për të marrë vesh cili ishte ai apo përsë kishte ardhur.

Duke përfytyruar se si do të largohej fytyra e nëpunësit të shërbimit, pas fjalëve që i kishte thënë, Hektor Veshi tha me vete se, sidofoftë, kota e kishte bërë aq alarmante gjendjen.

Po shkoi ndër mend se pati vendosur që për asgjë të mos vetëqortohej apo të kthehej mbapa, dhe e ngriti përsëri receptorin. Bëri afro njëzet telefonata në afro njëzet pika të ndryshme shitjeje, për të pyetur në kishte apo jo atje cigare me filtër. Pas kësaj përpjekjeje të stërmundimshme, u çlodh menjëherë kur vuri re se ora po arrinte katërmëdhjetë e dyzet e pesë minuta.

Në katërmëdhjetë e pesëdhjetë e pesë minuta, kur po përgatitej për të dalë, dëgjoi te

nëpunësi i shërbimit se ai njeriu që kishte trokitur në zyrë para disa orëve, dhe që Hektori s'e kishte pritur, vinte nga miniera.

— Unë prandaj e lashë të ngjitej gjer te ju pa u marrë vesh më parë me telefon, — tha gehrevrarë, po gjithsesi i sjellshëm nëpunësi i shërbimit.

Ai ishte të paktën shtatë-tetë vjet më i madh se Hektori, por fliste në këmbë.

— E pastaj? C'do me thënë kjo se ishte nga miniera? — i, tha pa pranuar tazbuste tonin e bisedës me nëpunësin e shërbimit.

XXIII

Në fund të kullës së pusit u dëgjuan tri sinjale, pastaj i katërti, i pesti dhe madje edhe i gjashti, gjë që i bëri njerëzit të shiheshin sy më sy. Punëtori sinjalist i sipërfares lajmëronte me «kodin e nëntokës» se po niseshin shefat drejtuesit e sektorit (sinjali i katërt) me shokë nga ndërmarrja (sinjali i pestë), po i gjashti(!). C'do të thoshte sinjali i gjashjtë? Pothuaj nuk e kishin përdorur kurrë në sistemin e sinjalizimit «për përdorim të brendshëm», sic e quanin me shaka punëtorët dhe kuadrot e minierës.

— Ej! Ka kontroll! Dëgjuat? Ka kontroll, të paktën nga ndërmarrja! — ngriti zërin sinjalisti në fundin e pusit.

Sinjalet u përsëritën, dhe tanë s'kishe pse

mendoje për ngatérresë në numërin e tyre; plot gjashtë herë u ndez llamba e kuqe.

— Ej! U thoni atyre se ka kontroll!

— Pse ngjiresh kot? Ç'ka këtu për t'u bërë merak?! Çfarë hile do të bëjmë ne këtu nën tokë! — qeshi dikush.

— Mos ndezin ndonjë cigare ata djemtë, ku i dihet, — foli përsëri sinjalisti. — Do na hapin telashe kot.

Vasoja nxiton, për merak, gjer te stacioni i pompave. Atje po pinin vërtet cigare.

— Qen, gdhë, rrotë, nuk të durohet? Pse s'del jashtë, xhanëm?

— Hë, mo, se s'ka rrezik këtu, ajri lëviz gjyryk!

— Shuaje, shuaje, për besë, të hodha në rezervuar!

Tjetri e shoi në çast, e shtypi mirë në baltë dhe e bëri të pazbulueshëm bishtin e cigares, po, tani ishte vonë.

Gjatë galerisë ku po zbritnin shefat, ndihej në çast era e duhanit, edhe sikur ky të pihej në frontin më të largët të nëntokës. Ajri qarkullonte në gjithë punimet dhe dilte nëpërmjet kësaj galerie që shërbente edhe si rrugëdalje e dytë.

Sinjalisti dalloi mes tyre Hektor Veshin! I dha atij dorën, i uroi mirëseardhjen pasi Hektori i pati thënë «puna mbarë» dhe po provonte në ato qaste një gjendje të veçantë, një ndjenjë

të përbërë prej gjëzimit, që ish-mekaniku, shoku i dikurshëm, begeniste të vinte e t'i takonte, aty në nëntokë. Hera e dytë që vinte në minierë.

Ky është njeriu, po thoshte me vete, ky është njeriu i mirë. E po hajde thuaj pastaj që u bë i madh i biri i botës dhe na harroi ne ku jemi e ç'ka qenë vetë më parë! Hije mbi dhë bëjnë të gjithë, po jo të gjithë e kanë hijen e tyre! Fryhen me pendët e të tjerëve. Jo nën tokë që s'të vijnë, por s'të njohin as kur përplasesh me ta e as të pyesin qysh rron, apo qysh vuan, apo kur do vdesësh makar të të pyesin vetëm të të pyesin! Jo, jo, mor vëlla. S'është kështu ky Hektori ynë!

— I ke veshët në vend, apo... Ku të kullot mendja?! — po pyeste përgjegjësi i sigurimit teknik në këto çaste. — Ej! Kush po pinte cigare tani?

— Cigare?! Këtu cigare? Jo, vallahi, vetëm një i marrë e ndez cigaren në minierë, — i tha sinjalisti duke e zotëruar gjendjen.

Hektor Veshi s'po fliste. Buzëqeshte lehtë duke dëgjuar fjalosjen e tyre si një moshatar që i ndodh të ndjekë një bisedë intime të rinjsh, e cila i kujton vitet e rinisë së vet. Sytë e tij të zez e të mëdhenj, të menduar apo të kredhur kushedi në ç'liqen të së shkuarës, tani dukeshin edhe më të mençur në sytë e shokëve të dikurshëm të punës. Ishin veshur nga një vel i lehtë mjegulle.

— Po lodheni nga një çikë, o shokë? —
pyeti Hektori më në fund, duke u ulur tek ai
stoli i drunjtë ku hanin dikur minatorët.

— E po edhe lodhemi. Në punë vijmë. Ti
e di vetë!

Përgjegjësi i sigurimit teknik nuk po ndi-
hej më.

Hektori queshte me një përzemërsi të pa-
mbarueshme. Ndoshta kjo vinte sepse se-
cili prej objekteve që shihte i kujtonte ato vi-
te. Çdo gjë ia turbullonte të shkuarën dhe
dukej sikur atij herë pas here i duhej pak
kohë sa të kthjellohej, të pastronte vështrimin
e mendimin.

Fytyra e tij sikur ishte zbutur ca, kishte
marrë ca tipare si femërore, të èmbla; vështri-
mi ca i rreptë, i atyre viteve, i gjallë, i rrëm-
byer, ishte qetësuar në jetën që po bënte.

— Që dikush po pinte duhan, ajo ia bën
muuu, por unë s'mora vesh ishte evropiane
apo turke, — tha duke qeshur pastaj ai.

Përgjegjësi i sigurimit teknik ishte larguar
e nuk dëgjonte dot.

«Evropiane», u thoshte Nebi Areni cigareve
me filtër. Hektori nuk e kishte harruar as
këtë. Ata që e dëgjuan aty, nën tokë, provu-
an përsëri një ngrohtësi që u rridhete e u për-
shkonte gjithë qenien si ai zjarri që përparon
duke djegur duhanin e cigares. Mjafton ta thi-
thësh ndonjëherë dhe ai nxiton.

Pas çdo fjale të Hektorit ata provonin një gjendje të tillë.

— Jo, shoku Hektor, s'pi duhan njeri në minierë! — tha dikush dhe në po atë çast, po atij që foli, por edhe të tjerëve, iu kujtua një atmosferë fajësie me të cilën pa të drejtë e kishin rrethuar të ardhurin. «S'paskemi më besim tek ai?! E përse? Me ç'të drejtë? Ç'bëri ai që ne të lëkundemi?»

Ej, ti, ishin gati t'i thoshin atij që pati folur pak më parë, lëri budallallëqet! Ka ardhur te ne sepse, dreqi e mori, kishte dëshirë të vinte, sepse na do, ka ardhur të na takojë, kurse ne e largojmë; padashur, po sidoqoftë e largojmë sa po fillojmë të ruhemti prej tij.

— Atij po, atij mund t'i fshiheni, por jo mua! — tha 'Hektori për përgjegjësin, sikur t'i lexonte mendimet e atyre që e kishin vënë në mes. — Por unë deri dje këtu kam qenë, deri dje kam qenë vetë punëtor unë!

Iu afrua sinjalistik te veshi, po zërin e ngri-
ti aq sa të dëgjonin të gjithë aty:

— Do të ta them unë ku i fshihni cigaret? Apo të ta them ku e pini duhanin? Hë, kolopuç!

Hektor Veshi i la befas aty ku ishin dhe, duke vazduar të queshtë më shumë për vete se për të tjerët, nxitoi për më tej:

— Dhe mos pandehni se ma hidhni mua!

Pas kësaj ai nuk mund të kthehej më midis tyre, siç kishte ardhur pak më parë. Dhe

ata, qoftë edhe padashur, nuk mund ta prisnin më si herë tjetër.

— Sikur të kishte qëndruar edhe pak aty, unë do t'ia kisha treguar emrin e atij që piu duhanin. Po! Por sa mirë që s'fola! Më mirë të pirdhja nga goja, sesa të tregoja! — po thoshte pak orë më vonë sinjalisti.

Hektor Veshi po kërkonte, pa asnje kusht, emrin dhe marrjen e masave ndëshkimore, ndaj atyre që kishin pirë duhan nën tokë.

Në barakë zëri i tij s'ishte ai me të cilin bisedoi nën tokë. Duke kujtuar që në fillim, të fjalës së vet së shoqëria është tjetër dhe detyra tjetër, pra që Hektori i parë s'duhej ngatërruar me Hektorin e dytë, ai e zbriti pak tonin:

— Unë kam punuar vetë në minierë, po kurrë nuk shkonim ndër mend të bënim gjëra të tillë! Apo jo, more Tomi?

— Nuk thashë gjë unë, më duket! — u përfshigj kot më kot ky i fundit.

Një lloj tendosjeje kishte mpirë lëvizjet e të gjitha fytyrave. S'ia hiqnin sytë Hektor Veshit. Dikur e kishin dëgjuar me po kaq vëmendje. Tani se ç'kishte ndryshuar, se ç'kishte ndodhur që ata prisnin e prisnin të formonin një bindje përfundimtare. Ngjanin, ashtu duke e dëgjuar dhe duke e vëzhguar, si ata prindërit që kërkojnë të vënë re ndryshimet e fëmijëve të vet pas një ndarjeje disavjetëshe.

Hektor Veshi e përsëriti edhe një herë se

ishte jo vetëm i befasuar që aty pihej duhan, por edhe i zemëruar.

— Në minierë kam punuar edhe unë, por... — tha prapë ai, po dikush nga punëtorët e ndërpreu:

— Një mut ke punuar nën tokë ti!

Qe një zë që u ngrit dhe u ul aty për aty. Si një zog që kërcen nga njëra degë në tjetrën. U duk sikur atë mund ta kishte dëgjuar vetëm gjysma e sallës.

Po dikush nga presidiumi i vogël tha:

— Foli njeri?

— Do flas unë, po të mbarojë shoku Hektor një herë! — tha Tomi Margiti pa u ngri-
tur fare nga vendi.

— Bëj ca durim! — foli prapë zëri nga presidiumi duke parë hepimin e njerëzve pasi Tomi kishte thënë «shoku Hektor».

«O, o! Sa mirë bëra që nuk ia tregova emrin Hektor Veshit! Për pak ma prishi mendjen», po përsëriste me vete sinjalisti që punonte në fundin e kullës së pusit.

XXIV

Ata që i kishin dëgjuar mirë fjalët e thëna aty, që njihnin edhe Tomi Margitin edhe Hektor Veshin, kishin në fytyra një dritë sitë pasqyruar nga 'një zjarr që digjet mbi mobilje të bukura.

Tomit i thernin gishtat dhe përpara se të fliste ia bënte me vete «pu-pu-pu!», siç bëjnë gratë kur ndjellin sherr.

Një çast më vonë, kur u ngrit për të folur, dukej si i shushatur, i përhumbur; nuk po mëtreg vesh në ishte ngritur vetë për të folur apo e kishin çuar të tjerët. Po ç'kam për të thënë, në fund të fundit, pyeti veten. Dihet që të pish duhan nën tokë është gjë e poshtër, po këtë ç'ta thuash, këtë e dinë të gjithë. Po ç'do thuash atëherë, or qyqar, i tha vetes, kur as nuk di gjë cili piu duhan sot, kur po zbritnin në galeri shoku Hektor me të tjerët.

— Ja që i kemi të gjithë nga dy sy e nga dy veshë për të parë e për të dëgjuar e nga një kokë për të mos harruar... — ia nisi shtruar Tomi Margiti.

— Lëri ato, 'Tomi,' nuk ua kemi ngenë shakave sot! — i tha dikush.

Po. Tomi dhe gjithë të tjerët ishin aq të qetë, sa... Një qetësi, një siguri që dukej se nuk do të dilte thatë, tregonte më vonë shoferi i makinës që kishte sjellë Hektor Veshin: «Unë e njihja Tomin nga të thënat e shokut Hektor dhe doli se nuk e njihja keq!»

— Më vdekshin fëmija, po gënjeva, — tha Tomi, sikur dikush kishte kërkuar që ai të betohej se do të thoshte të vërtetën e vetëm të vërtetën. — E kam parë me sytë e mi atë kur pinte duhan. Te stacioni i pompave ka pirë. Do të na marrin më qafë, vallahi, kalamaqtë rrugë-

gëve do të na i lënë! Keq më vjen, por emrin do t'ia them këtu. Më mirë le të qajë nëna e tij, se gjithë nënët tonë. Apo jo, o shokëni?

Qetësia dhe mpirja e fytyrave pas kësaj fillojë të shkrinte si ato tokat e buta në mëngjeset me ngricë, pasi nxeh dielli.

— Asnjë emër nuk ka për të dhënë! Ta shihni! — foli një punëtor nga fundi i sallës me zë të ulët.

Herë tjetër, kur shihte se mbledhja përsëriste veten e vet, apo kur dukej qartë që askund nuk do të arrinte, Tomi Margiti ngrihej e, si gjithnjë, fillonte me fjalët që të gjithë i dinin përmendsh, ngaqë përsëriteshin dendur prej tij:

«Si njeri pa shumë shkollë që jam...» dhe vazhdonte i shoqëruar me zë të ulët apo me lëvizje të buzëve nga të tjerët. Vazhdonte pastaj me zë të prerë të kritikonte me emër, po dilte që të kritikuarit ose ishin transferuar në sektorë të tjerë, ose kishin marrë lejen e zakonshme. Në asnjë rast ata nuk rastisnin të ishin aty, në sallë.

— Pashë plot që po përgatiteshin për të qeshur aty, — tregonte më vonë bateristja e ndërrresës, Roberta, — por unë, që e kisha prapa Tomi Margaritin dhe që u ktheva e ia pashë të bardhën e syrit të ngrirë e fare të zbrazur nga ngjyrat e ngrohta, e ndjeva, por edhe si femër, që pas kësaj do të kishte tollovi, zhurmë, grindje. Ashtu i kishte sytë ai dhe ju e

dini që unë i lexoj sytë siç lexojnë filxhanët fallxhoret! Po se çfarë do tē thoshte e si e qysh, këtë s'e mora dot me mend.

Tymi i cigareve që piheshin në barakë ngri-hej luart deri në tavanin prej kompensate, pastaj, si ato re'ë e bardha që paralajmërojnë dëborën, merrte pér nga dritaret e dera, në krahë tē presidiumit, që pér këtë i kishin lénë hapur.

— Po tē duhet doemos emri i atyre që kanë pirë duhan e po tē më urdhëroni ju t'jua them, jua tregoj, o shokëni! Po më mirë mos ma kërkoni këtë, më mirë... — vazhdoi pas një ndër-prerjeje tē shkurtër Tomi.

— Të lutem, Tomi! Kemi respekt pér punën tēnde e tē nderojmë, po ç'është nevoja tē zgjatesh kështu, — i thashë unë, tregonte më vonë inxhinieri i sektorit, përpara drejtorisë së minierës. — Ku ta dija unë ç'kishte ndër mend tē thoshte ai!

— Unë kam pirë një cigare, ja ku po jua them. Unë bashkë me shokun Hektor, por jo tanë. Atëherë kur ai ka qenë punëtor.

Salla gumëzhiu. Rrymat e brendshme, që nuk dihej se si po shfaqeshin kaq njëkohësisht, po turbullonin jo vetëm thellësinë por edhe sipërfaqen.

— Ja ku jua thashë. Vetë më shtrënguat, — tha Tomi Margiti duke u ulur më në fund, me druajtjen e një bashkëfajtori tē difishtë. «Sa tē meritoj le tē ndëshkohem!» si-kur thoshte qëndrimi i tij.

Shoku Hektor, edhe po të kishte ndër mend të sqaronte diçka, nuk mund ta bënte këtë gjë në këto çaste. Çdo lloj ndërhyrjeje, qoftë edhe përgënjeshtimi vetë, ishte krejt i tępert, i kotë në këtë gjendje. Ishte njëlloj si të mbroheshe me gurë ndaj një sulmi nga sipër; dhe gurët do të kthehet prapë mbi kokë, i thoshte vonë në mbrëmje normisti i sektorit gruas së vet, por ajo përsëri ngrinte supet.

— Unë nuk kuptoj dot, përse qenka kaq e rëndë përmendja e një cigareje të pirë para kaq vjetësh! Sesi është logjika juaj, që punoni në minierë! — i thoshte gruaja, mësuese e ciklit të ulët, të shoqit.

— Po ja! Pas dhjetë vjet martese, kur kemi tre fëmijë, më thua dot mua, ti, moj grua, se je e virgjër?! — mezi filloi ta qartësonte burri.

Unë nxitova të ndizja makinën, u tregonfe një ditë më vonë kolegëve të vet shoferi që erdhë me shokun Hektor. Ai u vonua edhe ca, u kthyesh duke u përpjekur të buzëqeshte, po në pasqyrë unë e shihja mirë se diçka e turbullonte. Ç'm'u desh mua të shkoja e të dëgjoja në mbledhje, thosha me vete njëherë, por pastaj «mirë bëra», thashë. E përse të mos i dimë të gjitha?

Do ktheheni në shtëpi? e pyeta shokun Hektor.

Jo, jo! Nuk kemi nge, më tha, dhe mua, të thuash të drejtën, sikur m'u dhimb. Të

vesh gjer te dera e të mos kthehet te gru-
aja...

XXV

Vetëm gruaja nuk harrohet, dëgjova të flis-
snin atje jashtë.

Ndoshta flasin përmua, thashë me vete;
Për mua s'kanë përsë flasin, thashë. Për gru-
an flasin kur nuk e pret burrin, jo kur e pret
kaq gjatë.

Kaq kohë pa ardhur dhe nuk u kthye as
këtë radhë?! Është e pamundur, tha një tjetër.
Sikur e ka harruar!

Po, për ne e kanë fjalën, thashë. Më erdhi
si hidhur kur thashë «ne». Ai ishte tjetër dhe
unë isha tjetër.

Vetëm gruaja nuk harrohet, tha prapë zëri
i parë. Ne këtu jemi e, kur afron fundi i tetë
orëshit, na rëndon malli për gratë, jo latë!

Aq më merr malli, o shokëni, sa, kur iki
nga shtëpia, e porosit gruan të mos ia vëré
grepin derës në darkë. Se do zgjoj gjithë pa-
llatin, i them, more vesh?! Dhe s'e vë grepin
ajo, se ma di kokën muaj! Ngrihet, kur vete
ora, e më pret te dera.

E qeshura e tyre vjen gjer këtu, te llambisteria,
po ne bateristët s'e marrim për keq.
Ne, gratë e minierës, të paktën, të rralla mi-
dis minitorëve, mësohem shpejt të dëgjojmë

vetëm aq sa duhet dëgjuar, atë që na takon neve. Mekanizmi i dëgjimit te ne të sjell ndër mend vetëstakimin e frigoriferëve kur temperatura ulet nga kufijtë e lejuar.

Ata nuk qeshin si njerëz të këqinj, thashë me vete, pa ndier asnjë lloj mërie për ta.

Ajo është flori, tha dikush. Flori, por digjet kot, shtoi një tjetër.

C'na duhet edhe nevë që mbajmë në gojë të tjerët.

Njeriu me njerëz rron. Edhe duhet të dëgjojë e të flasë për ta. Të ndihmojë, të ruhet, të mësojë diçka. Ky është njeriu.

Po s'e deshe, jepi udhët gruas. Nuk të dua, i thuaj e mbaroi puna. Mbledhin mendjen të dyja palët. Ja, siç e bëri Nebiu.

Lëre Nebon ti. Nuk shtyhetjeta me një grua, thotë ai.

Rri, more kopaçe, rri ti, gjëmon zëri i Nebos.

XXVI

Vili Haruni e ka pasur shok Hektorin.

Vili Haruni ka filluar të flasë tanë për Hektorin. C'kishte Hektori më shumë se unë? C'kishte më të mirë se unë? U kishte thënë dytre njerëzve, në shenjë affërsie. Po ju mos i bëni fjalë këto që po them, se, kushedi, thonë s'e ka dashur Vili të ngjitet lart. Po ju më

njihni mua, u kishte thënë ai, me një ton të tillë, i cili i kishte shtyrë dy-tre dëgjuesit që këto gjëra t'i bënин muhabet vetëm me dy-tre miqtë e vet, të cilët, të shtyrë nga po kjo ndjenjë, si ato tullat e ngritura në këmbë që rrëzojnë njëra-tjetrën, e kishin shpërndarë këtë intimitet deri në fund.

Pa e kuptuar ai, mblidheshin në biseda të vogla e të gjera, pluse të tij dhe minuse të tjera të Hektorit dhe, sado që ata kishin qenë shokë, dilte se, në mos rastësi, siç e quante në grupe të gjera Vili, ngritja e Hektorit ishte vepër e miqve dhe e dashamirëve të padeklaruar të tij.

Ju vetë e dini që për vite të tëra Hektori nuk çonte një lek në shtëpi. I linte klubeve, apo jo, thoshte Vili, si pa qëllim. Ja që kësh-
tu është, sikur thoshte.

Hektori me kë s'ka pirë, tha dikush, edhe me ty, Vili.

Po, ka pirë, nuk ka pse ta fshehë njeri. Por ai më njihte mua. Me siguri i shkonte mendja se, ku i dihej, po të ngrimesha unë më përparrë tij, do t'i duhesha.

E, mirë, bëni llafe kot ju. Ai është atjelart e ju angullini këtu poshtë, ia priti një tjetër. Ai ishte i shkathët, ishte i zoti i fjalës, manovronte, këtë thuaj. Dhe i lumtë!

Vili Häruni u detyrua të bënte «po» mesy.

Megjithatë mua më duhet të flas, tha me

vete. Ai nuk flet kот, dikça di, prandaj... po thoshtë një tjetër pёr Vilin.

Po Vili Haruni fliste vetëm pёr gjëra të shkuara, të vjetra.

— Të thuash të vërtetën, Hektori e ka pasur gogol punën, — thoshte ai.

— Dhe po të jetë e vërtetë kjo?!

— Ai që ka frikë punën fizike, të gjitha punët i bën me frikë se mos kthehet prapë aty.

— Kjo s'është e vërtetë në cdo rast, — tha një zë i ulët, por i vendosur, e që buronte prej një qetësie të brendshme.

Kishte folur Gani Elezi.

Njerëzit që ishin aty, heshtën. Pritën të fliste ai. Ai i dinte më mirë këto gjëra. Në qoftë se pёr këto biseda nuk do të ishtë i interesuar dikush, mendonte Ganiu në këtë çast duke pasur parasysh Vilin, ju pothuaj; pa asnjë rezervë, s'do t'i bënit.

Dhe në qoftë se ka ndonjë gjë të veçantë e interesante në këto biseda, kjo mund të ketë të bëjë vetëm me arsyen pёrse i provokon Vili Haruni ato. Po ja që ne pikërisht pёr këtë gjë nuk flasim. Edhe pse të gjithë ndiejmë e mendojmë njëlloj.

XXVII
Heshtjen Gani Elezit mund t'ia merrnin me dy kuptime.

Kujtonte të shkuarën e vet, apo duke pasur parasysh atë, gjykonte për Hektor Veshini?

Po heshtja e tij mund të kuptohej edhe si druatje për të thënë atë që mendonte më të vërtetë për punën fizike, autoritetin e saj, raportet me të tjerat.

Këto i kemi dëgjuar sa herë. Dhe e keqja është se s'kanë të bëjnë me thelbin e çështjes, tha më në fund ai, duke u mënjanuar paksa e pastaj duke u larguar fare nga grupei i njerëzve.

Po ky, c'pati kështu, tha dikush e të gjithë qeshën nga pak.

XXVIII

Roja e së dielës hyri të hënën në mëngjes në zyrat e sektorit, i turbulluar nga ajo që do të raportonte, po doli prej andej si i hutuar. Ajo që raportoi, ishte pak a shumë kjo:

— Iu afrua stendës së emulacionit pa u ruajtur nga njeri. Sikur i dhembnin sytë, — tha roja në zyrë, të hënën në mëngjes. — Sapo arriti aty, e shkuli fotografinë, e palosi dy-tri herë dhe e grisi! Pastaj, ashtu copë-copë, siç e bëri, e hodhi në një baltovinë dhe e llapazhit me këmbë. Iu afrua prapë tabelës, po nuk bëri gjë tjetër. Mua më ngriu gjaku e nuk i bëra zë fare, e lashë të ikte...

— Mirë, mirë, shko! — i tha qetë-qetë shefi

kur roja i la mbi tryezë copat e fotografisë së grisur.

— Janë bërë lémsh ca gjëra, apo unë jam tre-guar baballék në detyrën time, pyeste veten roja duke dalë. Po ti ç'ke që e vret kot mendjen, i tha vëtes pastaj. E more ditën e punës? Po. Atë që pe, e tregove? Po. Atëherë ç'të nënës ke që kruhesh kot?!

XXIX

— Jo! Vetëm fotografinë këtu jo! — pati-thënë me zë Gani Elezi.

Kishin kohë që ia kërkonin një fotografi, por ai nuk ua kishte sjellë. E kishin gjetur ata vetë. Atë fotografi kishte grisur...

Unë punoj se kështu duhet bërë, se të gjithë punojnë;

— Kot gënjen veten, o Gani! — i tha tek po lanin çekiçët Velo Mersini.

— Lërmë, të keqen, edhe ti, o Velo! Pa mirë këta të tjerët. Se ç'i ka zënë më mua, një allah e di!

— Po mirë e kanë.

— Edhe ti kështu thua? Nuk më thua dot gjë tjetër, ë?

— Po ti punën e ke bërë, o Gano.

— Si qeni le ta bëj. Dhe jua di për be-reqavers po të më nderoni për këtë, po kre-

naria juaj s'bëhem dot unë, apo e kam gabim, o Velo?

— Ku e di unë ku të vete mendja ty, por që e ke gabim, këtë e di edhe bufi. Vetëm ti s'do që s'do ta marrësh vesh!

— Mos u shkoni shumë pas qejfit, o Velo!
— tha një tjetër.

Pa e parë, Ganiu ia dalloi zërin.

Mezani, tha me vete, Mezan Nazemi.

— Unë i kam të njomë krahët, — iu përgjigj përnjëherë Ganiu atij.

— E po ne nuk do t'ju marrim dorën juve, — tha prapë Mezani. — Ta dini se ne po junderojmë më shumë se ju takon.

— Kujt i thua «juve» ti, o Mezan? pyeti duke u kthyer andej Gani Elezi.

— Ty dhe atij tjetrit, që iku nga ne, e, siç e ka zënë, prite kur të vijë prapë këtu:

Ganiu atë ditë provoi se përpara Mezan Nazemit të irrituar të ikte goja, nuk filsje dot. Si kur të ishe përpara ujkut.

Paska arsyе Vili Haruni që flet për Hektor Veshin lart e poshtë, tha me vete. Shkoi ndër mend se pothuaj gjithnjë ndryshimin e motit e ndiejnë banorët e kënetës të parët.

Më në fund, pas një ëndrrre të patregueshme, një ëndrrre që, edhe po ta tregoje, nuk mund ta shpjegoje, Hektor Veshin e thirrën (ai kishte harruar, pothuaj, ta thërritnin, ta kërkonin) diku, ku parandjenja i thoshte se nuk shkonte për mirë.

Por unë shkoj se më kanë thirrur, duhet të shkoj, tha me vete.

Atje ku e thirrën, nuk e pyetën për ëndrrën. Atje as që e dinin si flinte ai, në shihte ëndrra apo jo dhe çfarë ëndrra ishin ato, në qoftë se shihte.

Ulu, i thanë dhe, pasi u ul, ai ndenji i mpirë, si i hutuar, duke hetuar prapë e prapë, pa mundur të merrte vesh asgjë përsë e kishin thirrur me aq ngut, me atë mënyrë.

Njerëz si unë lindin e vdesin nën një shqetësim të përjetshëm, tha duke pritur.

Shkoi ndër mend se kur zbriti nga zyra e vet poshtë, nuk i la adresë nëpunësit të shërbimit, por as ai nuk e pyeti. Sikur folën në heshtje me njëri-tjetrin: «Nuk të duhet ty ku po shkoj!» «As që më duhet ta di, se ty nuk të kërkon më njeri!» sikur iu përgjigji nëpunësi i shërbimit me indiferencën e vet.

As shoferin nuk e kishte thirrur. E bezdiste prania e tij pas asaj që ndodhi në mbledhjen atje, te minatorët. Po shkoj më mirë në këmbë, tha me vete. Kushedi atje, ku më kanë

thirrur, e vënë re që po u shkoj në këmbë, pra kokulur.

Endrra ishte tjetër...

Atë, Hektor Veshin, e transferonin në një zyrë tjetër, të një ndërtese tjetër, madhëشتore.

Vetëm pak kohë nga fillimi i punës aty ndjeu se koka dhe shputat e duarve po i rriteshin me shpejtësi të llahtarshme, në shpërpjesëtim të plotë me pjesët e tjera të trupit. Kjo edhe e trembte, edhe e gëzonte. Herë-herë queshte që po bëhej «kokë e madhe», me gjymtyrë të fuqishme, po jo rrallë tronditej nga që, pa e kuptuar, po diferencohej prej njerëzve të tjerë.

Se erdhi një ditë kur shokët e zyrës dolën për të shkuar në shtëpi, kurse ai nuk mund të dilte dot më prej aty. Koka e duart ishin stërmadhuar aq shumë, sa duhej të prisheshin muret që të dilte ai. Që prej asaj dite kur u mor vesh që ai do të ishte aty i përhershëm, u quajt zyra e Hektorit. Në fillim në zyrë, pastaj në zyrat e tjera, madje ca më vonë në të gjitha zyrat, filluan të merrnin mendimin e tij përfundimtar.

Përmasat që mori, bënë që ai të vendoste edhe për ndryshimin, heqjen, lëvizjen, largimin, shtimin e pakësimin e zyrtarëve të të gjithë ndërtesës, ku vetëm ai ishte detyrimisht i përhershëm, madje i përjetshëm.

Vetë ndërtesa dhe vendi përqark saj mo-

rën emrin e Hektorit, të njeriut me kokë të madhe dhe ai e quajti të domosdoshme, madje detyrë të vetes, marrjen e masave ndëshkimi more ndaj të tjerëve. «Të tjerët» ishin gjithë çmabeteshin, veç tij.,.

— Apo nuk është kështu, shoku Hektor?...

— po i drejtoheshin. Vuri re se kishin ardhur disav të tjerë aty.

— Për se e kishit fjalën, ju lutem? — u përgjigj ai duke u përpjekur të dilte sa më shpejt nga realiteti i ëndrrës.

— Për punëtorët themi...

— Oh, punëtor kam qenë vetë unë, — e ndërpreu Hektori duke qeshur.

— Ndoshta, — tha tjetri fare qetë.

— Si ndoshta?! Unë e di mirë së ç'kam qenë!

— Aq më keq! po të jetë kështu! — përsëri bashkëbiseduesi përballë.

Po kush është ky? Ku e kam parë? Ku? Si? Po vriste mendjen duke parë fytyrën e qetë, po ku një zemërim nuk mund ta fshihte dot praninë e tij. Mendoi se prej kësaj marramendjeje do të cilrohej vetëm po ta pyeste drejtpërdrejt këtë njeri: «Ku jemi parë? Hë, more shok, ku, pse na turbulloni kot kështu?»

— Sikur të më kishe harruar vetëm mua, do të ta falja, fare thjesht, por... — i tha tjetri. — Nuk është në dorën time, as të kurrikujt fjetër... Kjo që ke harruar ti...

Pas kësaj çdo gjë u qartësua me një shpjegim po aq të llahtarshëm, sa ndodhi në ëndërr rritja e kokës.

— Vërtet ke qenë punëtor ti?! — e pyeti një tjetër duke dalë jashtë.

— Po, po, përsë pyesni kështu?! — u habitai.

— Është për t'u habitur! — thanë dy të tjerët, nga ata që kishin qenë brenda, duke e vështruar si një qenie që, çuditërisht, ekzistonte ende.

Me gjithë ato që dëgjuam për të... dhe të ketë qenë me të vërtetë punëtor?!

XXXI

— Ju kujtohet vallë ai Hektori, ai që trengonte, dikur, ato barceletat? Hë, mo, ai që tërbonte shefat e të deleguarit, që fliste aq bukur për minatorët? ... S'ju bie ndër mend?

— Akoma jo.

— Ai, pra, që u ngrit lart...

— Ah, po, po! E çfarë ka ndodhur?

— Ja, pra. Ai është shkarkuar e kthehet këto ditë prapë këtu.

XXXII

Nuk e dinim që, prej kaq kohe, shumë prej nesh kishim pasur rezerva për Hektor

Veshin. Asnjeri nuk mund tē thoshte pērse nuk i kishim kthyer nē fjalë ato qē kishim menduar. Pērse e kishim kyçur gojën kāq kohë. Tē paktën tē ishim ngritur e tē kishim thënë diçka ditën e miratimit tē karakteristikës së tij.

— Atë ditë zor se binte ndonjë fjalë nē vesh, — tha dikush duke ulur kokën. — Atëherë na mblodhën sa pēr tē provuar dëgjonim apo jo!

Zëri i mblidhet nē grykë e duket se ai hesht sikur ka frikë mos mbetet pa frymë.

— Sikur tē kesh mundësi qē t'i shikosh me përsëritje, si, nē televizor, ato qē kanë ndodhur, — thotë një tjetër, — o, si do dalin atëherë gabimet, fajet, o! Si golat nē përsëritjet e ndeshjeve tē futbollit!

— Ajo karakteristika e Hektorit ishte yç me detyrim — përcaktim e s'lëvizje dot tjetër.

— Ore vëlla, secili ka punën e vet. Atje ai vetë është zot e nuk tē lë t'i futësh hündët.

— E, mirë, mirë, thuaj! Kur bie shi, është mirë qē nē rrugë tē dalësh me çadër, po dole. Ose rri nē strehë e mos u ndiej! Dhe çadrën mos e mbaj përbys, se shiu bie nga sipër, jo nga poshtë!

— Or po shiko në punën tonë ti! Kûr avaria gjémón, ne e lëmë tē bëjë punën e saj, por më parë largojmë njerëzit e materialet, apo jo? Le tē hajë bishtin e vet shembja pastaj.

«Në kujtesën tonë nuk zë dot vend gjithçka, po thoshte me vete një minator aty më tej. Madje, kur na sheh nga larg, duket sikur për shumë gjëra ne nuk çajmë kokë.

Po nisja e një njeriu, që kishte kaq vjet mes nesh, për lart, nuk kish si të mos na e përpinte vëmendjen. Sidoqoftë, ai dilte anga ne dhe, në një mënyrë apo tjetrën, edhe druri, i shtrembër, në një pyll të drejtë, dru është. Dhe Hektori një lloj punëtori s'kishte si të mos ishte. Duke ndjekur ngjitjen e tij, ne shihnim veten tonë, provonim veten...

— Mua për vete sesi më duket kur përdor fjalën «lart»! Hektori u nis për lart, themi ne. Nuk di që kur ka mbetur ky përfytyrim për punën e kuadrit, të drejtuesve. Ndoshtha nga kjo vjen edhe ajo që, pse ta mohojmë tanë, atëherë ne mendonim më të vërtetë se Hektori mund ta bënte punën «lart». E pse? Vëtëm pse ai fliste bukur. Dhe, të paktën unë, e kam quajtur të folurën si talent për tu ngjitur atje.

— E kam thënë unë, mor vëlla, jo! vëtëm nga praktika ime, por edhe nga historia bortërore, femra, po që shumë e bukur, është budallaqe, kurse burri, po foli bukur, është mashtrues.

— Një ditë kishte sjellë furnitorin e ndërmarrjes për të dhënë llogari para minatorëve. «Unë s'jam armatosur, po zemra më dhemb kur pashë që po prisin shyllat e trasha me

sqepar Çak-çak Çak-çak Na thuaj, shoku furnitor, pse na i lodhni kot njerëzit, pse nuk sillni sharra dhe lima sharre? Pse na i bëni njerëzit të pakënaqur? — Kështu e mbërtheu me fjalë furnitorin, që e humbi toruan fare.

— Kush e dinte që do t'i vente filli kështu? — Po fliste për Hektorin, sikur ishte fjala për një të vdekur.

Njerëzit pinin cigare dhe bisedonin. Pastaj heshtnin ca e prapë kujtonin diçka dhe e tregonin.

— Ditën kur do ikte, erdhi e na takoi të gjithë. Fluturonte, ore, fluturonte fare. Sikur e patën mbajtur lidhur këtu. Aq gëzonitë, sa i ishte derdhur në krah Nebi Arenit. «Edhe mua më puthe a derëmbyllur?!» — i tha Nebiu duke e shtyrë tutje.

Po gëzon që ikën? e pyeta unë, tregonte një minator që tanë kishte dalë në pension. Sytë ia shihja afër, as një pëllëmbë larg. Për mirë po iki, apo jo më tha. Pse, këtu me ne nuk ishte mirë? Po njeriu përpinqet përmë mirë e më mirë, ma priti sikur ta kishte përgjigjen në majë të gjuhës. Apo nuk bën që të ngrihet lart i biri i Zeqir Veshit?! shtoi pastaj si për të ma rrëzuar njëherësh edhe hijen më të vogël të dyshimit. I ziu Zeqir, të zezë e kishte pasur jetën e vdekjen vërtet. Dhe unë i besova Hektor Veshit, o shokëni. E si të mos i besoja?.. Kush mund t'i besojë tjetër njeriu sot?

— Unë i shkova në zyrë, para ca kohe, — tregoi një tjetër. — E kisha edhe unë një hall, se njeri jam edhe unë, e i shkova atje ku punonte. Ç'është e vërteta, disave ai u kishte bërë hall, po mua nuk më dëgjoi fare. Më priti me këmbët e para. «Kjo është zyra e pullit, nuk është imja!» — filloi të më bërtiste sikur më zuri në vreshtin e Zeqir Veshit. Fytyra iu err pak nga pak e unë ika. As që më shkoi ndër mend ta sqaroja, siç erdhi puna. E ç'doja unë i ziu? T'ia shtynin një vit të drejtën e studimit djalit të dytë, sa të mbaronte i pari, se ku u dilej dot të dyve me para. Ika duke djersirë mendjen time. Pse të bënte ash-tu, thosha, duke zbritur shkallët. Më thirri de-zhurni e desha s'desha, unë ia tregova hallin. Telefonoi në dy vende dhe «ik!» më tha, u bë ajo punë. E, more, e! Dezhurni e zgjidhi hallin tim. Nuk i tregova njeriu, gjer sot, për Hektorin. Edhe po të tregoja, nuk do të më besonte askush, se edhe unë vetë nuk do ta besoja, po të ma tregoni një tjetër atë që kishte ndodhur me mua.

Ja që së vërtetës, së drejtës i kërkojmë prova akoma dhe dëshmitarë, për të bërë fajtore gënjeshtrën, të padrejtën, hipokriten.

XXXIII

Po mua, mua përse më trazojnë bisedat për Hektor Veshin?

Pa e kuptuar as vetë, Gani Elezi kishte filluar ta përafronte jetën e vet me të Hektorit, për të cilin thuhej se do ta kthenin së shpejti në qytet.

Sado i largët të ishte shëmbëllimi, sado që yjet e jetës së tyre kishin shkëlqyer në kohë të largëta, Ganiu nuk ngurronte të pranon te se prapë ata kishin diçka të përafërt. Kjo «diçka» e Ganiut dikur, po përsëritez te Hektori tani, paçka se në një trajtë tjetër.

Hamendja për ta ushqyer këtë mendim brodhi larg e afër, si një kalë i uritur që këput litarët me të cilët e kanë ngjacuar netve të mendimit.

Atëherë e kishin caktuar llogaritar në një kooperativë që vetëm kryetarin (ish-partizan) dhe llogaritarin kishin kuadro. Ganiu kishte shkollë vetëm një vit të tregtarës.

Grumbullonin grurin në lëmë dhe, për të mos e prekur me dorë njeri, natën, mbi pirgun e grurit, ai shkruante me gisht: *Rroftë Pushteti Popullor!* Dhe s'e ngiste njeri grurin.

Tani është tjetër, tha Ganiu duke qeshur me vete. Tani çdo gjë është tjetër, çdo gjë është ngritur lart, prandaj s'është aq e lehtë të ngjitesh. Por edhe të qëndrosh këtu poshtë, s'është më e lehtë, shtoi duke qeshur.

Ai u nis nga punëtorët, si element i tyre, dhe jo si ti, prandaj ka përgjegjësi më të madhe. Po ku ka rëndësi fillimi, nisja, kur ti e

mbylle aq keq karrrieren tende, i tha vetes si pér t'i mbyllur gojén.

Duke e krahaksuar pa pushim veten me Hektorin, né një kohë që dëgjonte aq shumë pér të, Gani Elezit i dukej se nuk duhej të linte të teprohej me lavdërimet pér veten.

Grisi fotografinë e vet, heshti kur dëgjoi fjalët e Mezan Nazemit, por mendoi se pas kësaj diçka mund të merrej vesh: Hektor Veshi, si dukej, s'i kishte punët mirë.

Sado që ai ishte tjetër, sado që né këto kohë njerëzit aty mendonin pér ata të dy né mënyra të kundërtta, pa kuptuar pse, Gani pëshpëriti përsëri: «Gani Elezi nuk ka pü- nët mirë!»

Dhe sikur të mendonte vërtet pér veten, u pérpoq të përfytyronte një rënie të mundshme pér Hektor Veshin, por s'mundi.

Jo, ajo do të ishte diçka e rëndë, mendoi, e papërfytyrueshme. Po aq sa e pamundur, shtoi pastaj duke mendur se, sidoqoftë, mund të bënte diçka.

XXXIV

Korriku i pati mbyllur njerëzit nëpër kabinë. Si ata djemtë e vetëm, tekanjozë, qe bërë papritur i padurueshëm. Vera, pér disa ditë radhazi, ishte kthyer né vjeshtë të vërtetë.

Një erë gjerryese, prej grimcave të rrëres,

rrahu pa pushim edhe xhamat e dritareve të makinës me të cilën udhëtonin.

— Sa keq për ata që u digjen ditët kot, — tha shoferi për plazhistët e mbyllur brenda.

E ç'e keqe qenka vetëm pse humbin dytri ditë plazh, tha me vete Hektor Veshi. Dhe shoferi sikur nuk e dinte se ku shkonin tha me zë:

— Ja, ata djemtë po lahen akoma.

— Ne flasim për shumicën, jo për disa, — qeshi lehtë shoferi.

Për disa dhe për ndonjë, shtoi me vete tjetri.

Në ata treqin metra rrugë buzë detit Hektori vuri re guaskat që ishin zbuluar nga era mbi rërën e bregut. Qindra mijëra, të të gjitha ngjyrave, si në një mozaik të vërtetë, ende të papërfunduar. Mbi këto guaska shtrihen njerëzit pothuaj të zhveshur!? pyeti veten. Ehe, sa gjëra nuk di njeriu, iu përgjigj, As aq sa i duhen s'di dot!

As ai vetë nuk dinte, midis të tjershë, përsë po bënte ç'ishte e mundur të kthehej në qytetin e vet sa më vonë, kur të binte mbrëmja. Nuk donte ta shihnin? Po një ditë ata do të më shohin! Nesër apo pasnesër, a tri ditë më vonë, ku ka rëndësi kjo. I padukshëm nuk mund të bëhem, tha me vete. Përderisa vetë u përpoqe kaq gjatë të bëheshe tepër i dukshëm! Tani s'e kam më në dorë të mos bie në sy,

tha më në fund. As të mbyllem, të vetëburgosem në shtëpinë time, as këtë s'e bëj dot. Sa mirë do të ishte po të më kishin harruar, të mos dinin asgjë për mua... Të paktën të mos dinë që unë po kthehem sonte në qytet!

Ah, sikur të mos më presin! Sa mirë do ishte!

Një çast më vonë, kur mendoi atë që dëshironte, ndjeu të rrëqethura në trup e pastaj trupin ia mbuluan djersët. Mezi po merrte frymë, kur në mbulesën e errët të mbrëmjes u shfaqën dritat e qytetit.

— Të lutem, ndalu pak! — i foli shoferit. Makina ndali për pak.

Hektori doli dhe u ul në një gur.

— Duhet të kthehem prapë sonte, — tha shoferi.

— Po hipi sipër më mirë. Aty ndoshta lehtësohem pak.

— Si të duash, por ke djersirë, do ftohesh, — tha tjetri.

Makina kaloi mbi një urë të sapopërfunduar, kaloi mes një grumbulli pallatesh e doli në rrugën e gjerë. Ata tanë shëtitin, tha për bëshkëqytetarët. Edhe plot të tjerë ngrinin supet kur shihnin sa shumë njerëz dilnin në mbrëmje në dy trotuaret e vetme e të ngushta të qytetit të vogël minator.

U përpoq të mos dukej në mes të mobilive që po sillte me vete. Duke qëndruar ashtu i përkulur, gati si gjunjazi, ngjante si një nje-

ri që pati hipur në atë makinë rrugës, në ecje e sipër, fshehurazi, pa i thënë shoferit, kurse makina sillte pikërisht atë.

Po diku iu desh të zbulohet, madje të zbriste nga karroceria e të hynte në kabinën e ndriçuar, se duhej që t'ia tregonte rrugën dikush shoferit.

Tani nuk mund të mos e shihnin.

— Hektori, mej! Erdhi Hektor Veshi! — dëgjoi të flisnin. Sikur pëshpëritnin të rriturit e bërtitnin të vegjlit, që, edhe pse s'e kishin njohur, kishin dëgjuar pér të aq, sa t'i jepnin zërit atë dridhërimën e veçantë të këtyre rasteve.

Me qarkullim ka ardhur?! — u dëgjua që thoshte dikush. Pyeste, përgjigjej, apo tallej, kjo nuk kishte asnjë rëndësi më. Po aq sa kureshtja pér të mësuar cili ishte ai që pyeste, përgjigjej apo tallej. Kushdo mund tabentë këtë në qytet, ku ai kishte vetëm dy vëllezër dhe gruan, me të cilën nuk bashkëjetonte që prej s'di sa kohësh.

— Ka ardhur me qarkullim, natën! — u përgjigj një zë tjetër.

Pas kësaj ai e kuptoi se ata dy njerëz që u afroan te makina e i propozuan ta ndihmonin, pa dyshim do të ishte prej fundërrinës së qytetit dhe kishin shpresë mos rrëmbenin ndonjë send.

Me këta do ta kishte më lehtë. Ndaj tyre nuk duhej të kishte shumë druajtje.

Ajo qëndronte te hyrja e njërës prej dhomave. Mbështetur te parvazi i derës me supin e djathëtë.

— Erdhe? — pyeti me ngadalë, zëulët.

Hektori nuk iu përgjigj, duke e ditur mirë se ajo nuk priste përgjigje. As që priste, madje, prej tij, kërkesën për ta falur, në një formë apo tjetrën.

Gjatë rrugës ai pa menduar gjatë për Mirjanën. Herë pas here në gjithë qenien e tij ndiente si vërvshonte një vrull fajësie ndaj kësaj gruaje të braktisur në heshtje.

— Po këto?! Mobiljet e tua?! Vetëm je? — pyeti ajo e befasuar.

Ku e ke hallin? Përse dyshon vallë?, mendoi Hektori. Si grua pyeti?

Prapë nuk foli. Sikur të druhej mos zëri i tij do të ndizte si eshkë heshtjen e saj, që kërciste si turrë drush të thata.

Duke ardhur, pati dyshuar mos ajo nuk do t'ia hapte derën fare.

Po Mirjana, pasi u end pak te hyrja e dhomës së vet, mbylli derën dhe nuk e hapi më.

Sidoqoftë Hektori i ishte mirënjohnës për atë butësi, e cila, sado e sipërfaqshme që ishte, prapë butësi e kishte emrin.

Solli ndër mend faktin se ende ata figuronin si bashkëshortë në dokumentet zyrtare,

po ky iu duk argumenti më qesharak për ta shpjeguar qetësinë e Mirjanës.

Disa ditë do të më duhet të rri mbyllur këtu, në këtë dhomë, tha me vete. Tej murit ndarës, në dhomën tjeter, do të ishte ajo, që ende mbante mbiemrin e tij.

Në mëngjes, kur hapi derën e vet, në një karrige vuri re një pjatë. Dy vezë të skuqura e ca djathë e bukë.

Dikur kemi ngrënë në një pjatë si kjo, tha ai gati me zë. Dikur... jemi dashur! Unë, dështaku... unë ika, unë... Ai ishte i sigurt se kurrë, në një mijë seanca hetuesie, sado të ashpra, ai nuk do të mund të nxirrte dot qoftë edhe një shkak, një arsy, sado minore, përtë justifikuar qëndrimin ndaj kësaj gruaje.

Në orët e vona të natës doli në dritare, vëzhgoi frymëmarrjen e qytetit, i cili gjithnjë flinte përgjysmë. Nën tokë punonin minatorët.

U mundua të përfytyronte edhe lëvizjet në dhomën tjeter. Apo as ajo nuk flinte? Vuri veshin në murin midis dhe provoi të përgjonte.

Kur në mëngjes gjeti vezët e skuqura e dja-thin mbi karrige, mbrapa derës, mendoi se ajo do të vepronë kështu edhe në drekë, edhe në darkë, e pse jo, edhe pasdarke, shpresoi, edhe vetë s'dinte pse. Dëgjoi hapa në korridor e, kur ata u shuan, hapi derën, po pas saj nuk kishte as karrige, as pjatë, as gjë.

As vëllezërit s'po vijnë, mendoj i turbulluar, sikur pak më parë të kishte humbur shpresën e fundit.

Kur kishte vdekur nëna, ai kishte ardhur vetëm për dy orë. Pas varrimtë saj Hektori nuk ishte kthyer në shtëpi...

Vonë, në mbrëmjen e ditës së dytë, kur ora kaloi dhjetën e rruga sadopak mund ta fshihet me gjysmerrësirën e saj, ai doli nga dhoma, pastaj nga korridori i pazhurmë, zbriti shkallët dhe... Nga do shkoj, pyeti veten. Askund! Ku të të çojnë këmbët, u përgjigj. I vetëm shkon ku mund, ku të duash.

Hë, de, lëvizni, u foli këmbëve duke e menduar veten si një barkë me vela në det të hapur. Po era, era...

XXXVI

— Sekush vejevinte përparrë shtëpisë sonë!
— i tha gruaja, kur Qerem Veshi hyri brenda.

Ai e pa në sy për të marrë vesh diçka më tepër, po kuptoi se s'mund të kërkonte gjë më shumë se ajo që dëgjoi.

— M'u duk se atë njeri e pashë edhe mbrëmë, — shtoi ajo. — Kalon këtu, hedh një sy këtej dhe ikën për të ardhur prapë. Se ç'ka!
— Gruaja qeshi sikur donte ta qetësonte, t'i thoshte se ai njeri s'kishte punë fare me të, si grua.

Qeremi pas pak u afrua te dritarja.

— More vesh gjë pér Hektorin?

— Më lër rehat edhe ti, — iu përgjigj gruas.

— Po e keni vëlla! — tha prapë ajo.

— Sepse kemi një mbiemër?

— Edhe pér atë, po keni edhe një gjak.

Ajo e ngriti zërin. Po i rrinte përballë.

— E kam unë vëlla apo e ke ti Hektorin?

— Qeremi foli me ton të lartë. «E more vesh, mos ma mërzit më kokën, po deshe», do të thoshte ajo.

— Mos e kanë sjellë prapë këtu? — pyeti përsëri ajo.

Qeremi nuk iu përgjigj. Po ndiqte me vëmendje diçka atje tej, në rrugë.

— Ai është, — tha gruaja, duke iu afruar dritares.

Ishte Mezan Nazemi.

— Qeni! Qeni i Nuro Çelës! shau. Nuro Çela, gjahtari më i zoti i qytetit, mbante qentë me nuhatjen më të mirë.

Gruaja qeshi.

Mezani bëri po ato lëvizje që kishte thënë ajo. Sikur me të vërtetë të provonte sharjen e Qeremit, ngriti pak turinjtë përpara portës së hapur dhe u largua. Më tej e ktheu edhe një herë kokën pas.

— Qen gjahu! — tha prapë Qeremi.

— Pse shan ashtu? — pyeti gruaja.

— Unë nuk e shaj. Unë i thërres gjérat me emër.

Ajo qeshi. Një çast më vonë, si grua, e shpuri mendjen larg, pastaj tha:

— Mos ka ardhur Hektori?

— Kushedi...

Mezani po kalonte përsëri përpëra portës. Po ajo lëvizje e kokës, po ata hapa, të përhumburi. Ç'të ketë, maskarai?

Të nesërmen në mëngjes, kur pas asaj ere të çmendur peizazhi ishte qetësuar më në fund. Qerem Veshi nuk e duronte dot më valën e pafund, të padukshme sa dhe të pareshtur të bisedave për Hektorin.

Mori radion «Iliria» dhe u nis për në lumë. Ishte i ngacmuar, sa kërkoi ndonjë muzikë të qetë.

Po ky, tha me vete kur pa se vinte drejt tij Mezan Nazemi. Mendoi të ngrihej, të linte kapelen mbi radio dhe të hidhej në ujërat e lumit.

Sikur t'i dinte këto, Mezani i foli që atje tej:

— Shko, shko lahu! M'i lër edhe syzet e diellit mua! Kur të vish, flasim.

— Të flasim? Për çfarë do flasim?

— Shko, shko lahu! Të pres unë! Qeshjes së tij të veçantë, karakteristike, të njojur në qytet, nuk mund t'i qëndroje.

Qeremi u vonua sa mundi, notoi sa mend e lanë krahët në lumë, u hapi kot muhabet

dy-tre të tjerëve, po Mezani e priti duke i buzëqeshur.

— Vete nga vete vala, por prapë në breg vjen! — tha duke tundur kokën si qortim për vonesën.

— Pse je munduar? — e pyeti Qerimi.

— T'ia ulim pak zërin radios?

Zëri i Mezanit ishte tepër përkëdhelës.

— Mua nuk më bezdis, — tha tjetri.

— Mbrëmë, pas orës dhjetë, ai doli nga shtëpia. Për një orë e gjysmë shëtiti i vetëm. Ku nuk shkoi. Gjithë rrugicat i shkeli, pëllëmbë për pëllëmbë. Nga lulishtja e vjetër, në parkun e ri, doli në Unazë dhe u kthyë prapë në shtëpi. Nuk ndaloi askund.

— Për kë e ke fjalën? — pyeti Qeremi.

— Për Hektorin, për kë tjetër?

— Erdhi? Kur? — pyeti për të vëllanë.

— E sollën. Ka dy ditë, — qeshi tjetri mbytur.

Dielli ngrohte fort dhe Mezani nuk ishte zhveshur. Djersë nuk lëshonte as edhe një pikë. Kur buzëqeshte pas një kënaqësie të vëçantë, njerëzit vinin re se trapezi i mustaqeve i shndërrohej në katror e më tej akoma në elips, duke thyer të gjitha rrëgullat e gjeometrisë plane.

— I fole ti, Mezan?

— Po përsë t'i flisja?

— E përsë e ndoqe atëherë? Pse i shkove mbrapa?

Mezani qeshi im pak me dhëmbët si kokrra tē bardha orizi. Sikur u skërmit.

— Unë i kam dobësi këta që bien. Ke parë ndonjëherë milingona tē mbetura midis dy rrjedhave uji? Venë andej, ujë, vijnë këtej, prapë ujë, gjersa lodhen, lodhen, shushaten. Atëherë kur kanë humbur çdo shpresë shpëtimi, provo t'u zgjatësh një fije kashtë dhe milingonat fillojnë përsëri tē shpresojnë.

Qen, qen, mendonte përsëri tē Qerem Veshi. Nuk ndiente asnjë mundësi për t'i kundërvënë diçka kësaj kënaqësie tē tjetrit. Një njeri që s'di përsë i solli ndër mend korbat që ndjezin kërmat.

Po Hektori është im vëlla, mendoi befas.

— Unë kam edhe kureshtjen tjefër: ku do tē trokasë? Kush do ta thérresë? Ku do tē strehohet?

— Ai nuk është ilegal.

Qeremi ishte prishur në fytyrë. Mezani sikur edhe përkëtë ndiente kënaqësi.

— Kot po më zemërohesh. Ne po flisnim në përgjithësi, jo për Hektorin. Po këto punë këshfu janë. Karrierat, sidomos ato tē shpejtat, si e Hektorit tonë, duket sikur janë tē lehta. Të vjen e mira te dera. Merrmë, tē thotë. E tē shtrohen përparrë shkallë tē pafundme, tē parnumërueshme. Ngjitu sa tē duash! Po pikërisht te kjo lehtësi në dukje fshihet çdo shkallë rënjeje. Mjerë ai që mashtrohet!

Atëherë çdo gjë bëhet sa tē hapësh e tē mbyllësh sytë. Rënia nuk ndodh shkallë pas

shkalle, si ngjitja, jo. Gjendet gjithnjë dikush, një njeri i zellshëm, që heq shkallën e fundit. Rënia pas ngjitjes së shpejtë quhet rrokullisje, Qerem.

— Korb! Qen! — tha Qeremi me zë.

— Ju s'keni pasur asnjë të mirë prej tij. — po thoshte Mezan Nazemi duke lëvizur duart e tij të shkurtra. — Asnjë privilegj s'ju ka bërë. Edhe kur erdhi këtu, te ju s'u kthye. Edhe në varrimin e nënës suaj ai...

— Ik! Dëgjon? Ik! — i bërtiti, pa duruar dot më tjetri.

— Qenke i paduruar!

Qeremi s'po kuptonte dot ç'duhej të duronte më tepër sipas Mezanit.

— Hektori erdhi dy herë përpara portës sate. U afrua te porta, po nuk i ra ziles. U kthye pas dhe iku. E dinte se ti nuk do ta pranoje.

Qeremi do të donte ta shante, e më tepër akoma, ta pështynte mu në mes të trapezit të mustaqeve.

— Ai nuk ju ka begenisur kurrë ju, unë e di mirë këtë, po hajde mbushu mendjen njerëzve të tjerë. Vëllai vëlla mbetet, gjaku...

— Largohu, djall! — bërtiti Qerem Veshi duke mbushur duart me rërë.

E ndoqi me sy të çakërryer këtë qenie të lemerishme, këtë individ ndoshta të fundit të grupit të vet që, çuditërisht pse, ende nuk ishte zhdukur.

Si ata ujqt që shfaqen rrallë në rrugët përmes hapësirave të shpyllézuara e të kultivuara, me kohë, ky njeri sikur rronte vetëm me ankthin e andrallat që u krijonte të tjerëve.

XXXVII

— Sikur të të dërgojmë në sektorin ku ke punuar më përpara... — e pyeti shefja e kuadrit duke hequr syzet me xhamar plus, si për ta bindur se ajo po e vështronë me përmasat reale të tij.

— Po mirë, — tha ai duke pritur tej sportit në portën e brendshme me shufra hekuri.

— Nuk kemi ndonjë orientim konkret ku të të dërgojmë, prandaj po të pyes, jo për gjë tjetër.

Tjetri nuk bëri zë. Unë nuk thashë gjë! u duk sikur thoshte.

Tërhoqi shkresat, i rregulloi dhe lëshoi një «mirupafshim».

Në zyrën e instruktimit e pyetën ç'punë kishte bërë. «Mekanik», tha duke kujtuar njëqind herë veten se mos padashur thoshte se kishte qenë edhe kryetar i bashkimeve profesionale, edhe... Po budallallëkun më të madh ulëritës do ta bënte sikur të thoshte aty se kishte punuar minator. Kjo do të ishte një herë e mirë shkattereduese.

— Minator s'paskeni punuar? — pyeti dikush.

— Jo, jo! — u përgjigj Hektor Veshi.

— Asnjë ditë?! — ngulmoi, tjetri.

— Asnjë.

— Do të keni rast, besoj, të punoni tani! — tha tjetri aq korrekt në dëshirën për humor.

E po ç'të bëjmë, për pak u përgjigj Hektori, po më vonë tha me vete që kishte bërë shumë mirë që kishte heshtur. Tani do të mësohesh, duhet, edhe me gjëra që nuk të pëlqeijnë, i tha vetes.

Në pasqyrë, pasi veshi kominoeshet e nëntokës, pa një kopje të ngjallur, si të qullosur, të Hektorit të dikurshëm.

Çdo gjë ishte përbysur, dhe ai, çuditërisht, po i bindej, po e pranonte këtë shpërbërje.

Pas disa lëvizjeve të vogla, siç ishin mbërthimi i pullave, palosja e peceve dhe veshja e çizimeve (ah, çizmet!), zgjerimi i rrëthit të kapeles sipas numrit të kokës (kokë e madhe unë!), iu duk se po i merrej pak fryma. Sikur tërë këto ditë të kishte vrapuar deri këtu.

Dikur, atëherë kur dhënen e dorës së tij të butë e të bardhë ai e quante privilegj, dhe kur në ndonjë moment të rrallë pati çuar mendjen te një rënie e mundshme, kishte besuar se, nëse një ditë kjo mundësi do kthehej në realitet, ai, si konstrukt, të paktën, do të thërrmohej.

Tani që për shkaqe dhe arsy... (ah, léri arsyet, pavarësisht prej tyre!), kjo kishte ndodhur, ai prapë mbeti vital, të paktën si konstrukt.

Se, në fund të fundit, ç'bëra? Gjithnjë ka

pasur njerëz që synojnë dhe që dështojnë.

Të nesërmen në mëngjes u nis për në minierë. I ra shkurt kodrave. Andej nga kishte udhëtar me Mirjanën dikur.

E quajti të vështirë të udhëtonte me makinën e minatorëve. Qoftë edhe padashur do ta fshikte ndonjë bisht e qeshure.

Këtyre kodrave vravonte kur ishte djalë.

Rrugës, atëherë, takonte shpesh Nebi Arenin, që vinte nga fshati. Më shpesh e arrinte dhe e linte mbrapa. Ndonjëherë e arrinte dhe ecte me të. Punëtorët janë njëlloj të gjithë, por, prapë, po të klasifikoheshin ata të sektorit të Nebrit, ky do rreshtohej i fundit.

Edhe pse sot po ecte me hap, po e arrinte Nebi Arenin. Njëzet-tridhjetë hapa përparrë. Ta arrij apo jo? T'i flas? Të mos e arrinte, do të vonohej, ta arrinte, pa dyshim që do t'i fliste. Po a do të më përgjigjet? — pyeti veten i kapurngushtë nga kjo pyetje.

Edhe pse jakën e kominosheve ai mund ta ketë ende të papastër, Nebiu me të drejtë mund të mos begenisë të ma kthejë njatjetën, mendoi.

Vendosi ta arrinte, ta kalonte e të mos i fliste. I nxitoi hapat.

Tjetri ecte po me ata hapa si para shumë vjetësh. As që po reagonte ndaj hapave që po e arrinin. Me siguri më ka parë, mendoi Hektori.

Pa e kontrolluar veten, sikur nuk ishte ai që sapo vendosi të mos i fliste, kur doli në krah

të Nebiut, gati instinktivisht, meqë u panë në sy për një çast, Hektor Veshi i foli.

— Njatjeta, Nebi!

— Hajde lipsu! Shiko udhën tënde ti, dëgjove? Shiko halenë tënde!

Nebiu tha këto dhe uli vështrimin tek hidhte këmbët. Vetullat e trasha e të rënda as që i tundeshin fare.

Pas kthimit këtu, (e dinte Hektor Veshi), do t'i ndodhët të fërkohej, të grindej e të fyhej, të mos e përfillnin njerëz gjithfarësh e në secilin rast, ndoshta, do t'i duhej të ulte kokën, të mbli-dhej e të rrëgjohej si ai molusku kur ndien lë-vizje të dyshimta në ujin ku noton.

Në fund të fundit, mëria e Nebiut është një paralajmërim për atë që ndoshta do të duhet ta presësh nga të tjerët, këshilloi veten duke nxituar përpara tjetrit.

Nga maja e kodrës që po zbriste, njerëzit atje poshtë iu dukën si miza, të vegjël, me lëvizje rrëgjake. Dikush, Kozmai, ndoshta, këndonte «moj e mira, të marrtë e mira», te fusha e shkarkimit dëgjohej zhurma angullitëse e arganellos që nxirrte vagonët e ndërresës së natës, kurse, në kovaçhanën e Nasho Kiços çekani godiste rreptë mbi hekurin e përskuqur të thikave të çekiçeve rrëzues.

Duke iu afruar kësaj rropullie, kësaj lëvizjeje si të çmendur, vuri re se, ndërsa njerëzit e gjithçka po rritheshin në sytë e tij, po merrnin përmasa reale, ai vetë po zvogëlohej.

Kur u afrua edhé më, ata e ndien. Disa koka u kthyen dhe e panë, secila në mënyrën e vet, po në një çast, u ulën njëherësh.

Uli kokën edhe Hektor Veshi, dhe aty, përpara këmbëve të tij, dalloi hijen e vet. Kjo dihet, tha me vete, hijen do ta kem gjithnjë me vete.

Dielli e rrihte nga prapa. Ah, e shkuara ime, tha pothuaj i djersitur.

XXXVIII

— Fiks shtatë. Është mësuar me orar zyrtar,

— tha njëri prej punëtorëve.

— Ç'e do se... zyrën s'po e gjen dot!

— Çojeni te gryka e galerisë! — tha prapë zëri i parë, duke e gjallëruar gjendjen.

— Lëreni njeriun të rrojë në hallin e vet!

— tha Velo Mersini tek ngiste sharrën e drurit.

Veloja mbante kapele meshini, nga ato të vjetrat; nuk i duronte dot kapelet prej kauçuku.

Thinjat, në flokët e qethur gjithnjë shkurt, sikur e shtonin edhe më detyrimin për ta dëgjuar.

Velo Mersini u ngrit, la *sharrën* mënjanë dhe me limë në dorë u drejtua nga vendi ku qëndroi Hektor Veshi.

— Erdhe, o Hektor, ë? — pyeti me zë të ulët, por që u dëgjuan gjer atje tej.

S'e harroi dot bukën e vjetër! — ia priti njëri nga ata, sikur kërkonte të mos e zgjatnin me këto sjellje të buta.

Velo Mersini ktheu kokën qortues andej.
«Mosni, more, mosni, q'bëni kështu?!»

Hektori dukej si një fëmijë i kapur në faj,
që rri e dëgjon qortimet e të tjerëve.

Atë që po ndodhët, jo se nuk e kishte pritur,
jo se nuk pati menduar që mund të zhvillohej kjo lloj ceremonie. Por prapë sikur s'po merrte ato përmasa që pati përfytyruar ai.

Po prit, prit, i tha vetes. Nuk përbëhet vetëm nga kjo orë, as nga kjo ditë, pritja jote! Do të vazhdojë gjatë ajo!

Punëtorët po hynin në barakën e pesëminutëshit.

Një nga një po i linin vetëm ata të dy, Velon dhe Hektor Veshin, aty ku ishin.

— Me këmbë i bëre punët, jo me dorë! — i tha minatori duke u ngritur.

U nis pastaj, avash-avash, për të ikur.

— Jemi ca të duruar ne, por edhe të ashpër jemi, a... Malin mbi supe e mbajmë, po jo kësh-
tu, jo si e bëre ti! Po të na e kenë me hile,
fijen e flokut e ndiejmë tepër e na rëndon. E
ti jo kaq, por gurë na ke hedhur!

Për disa minuta mbeti aty në këmbë, pa bërë dot për andej nga e thërritnin.

— Megjithatë ul kokën e puno. Përpiku të rrrosh edhe ndryshe njëherë, ku i dihet. Mbësë këtu e ke pasur të mirën tënde. Mbësë kot vajte e u ngatërrrove me ca punë që mië shumë i djallose...!

Hektor Veshi ishte ngritur në këmbë edhe ai,
Ishte gati t'i shkonte prapa.

— Ulu e rri! Prit këtu! Atje mos hajde! —
i tha minatori, duke treguar barakën e pesëminutëshit.

Në ato çaste dukej sikur këshillonte një fëmijë që kishte ngacmuar folenë e bletëve, t'i largohej asaj.

Velo Mersini bëri për andej nga e prisnin.

Kur po hynte brenda, që andej erdhi zëri i dikujt që po thoshte disa herë radhazi: «Ej, kemi harruar të deleguarin jashtë! Kemi harruar të deleguarin jashtë!»

E qeshura erdhi e mbytur gjer tek rrinte ulur Hektor Veshi.

Eshtë mirë të ngrihem e të largohem ca, mendoi, se duket sikur po i përgjoj. Edhe për mua mbapse s'është mirë të dëgjoj të gjitha ato që mund të thonë.

XXXIX

«Kjo ndoshta do të mbetet dita më e gjatë
në jetën time, tha me vete kur i pa të dilnin
pas pak nga baraka e pesëminutëshit.

Dhe përgatitu, dëgjove, i tha vetes, përgatitu
të dëgjosh edhe të tjera!

Iu duk se, kur po dilnin, grupe-grupe, po
flisnin për të e madje po vinin drejt tij.

— Mos ki keq sot, ti, Velo, se t'i dhanë dy
ndihmës, — tha dikush me zë të lartë.

Njëri jam unë, mendoi Hektor Veshi, po tje-

tri, kush është? Për disa ditë nuk do t'i kërkonin realizim norme, siç bëhej me të gjithë ata që vinin rishtas në minierë. Si punëtor i ri!

Kur Velo Mersini u duk të hyrja e barakës, Hektor Veshi shkoi për andej, por pa u nxituar.

— Hajde edhe ti, beqar! — i tha dikujt benda barakës Veloja.

Që andej doli Nebi Arëni. I dyti qenka Nebiu, mendoi Hektori.

Bëri pas tyre, nga kavaletat e druve.

— Me ne do të punojë ai? — pyeti Nebiu, po Veloja nuk ia vari fare.

— Të kanë dhënë ndihmës kryetarin, o Velo! — tha Hektor Veshi për veten.

— Kryetar jam unë këtu. Ti ngri atë shtyllën e pishës, atë bëj. — Nuk po bënte aspak shaka.

Hektor Veshi u gjend fare i pambrojtur. Tjetri kishte bërë një ngecje të mençur.

Po ky m'u duk se më mbrojti qëparë, tha me vete për atë.

Shtylla s'ishte e lehtë, por edhe sikur të binte përmbyss nën të, ai nuk kishte ndër mend të qahet.

I afrouan shtyllat që do të përdornin dhe u ulën. Nebiu u ul nga ana tjetër e Velos, madje Hektorit iu duk se e vështronte me një lloj druajtjeje të përzier me frikë.

Kur nisën të përgatitnin shtyllat, në çastet kur nuk punonte sharra apo midis dy gülçeve të

goditjeve me sqepar, Veloja tha dy-tri herë «më mirë të kishe ndenjur këtu, me ne», «të paktën të kishe ndenjur edhe ca më shumë», ose «pse, pak është tu njitesh ditë për ditë galerive?» Në çdo rast Nebiu tundte kokën, sikur të thoshte: «Vëru veshin këtyre që po thotë Velua, ti, more kopaçe e djegur!»

— Hë, de, edhe sharrën ke harruar të heqesh? — i foli Veloja dikur. — Tërhiqe kur ke radhën e mos e shtyj kur e tërheq unë! Hajde, sharrohi bashkë, o Nebo, se ma mori shpirtin!

— Jo, nuk vij! — tha Nebiu.

Velo Mersini e pa me çudi. Nebiu nuk kundërshtonte kurrë. Ç'ishte kjo?

— Më bënë veshët, apo?... — pyeti me zë të ulët Veloja. Kushedi sa herë i qortonte të tjerët kur e tepronin në shakatë me Nebiun, madje «haram e paç», i thosht këtij, «haram, që duron kaq shumë! Po gojën pse e ke ti, po dy duart pse i ke, mor të hëngërt dreqi, të hëngërt». i thoshte. Po Nebiu kurrë nuk zemërohej, kurrë nuk ankohej, me asnjerin nuk grindej, vetëm thoshte «po rri, mor kopaçe e djegur, ç'ke me mua?» dhe kaq.

— Nuk punoj me një sharrë me atë unë, — tha rreptë, duke treguar me gisht nga Hektori.

Velo Mersini qeshi me zë.

Njëzet metra më lart, në breg, po dëgjonte e shihte atë skenë edhe inxhinieri i sektorit.

— Pse, mor qyq, s'punon me tē ti? — e pyeti Nebi Arenin.

— Jo, more vëlla, nuk dua t'i lë fëmijët rrugëve unë, pér kokë tē këtij kopaçes së djegur! — u përgjigj ky.

Sapo ishte ndarë puna, Nebi Areni kishte kapur mënjanë inxhinierin dhe i kishte thënë: «O shoku inxhinier, unë nuk i di mirë këto punë, se pa shkollë jam, por... më thuaj troç mua ti... mos ka rrezik pér mua po tē punoj me atë armikun unë?».

— Mirë bëra që e pyeta! — shtoi akoma Nebiu në sy tē Hektor Veshit. Të tjerët qeshnin. Vetëm Nebiu dhe Hektori s'qeshnin.

— Kopaçja e djegur na bëri me sëkëlldi, — tha Neboja.

Pas kësaj edhe Hektori u detyrua tē qeshte, sado që ishte i qartë në vetvete se këtu, tē paktën pér tē, nuk kishte asgjë zbavitëse ose pér tē qeshur.

— Sidoqoftë ti mos e humb vigjilencën, Nebo! — tha inxhinieri.

— Po mirë i thashë! Ç'emér tjetër ka ky kopaçja? Inxhinieri më tha që armik s'është, po ç'djall është? Se ky një lloj kake është, po i njomë apo i thatë?!

Duke marrë zemër nga kjo heshtje, Nebiu iu afrua Hektorit dhe i tha ta dëgjonte e t'i jepte përgjigje:

— Ç'bëre pér ne shokët e tu ti, atje ku vajte? Hajde, këtë më thuaj ti mua!

Me sytë që i shkëlqenin nga kënaqësi, vësh-troi nga Veloja. «Mirë e pyeta, ë?»

Hektor Veshi do të donte t'i thoshte diçka, t'i thoshte, për shembull, se q'do të donte ai, Nebi Areni, të bënte «atje ku vajti», apo t'i thoshte se kjo nuk ishte aq e thjeshtë, apo... por të gjitha do të ishin pa vend.

— Se mos e la njeri punën, që ne të shpresonim te ky, o Nebo, po ne kërkonim që ky të mos bënte atë që bëri, ja, vetëm kaq kërkonim të bënte për ne ky!

— Po ç'bëri andej ky, o Velo vëllai, se nuk po e marr vesh këtë punë unë, — pyeti Nebi Arseni sikur lypte ndihmë.

— E kush e la të bënte tjetër gjë, po ja, njomi të mbathurat e veta. Ja, këtë bëri.

Nebiu qeshi gjatë pas kësaj. Hektori pas pak e la sharrën.

— Kam dhimbje koke, — tha.

— E nga të mos kesh dhimbje koke, kur nga ti po na dhemb edhe neve koka, — i tha si pa mëshirë Nebiu dhe Hektor Veshit i hipi një inat i verbër. Ndonëse nuk po ndodhë asgjë më tepër se ç'kishte pritur, prapë sikur po i dhimbsej vetja.

Ata nuk më thanë gjë më tepër, tha një çast më vonë me vete, por sesi m'i thanë. Sesi...

Do të duroj, kishte thënë përpëra se të nisej për këtu, po nuk po duronte dot aq lehtë.

— U mërzite apo u lodhe? — dëgjoi zërin e

Velo Mersinit nga prapa. — Apo tē ra nuri ty, zotrote?

— E po kur ka hundë akoma ky kopaçja! — tha menjéherë pas tij Nebi Areni.

XL

— Njeriu s'e lë vetëm kurrë njeriun, — tha tē nesërmen në barakë Velo Mersini.

— Njeriut edhe miu ka qejf t'i rrijë afër, — shtoi, si gjithnjë i ndodhur, Tomi Margiti.

— Mirë e ka Veloja. Jo shkojmë nga shkojmë ne dhe thumin te Hektor Veshi! Ai ka kusuret e veta, — vazhdoi më tej një tjetër, — por edhe ne tē tjerët s'jemi pa gjë. Edhe Hektori ka tē drejtë tē ngrihet e tē na thotë: pse, pse më latë gjer këtu, tē na thotë!

— Pa tē ngrihet e tē na i thotë këto, pa tē shohë! Rri, ore, po s'i ka faj njeri atij. E di vetë që është deri në grykë... Pa tē ma japid një ditë tē punojë me mua! Po nuk ia lidha vagonin prapa shpine, po mos më thënçin Vili Haruni...

— Ti, Harun, rri urtë, se vetëm ti nuk ke gojë tē flasësh pér tē!

— Flas që ç'ke me tē, se i vunë tē ndenjurat majë sa iku nga ne. E kishim përkëdhelur.

— Rakinë e di unë mirë që ia ke çuar ti.

— Raki kam pirë edhe me ty unë.

— Kemi pirë, po në shtëpi nuk më ke sjellë,

se nuk ke pasur pse tē ma sillje. Hektorit i je lëpirë si ato konet. Doje tē ikje edhe ti nga miniera, prandaj.

— Unë më duket se nuk fyeva njeri. — tha Vili Haruni duke kërkuar mbrojtje te tē tjerët.

— E vërteta asnjëherë nuk fyen, — iu përgjigj prerë Toni Margiti. — Dhe boll më me fjalë!

Në tē vërtetë tē gjithë sa ishin aty kishin nevojë për qetësi dhe prehje pas këtij debati tē madh, që përsëriste tē shkuarën në njëjind fytyra.

— Po ç'bëri ky, ë? Pse nuk ma thotë njeri, ç'bëri Hektor Veshi andej, ë? — pyeste xha Sotka tek i shihte tē hutuar, tē zemëruar e tē heshtur.

— Rri urtë edhe ti! Më mirë që nuk ke veshë! — i thanë, por ai ngulte këmbë. Pyeste dikë tjetër.

— Hajde, thuaja xha Sotkës, thuaja! Ç'bëri ky djalli ynë atje lart?

— Turpëroi veten! — i tha Sabri Vela, i dehur prapë.

— Vetëm kaq? Po mirë t'i bëhet!

— Po do thonë se hëpërhë karrigia i merr në qafë punëtorët!

— Si, si the, or djalë?

— Lëri tē punojnë minatorët, do thonë. Atë dinë tē bëjnë ata. Të punojnë dhe tē pinë!

— E po edhe do thonë. Gjithnjë kanë thënë.

— E, mirë, mirë, kë dua të sqaroj unë! — tha tjetri duke e lënë të çuditur xha Sotkën.

— Kot që rroj, kot, — përsëriti ky monologun e njojur. — Ç'e do veteń trung. Pa veshë, pa... Kot që rroj!

XXXXI

Thonë se po afrohen përsëri, tha dikush, kur Mirjana Leloja hyri në llambisteri.

E po kanë qenë kaq vjet në një shtrat, or vëlla. Kollaj është ta lësh duhanin? Jo. E pra, më lehtë lihet duhani se gruaja!

Ku e di unë se si u vete filli ca punëve? Edhe ai kaq vjet qëndroi me ne këtu në minierë, por iku dhe... ku ju kam parë na tha. S'na hyn më në zemër ai neve, sikur edhe në kurriz të na mbajë gjithë ditën e gjithë natën!

Ngjajnë vërtet, tha me vete Gani Elezi. Hektor Veshi iu duk si një aktor që në të njëjtën skenë luan dy drama, dy role të ngjashme aq shumë me njëri-tjetrin. E ka dashur atë grua aq, sa ka dashur me të vërtetë punën. Nga ajo grua dhe nga minatorët ishte larguar tinëz, pa e deklaruar ndarjen. Dhe në fund është i detyruar të kthehet te të dy.

— Ngjajnë kaq shumë, — tha prapë Gani Elezi, këtë radhë me zë. — Po nuk janë njëlloj të dyja rastet! Ajo mund ta falë më lehtë, — tha për Mirjanën. — Kurse ne...

Kush ne, pyeti veten, kush ne? Cili hyn në këtë fjalë? Edhe unë?

— Ne, minatorët, tha pastaj.

Këtu është e pamundur të veçohesh.

— Do të mësohesh edhe ti, — i tha Hektorit.

— Vërtet e ke?

— Kam shkak përse! — Gani Elezi bëri sikur nuk e vuri re ironinë e tjetrit. — Shumë kush çuditet kur dëgjon se galerinë e mban, veç armaturës, edhe fryma e njeriut, por ja që është e vërtetë, se avaritë e shembjet në minierë ndodhin më tepër të dielave, ditët e pushimit.

— Po më tregon kuriozitetë?!

— Pse, ke ndër mend të largohesh prapë nga miniera?!

— Dhe të kanë ngarkuar ty me këtë punë?! Ja ku po ta them se mua më janë mërzitur téré ato fjalë që ty dhe të tjerëve ju duken optimiste!

— Ngaqë vetë i ke përdorur keq!

— Mbase! Por dëgjomë edhe pak!

— Vetëm mos u bëj qaraman, — i tha Gani Elezi duke ia hedhur dritën e llambës syve.

— Si ti, punëtor i dalluar, unë nuk bëhem dot!

Hektor Veshi po tallej. Po le të tallej. Ai ishte njeri me plagë të re. Ajo i dhimbte dhe, kur ka dhimbje të tillë, njeriut s'i hyn gjë në sy. I dinte mirë këto gjëra Gani Elezi. Kishte qenë edhe vetë dikur me plagë të re.

Nuk kërkova të punoja me ty që të të bëj punëtor të dalluar, — i tha Hektorit, — por që të mos shtiresh më tej.

— S'di të kem qenë kurrë i tillë!

— S'ke qenë, por je hequr si punëtor. Je nisur për andej si punëtor dhe këta të kanë besuar, siç i besojnë vetes.

Zëri i Gani Elezit hahej me veten. Po t'i dëgjonte dikush tjeter, aty në errësirën e galerisë, do të besonte se ai duhej të ishte i fyter prej tjetrit. I copëtonte fjalitë, i ndante padashur dhe, pa mundur t'i nxirrte të plota, i bënte ato më të ashpra.

Llambat e të dyve e përplasnin tubin e drithës përdhe, kërlesheshin me njëra-tjetrën, zhvendoseshin.

— Ti i zhgënjeve. Se kurrë nuk ke qenë punëtorë në thelb. E ke pasur punën detyrim, nuk mund ta respektoje atë dhe njerëzit e saj. I zhgënjeve, dhe ti e di, është fjala për njerëz që edhe diellin edhe ajrin s'i kanë me të tepërt.

— Sipas teje unë duhet të gjej ndonjë galeri pa rrugëdalje dhe të mbetem aty?

— S'e bën dot këtë ti, jo, por ata duhet ta marrin vesh sa më shpejt se ti ke qenë si ajo veza që lë qyqja në folënë e bilbilave. Ata të ngrohën, ti çave lëvozhgën dhe vetëm atëherë u pe c'ishe.

Hektor Veshi nuk po ndihej fare, po tjetri e dinte se kjo s'do të thoshte se i jepte të drejtë.

— Këto gjëra i di mirë ti tani, — tha Hektori dhe Ganiu ua rroku në çast ku goditnin.

— E ke radhën ti për t'i mësuar! — u përgjigj po në atë mënyrë Ganiu. — Dhe s'e ke të lehtë, ta dish. Nëse nuk të deshën dot ata, kush mund të të dojë tjetër? I ke zhgënjer dhe këto zhgënje janë borxhe të përjetshme!

Zëri i Gani Elezit u ashpersua kur nxori këto fjalë. Po sytë u bënë të qeshur e të mençur prej mirësisë.

— Ai që ka kaluar më parë rrugën tënde, ka të drejtë të të shesë pak mend, apo jo, — tha pastaj.

Nga andej tutje po afrohej një llambë. Di-kush po vinte.

— Ikim? — tha Hektor Veshi. — Është më mirë mos të të shohin kokë më kokë me mua.

Tjetri nuk lëvizi. Është punë e madhe të mos kesh frikë nga njerëzit, tha me vete.

Drita e llambës që po afrohej, humbi për disa caste. Siç dukej, ai që vinte po ecte në terr duke u orientuar sipas dy llambave që shihte përrapa. Ose nuk po lëvizte fare. Por u dëgjuan hapat, llapashitja e çizmeve në pellgjet midis shinave dhe, kur po arrinte te Ganiu dhe Hektori, drita e llambës u ndez. Fasha e saj u ngrit, tregoi fytyrat e të dyve, pastaj të të tretit, atij që kishte ardhur, Mezan Nazemit.

— E! Të dy bashkë ju, ë?! — tha ai, si në ngërc, dhe vazhdoi të ecte, mes errësirës, si i verbër.

XLII

— E more yesh? Kishin dalë së bashku mbrëmë.

— E përse çuditesh?

— Si përse?! Gjithçka mund të prisja, por që të duheshin vërsëri ata të dy... kurrë!

Tjetri nuk foli. Edhe ai kështu pati menduar. Edhe tani ishte i sigurt se po t'i e cte edhe më tei. Hektor Veshi mbasë s'do të ishte kuituar kurrë për këtë grua.

Kaq kohë të harruar dhe asniëri vrei tvré s'ishte kujtar të bënte ndarjen zyrtare. Sikur ka aenë e thënë të mbeten bashkë. Por edhe ajo, c'grua e çuditshme!

— Prapë unë nuk mund të besoi se ata do të arrijnë ta duan niéri-tjetrin! — tha pas pak i pari. — Pas fyerieve të tillë, të shpallura, sic ishte largimi i Hektorit, ndarja bëhet e paevitueshme. Madje, sado është ajo prish një lidhje, pravë sado është ajo shkatërron dicka, prapë ajo merr edhe hiieshinë e një veprimi madhor! Kur dëgjova se ishin parë të dilnin të dy bashkë, sepse besova se do të shkonin në zyrën e gjendjes civile. S'e marr vesh...

— Ti gjykoni nga iashtë, prandai. — kundërshtonte tjetri. — Nuk është krejt ashtu. Ata mbasë vërtet janë ndarë dje, mbasë... po prapë...

— Po si mund të bashkëjetojnë ata, si? Ai do të torturohet nga pamundësia për të shpjeguar kohën e ftohjes, edhe sikur pas kësaj t'i kushto-

het kësaj gruaje. Kurse ajo do të harxhonte kushti sa qindra tableta valiumi për të fjetur e qetë pranë atij që e largoi aq ftohtë dikur. Proçka! S'e kuptoj si thua ti, pas kësaj, se ata prapë mund të dashurohen!

Tjetri buzëqeshi si i zënë në mendim të turpshëm.

— Unë nuk thashë që ata doemos do të dashurohen, — tha pastaj. — Asnjëri prej tyre nuk do ta kërkojë një gjë të tillë. Një bashkëjetesë si e tyrja mjaftohet edhe me një mirëkuptim të vogël, më një ngrohtësi familjare që mund të quhet «dashuri e përditshme»! Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, ose «dashurie ditore», të dyja palët heshturazi, merren vesh që asnjëri të mos kërkojë arsyet dhe shkaqet e ftohjes së dikurshme. Atyre tanimë nuk u duhet cili ishte fajtori, apo si duhet ndëshkuar ai. Përkundrazi, secili prej tyre do të përpinqet t'ia lehtësojë tjetrit arritjen e kësaj mpirjeje të kujtesës për të shkuarën. Fillimi do të lodhen ca, nuk është e lehtë, por ja që u duhet, është metoda e vetme rregulluese, e domosdoshme për simbiozën e mëtejshme.

E P I L O G

Eshtë një orë fare e përshtatshme, e pritur për një kohë të gjatë: pothuaj muzg. Qetësinë e thyen vetëm rrahja e krahëve të një zogu, Kthetrat e tij më në fund kapen në degën e një peme, pranë një foleje.

Nuk është foleja e tij, është e një zogu tjetër, e një zogu të bukur. Në fole janë vetëm vezët. Zogu i bukur ka flutuar për diku tjetër.

Këtë ka pritur vizitori i muzgut, ikjen e zogut të bukur. Punë për të ku ka shkuar, mjaft që nuk është në fole.

Zogu i muzgut sikur nuk nxitohet t'i kryejë ato punë për të cilat ka ardhur: I numëron mirë vezët e folesë, i numëron përsëri, siç dinë të numërojnë zogjtë e muzgut, pastaj e merr njërrën prej tyre dhe e flak tutje, sa më larg. Nga pendët e tij të errëta nxjerr një vezë tjetër, e përkund edhe pak nëpër to, se e ka vezën e vet atë, e krahason për një çast me ato të folesë dhe i kënaqur e vendos midis tyre.

Këlthet edhe një herë i kënaqur dhe u jep rrugë krahëve të tij.

Punë për të ku ka shkuar, thotë edhe një herë, përqeshës për zogun e bukur. Dhe për të

ardhur le të vijë kur të dojë, se në shtëpinë e tij do të vijë.

Sa pér vete, ulet në një degë tjetër, të një peme gjethedendur aty pérballë. Mbérthehet mirë aty dhe pret. Unë kam nam të keq, thotë po aq me humor pér veten. Sikur përtokam të rrit e të ngroh vezët e zogjve të mi! Ke pér të mbetur qyqar, më thonë të tjerët, duke i besuar ende asaj legjende të krijuar nga unë. Po mirë, de, mirë, qyqar le të mbetem! Shtohuni e shumohuni ju pér mua!

Në muzgun e nxirë edhe më, ndihet fluturimi i nxituar i një zogu tjetër; natyrisht që është zogu i bukur. Kapërthen vërtik degën pranë folesë së tij, hedh një vështrim krakaritës brenda folesë, pastaj edhe më të hollësishëm, bindet që aty nuk mungon as edhe një nga vezët, pra që nuk ka ndodhur asgjë me zogjtë e tij të ardhmë, bën edhe një fluturim qetësues pérreth pemës, këlthet edhe ai gëzueshëm, vetëm pér vëten e tij dhe ulet në fole. Sa më shumë ngrohtësi pér të vegjlit e mi, i thotë vetes, sa më shumë!

Pas pak i zë veshi një si pérplasje të fshehur krahësh, sikur një zog tjetër, a kushedi, largohej pér diku. Secili ka jetën e vet, mendon zogu i bukur, secili ka gëzimet e hidhërimet e veta, pavarësisht prej të tjerëve.

Gëzimi im është që të rrit këta vogëlushi, që akoma më fshihen si me turp brenda lëvozhgës së vezëve.

PËRMBAJTJA

Letra për të dashurën e tjetrit	3
Gruaja e Zimes	12
Nata e ditëlindjes	22
Ai me çizme të grisura	33
Versioni më komod	44
Nëpunës të zyrës së vulës	61
Të paguarit e heshtjes	70
Reizi pa mbiemër	83
Nesër më dhjetë e gjysmë	97
Thonjtë e maceve që më përkëdheleshin	105
Përpjekje për të rregulluar humorin	121
Ata thonë vetëm të vërteta	131
Marrëveshje për të jetuar	143
Jeton njeriu sidoqoftë	157
Rrugës, në të kundërt	173

U shoheshin nga shqipja me 26 Dhjetor 1980
Doli nga shqipja me 26 Nëntor 1980

Thessaloniki 1980 - Fotoniti DEXTERA Gjatë 25.04.88
KOMBINATI POLITIGRAFIK - Spikalaprintesa e Re
Tirana - 1980